# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria-Vlada-Government*

# PROJEKTLIGJI PËR SHOQËRITË TREGTARE[1]

# DRAFT LAW ON BUSINESS ORGANIZATIONS[2]

# NACRT ZAKONA O POSLOVNIM DRUŠTVIMA[3]

[1] Projektligji per Shoqerite Tregtare, eshte aprovuar ne mbledhjen e 09 te Qeverise se Kosoves, me Vendimin nr. 11/09, date 20.10.2017
[2] Draft Law on Business Organizations, was approved on 09 meeting of the Government of Kosovo, with the decision no. 11/09, date 20.10.2017
[3] Nacrt Zakona o Poslovnim Drustvima, usvojen je na 09 sednicu Vlade Kosova, sa odlukom br. 11/09, datum 20.10.2017

| | | |
|---|---|---|
| Kuvendi i Republikës së Kosovës, | The Assembly of Republic of Kosovo, | Skupština Republike Kosova, |
| Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, | Based on Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo, | Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo, |
| Miraton: | Approves: | Usvaja: |
| **LIGJ PËR SHOQËRITË TREGTARE** | **LAW ON BUSINESS ORGANIZATIONS** | **ZAKONA O POSLOVNIM DRUŠTVIMA** |
| **PJESA E PARË<br>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME** | **PART ONE<br>GENERAL PROVISIONS** | **PRVI DEO<br>OPŠTE ODREDBE** |
| **Neni 1<br>Qëllimi** | **Article 1<br>Purpose** | **Član 1<br>Svrha** |
| 1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i: | 1. The purpose of the present Law is to specify: | 1. Svrha ovog Zakona je da utvrdi: |
| 1.1. llojeve të shoqërive tregtare përmes së cilave mund të zhvillohen veprimtaritë ekonomike në Kosovë; | 1.1. the types of Business Organization through which Business Activity may be conducted in Kosovo; | 1.1.vrste poslovnih društava preko kojih se može obavljati poslovna delatnost na Kosovu; |
| 1.2. subjekteve të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës; | 1.2. other entities required to register with the Kosovo Business Registration Agency; | 1.2.druge subjekte za koje se zahteva upis u Kosovsku Agenciju za registraciju preduzeća; |
| 1.3. organizimit, kompetencave dhe funksioneve të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës; | 1.3. the organization, competencies and functions of the Kosovo Business Registration Agency; | 1.3.organizaciju, nadležnosti i funkcije Kosovske Agencije za registraciju preduzeća; |
| 1.4. kërkesave, kushteve dhe | 1.4. the requirements, conditions and | 1.4.zahteve, uslove i procedure |

| | | |
|---|---|---|
| procedurave të regjistrimit dhe çregjistrimit, për secilin lloj të shoqërive tregtare;<br><br>1.5. organizimit të shoqërive tregtare; dhe<br><br>1.6. të drejtave dhe detyrimeve të aksionarëve, Përfaqësuesve të Autorizuar, pronarëve, drejtorëve, menaxherëve, dhe palëve të treta në lidhje me Shoqëritë Tregtare.<br><br>2. Ky ligj është plotësisht në përputhje me:<br><br>2.1. Direktivën 2009/101/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 16 shtator 2009 për bashkërendimin e masave mbrojtëse të cilat kërkohen, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe palëve të treta, nga shtetet anëtare të kompanive në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 48 të Traktatit, me pikëpamjen që këto masa mbrojtëse të bëhen të barasvlershme;<br><br>2.2. Direktivën e njëmbëdhjetë të Këshillit 89/666/EEC, të datës 21 dhjetor 1989 lidhur me kërkesat për zbulim sa i përket degëve të hapura në një Shtet Anëtar nga lloje të caktuara kompanish të rregulluara me ligj të një Shteti tjetër; | procedures of registration and deregistration of each type of Business Organization;<br><br>1.5. the organization of Business Organizations; and<br><br>1.6. the rights and obligations of Shareholders, Authorized Representatives, owners, directors, managers, and third parties in relation to Business Organizations.<br><br>2. This Law is in fullcompliance with:<br><br>2.1. Directive 2009/101/EC of the European Parliamentand of the Council of 16 September 2009on coordination of safeguards which, for the protection of the interests of members and thirdparties, are required by Member States of companies within the meaning of the second paragraph ofArticle 48 of the Treaty, with a view to making such safeguards equivalent;<br><br>2.2. Eleventh Council Directive 89/666/EEC, of 21 December 1989, concerning disclosure requirements in respect of branches opened in a Member State by certain types of company governed by the law of another State (89/666/EEC); | registracije i brisanja za svaku vrstu poslovnog društva;<br><br>1.5.organizaciju poslovnih društava, i<br><br>1.6.prava i obaveze deoničara, ovlašćenih predstavnika, vlasnika, direktora, menadžera i trećih strana povezanih sa poslovnim društvima.<br><br>2. Ovaj zakon je u potpunosti u skladu sa:<br><br>2.1. Direktivom 2009/101/EK Evropskog Parlamenta i Saveta od 16. septembra 2009 o usklađivanju zaštitnih mera koje, radi zaštite interesa članova i trećih strana, Države Članice zahtevaju od preduzeća u smislu drugog stava člana 48 Ugovora, u cilju izjednačavanja takvih zaštitnih mera;<br><br>2.2. Jedanaestom direktivom Veća 89/666/EECod 21. decembra 1989. o zahtevima objavljivanja podataka u vezi s podružnicama koje su u nekoj državi članici otvorile određene vrste trgovačkih društava na koje se primenjuje pravo druge države |

| | | |
|---|---|---|
| 2.3. Direktivën 2011/35 / EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 5 prill të vitit 2011 në lidhje me bashkimet e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar; | 2.3.Directive 2011/35/EU of the European Parliamentand of the Councilof 5 April 2011concerning mergers of public limited liability companies; | 2.3. Direktivom 2011/35/EU Evropskog parlamenta i Većaod 5. aprila 2011. o spajanjima javnih društava sa ograničenom odgovornošću; |
| 2.4. Direktivën e gjashtë të Këshillit 82/891/EEC, të datës 17 dhjetor 1982, bazuar në nenin 54 (3) (g) të Traktatit, sa i përket ndarjes së shoqërive tregtare publike me përgjegjësi të kufizuar, këtu e tutje direktiva 82/891/EEC; | 2.4.Sixth Council Directive 82/891/EECof 17 December 1982 based on Article 54 (3) (g) of the Treaty, concerning the division of public limited liability companies, hereinafter directive 82/891/EEC; | 2.4. Šestom direktivom Veća 82/891/EECod 17. decembra 1982. na temelju člana 54. stava 3 tačke (g) Ugovora, koja se odnosi na deobu poslovnih društava sa ograničenom odgovornošću, u daljem tekstu Direktiva 82/891/EEC; |
| 2.5. Direktivën 2005/56/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 26 tetor 2005 për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar; | 2.5.Directive 2005/56/ECof the European Parliamentand of the Council of 26 October 2005 on cross-border mergers of limited liability companies; | 2.5. Direktivom 2006/56/EC Evropskog parlamenta i Veća od 26. oktobra 2005. o prekograničnim spajanjima poslovnih društava sa ograničenom odgovornošću; |
| 2.6. Direktivën 2012/17/EU të Parlamentit dhe të Këshillit, të datës 13 qershor 2012, për ndryshim dhe plotësimin e Direktivës së Këshillit 89/666/EEC dhe Direktivave 2005/56/EC dhe 2009/101/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit sa i përket ndërlidhjes së regjistrave qendror, komercial dhe të shoqërive tregtare. | 2.6. Directive 2012/17/EU of the European Parliament and of the Council of 13 June 2012 amending Council Directive 89/666/EEC and Directives 2005/56/EC and 2009/101/EC of the European Parliament and of the Council as regards the interconnection of central, commercial and companies registers. | 2.6. Direktivom 2012/17/EU Evropskog parlamenta i Veća od 13. juna 2012. o izmeni i dopuni Direktive Veća 89/666/EECi direktiva 2005/56/EC i 2009/101/EC Evropskog parlamenta i Veća u vezi s povezivanjem centralnih registara, trgovačkih registara i registara trgovačkih društava. |
| 3. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2012/30/EU të Parlamentit | 3. This Law is partially in compliance with Directive 2012/30/EU of the European | 3. Ovaj zakon je delimično u skladu sa Direktivom 2012/30/EU Evropskog |

| | | |
|---|---|---|
| Evropian dhe të Këshillit, të datës 25 tetor 2012, për bashkërendimin e masave mbrojtëse të cilat kërkohen, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, nga Shtetet Anëtare të kompanive në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 54 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, sa i përket formimit të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me pikëpamjen që këto masa mbrojtëse të bëhen të barasvlershme; | Parliament and the Council, of 25 October 2012on coordination of safeguards which, for the protection of the interests of members and others, are required by Member States of companies within the meaning of the second paragraph of Article 54 of the Treaty on the Functioning of the European Union, in respect of the formation of public limited liability companies and the maintenance and alteration of their capital, with a view to making such safeguards equivalent. | parlamenta i Veća od 25. oktobra 2012. o usklađivanju zaštitnih mehanizama koje, radi zaštite interesa članova i trećih osoba, države članice zahtevaju od trgovačkih društava u smislu člana 54. drugog stava Ugovora o funkcioniranju Evropske unije, u pogledu osnivanja društava sa ograničenim odgovornostima i održavanja i promene njihovog kapitala, a u cilju ujednačavanja tih zaštitnih mehanizama |
| **Neni 2**<br>**Fushëveprimi** | **Article 2**<br>**Scope** | **Član 2**<br>**Delokrug** |
| 1. Ky ligj zbatohet për të gjitha shoqëritë tregtare dhe subjektet tjera të përcaktuara në këtë ligj. | 1. The present Law shall apply to all Business Organizations and other entities as stipulated in the present Law. | 1. Ovaj Zakon se primenjuje na sva poslovna društva i druge subjekte utvrđene Zakonom. |
| 2. Rregullat për lëshimin e lejeve, licencave ose formave të tjera të lejimit, rregullimi i aktiviteteve në të cilat angazhohet shoqëria tregtare pas regjistrimit, kontabiliteti, raportimi financiar, tatimet si dhe praktikat e punës dhe punësimit të shoqërive tregtare nuk janë në fushëveprim të këtij ligji – përveç shkëmbimit të të dhënave ndërmjet sistemeve elektronike të institucioneve përgjegjëse për këto fusha në ARBK, duke përfshirë institucionet përgjegjëse për administratën tatimore dhe raportimin financiar. | 2. The rules for issuing permits, licenses or other forms of Permissions, the regulation of activities undertaken by the Business Organization after registration, accounting, financial reporting, taxes and labour and employment practices in Business Organizations are not within the scope of the present Law, except for the exchange of data between electronic systems of the institutions responsible for these areas with the KBRA, including the institutions responsible for tax administration and financial reporting. | 2. Pravila za izdavanje dozvola, licenci ili drugih oblika dozvola, uređenje aktivnosti u kojima se angažuje poslovno društvo nakon registracije, računovodstvo, finansijsko izveštavanje, porezi, kao i prakse rada i zapošljavanja poslovnih društava nisu u delokrugu ovog Zakona, osim za razmenu podataka između elektronskih sistema institucija odgovornih za ove oblasti sa KARP, uključujući institucije odgovorne za poresku administraciju i finansijsko izveštavanje. |

| Neni 3<br>**Përkufizimet** | Article 3<br>**Definitions** | Član 3<br>**Definicije** |
|---|---|---|
| 1. Secila nga termet dhe shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç nëse konteksti në të cilin këto terme paraqiten, kanë kuptim tjetër: | 1. Whenever used in the present Law, the following terms and phrases shall have the following meanings unless the context within which such term or phrase appears clearly intends another meaning: | 1. Svaki od izraza i naziva korišćenih u ovom zakonu imaju dole utvrđeno značenje, osim ukoliko kontekst u kojem su ti izrazi ili fraze korišćene imaju drugačiji smisao: |
| 1.1. “Aksioni” nënkupton një letër me vlerë e cila paraqet të drejtë pronësore në një Korporatë e cila i jep pronarit të aksionit të drejtat e përcaktuara me këtë ligj. | 1.1. “Share” means a security representing an ownership right in a Corporation, which grants the owner of the Share, the rights specified in the present Law. | 1.1.“Deonica”znači hartija od vrednosti koja predstavlja imovinsko pravo u Korporaciji, a kojom se vlasniku deonice daje pravo utvrđeno ovim Zakonom. |
| 1.2. “Aksionarë” nënkupton personin fizik ose juridik dhe/ose Shoqërinë Tregtare që mund të disponojë me të drejtat që janë të përfaqësuara në Aksion. | 1.2. “Shareholder(s)” means a natural or legal Person and/or Business Organizations that may exercise the rights as represented by the Share(s). | 1.2.“Deoničar“ znači fizičko ili pravno lice i/ili poslovna društava koji može da raspolaže sa pravima koja su zastupljena u deonici. |
| 1.3. “Anëtar i familjes” përfshin:<br>1.3.1. bashkëshortin/en, prindin, vëllaun, motrën, fëmiun apo nipin/mbesën | 1.3. “Family member” includes:<br>1.3.1 a spouse, parent, brother, sister, child or grandchild; | 1.3.“Član porodice” obuhvata:<br>1.3.1. bračni drug, roditelj, brat, sestra, dete ili unuk/a; |
| 1.3.2. vëllaun, motrën, prindin apo bashkëshortin e cilitdo prej pikës së sipërme; ose | 1.3.2 a brother, sister, parent or spouse of any of the foregoing; or | 1.3.2. brat, sestra, roditelj ili bračni drug bilo koga od prethodnih; ili |
| 1.4. “Autoritet publik” do të thotë | 1.4. “Public Authority” means: | 1.4. “Javni organ” znači |
| 1.4.1. çdo autoritet ekzekutiv | 1.4.1. any governmental executive | 1.4.1. svaki izvršni organ vlasti, javni |

| | | |
|---|---|---|
| qeveritar, organ publik, ministri, departament, agjenci, komunë ose autoritete të tjera që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative ose gjyqësore në Kosovë; | authority, public body, Ministry, department, agency, municipality or other such authority that exercises executive, legislative, regulatory, administrative or judicial powers within Kosovo; | organ, ministarstvo, odeljenje, agenciju, opštinu ili druge organe koji vrše izvršnu, zakonodavnu, regulativnu, upravnu ili sudsku vlast na Kosovu; |
| 1.4.2. çdo ndërmarrje, organizatë ose ent që ushtron cilëndo nga kompetencat e lartpërmendura konform një akti ligjor ose nën-ligjor ose delegimit të kompetencave në fjalë nga një autoritet tjetër publik; dhe | 1.4.2. any enterprise, organization or establishment to the extent it exercises any of the afore-mentioned powers pursuant to a grant of authority given by a normative or sub normative act or pursuant to a delegation of authority from another Public Authority; and | 1.4.2. svako preduzeće,organizacija ili zavod koji vrši bilo koju od gorenavedenih nadležnosti u skladu sa zakonskim podzakonskim aktom ili delegiranjem navedenih nadležnosti od strane drugog javnog organa; i |
| 1.4.3. çdo zyrtar, shërbyes civil, punonjës ose agjent i ndonjërës nga të lartë përmendurat. | 1.4.3 any official, civil servant, employee or agent or any of the aforementioned. | 1.4.3. svaki službenik, civilni službenik, zaposleni ili agent jednog od gorenavedenih. |
| 1.5. “Degë e Shoqërisë së Huaj Tregtare” nënkupton subjektin e regjistruar në Kosovë për ushtrimin e veprimtarisë së ligjshme ekonomike nga një Shoqëri e Huaj Tregtare e themeluar sipas një ligji të një juridiksioni jashtë Kosovës. | 1.5. “Branch of a Foreign Business Organization” means an entity registered in Kosovo to exercise lawful Business Activities for a Foreign Business Organization duly established under the law of a jurisdiction outside of Kosovo. | 1.5. “Ogranak stranog poslovnog društva” znači subjekat koji je registrovan na Kosovu za vršenje zakonske privredne delatnosti od strane stranog poslovnog društva osnovanog prema zakonu određene jurisdikcije van Kosova. |
| 1.6 ."Ditë" nënkupton ditë kalendarike. | 1.6 ."Day" means a calendar day. | 1.6. “Dan” znači kalendarske dane. |
| 1.7 “Gjykata” do të thotë cilado gjykatë kompetente. | 1.7 “Court” means any court of competent jurisdiction. | 1.7 “Sud” znači svaki nadležni sud. |
| 1.8. “Kontributi” do të thotë një shumë | 1.8. “Contribution” means an amount | 1.8. “Doprinos” znači iznos ili vrednost |

| | | |
|---|---|---|
| ose vlerë që personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqëria Tregtare i paguan një ortakërie ose një Korporate, në këmbim të një kuote në Ortakërinë e Përgjithshme ose Ortakërinë e Kufizuar ose një Aksioni në një Korporatë . | or something of value that a natural or Legal Person and/or Business Organization pays or provides to a Partnership or a Corporation in exchange for a General or Limited Partnership Interest, or a Share in a Corporation. | koju fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo plaća partnerstvu ili korporaciji u zamenu za učešće u generalnom partnerstvu ili ograničenom partnerstvu ili za deonicu korporacije. |
| 1.9. "Korporatë" do të thotë një Shoqëri Aksionare ose Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të regjistruar në Kosovë. | 1.9. "Corporation" means a Joint Stock Company or Limited Liability Company registered in Kosovo. | 1.9. "Korporacija" znači deoničarsko društvo ili društvo sa ograničenom odgovornošću registrovano na Kosovu. |
| 1.10. "Kuotë" nënkupton interesin pronësor të një Ortaku në një Ortakëri të Përgjithshme ose Ortakëri të Kufizuar. | 1.10. "Partnership Interest" means an ownership interest of a Partner in a General or Limited Partnership. | 1.10. "Udeo – kvota" znači vlasnički interes jednog ortaka i partnerskom društvu ili ograničenom partnerstvu. |
| 1.11. "Lejim" nënkupton të gjitha format e lejeve dhe licencave të përcaktuara në ligjin në fuqi për sistemin e lejeve dhe licencave. | 1.11. "Permission" means all types of permits and licenses as provided by the applicable law on the systems of permits and licenses. | 1.11. "Dozvoljavanje" znači sve vrste dozvola i licenci koje su propisane zakonima na snazi za sistem dozvola i licenci. |
| 1.12. "Ministri" do të thotë Ministri i ministrisë përgjegjëse për regjistrimin e shoqërive tregtare. | 1.12. "Minister" means the Minister of the Ministry responsible for registration of business organizations. | 1.12."Ministar" znači ministar nadležnog ministarstva za registraciju poslovnih društava. |
| 1.13. "Ministria" do të thotë Ministria përgjegjëse për regjistrimin e shoqërive tregtare. | 1.13. "Ministry" means the Ministry responsible for registration of business organizationa. | 1.13."Ministarstvo"znači nadležno ministarstvo za registracijuposlovnih društava. |
| 1.14. "Ortakëri" do të thotë Ortakëri e Përgjithshme ose Ortakëri e Kufizuar e regjistruar në Kosovë. | 1.14. "Partnership" means a General or Limited Partnership registered in Kosovo. | 1.14."Partnerstvo" znači generalno partnerstvo ili ograničeno partnerstvo registrovano na Kosovu. |

| | | |
|---|---|---|
| 1.15. “Person” nënkupton vetëm personin fizik. | 1.15. “Person” means only a Natural Person. | 1.15. “ Lice” znači samo fizičko lice. |
| 1.16. “Përfaqësues i Autorizuar” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 24 të këtij ligji. | 1.16. “Authorized Representative” shall have the meaning provided in Article 24 of the present Law. | 1.16. “ Ovlašćeni predstavnik” ima značenje koje je određeno članom 24. ovog Zakona. |
| 1.17. “Përfaqësuesi me Prokurë” ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 24 të këtij ligji. | 1.17.“Authorized Proxy” shall have the meaning provided in Article 24 of the present Law. | 1.17. „Opunomoćenik” ima značenje koje je određeno u članu 24. ovog Zakona. |
| 1.18. “Person Juridik” sipas këtij ligji është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar dhe Shoqëria Aksionare, apo një person tjetër juridik i themeluar sipas ligjeve te aplikueshme të Kosovës apo të një shteti të huaj. | 1.18. “Legal Person” as used in the present law shall mean a Limited Liability Company and a Joint Stock Company, or another legal person established under the applicable laws of Kosovo or a foreign country. | 1.18. “Pravno lice” prema ovom Zakonu je društvo sa ograničenom odgovornošću i deoničarsko društvo, ili drugo pravno lice osnovano u skladu sa važećim zakonima na Kosovu ili stranoj zemlji. |
| 1.19. “Përfaqësuesi i Autorizuar në Procedurë të Falimentimit” nënkupton përfaqësuesin e pasurisë falimentuese i cili: | 1.19. “Authorized Representative in a Bankruptcy Procedure” shall mean the representative of the bankruptcy estate, who is the: | 1.19. “Ovlašćeni zastupnik u stečajnom postupku” znači predstavnik stečajne imovine koji: |
| 1.19.1 në procedurë të likuidimit është Administratori i falimentimit; | 1.19.1. bankruptcy administrator in a liquidation procedure; | 1.19.1. u stečajnom postupku je stečajni upravnik; |
| 1.19.2. në procedurë të riorganizimit është debitori kur vepron si debitori në posedim; | 1.19.2. debtor in reorganization procedure, when acting as debtor in possession; | 1.19.2. u postupku reorganizacije je dužnik kada postupa u svojstvu dužnika u posedu; |
| 1.19.3. administratori i falimentimit në rastet kur emërohet nga gjykata në procedurë të | 1.19.3. bankruptcy administrator, upon Court appointment in reorganization. | 1.19.3. stečajni upravnik u slučajevima kada ga sud postavi u postupku reorganizacije. |

| | | |
|---|---|---|
| riorganizimit. | | |
| 1.20 “PPAP” nënkupton Programet për Pronësinë e Aksioneve nga Punonjësit. | 1.20. “ESOP” means Employee Share Ownership Program. | 1.20.“PVDZ” znači Program za vlasništvo deonica zaposlenih. |
| 1.21. “Regjistri” do të thotë Regjistri i Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë të Kosovës. | 1.21. “Registry” means the Kosovo Registry of Business Organizations. | 1.21.“Registar” znači Kosovski Registar poslovnih organizacija i poslovnih naziva. |
| 1.22.“Shoqëri Tregtare” është term i përgjithshëm që do të thotë dhe përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas këtij ligji apo të një ligji tjetër siç është përcaktuar në nenin 5 paragrafi 3 i këtij ligji, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare. | 1.22. “Business Organization” is a general term, which shall mean and shall include any type of Business Organizations established in Kosovo under the present law or another law as specified under Article 5 paragraph 3 of this law, including Individual Businesses, General Partnerships, Limited Partnerships, Limited Liability Companies and Joint-Stock Companies. | 1.22.“ Poslovno društvo” je opšti izraz koji znači i obuhvata svaku vrstu poslovnog društva osnovanog na Kosovu u skladu sa ovim Zakonom ili nekim drugim zakonom kao što je navedeno u članu 5. stav 3 ovog zakona, uključujući individualna preduzeća, generalna partnerstva, ograničena partnerstva, društva sa ograničenom odgovornošću i deoničarska društva. |
| 1.23. “Shpërndarje” do të thotë shpërndarja e dividendëve dhe cilado bartje e të hollave ose pasurisë tjetër materiale apo jo-materiale, nga një Ortakëri ose Korporatë në cilindo ortak ose aksionarë të saj, për shkak të statusit të tyre si ortak, ose aksionar. | 1.23. “Distribution” means distribution of dividends or any transfer of money or other property, whether tangible or intangible, from a Partnership or a Corporation to any of its partners or Shareholders because of his/her status as a partner or Shareholder. | 1.23.“Raspodela” znači raspodelu dividendi i svaki prenos novca ili druge materijalne ili nematerijalne imovine sa jednog ortaka ili korporacije na bilo kojeg ortaka ili deoničara, zbog njihovog statusa kao ortaka ili deoničara. |
| 1.24.“Veprimtaria Ekonomike” do të thotë çdo lloj aktiviteti i rregullt ose i përsëritur i cili përfshin ofrimin, sigurimin ose prodhimin e mallrave, shërbimeve, pronës dhe/ose punëve për | 1.24. “Business Activity” means any type of regular or repeated activity involving the offering, providing or producing of goods, services, property and/or works to or for any Person or | 1.24. “Privredna delatnost” znači svaku vrstu redovne ili ponovljene delatnosti koja obuhvata ponudu, obezbeđivanje ili proizvodnju robe, usluga, imovine i/ili radova za jedno lice ili poslovno |

| | | |
|---|---|---|
| një person ose Shoqëri Tregtare, në këmbim ose në pritje të çfarëdo lloj pagese ose kompensimi; me kusht që punëtori i cili kryen shërbime për punëdhënësin e tij të mos konsiderohet se ushtron veprimtari ekonomike përderisa shërbimet e tilla të kompensohen sipas kontratës së punëtorit me punëdhënësin. | Business Organization in return for or in expectation of any type of payment or compensation; provided, however, that an employee who provides services to his/her employer shall not be considered to be conducting “Business Activity” to the extent such services are required by and compensated pursuant to the employee’s contract of employment with the employer. | društvo, u zamenu za ili očekujući bilo kakvu vrstu isplate ili naknade; uz uslov da se radnik koji obavlja usluge za svojeg poslodavca ne smatra da obavlja privrednu delatnost sve dok se takve usluge zahtevaju ugovorom ili se nadoknađuju prema ugovoru u zapošljavanju radnika sa poslodavcem. |
| **Neni 4**<br>**Veprimtaria Ekonomike** | **Article 4**<br>**Business Activity** | **Član 4**<br>**Privredna delatnost** |
| Veprimtaria Ekonomike në Kosovë mund të ushtrohet vetëm nga Shoqëritë Tregtare të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe me ligj. | Business Activities in Kosovo may be undertaken only by Business Organizations registered at the Kosovo Business Registration Agency, unless otherwise expressly provided by law. | Privrednu delatnost na Kosovu mogu da vrše samo poslovna društva registrovana u Kosovsku Agenciju za Registraciju Preduzeća, osim ako je drugačije izričito propisano zakonom. |
| **Neni 5**<br>**Llojet e Shoqërive Tregtare në Kosovë** | **Article 5**<br>**Types of Business Organizations in Kosovo** | **Član 5**<br>**Vrste poslovnih društava na Kosovu** |
| 1. Një Shoqëri Tregtare mund të themelohet në Kosovë si Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose Shoqëri aksionare. | 1. A Business Organization may be established in Kosovo as an Individual Business, General Partnership, Limited Partnership, Limited Liability Company or Joint Stock Company. | 1. Na Kosovu se kao poslovno društvo može osnovati individualno preduzeće, generalno partnerstvo, ograničeno partnerstvo, društvo sa ograničenom odgovornošću ili deoničarsko društvo. |
| 2. Përveç formave themelore të organizimit të Shoqërive Tregtare të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve regjistrohen edhe | 2. Apart from the basic types of organization of Business Organizations as provided in paragraph 1 of this Article, the Kosovo Business Registration Agency | 2. Pored osnovnih oblika organizovanja poslovnih društava utvrđenih stavom 1 ovog člana, u Kosovsku Agenciju za Registraciju Preduzeća se registruju i |

| | | |
|---|---|---|
| Dega e Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë, Zyra e Përfaqësisë së Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë, ndërmarrjet publike sipas ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. | shall also register the Branch of a Foreign Business Organization in Kosovo, the Representative Office of a Foreign Business Organization in Kosovo, Publicly Owned Enterprises according to the applicable Law on Publicly Owned Enterprises, and Socially Owned Enterprises under the administration of the Privatization Agency of Kosovo. | ogranak stranog poslovnog društva na Kosovu, kancelarija predstavništva stranog poslovnog društva na Kosovu, javna preduzeća prema zakonu na snazi o javnim preduzećima i društvena preduzeća pod upravom Kosovske agencije za privatizaciju. |
| 3. Me ligj të veçantë mund të përcaktohen edhe forma të tjera të organizimit të Shoqërive Tregtare ose subjekte të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve. Forma e organizimit si dhe të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve në këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera rregullohen në ligjin përcaktës më të cilin krijohet Shoqëria Tregtare ose subjekti përkatës. Dispozitat e ligji të vecantë që rregullojnë këto shoqëri tregtare ose subjekte të tjera, duke përfshirë dispozitat e ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, kanë përparësi ndaj dispozitave të këtij ligji. | 3. A special law may provide other forms of organization of Business Organizations or other entities required to register at the Kosovo Business Registration Agency. The manner of organization and rights and duties of parties in such business organizations or other entities shall be provided for by relevant legislation upon which the business organization or relevant entity is established. Provisions of such special law providing on such business organizations or entities, including the applicable provisions on public enterprises shall prevail over the provisions of the present Law. | 3. Posebnim zakonom se mogu odrediti i drugi oblici organizovanja poslovnih društava ili drugih subjekata za koje se zahteva registracija u KosovskuAgenciju za Registraciju Preduzeća. Oblik organizovanja i prava i obaveze svih strana u ovom poslovnom društvu ili drugim subjektima se uređuju prema određujućem Zakonu prema kojem se osniva poslovno društvo. Odredbe posebnog zakona koje uređuju ovo poslovno društvo ili druge subjekte, uključujući odredbe na snazi o javnim preduzećima, imaju prednost nad odredbama ovog zakona. |
| **Neni 6**<br>**Qëllimet e Ligjshme** | **Article 6**<br>**Lawful purposes** | **Član 6**<br>**Zakoniti ciljevi** |
| 1. Shoqëria Tregtare mund të themelohet dhe regjistrohet për çfarëdo qëllimi dhe mund të kryejë çfarëdo Veprimtarie Ekonomike që nuk është e ndaluar me legjislacionin në fuqi. | 1. A Business Organization may be established and registered for any purpose and undertake any Business Activity that is not prohibited by the legislation in force. | 1. Poslovno društvo može biti osnovano i registrovao za svaki cilj i može obavljati bilo koju vrstu privredne delatnosti, koja nije zabranjena važećim zakonima. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Çdo person nga mosha tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, Shoqëri Tregtare ose grup i përbërë nga një ose më shumë persona nga mosha tetëmbëdhjetë (18) vjeçare dhe/ose Shoqëri Tregtare mund të themelojë dhe regjistrojë një Shoqëri Tregtare. | 2. Any Person from the age of eighteen (18) years, a Business Organization or a group consisting of one or more Persons from the age of eighteen (18) and/or Business Organizations may establish and register a Business Organization. | 2. Svako lice starije od osamnaest (18) godina, poslovno društvo ili grupa koju čini jedno ili više lica starijih od osamnaest (18) godina i/ili poslovnih društava može osnovati i registrovati poslovno društvo. |
| 3. Nëse Shoqëria Tregtare themelohet dhe regjistrohet për ushtrimin e një Veprimtarie Ekonomike për të cilën nevojitet një Lejim sipas një ligji tjetër, regjistrimi i kësaj Shoqërie Tregtare në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve nuk konsiderohet si autorizim për të ushtruar atë Veprimtari Ekonomike. Shoqëria Tregtare është vetë përgjegjëse që pas regjistrimit, të identifikojë, aplikojë dhe të marrë Lejimin nga Autoriteti Publik përkatës para fillimit të Veprimtarisë Ekonomike përkatëse. | 3. If a Business Organization is established and registered for the conduct of a Business Activity that is subject to a Permission established by another law, the registration of such Business Organization at the Kosovo Business Registration Agency shall not constitute any kind of authorization to engage in such Business Activity. It shall be the sole responsibility of the Business Organization, after registration, to identify, apply for and obtain any and all such Permissions from the responsible Public Authority before engaging in the concerned Business Activity. | 3. Ukoliko se poslovno društvo osnuje i registruje za vršenje određene privredne delatnosti za koju je prema nekom drugom zakonu potrebna dozvola, registracijom ovog poslovnog društva u Kosovsku Agenciju za Registraciju Preduzeća se ne podrazumeva ovlašćenjem za vršenje takve privredne delatnosti. Poslovno društvo samo snosi odgovornost za registraciju, identifikaciju, aplikaciju i dobijanje dozvole nadležnog javnog organa pre pokretanja dotične privredne delatnosti. |

| | | |
|---|---|---|
| **PJESA E DYTË<br>AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE TË KOSOVËS DHE REGJISTRIMI**<br><br>**KAPITULLI I<br>AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË** | **PART TWO<br>KOSOVO BUSINESS REGISTRATION AGENCY AND REGISTRATION**<br><br>**CHAPTER I<br>KOSOVO BUSINESS REGISTRATION AGENCY** | **DRUGI DEO<br>KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJU PREDUZEĆA I REGISTRACIJA**<br><br>**POGLAVLJE I<br>KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJU PREDUZEĆA** |
| **Neni 7<br>Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë** | **Article 7<br>Kosovo Business Registration Agency** | **Član 7<br>Kosovska Agencija za registraciju preduzeća** |
| 1. Agjencia e Regjistrimit të Biznesevetë Kosovës (në tekstin e mëtejmë“ARBK”) funksionon si organ qendror i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë. | 1. The Kosovo Business Registration Agency (hereinafter “KBRA”) shall operate as a central state administration body within the Ministry. | 1. Kosovska Agencija za Registraciju Preduzeća (u daljem tekstu “KARP“) funkcioniše kao centralni organ državne uprave u okviru Ministarstva. |
| 2. ARBK e ka selinë në Prishtinë. | 2. KBRA shall have its headquarters in Prishtina. | 2. KARP ima sedište u Prištini. |
| **Neni 8<br>Organizimi i ARBK** | **Article 8<br>Organization of KBRA** | **Član 8<br>Organizacija KARP-a** |
| 1. ARBK ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe është institucioni i vetëm që ofron shërbim për publikun përmes sportelit të saj qendror dhe qendrave të regjistrimit në komuna me të cilat lidhë marrëveshje bashkëpunimi. | 1. KBRA has jurisdiction throughout the territory of the Republic of Kosovo and is the sole institution providing services to the public, in its central office and registration centres in municipalities with which it signs memorandums of collaboration. | 1. KARP ima nadležnost na celoj teritoriji Republike Kosovo i samostalna je institucija koja pruža usluge namenjene javnosti putem svojih centralnih šaltera i centara za registraciju u opštinama sa kojima ima potpisan sporazum o saradnji. |
| 2. ARBK ofron shërbim në komuna përmes | 2. KBRA shall offer services in | 2. KARP pruža usluge u opštinama putem |

| | | |
|---|---|---|
| qendrave të regjistrimit në komuna në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Ministria lidh marrëveshje bashkëpunimi me komunat përkatëse, në të cilën përcaktohen kushtet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit dhe treguesit kryesor të performancës, kualifikimet dhe kriteret e posaçme profesionale të nëpunësve në qendrat e regjistrimit në komuna si dhe trajnimet e detyrueshme për nëpunësit e sporteleve në komuna. | municipalities through the municipal registration centres, in compliance with the provisions of the present law. The Ministry shall sign memorandums of collaboration with respective municipalities, stipulating the conditions and criteria for the provision of such services and the key performance indicators, the qualifications and specific professional criteria for staff members in municipal registration centres, and mandatory training for the staff members in municipal registration centres. | centara za registraciju u skladu sa odredbama ovog zakona. Ministarstvo potpisuje sporazum o saradnji sa određenom opštinom u kojem se utvrđuju uslovi i kriterijumi pružanja usluga kao i glavni pokazatelj učinka, kvalifikacije i posebni profesionalni kriterijumi za zaposlene u centrima za registraciju u opštinama kao i obavezne obuke za zaposlene na opštinskim šalterima. |
| 3. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e qendrave të regjistrimit në komuna barten nga komuna. | 3. The expenses for the maintenance and management of the municipal registration centres shall be carried by the municipalities. | 3. Troškove za održavanje i upravljanje centrima za registraciju snosi opština. |
| **Neni 9**<br>**Funksionet dhe Kompetencat e ARBK** | **Article 9**<br>**Functions and Competencies of KBRA** | **Član 9**<br>**Funkcije i ovlašćenja KARP-a** |
| 1. ARBK bën regjistrimin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë, si dhe është e autorizuar për kryerjen e funksioneve të tjera të përcaktuara me këtë Ligj apo funksioneve që i janë caktuar ARBK me ligje të tjera. | 1. KBRA shall register Business Organizations and Trade Names, and shall be authorized to undertake any such other functions as provided by the present Law or functions as assigned to KBRA by other laws. | 1. KARP obavlja registraciju poslovnih društava i poslovnih naziva, a ima i ovlašćenje za obavljanje drugih funkcija utvrđenih ovim zakonom ili funkcija koje određuje KARP drugim zakonima. |
| 2. ARBK përgatit dhe publikon formularët, autorizimet dhe procedurat e nevojshme me qëllim të lehtësimit të regjistrimit të Shoqërive Tregtare. Formularët dhe procedurat miratohen nga Drejtori i | 2. KBRA shall prepare and publish all necessary forms, authorizations and procedures with the goal of facilitating registration of Business Organizations. Such forms and procedures shall be | 2. KARP priprema i objavljuje potrebne obrasce, ovlašćenja i procedure sa ciljem olakšavanja registracije poslovnih društava. Obrasce i procedure odobrava generalni direktor KARP-a u skladu sa odredbama |

| | | |
|---|---|---|
| Përgjithshëm i ARBK në përputhje me dispozitat e këtij ligji. | approved by the General Director of KBRA, in compliance with the provisions of the present Law. | ovog zakona. |
| 3. ARBK harton dhe publikon në faqen e vet zyrtare të internetit, si dhe ti vë në dispozicion në të gjitha qendrat e regjistrimit të bizneseve, modelet e Marrëveshjeve të Ortakërisë, Statutit dhe Marrëveshje e Inkorporimit për Korporata, të cilat mund t'i përdorin Shoqëritë Tregtare, por pa qenë të obliguar t'i përdorin, gjatë regjistrimit të tyre në ARBK. | 3. KBRA shall develop and publish on its official website and make widely available in all business registration centres models of Partnership Agreements for Partnerships, the Charter and Agreementof Incorporation for Corporations, which these Business Organizations can, but are not obligated to use during registration at KBRA. | 3. KARP izrađuje i objavljuje na svojoj službenoj internet stranici i čini široko dostupnim u svim centrima za registraciju preduzeća modele partnerskih sporazuma za partnerstvo, povelju i Sporazum o Uključivanju u korporaciji, koje poslovne organizacije mogu, ali nisu obavezne koristiti prilikom registracije u KARP. |
| 4. Të gjithë formularët, modelet dhe procedurat e përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni publikohen në formë elektronike dhe janë në dispozicion falas në internet dhe në formë fizike në ARBK. | 4. All such forms, models, and procedures specified in paragraph 2 and 3 of this article shall be published electronically and shall be available without charge online and in hard copy at KBRA. | 4. Svi obrasci, modeli i procedure utvrđeni u stavu 2 i 3 ovog člana, objavljuju se u elektronskom obliku i besplatno su na raspolaganju na internetu i u štampanom obliku u KARP-u. |
| 5. Formularët e përgatitur nga ARBK duhet të përmbajnë të dhënat e detyrueshme të përcaktuara në mënyrë të veçantë për secilin lloj të Shoqërive Tregtare sipas këtij ligji. Formularët mund të përmbajnë edhe një pjesë të veçantë në të cilën Përfaqësuesi i Autorizuar ose Përfaqësuesi me Prokurë i Shoqërisë Tregtare mund të deklarojë të dhëna të tjera plotësuese, por të cilat nuk e kufizojnë Shoqërinë Tregtare në ushtrimin e veprimtarive të saj të ligjshme. | 5. The forms prepared by KBRA shall contain all the mandatory data, stipulated specifically for each type of Business Organizations according to the present Law. The forms may contain a special section in which the Authorized Representative or Authorized Proxy Representative of the Business Organization may declare other additional data, but which shall not limit the Business Organization in conducting its lawful activities. | 5. Obrasci koje priprema KARP treba da sadrže obavezne podatke koji su na poseban način utvrđene za svaku vrstu poslovnog društva u skladu sa ovim zakonom. Obrasci mogu sadržati i poseban deo u kojem ovlašćeni predstavnik ili ovlašćeni opunomoćenik poslovnog društva može da pruži druge dopunske podatke, ali koji ne ograničavaju poslovno društvo u obavljanju njegovih legitimnih aktivnosti. |

| | | |
|---|---|---|
| 6. ARBK përgatit dhe publikon, në faqen e vet zyrtare, raportet e matjes së performancës, të cilët reflektojnë efektivitetin e shërbimeve të regjistrimit të bizneseve që ofrohen nga Zyra qendrore e ARBK-së dhe qendrat komunale të regjistrimit të bizneseve. Raportet e tilla duhen të përgatiten dhe publikohen në baza tremujore dhe vjetore. | 6. KBRA shall prepare and publish on its official website performance measurement reports which reflect the effectiveness of business registration services offered by the KBRA central office and municipal business registration centres. Such reports shall be prepared and published on a quarterly and annual basis. | 6. KARP priprema i objavljuje na svojoj internet stranici izveštaje o merenju učinka koji odražavaju delotvornost usluga registracije biznisa koje nudi centralna služba KARP i opštinski centri za registraciju biznisa. Ovakvi izveštaji se pripremaju i objavljuju kvartalno i godišnje. |
| 7. Ministri nxjerr Kodin e Qeverisjes Korporative, së bashku me dispozitat për monitorimin dhe zbatimin e këtij kodi. Kodi i Qeverisjes Korporative miratohet në formë të udhëzuesit dhe nuk përbën akt ligjor. | 7. The Minister shall adopt a Corporate Governance Code, including provisions on monitoring and implementation of this Code. The Corporate Governance Code is approved in the form of a guideline and is not a legal act. | 7. Ministar uspostavlja Kodeks korporativnog upravljanja, zajedno sa odredbama za praćenje i sprovođenje ovog koda. Kodeks korporativnog upravljanja se usvaja u obliku uputstva i ne sadrži zakonske akte. |
| **Neni 10**<br>**Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës** | **Article 10**<br>**General Director of the Kosovo Business Registration Agency** | **Član 10**<br>**Generalni direktor Kosovske Agencije za registraciju preduzeća** |
| 1. Veprimtaria e ARBK drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme që janë përcaktuar në legjislacionin e aplikueshëm për nëpunësit civil. | 1. The activity of KBRA shall be led by the General Director, who must meet the general and special requirements as provided in the applicable legislation on civil servants. | 1. Delatnošću KARP-a upravlja Generalni direktor koji treba da ispunjava opšte i posebne zahteve koji su utvrđeni zakonodavstvom kojim se odnosi na civilne službenike. |
| 2. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për administrimin e ARBK, duke përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore. | 2. The General Director shall be responsible for administering the KBRA, including human resource management. | 2. Generalni direktor je odgovoran za upravljanje KARP-om, uključujući i upravljanje ljudskim resursima. |
| 3. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson ARBK në marrëdhëniet me palët e treta. | 3. The General Director shall represent the KBRA in third party relations. | 3. Generalni direktor predstavlja KARP u odnosima sa trećim licima. |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Drejtori i Përgjithshëm i ARBK ushtron kompetenca drejtuese dhe nxjerr vendime dhe udhëzime të tjera të detyrueshme për rregullimin e procesit të regjistrimit të Shoqërive Tregtare për qendrat e regjistrimit në pajtim të plotë me këtë ligj. Shprehimisht përcaktohet se vendimet dhe udhëzimet e nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i ARBK sipas këtij ligji nuk do të vendosin kërkesa, kushte ose kufizime që nuk janë përcaktuar shprehimisht me këtë ligj. | 4. The General Director of KBRA exercises managing powers and issues decisions and other binding instructions regulating the process of registration of Business Organizations for the registration centres in full compliance with the present Law. It is hereby expressly provided that decisions and instructions issued by the KBRA General Director pursuant to this law shall not set forth requirements, conditions and limitations that are not expressly provided for by this law. | 4. Generalni direktor KARP-a vrši dužnost direktora i donosi odluke i druga obavezna uputstva za regulisanje procesa registracije poslovnih društava u centrima za registraciju u skladu sa ovim zakonom. Ovim zakonom je izričito propisano da odluke i uputstva koja donese generalni direktor KARP-a u skladu sa ovim zakonom neće odrediti zahteve, uslove i ograničenja koja nisu izričito propisana ovim zakonom. |
| 5. Drejtori i Përgjithshëm i ARBK i raporton Ministrit me shkrim për menaxhimin administrativ, financiar dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve sa herë që i kërkohet, por jo më pak se një herë në vit. | 5. The General Director of KBRA shall report in writing to the Minister regarding the administrative and financial management and the quality of services provided, whenever required, but not less than once per year. | 5. Generalni direktor KARP-a podnosi izveštaj Ministru u pisanom obliku o administrativnoj i finansijskoj upravi kao i o kvalitetu usluga kad god je to potrebno, ali ne manje od jednom godišnje. |
| **Neni 11**<br>**Nëpunësit e ARBK-së** | **Article 11**<br>**KBRA Staff Members** | **Član 11**<br>**Službenici KARP-a** |
| Nëpunësit e ARBK-së janë nëpunës civil dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. | KBRA staff members shall be civil servants and they shall be subject to provisions of the civil service legislation in the Republic of Kosovo. | Službenici KARP-a su civilni službenici i na njih se primenjuju odredbe zakona o civilnoj službi Republike Kosovo. |
| **Neni 12**<br>**Nëpunësit e Qendrave të Regjistrimit në Komuna** | **Article 12**<br>**Staff of the Municipal Registration Centres** | **Član 12**<br>**Službenici Centara za registraciju u opštinama** |
| Nëpunësit e qendrave të regjistrimit në | Staff members of the Municipal | Službenici centara za registraciju u |

| | | |
|---|---|---|
| komuna janë nëpunës civil të komunës. | Registration Centres shall be civil servants of the Municipalities. | opštinama su civilni službenici opštine. |
| **Neni 13**<br>**Buxheti** | **Article 13**<br>**Budget** | **Član 13**<br>**Budžet** |
| ARBK financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. | KBRA shall be funded by the Budget of the Republic of Kosovo. | KARP se finansira iz budžeta Republike Kosovo. |
| **Neni 14**<br>**Taksa për Shërbime** | **Article 14**<br>**Service Fees** | **Član 14**<br>**Naknada za usluge** |
| 1. ARBK realizon të ardhura nga ofrimi i shërbimeve në mbështetje të funksioneve të përcaktuara në këtë ligj ose në ligjet e tjera në fuqi. | 1. KBRA shall generate income from providing services to support functions as provided by the present law or by other laws in force. | 1. KARP ostvaruje prihode od pružanja usluga u skladu sa funkcijama utvrđenim ovim zakonom ili drugim zakonima na snazi. |
| 2. Shoqëritë Tregtare me rastin e hapjes dhe çregjistrimit të tyre nuk paguajnë taksë për shërbime. | 2. Business Organizations shall not be required to pay any service fees during initial registration or deregistration. | 2. Poslovna društva prilikom njihovog otvaranja i odjave ne plaćaju naknadu za uslugu. |
| 3. Taksat për shërbimet e tjera përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministri brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Deri në miratimin e aktit nënligjor të përcaktuar në këtë paragraf vazhdojnë të aplikohen taksat e aplikueshme në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. | 3. Other service fees shall be specified in a sub-legal act adopted by the Minister within six (6) months from the entry into force of the present law. Until such normative act as provided by the present paragraph is adopted, fees applicable before the entry into force of the present law shall apply. | 3. Naknada za druge usluge se utvrđuje podzakonskim aktima koje usvaja ministarstvo u roku od šest (6) meseci od stupanja na snagu ovog zakona. Do usvajanja podzakonskih akata određenih u ovom stavu primenjivaće se naknade koje su bile na snazi u momentu stupanja na snagu ovog zakona. |
| 4. Gjatë përcaktimit të taksave, Ministri duhet të sigurojë që këto taksa të bazohen në parimin e mbulimit të shpenzimeve administrative dhe të mos vendosin barrë të | 4. In his/her determination of fees, the Minister shall ensure that such fees are set in accordance with the principle of administrative cost recovery, and avoid | 4. Tokom utvrđivanja naknada, ministarstvo je dužno da osigura da se ove naknade u načelu zasnivaju na pokrivanju administrativnih troškova kao i da ne |

| | | |
|---|---|---|
| tepruar dhe të shkaktojnë pengesa në regjistrimin e shoqërive tregtare apo ndryshimin në regjistrim. Të gjitha taksat duhet të bazohen vetëm në llojin e dokumentit të parashtruar dhe nuk do të bazohen kurrsesi në vlerën, qarkullimin apo kapitalin e Shoqërisë Tregtare. | placing any undue burdens or any impediments in registering Business Organizations or amending such registration. All such fees shall be based on the type of document submitted and shall not in any case be based on the value, turnover or capital of the Business Organization. | predstavljaju veliki namet i ne uzrokuju prepreku u registraciji poslovnih društava ili izmenu u registraciji. Sve naknade treba da se zasnivaju na vrsti predstavljenog dokumenta a ne na vrednosti, prometu ili kapitalu Poslovnog društva. |
| 5. Të gjitha taksat e miratuara sipas paragrafit 3 të këtij neni shpallen në çdo qendër të regjistrimit në formë fizike dhe në faqen e internetit të ARBK. | 5. All such fees established according to paragraph 3 of the present Article shall be posted in every registration centre in hard copy, and online in the KBRA website. | 5. Sve usvojene naknade prema stavu 3 ovog Člana, objavljuju se u svakom centru za registraciju u fizičkom obliku kao i na internet stranici KARP-a. |
| **KAPITULLI II<br>REGJISTRI I SHOQËRIVE TREGTARE DHE NATYRA E REGJISTRIMIT** | **CHAPTER II<br>REGISTRY OF BUSINESS ORGANIZATIONS AND NATURE OF REGISTRATION** | **POGLAVLJE II<br>REGISTAR POSLOVNIH DRUŠTAVA I PRIRODA REGISTRACIJE** |
| **Neni 15<br>Regjistri i Shoqërive Tregtare** | **Article 15<br>Registry of Business Organizations** | **Član 15<br>Registar Poslovnih društava** |
| 1. Regjistri është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilën Shoqëri Tregtare dhe subjekt tjetër që ka detyrimin e regjistrimit, siç është përcaktuar në këtë ligj. | 1. The Registry is a unitary database, separated in specific electronic files for each Business Organization and other entity required to register, as provided by the present Law. | 1. Registar je jedinstvena baza podataka podeljena na posebne elektronske datoteke za svako poslovno društvo i druge organe za koje je u obavezi da registruje, kao što je i predviđeno ovim zakonom. |
| 2. Regjistri mbahet në format elektronik. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo në format elektronik, sipas këtij ligji do të regjistrohen nga | 2. The Registry is kept in electronic format. All data, applications and associated documents, submitted in paper or electronic format, according to this Law shall be registered by KBRA in an | 2. Registar ostaje u elektronskom obliku. Svi podaci, zahtevi i prateća dokumenta podneta u pisanom ili elektronskom obliku, biće registrovana od strane KARP-a u skladu sa ovim zakonom u elektronskom |

| | | |
|---|---|---|
| ARBK në format elektronik në dosjen e Shoqërisë Tregtare në Regjistër. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese: | electronic format in the Registry file of the Business Organization. All data, applications and associated documents: | obliku u datoteci poslovnog društva u Registru. Svi podaci, zahtevi i prateća dokumenta: |
| 2.1. të paraqitura nga aplikantët në format elektronik, sipas këtij ligji, ruhen dhe arkivohen nga ARBK vetëm në format elektronik; | 2.1. filed by applicants in electronic format, according to the law, are stored and archived by KBRA only in electronic format; | 2.1. podneta od strane podnosioca zahteva u elektronskom obliku, u skladu sa ovim zakonom, arhiviraju se od strane KARP-a samo u elektronskom obliku; |
| 2.2. të paraqitura në format shkresor, sipas këtij ligji, konvertohen dhe ruhen nga ARBK në format elektronik. ARBK nuk ka detyrim ti mbajë apo ti arkivojë aplikimet dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura në format shkresor. | 2.2. filed in paper version, according to the law, are converted and stored by KBRA in electronic format. KBRA is not required to maintain or archive applications and other documents filed in paper format. | 2.2. Podneta u pisanom obliku, u skladu sa ovim zakonom, prebacuju se i čuvaju od strane KARP-a u elektronskom obliku. KARP nema obavezu da čuva ili arhivira zahteve i prateća dokumenta podnesena u pisanom obliku. |
| 3. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave, të njoftuara dhe të depozituara në Regjistër, kryhen nëpërmjet sistemit elektronik. | 3. Registration, processing and storing of data, as filed and deposited with the Registry, shall be performed through an electronic system. | 3. Registracija, obrada i čuvanje podataka, prihvaćenih i uskladištenih u Registru, vrši se putem elektronskog sistema. |
| 4. Regjistri i Shoqërive Tregtare është regjistër elektronik i cili mirëmbahet nga ARBK në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e regjistrave publik dhe sigurimin e integritetit të të dhënave. | 4. The Registry of Business Organizations is an electronic registry, maintained by KBRA, in cooperation with the institutions of the Republic of Kosovo responsible for the maintenance and storage of public registries and ensuring data integrity. | 4. Registar poslovnih društava je elektronski registar koji održava KARP u saradnji sa nadležnim institucijama Republike Kosovo za čuvanje i održavanje javnih registara i bezbednost integriteta podataka. |
| 5. ARBK obligohet që të bashkëpunojë rregullisht me organet e tjera të administratës shtetërore për të siguruar | 5. KBRA shall regularly collaborate with all other state administration bodies to ensure regular updates to the information | 5. KARP je obavezan da redovno sarađuje sa drugim državnim administrativnim organima, kako bi obezbedio redovno |

| | | |
|---|---|---|
| përditësimin e rregullt të informatave të përfshira në Regjistër dhe të gjitha organet e administratës shtetërore janë të obliguara t'i dorëzojnë ARBK-së informatat që nevojiten për përditësimin e regjistrit, në pajtim me ligjin në fuqi. | contained in the Registry and all state administration bodies are required to submit to the KBRA information needed to update the registry, in accordance with applicable law. | ažuriranje informacija obuhvaćenih Registrom i sva državna administrativna tela imaju obavezu da KARP-u podnose informacije koje su potrebne za ažuriranje registra, u skladu sa važećim zakonom. |
| **Neni 16**<br>**Të Dhënat që Regjistrohen** | **Article 16**<br>**Data Required to be Registered** | **Član 16**<br>**Podaci koji se registruju** |
| 1. Regjistri duhet të përmbajë të dhëna, që i përkasin regjistrimit dhe çregjistrimit së Shoqërive Tregtare dhe subjekteve të tjera, çdo ndryshim në status dhe organizim të Shoqërisë Tregtare ose subjektit tjetër si dhe të dhëna të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi. | 1. The Registry shall contain data related to the registration and deregistration of Business Organizations and other entities, any amendments to the status and organization of Business Organizations or any other entity, and other data as provided by the legislation in force. | 1. Registar treba da sadrži podatke koji se tiču registracije i ispisivanja poslovnih društava i drugih organa, svaka promena u statusu i organizaciji poslovnog društva ili drugih organa kao i drugi podaci predviđeni zakonodavstvom na snazi. |
| 2. Vetëm të dhënat e kërkuara me këtë ligj, ligje të tjera në fuqi, apo akte nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi, futen në Regjistër. | 2. Only data required by this Law, other applicable laws or secondary legislation adopted in accordance with this law or other applicable laws shall be entered in the Registry. | 2. Podaci zahtevani ovim zakonom, drugim važećim zakonima ili sekundarnim zakonodavstvom usvojenim u skladu sa ovim zakonom ili drugim važećim zakonima, biće uneti u registar. |
| **Neni 17**<br>**Mënyra dhe Procedura e Regjistrimit** | **Article 17**<br>**Mode and Procedure of Registration** | **Član 17**<br>**Način i postupak registracije** |
| 1. Regjistrimi fillestar, regjistrimet e tjera dhe ndryshimi dhe plotësimi i të dhënave ekzistuese në Regjistër bëhet me aplikim në cilëndo qendre të regjistrimit të ARBK, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, pavarësisht vendit të ushtrimit të Veprimtarisë Ekonomike, vendbanimit apo | 1. Initial registration, other registrations and amendments to the existing data in the Registry shall be made through an application at any KBRA Registration Centre, throughout the whole territory of the Republic of Kosovo, regardless of the place of exercise of Business Activity, | 1. Prva registracija, druge registracije kao i izmene i dopune postojećih podataka u Registru vrše se podnošenjem zahteva u bilo kojem centru za registraciju KARP-a na celoj teritoriji Republike Kosovo, bez obzira na mesto vršenja privredne delatnosti, mesto stanovanja ili sedišta |

| | | |
|---|---|---|
| selisë së aplikantit ose në mënyrë elektronike sipas nenit 18 të këtij ligji. | place of residence or seat of applicant, or electronically in accordance with Article 18 of the present Law. | podnosioca zahteva, ili elektronskim putem u skladu sa Članom 18. ovog zakona. |
| 2. ARBK bën regjistrimin fillestar, regjistrimet dhe ndryshimet tjera të të dhënave ekzistuese në Regjistër sipas aplikimit të Shoqërisë Tregtare, në bazë të vendimit të gjykatës apo me ndonjë bazë tjetër të përcaktuar me ligj. ARBK-ja nuk ka të drejtë të refuzojë regjistrimin fillestar, regjistrimet tjera dhe ndryshimin dhe plotësimin në e të dhënave ekzistuese nëse dorëzohen të gjitha dokumentet që kërkohen me ligj dhe nëse ato janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji apo ligjeve të tjera në fuqi. | 2. KBRA shall make the initial registration, other registrations and amendments to the existing data in the Registry on application of the Business Organization, on the basis of a court decision or on another basis provided by law. The KBRA shall not have the right to decline from initial registration, other registrations and amendments to the existing data if all documents required by law are submitted, and they comply with the requirements of this Law or other applicable law. | 2. KARP će izvršiti inicijalnu registraciju, druge registracije i izmene postojećih podataka u registru na prijavi poslovne organizacije, na osnovu sudske odluke ili po drugoj osnovi utvrđenoj zakonom. KARP nema pravo da odbije početnu registraciju, druge registracije i izmene postojećih podataka ukoliko su podneti svi dokumenti zahtevani po zakonu, i oni su u skladu sa zahtevima ovog zakona ili drugog važećeg zakona. |
| 3. Aplikimi nga Shoqëria Tregtare duhet të përcillet me dokumente që përbëjnë bazën për regjistrim në Regjistër. Dokumenti i dorëzuar në ARBK duhet të përmbajë informatat e përcaktuara me këtë ligj dhe ligje të tjera në fuqi. | 3. An application of the Business Organization must be accompanied by the documents which are the basis for an entry in the Registry. A document submitted to the KBRA shall contain the information prescribed by this Law or other applicable law. | 3. Zahtev poslovnog društva mora da bude potkrepljen dokumentima koji su osnova za unos u registar. Dokument koji se podnosi KARP-u sadrži informacije propisane ovim zakonom ili drugim važećim zakonom. |
| 4. Pas dorëzimit të aplikimit për regjistrimin fillestar, regjistrimet e tjera dhe ndryshimet në të dhënat ekzistuese në Regjistër, ARBK-ja shënon në aplikim datën dhe kohën e saktë të pranimit të aplikimit, si dhe duhet të krijojë një listë të dokumenteve që i janë bashkëngjitur aplikimit, si dhe të shënojë numrin e faqeve | 4. Upon submission of an application for initial registration, other registrations and amendments to the existing data in the Registry, KBRA shall inscribe on the application the date and exact time of receipt of the application and shall develop a list of documents attached to the application and indicate the number of | 4. Po podnošenju prijave za početnu registraciju, druge registracije i izmene postojećih podataka u registru, KARP upisuje na prijavi datum i tačno vreme prijema prijave i izrađuje spisak dokumenata koji se prilaže uz prijavu i pokazuje broj stranica u svakom dokumentu. Upis će potpisati službenik koji |

| | | |
|---|---|---|
| në secilin dokument. Shënimi i tillë nënshkruhet nga zyrtari që pranon aplikimin. | pages in each document. The inscription shall be signed by the official who receives the application. | primi prijavu. |
| 5. ARBK-ja bën regjistrimin në Regjistër dhe publikon informatat dhe dokumentet në pajtim me nenin 22 të këtij Ligji jo më vonë se dy (2) ditë pune pas pranimit të aplikimit. | 5. The KBRA shall make an entry in the Registry and publish the information and documents according to article 22 of this Law not later than two (2) working days after receiving an application. | 5. KARP će izvršiti unos u registar i objaviti informaciju i dokumente u skladu sa članom 22 ovog Zakona, najkasnije dva (2) radna dana od prijema prijave. |
| 6. Menjëherë pas pranimit nga ARBK-ja të aplikimit për regjistrim apo çregjistrim apo për ndryshimin e të dhënave në Regjistër, si dhe pas pranimit të çfarëdo dokumenti tjetër, ARBK-ja i dorëzon Përfaqësuesit të Autorizuar ose Përfaqësuesit me Prokurë një vërtetim me shkrim që përmban kohën dhe datën e saktë të pranimit të aplikimit apo dokumenteve të tjera. | 6. Immediately after KBRA receives an application for registration or deregistration or any amendments to the data in the Registry, and after receiving any other document, KBRA shall submit to the Authorized Representative or Authorized Proxya written confirmation showing the exact time and date of the receipt of the application or such other document. | 6. Odmah nakon što KARP primi prijavu za registraciju ili de-registraciju ili bilo kakve izmene u podacima u registru, i nakon prijema bilo kojeg drugog dokumenta, KARP podnosi ovlašćenom predstavniku ili ovlašćenom opunomoćeniku pisanu potvrdu na kojoj se pokazuje tačno vreme i datum prijema prijave ili drugog takvog dokumenta. |
| 7. Nëse aplikimi për regjistrim, çregjistrim apo ndryshim të të dhënave në Regjistër nuk përmbush kërkesat e këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër në fuqi, si dhe për shkak të kësaj mos përmbushjeje, nuk mund të regjistrohet brenda dy (2) ditësh pune nga data e pranimit, ARBK-ja njofton Përfaqësuesin e Autorizuar ose Përfaqësuesin me Prokurë për këtë fakt, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe cakton një afat jo më të gjatë se dhjetë (10) ditë pune për korrigjimin e mangësisë(ve). Nëse këto mangësi nuk korrigjohen deri në | 7. If the application for registration, deregistration or amendment of the data in the Registry fails to meet the requirements of this law or other applicable law, and due to such failure, it cannot be registered within two (2) working days from the date of receipt, KBRA shall notify the Authorized Representative or Authorized Proxy of such fact, pursuant to applicable legislation and shall set a deadline not longer than ten (10) working days for correcting the omission/s. If the omissions are not corrected by the end of the | 7. Ukoliko prijava za registraciju, brisanje registracije ili izmenu podataka u registru ne ispunjava zahteve iz ovog zakona ili drugih važećih zakona i zbog ovakvog propusta ne može biti registrovana u roku od dva (2) radna dana od dana prijema, KARP obaveštava ovlašćenog predstavnika ili ovlašćenog opunomoćenika o ovoj činjenici, shodno važećem zakonodavstvu, i utvrđuje rok koji nije duži od deset (10) radnih dana za popravku propusta. Ukoliko propusti ne budu ispravljeni do isteka roka, KARP može da odbije da odobri prijavu. |

| | | |
|---|---|---|
| fund të afatit, ARBK-ja mund të refuzojë përmbylljen e aplikimit. | deadline, the KBRA may refuse to satisfy the application. | |
| 8. Çdo Shoqëri Tregtare është e obliguar të përditësojë të dhënat e regjistruara në Regjistër, si dhe të sigurojë saktësinë e tyre të përhershme dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e këtij ligji. Ndryshimi i të dhënave nga ato të regjistruara duhet të paraqitet në ARBK brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data kur ka ndodhur ndryshimi përkatës. | 8. Each Business Organization is required to update the data registered in the Registry and ensure their permanent accuracy and compliance with the requirements of the present law.Any amendment to such registered data shall be submitted to the KBRA within fifteen (15) days from the date of such change occurring. | 8. Od svakog poslovnog društva se zahteva da ažurira podatke registrovane u registru i da obezbedi njihovu permanentnu tačnost i usklađenost sa zahtevima ovog zakona. Svaka promena registrovanih podataka se treba prijaviti KARP-u u roku od petnaest (15) dana od dana kada je došlo do te promene. |
| 9. Aplikimi për ndryshim të informatave në regjistër duhet të dorëzohet menjëherë në ARBK nëse të dhënat e regjistruara në Regjistër ndryshojnë, duke përfshirë rastin e emërimit, heqjes apo ndryshimit të së drejtës së përfaqësimit të një drejtori menaxhues apo anëtari Bordi të Korporatës, emërimin e Përfaqësuesit të Autorizuar në Procedurë Falimentimi, apo fillimin e shpërbërjes vullnetare të Korporatës në pajtim me këtë ligj. | 9. An application for amendment of Registry information shall be immediately submitted to the KBRA if the data entered in the Registry change, including in the case of appointment, removal or change of the right of representation of a managing director or board member of a Corporation, the appointment of an Authorized Representative in a Bankruptcy Procedure, or initiation of voluntary dissolution of a Corporation in accordance with this law. | 9. Prijava za izmenu informacije u registru odmah se podnosi KARP ukoliko se podatak koji je unet u registar menja, uključujući i slučajeve imenovanja, smene ili promene prava na zastupanje ili direktora i člana odbora korporacije, imenovanje ovlašćenog predstavnika u stečajnom postupku ili pokretanje dobrovoljnog gašenja korporacije u skladu sa ovim zakonom. |
| 10. Përfaqësuesi i Autorizuar ose Përfaqësuesi me Prokurë mund të dorëzojë dokumentet e regjistrimit në ARBK në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Është e drejtë ekskluzive e Përfaqësuesit të Autorizuar ose Përfaqësuesit me Prokurë të zgjedhë gjuhën, ndërsa ARBK-ja është e obliguar të pranojë dokumentet e | 10. The Authorized Representative or Authorized Proxy may file the registration documents at KBRA in the Albanian, Serbian or English language. It shall be the exclusive right of the Authorized Representative to choose the language, and KBRA is required to accept registration documents filed in any of these three | 10. Ovlašćeni predstavnik ili ovlašćeni opunomoćenik za registraciju može podneti dokumente za registraciju kod KARP na albanskom, srpskom ili engleskom jeziku. Isključivo je pravo ovlašćenog predstavnika da izabere jezik, a od KARP se zahteva da prihvati dokumente za registraciju podnete na bilo kojem od ova tri jezika. Ukoliko je |

| | | |
|---|---|---|
| regjistrimit të dorëzuara në cilëndo prej këtyre tri gjuhëve. Nëse dokumenti origjinal është përgatitur në gjuhë tjetër nga gjuhët e përmendura më lart, dokumentit të tillë duhet t'i bashkëngjitet përkthimi nga një përkthyes i autorizuar në cilëndo prej këtyre tri gjuhëve. | languages. If an original document is prepared in another language than the ones mentioned above, such document must be attached a certified translation into any of these three languages. | originalni dokument pripremljen na drugom jeziku osim onih gore pomenutih, ovakav dokument mora da sadrži priložen overen prevod na neki od ova tri jezika. |
| 11. Përfaqësuesi i Autorizuar ose Përfaqësuesi me Prokurë mund të tërheqë aplikimin para se të bëhet regjistrimi në Regjistër. | 11. An Authorized Representative or Authorized Proxy may withdraw the application before an entry in Registry is made. | 11. Ovlašćeni predstavnik ili Ovlašćeni opunomoćenik može povući prijavu pre nego što se izvrši unos u registar. |
| 12. Aplikimet dhe dokumentet e dorëzuara në ARBK përpunohen në pajtim me procedurën për regjistrim të përcaktuar nga Ministria, përmes një akti nënligjor të miratuar në pajtim me këtë ligj. | 12. Applications and documents submitted to KBRA shall be processed pursuant to the procedure provided for the registration proceedings by the Ministry through a sub-legal act adopted in accordance with this law. | 12. Prijave i dokumente koji se podnose KARP obrađuju se shodno proceduri određenoj za postupak registracije od strane ministarstva putem podzakonskog akta usvojenog u skladu sa ovim zakonom. |
| 13. Nëse një ligj i veçantë kërkon regjistrimin në ARBK sipas paragrafit 2 të këtij neni, procedura e regjistrimit në ARBK duhet të specifikohet me atë ligj të veçantë, apo ndonjë akt nënligjor të miratuar në pajtim me atë ligj të veçantë. Ato akte nënligjore duhen hartuar në bashkëpunim me Ministrinë dhe ARBK-në. | 13. In case a special law requires registration at KBRA as per paragraph 2 of present Article, the KBRA registration procedure shall be specified by such special law or any sub-legal act adopted pursuant to such special law. All such sub-legal acts shall be drafted in collaboration with the Ministry and KBRA. | 13. U slučaju da specijalni zakon zahteva registraciju u KARP prema stavu 2 ovog člana, postupak registracije KARP se precizira takvim specijalnim zakonom ili podzakonskim aktom usvojenim shodno specijalnom zakonu. Svi ovakvi podzakonski akti izrađuju se u saradnji sa ministarstvom i KARP. |
| **Neni 18**<br>**Shërbimet e Regjistrimit Elektronik** | **Article 18**<br>**Electronic Registration Services** | **Član 18**<br>**Registracija i usluge elektronskog registra** |
| 1. Me qëllim të lehtësimit të procedurave të | 1. For the purpose of facilitating | 1. Sa ciljem olakšavanja procedura |

| | | |
|---|---|---|
| regjistrimit të Shoqërive Tregtare dhe ofrimit të shërbimeve të tjera të ndërlidhura me regjistrimin, ARBK është e autorizuar që të iniciojë regjistrimin elektronik të Shoqërive Tregtare dhe të ofrojë shërbime tjera të regjistrimit elektronik.<br><br>2. Veprimet e regjistrimit elektronik dhe shërbimet tjera të regjistrimit kryhen nëpërmjet mjeteve elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik.<br><br>3. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet, afatet dhe procedurat për regjistrimin e Shoqërive Tregtare dhe ofrimin e shërbimeve të tjera të regjistrimit elektronik nga ARBK sipas këtij ligji.<br><br>**Neni 19**<br>**Numri Unik Identifikues**<br><br>1. Me rastin e regjistrimit fillestar, Shoqërisë Tregtare ose subjekti tjetër i përcaktuar në nenin 23 të këtij ligji i lëshohet Numri Unik Identifikues i cili shërben njëkohësisht si numër për identifikimin e Shoqërisë Tregtare për qëllime të regjistrimit dhe për qëllime | registration procedures for Business Organization, and providing other registration related services, KBRA is authorized to initiate electronic registration of Business Organizations and provide other electronic registration services.<br><br>2. Electronic registration activities and other registration services shall be conducted by using electronic means and devices, which guarantee the authenticity of origin and inviolability of the content of documents in electronic format.<br><br>3. The Ministry, through a sub-legal act, shall determine the conditions, time limits and procedures for electronic registration of Business Organizations and the provision of other electronic registration services by KBRA in accordance with the present law.<br><br>**Article 19**<br>**Unique Identification Number**<br><br>1. Upon initial registration, the Business Organization or other entity as provided by Article 23 of the present Law shall receive a Unique Identification Number, which shall simultaneously serve as an identification number for the Business Organization for registration and taxation | registracije poslovnih društava i pružanja drugih usluga u vezi registracije, KARP je ovlašćen da pokrene elektronsku registraciju poslovnih društava kao i da ponudi druge usluge elektronske registracije.<br><br>2. Radnje elektronske registracije i druge usluge registrovanja vrše se putem elektronskih instrumenata koji garantuju autentičnost porekla i integritet sadržaja dokumenata u elektronskom obliku.<br><br>3. Ministarstvo podzakonskim aktom određuje uslove, rokove i procedure za registraciju Poslovnih društava i pružanje drugih usluga elektronske registracije od strane KARP-a u skladu sa ovim zakonom.<br><br>**Član 19**<br>**Jedinstveni identifikacioni broj**<br><br>1. Prilikom prve registracije poslovno društvo ili drugi organ određen u članu 23. ovog zakona izdaje Jedinstveni identifikacioni broj koji istovremeno služi kao broj za identifikaciju Poslovnog društva u registracione i poreske, kao i u druge svrhe utvrđene podzakonskim aktima |

| | | |
|---|---|---|
| tatimore, si dhe për qëllime të tjera të përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria sipas paragrafit 2 të këtij neni. | purposes, and other purposes as specified in a sub-legal act adopted by the Government, in accordance with paragraph 2 of this article. | usvojenim od strane Vlade u skladu sa stavom 2. ovog člana. |
| 2. Brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Ministria në bashkëpunim me Ministrinë e Financave do të hartojë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës do të miratojë një akt nënligjor me të cilin përcaktohen kërkesat, kushtet dhe procedurat për krijimin e Numrit Unik Identifikues. | 2. Within six (6) months from the entry into force of this Law, the Ministry, in cooperation with the Ministry of Finance, shall draft, and the Government of the Republic of Kosovo shall adopt a sub-legal act setting forth the requirements, conditions and procedures for the creation of the Unique Identification Number. | 2. U roku od šest (6) meseci od stupanja na snagu ovog zakona, Ministarstvo u saradnji sa Ministarstvom finansija će izraditi a Vlada Republike Kosovo će usvojiti podzakonski akt kojim se utvrđuju zahtevi, uslovi i procedure za utvrđivanje Jedinstvenog identifikacionog broja. |
| 3. Brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjitha autoritetet publike veprimtaria e të cilave ndikohet nga krijimi i numrit unik identifikues obligohen që të hartojnë dhe dorëzojnë për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në ligjet ose aktet nënligjore përkatëse. | 3. Within one (1) year from the entry into force of the present law, all Public Authorities the activities of which are affected by the establishment of the unique identification number shall be required to draft and submit for the approval to the Government of the Republic of Kosovo the necessary amendments to the respective laws and sub-legal acts. | 3. U roku od jedne godine (1) od stupanja na snagu ovog zakona, sve javne vlasti čija delatnost utiče na utvrđivanje Jedinstvenog identifikacionog broja, u obavezi su da izrade i predaju na usvajanje u Vladi Republike Kosovo neophodne izmene i dopune u odgovarajućeg zakona ili podzakonskih akata. |
| **Neni 20**<br>**Natyra e Regjistrimit** | **Article 20**<br>**Nature of Registration** | **Član 20**<br>**Priroda registracije** |
| 1. Regjistrimi fillestar, regjistrimet e tjera dhe ndryshimi apo plotësimi i të dhënave në Regjistër si dhe çregjistrimi në ARBK kanë efektin juridik të përcaktuar me këtë ligj. | 1. Initial registration, any other registration and amendments to data in the Registry, and deregistration at KBRA have legal effect prescribed by this law. | 1. Prva registracija, sve ostale registracije i izmene i dopune podataka u registru kao i odjava u KARP-u imaju pravni efekat propisan ovim Zakonom. |
| 2. Informatat dhe dokumentet e regjistruara | 2. The registered information and | 2. Registrovane informacije i dokumenti |

| | | |
|---|---|---|
| dhe të publikuara në pajtim me nenin 22 të këtij ligji konsiderohen si të sakta ndaj një pale të tretë, përveç nëse pala e tretë ka njohuri ose është dashur të dijë që regjistrimi apo dokumenti nuk është i saktë. Regjistrimi konsiderohet të mos vlejë në lidhje me transaksionet që lidhen para ditës së gjashtëmbëdhjetë (16) pas regjistrimit në Regjistër, nëse një palë e tretë dëshmon se pala e tretë nuk ka pasur njohuri e as nuk është dashur të ketë njohuri për përmbajtjen e regjistrimit. | documents published according to article 22 of this Law shall be considered as correct with regard to a third person, except if the third person knew or should have known that the registration or document is not correct. A registration shall be considered not to apply with regard to transactions which are concluded before the sixteenth (16) day after the entry is made in the Registry if a third person proves that the third person was not aware nor should have been aware of the content of the registration. | objavljeni u skladu sa članom 22. ovog Zakona će se smatrati pravilnim u smislu trećih lica, izuzev ako je treće lice znalo ili je trebalo da zna da registracija ili dokument nije pravilan. Smatraće se da se registracija ne odnosi na transakcije koje su zaključene pre šesnaestog (16) dana nakon unosa u registar, ukoliko treća strana dokaže da treća strana nije bila svesna niti je trebala biti svesna sadržaja registracije. |
| 3. Nëse informatat që duhen regjistruar në Regjistër nuk janë regjistruar në Regjistër, informatat e tilla do të kenë efekt juridik mbi palët e treta vetëm nëse ato palë të treta kanë pasur njohuri ose është dashur të kenë njohuri për informatat e tilla. | 3. If information which must be entered in the Registry is not entered in the Registry, such information shall have legal effect with regard to a third person only if the third person knew or should have known about such information. | 3. Ako informacije koje trebaju da budu unete u registar nisu unete u registar, takve informacije će imati pravni efekat prema trećim licima samo ukoliko je treće lice znalo ili trebalo znati o takvoj informaciji. |
| **Neni 21**<br>**Korrigjimi i Gabimeve** | **Article 21**<br>**Correction of Errors** | **Član 21**<br>**Ispravljanje grešaka** |
| 1. ARBK mund t'i korrigjojë gabimet e saj në çdo kohë. Në këtë rast, ajo duhet: | 1. KBRA may correct its own errors at any time. In this case, it shall: | 1. KARP može ispraviti svoje greške u svakom momentu. U ovom slučaju treba da: |
| 1.1. t'ia bashkëngjesë dokumentit të regjistruar një shënim që tregon natyrën, datën, kohën dhe arsyet e korrigjimit; dhe | 1.1. attach a note to the registered document describing the nature, date, time and reasons of such correction; and | 1.1.priloži registrovanom dokumentu prilog koji govori o prirodi, datumu, vremenu i razlogu ispravke; i |
| 1.2. menjëherë t'ia dorëzojë Shoqërisë | 1.2. immediately notify the Business | 1.2.odmah dostavi poslovnom društvu |

| | | |
|---|---|---|
| Tregtare përkatëse shënimin e sipër cekur.<br><br>2. Një Shoqëri Tregtare mund t'i korrigjojë gabimet e saj në çdo kohë me paraqitjen e kërkesës gjegjëse në ARBK.<br><br>3. Nëse ARBK-ja ka informata në lidhje me pasaktësinë e një të dhëne të regjistruar apo që një e dhënë mungon, ARBK bën hulumtimet e duhura.<br><br>4. Pas vërtetimit që të dhënat në Regjistër janë të pasakta apo mungojnë, ARBK-ja njofton Shoqërinë Tregtare në aplikimin e së cilës duhet bërë regjistrimi. Nëse nuk ka kundërshtim ndaj regjistrimit apo korrigjimit të informatave brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas atij njoftimi, ARBK-ja bën regjistrimin apo korrigjon të dhënat. Pas pranimit të kundërshtimit, ARBK-ja vendos nëse ai kundërshtim ka bazë.<br><br>5. Autoritetet Publike, noterët dhe përmbaruesit privatë janë të obliguar të njoftojnë ARBK-në mbi informatat e pasakta në Regjistër, apo mbi çfarëdo lloj informate që nuk është dorëzuar në Regjistër, për të cilën kanë fituar njohuri.<br><br>6. Nëse dorëzohen informata të pasakta në ARBK, Shoqëria Tregtare dhe Përfaqësuesi i Autorizuar ose Përfaqësuesi me Prokuorë | Organization of the above-mentioned note.<br><br>2. A Business Organization may correct its own errors at any time, by filing the respective application with KBRA.<br><br>3. If KBRA has information concerning the incorrectness of an entry or that an entry is missing, the KBRA shall make the appropriate inquiries.<br><br>4. Upon ascertaining that data in the Registry is incorrect or missing, the KBRA shall notify the Business Organization on the basis of whose application the entry should be made. If no objection to making or correcting the information is made within fifteen (15) days after the notice, the KBRA shall make or correct the entry. Upon receipt of an objection, the KBRA shall decide whether the objection is justified.<br><br>5. Public Authorities, notaries and private enforcement officers are required to notify KBRA of any incorrect information in the Registry or of any information which has not been submitted to the Registry that they become aware of.<br><br>6. If incorrect information is submitted to KBRA, the Business Organization and Authorized Representative or Authorized | gore pomenutu belešku.<br><br>2. Poslovno društvo može ispravljati svoje greške u svakom momentu podnošenjem odgovarajućeg zahteva KARP-u.<br><br>3.Ukoliko KARP raspolaže informacijama u vezi netačnosti bilo kojeg unosa ili da nedostaje unos, KARP će izvršiti odgovarajuća ispitivanja.<br><br>4. Nakon potvrđivanja da podaci u Registru nisu tačni ili nedostaju, KARP je dužan da obavesti poslovno društvo na osnovu aplikacije u čije ime je unos upisan. Ukoliko ne bude dostavljena primedba o izvršenju ili ispravljanju greške u roku od petnaest (15) dana nakon obaveštenja., KARP će izvršiti ili ispraviti unos. Nakon prijema primedbe, KARP će doneti odluku da li je primedba opravdana.<br><br>5. Javni organi, javni beležnici i privatni izvršioci su dužni da obaveste KARP o bilo kakvim nepravilnim informacijama u Registru ili o informacijama koje nisu dostavljene Registru kada steknu saznanja o istima.<br><br>6. U slučaju podnošenja netačnih informacija KARP-u, poslovno društvo, ovlašćeni predstavnik ili ovlašćeni |

| | | |
|---|---|---|
| që kanë dorëzuar dokumentet në ARBK mbajnë përgjegjësi për dëmet që mund të jenë shkaktuar me keqdashje. | Proxy shall be liable for any damage wrongfully caused. | opunomoćenik će snositi odgovornost za neopravdano prouzrokovanu štetu. |
| **Neni 22**<br>**Publikimi i Ekstraktit të Regjistrit në Faqen Zyrtare të Internetit të ARBK -së** | **Article 22**<br>**Publication of Extract of Registry in the Official KBRA Website** | **Član 22**<br>**Objavljivanje uverenja iz registra na zvaničnoj internet stranici KARP-a** |
| 1. Për secilën Shoqëri Tregtare të regjistruar, ARBK publikon në faqen e saj zyrtare në internet të dhënat dhe dokumentet në vijim, ose çfarëdo ndryshimi të këtyre të dhënave, në kohën e përfundimit të regjistrimit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji: | 1. For each registered Business Organization, KBRA shall publish in its official website the following data and documents, or any amendment to such data at the time of completion of the registration pursuant to Article 17 of this law: | 1. Za svako registrovano poslovno društvo, KARP objavljuje na svojoj zvaničnoj internet stranici sledeće podatke i dokumente, ili bilo kakvu izmenu ovih podataka, u vreme okončanja registracije u skladu sa članom 17. ovog zakona: |
| 1.1. emrin zyrtar dhe Numrin Unik Identifikues të Shoqërisë Tregtare; | 1.1. The official name and Unique Identification Number of the Business Organization; | 1.1. zvanični naziv i jedinstveni identifikacioni broj poslovnog društva |
| 1.2. të gjithë emrat tregtar të Shoqërisë Tregtare; | 1.2. All Trade Names of the Business Organization; | 1.2. sve tržišne nazive poslovnog društva; |
| 1.3. llojin e Shoqërisë Tregtare; | 1.3. type of Business Organization; | 1.3. vrstu poslovnog društva; |
| 1.4. adresën e Shoqërisë Tregtare; | 1.4. address of the Business Organization; | 1.4. adresu poslovnog društva; |
| 1.5. emrin dhe adresën e secilit themelues; | 1.5. name and address of each founder; | 1.5. ime i adresu svakog osnivača; |
| 1.6. listën e aksionarëve të Korporatave të mbajtura në pajtim me nenin 83 dhe nenin 134 të këtij ligji, emrat dhe adresat e ortakëve të ortakërive të | 1.6. list of shareholders of corporations held in accordance with Article 83 and Article 134 of this law, names and addresses of partners of general | 1.6. listu deoničara korporacija, koja se održava u skladu sa članom 83. i 134. ovog Zakona, imena i adrese partnera generalnog partnerstva i ograničenih |

| | | |
|---|---|---|
| përgjithshme dhe atyre të kufizuara; | partnerships and limited partnerships; | partnerstava; |
| 1.7. emrat e Përfaqësuesve të Autorizuar si dhe një shpjegim nëse ata mund ta përfaqësojnë Shoqërinë Tregtare individualisht apo bashkërisht, si dhe, nëse është e aplikueshme, emrin dhe adresën e personit përgjegjës për pranimin e dokumenteve sipas nenit 25 të këtij ligji; | 1.7. names of Authorized Representatives and a clarification whether some or all Authorized Representatives shall represent the Business Organization individually or jointly, and if applicable, the name and address of the person responsible to receive documents according to Article 25 of this Law; | 1.7. imena ovlašćenih predstavnika i objašnjenjeda li neki od ovlašćenih predstavnika predstavljaju poslovno društvo individualno ili zajednički, i ako je primenjivo, ime i adrese lica nadležnog za primanje dokumenata u skladu sa članom 25. ovog Zakona; |
| 1.8. kohëzgjatjen e Shoqërisë Tregtare, nëse nuk është e përhershme; dhe | 1.8 the duration of the Business Organization, if it is not permanent; | 1.8. trajanje poslovnog društva, ukoliko nije trajno; |
| 1.9. kapitalin themeltar për Shoqëritë Aksionare. | 1.9 charter capital for the Joint Stock Companies; | 1.9. osnivački kapital deoničarskog društva; |
| 1.10. emrat e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për Korporatat; | 1.10. the names of members of Board of Directors for Corporations; | 1.10. imena članova upravnog odbora za korporacije; |
| 1.11. teksti i plotë i Marrëveshjes së Ortakërisë për Ortakëri, Statutit dhe Memorandumi i Inkorporimit i një Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar apo Shoqërie Aksionare, në version përfundimtar të dorëzuar në ARBK; | 1.11. complete text of the Partnership Agreement for Partnerships, the Charter and Memorandum of Incorporation of a Limited Liability Company or Joint Stock Company in final version submitted to KBRA; | 1.11. celokupni tekst sporazuma o partnerstvu za partnerstva, statuta ili memoranduma o inkorporaciji za društvo sa ograničenom odgovornošću i deoničarsko društvo u konačnoj verziji, dostavljenoj KARP-u, |
| 1.12. inicimin i shpërbërjes vullnetare të Korporatës në pajtim me këtë ligj ose inicimin e procedurës së falimentimit të Shoqërisë Tregtare në pajtim me ligjin në fuqi për falimentimin; | 1.12. the initiation of voluntary dissolution of a Corporation in accordance with this law or the initiation of bankruptcy proceedings of the Business Organization in accordance with the applicable law on | 1.12. pokretanje dobrovoljnog raspuštanja korporacije u skladu sa ovim Zakonom i pokretanje stečajnog postupka poslovnog društva u skladu sa zakonom na snazi o stečaju, |

| | | |
|---|---|---|
| | bankruptcy; | |
| 1.13. shpalljen si të pavlefshme të Shoqërisë Tregtare nga gjykatat; | 1.13. any declaration of nullity of the Business Organization by the courts; | 1.13. izjavu o poništenju poslovne organizacije od sudova; |
| 1.14. emërimin e Përfaqësuesit të Autorizuar në Procedurë Falimentimi, detajet në lidhje me ta si dhe kompetencat përkatëse të tyre, përveç nëse kompetencat e tilla rrjedhin shprehimisht dhe ekskluzivisht nga ligji; | 1.14. the appointment of an Authorized Representative in a Bankruptcy Procedure, particulars concerning them, and their respective powers, unless such powers are expressly and exclusively derived from law; | 1.14 imenovanje ovlašćenog predstavnika u stečajnom postupku, informacije o njima kao i njihova ovlašćenja, izuzev ako su ta ovlašćenja izričito i ekskluzivno propisana zakonom, |
| 1.15. përfundimi apo likuidimi i Shoqërisë Tregtare. | 1.15. the termination or liquidation of the Business Organization. | 1.15. gašenje ili likvidaciju poslovnog društva. |
| 2. Për çdo degë të regjistruar të Shoqërisë së Huaj Tregtare, ARBK publikon në faqen zyrtare të internetit të dhënat dhe dokumentet si në vijim, apo ndryshimet në të dhënat e tilla, në kohën e përfundimit të regjistrimit fillestar të Degës së Shoqërisë së Huaj Tregtare apo ndonjë regjistrimi tjetër: | 2. For each registered Branch of Foreign Business Organization, KBRA shall publish in its official website the following data and documents, or any amendment to such data, at the time of completion of the initial registration of the Branch of Foreign Business Organization or any other registrations: | 2. Za svaki registrovani ogranak stranog poslovnog društva, KARP na svojoj internet stranici objavljuje sledeće podatke i dokumenta ili izmene i dopune takvih podataka, u vreme okončanja registracije ogranka stranog poslovnog društva ili druge registracije: |
| 2.1. emri zyrtar i Degës së Shoqërisë së Huaj Tregtare; | 2.1.the official name of the Branch of the Foreign Business Organization; | 2.1. zvanični naziv ogranka stranog poslovnog društva |
| 2.2. vendi dhe adresa e Degës së Shoqërisë së Huaj Tregtare; | 2.2. the location and address of the Branch of the Foreign Business Organization; | 2.2. mesto i adresu stranog poslovnog društva, |
| 2.3. regjistri në të cilin është regjistruar Shoqëria e Huaj Tregtare si dhe numrin | 2.3. the register in which the Foreign Business Organization is registered and | 2.3. registar u kojem je registrovano strano poslovno društvo i registracioni |

| | | |
|---|---|---|
| e regjistrimit, nëse regjistrimi në regjistër parashihet me legjislacion të një vendi të huaj; | the registration number if entry in a register is prescribed by the law of the foreign country; | broj ukoliko je registracija u registar propisana zakonom strane zemlje, |
| 2.4. forma ligjore e Shoqërisë së Huaj Tregtare; | 2.4. the legal form of the Foreign Business Organization; | 2.4. pravni oblik stranog poslovnog društva, |
| 2.5. vendi nën ligjin e të cilit Shoqëria e Huaj Tregtare operon në vendin e huaj; | 2.5. the country under whose law the Foreign Business Organization operates in the foreign country; | 2.5. zemlju prema čijem zakonu stranog poslovno društvo deluje u stranoj zemlji, |
| 2.6. shuma e kapitalit të aksioneve të Shoqërisë së Huaj Tregtare nëse kjo është shënuar në regjistrin e vendit të Shoqërisë së Huaj Tregtare; | 2.6.the amount of share capital of the Foreign Business Organization if this is entered in a register of the foreign country of the Foreign Business Organization; | 2.6. iznos deoničarskog kapitala stranog poslovnog društva, ukoliko je to uneto u registar strane zemlje za stranog poslovno društvo, |
| 2.7. data e miratimit të Statutit të Shoqërisë së Huaj Tregtare si dhe të ndryshimeve në Statut, nëse këto janë shënuar në regjistrin e vendit të Shoqërisë së Huaj Tregtare; | 2.7. the date of adoption of the charter of the Foreign Business Organization and of amendments to the charter if these are entered in a register of the foreign country of the Foreign Business Organization; | 2.7. datum donošenja statuta stranog poslovnog društva i izmene i dopune statuta ukoliko su unete u registar strane zemlje stranog poslovnog društva, |
| 2.8. emrat e Përfaqësuesve të Autorizuar dhe informatat nëse disa ose të gjithë Përfaqësuesit e Autorizuar do të përfaqësojnë Shoqërinë Tregtare bashkërisht, si dhe nëse është e aplikueshme, emrin dhe adresën e personit kompetent për pranimin e dokumenteve sipas nenit 25 të këtij ligji; | 2.8. names of Authorized Representatives and information whether some or all Authorized Representatives shall represent the Business Organization jointly, and if applicable, the name and address of the person competent to receive documents according to Article 25 of this Law; | 2.8 imena ovlašćenih predstavnika i informacije da li će neki ili svi ovlašćeni predstavnici predstavljati poslovno društvo zajednički i, ako je primenjivo, ime i adrese lica kompetentnog za primanje dokumenata u skladu sa članom 25. ovog Zakona, |
| 2.9. fillimi dhe fundi i vitit financiar të | 2.9. the beginning and end of the | 2.9. početak i kraj finansijske godine |

| | | |
|---|---|---|
| Shoqërisë së Huaj Tregtare si dhe nëse Shoqëria e Huaj Tregtare duhet të publikojë raportin vjetor. | financial year of the Foreign Business Organization and whether the Foreign Business Organization must publish an annual report. | stranog poslovnog društva i da li je strano poslovno društvo dužno da objavljuje godišnji izveštaj. |
| 3. Informatat dhe dokumentet e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni mund të përdoren nga Shoqëria Tregtare ndaj palëve të treta vetëm pasi të jenë publikuar në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, përveç nëse Shoqëria Tregtare dëshmon se palët e treta kanë pasur njohuri. Megjithatë, sa i përket transaksioneve që bëhen para ditës së gjashtëmbëdhjetë (16) pas publikimit, dokumentet dhe informatat nuk mund të përdoren ndaj palëve të treta që dëshmojnë se ka qenë e pamundur që ata të kenë pasur njohuri për këtë. | 3. The information and documents specified in paragraph 1 and 2 of this Article may be relied on by the Business Organization as against third parties only after they have been disclosed in accordance with paragraph 1 of this article, unless the Business Organization proves that the third parties had knowledge thereof. However, with regard to transactions taking place before the sixteenth (16) day following the publication, the documents and information shall not be relied on as against third parties who prove that it was impossible for them to have had knowledge thereof. | 3. Informacije i dokumenti navedeni u stavovima 1 i 2 ovog člana se mogu uzeti u obzir od starne poslovnog društva naspram trećih strana jedino ako su objavljene u skladu sa stavom 1 ovog člana, osim ako poslovno društvo dokaže da su treće strane bile upoznate sa navedenim. Međutim, u pogledu transakcija koje su se dogodile pre šesnaestog (16) dana nakon objavljivanja, dokumenti i informacije se neće uzimati u obzir u odnosu na treće strane koje dokažu da je bilo nemoguće za njih da imaju saznanja o navedenom. |
| 4. ARBK-ja krijon dhe lejon mundësinë e shtypjes së versionit të ekstraktit drejtpërdrejt nga faqja e saj e internetit, duke paraqitur kohën dhe datën e saktë të shtypjes që mund të përdoret nga Shoqëritë Tregtare gjatë ndërveprimit me autoritetet publike. Autoritetet Publike bëjnë verifikimin e këtyre të dhënave duke i'u referuar të dhënave të publikuara nga ARBK në faqen e saj në internet. | 4. KBRA shall create and allow the possibility of printing a version of the extract directly from its website indicating the exact time and date of printing, that may be used by Business Organizations in their relations with public authorities. Public authorities shall verify such data by referring to data published by KBRA in its website. | 4. KARP osniva i dozvoljava mogućnost verzije za štampanje izvoda direktno sa svoje internet stranice navodeći tačno vreme i datum štampanja, koje će poslovna društva moći koristiti u interakciji sa javnim organima. Javni organi proveravaju ove podatke pregledom podataka koje je objavio KARP na svojoj internet stranici. |
| 5. Marrëveshja e Ortakërisë, Memorandumi | 5. A Partnership Agreement, | 5. Ugovor o partnerstvu, ugovor o |

| | | |
|---|---|---|
| i Inkorporimit dhe Statuti i një Korporate konsiderohen të jenë të vlefshme pas regjistrimit dhe publikimit të tyre në Regjistër, edhe nëse Marrëveshja e Ortakërisë, Memorandumi i Inkorporimit apo Statuti janë lidhur në rrethana që e bëjnë atë të pavlefshme. Marrëveshja e Ortakërisë, Memorandumi i Inkorporimit ose Statuti nuk mund të shfuqizohen pas regjistrimit dhe publikimit të tyre në Regjistër. | Memorandum of Incorporation and a Charter of a Corporation are deemed to be valid after their entry and publication in the Registry, even if the Partnership Agreement, Memorandum of Incorporation or Charter was entered into under circumstances rendering it void. The Partnerships Agreement, Memorandum of Incorporation or Charter shall not be repealed after their entry and Publication in the Registry. | inkorporaciji ili statut korporacije se smatraju validnim nakon njihovog unosa i objavljivanja u Registar, čak i kada su ugovor o partnerstvu, ugovor o inkorporaciji ili statut korporacije uneti prema okolnostima koje ga čine ništavnim. Ugovor o partnerstvu, ugovor o inkorporaciji ili statut korporacije se ne mogu poništiti nakon unosa i objavljivanja u Registru. |
| **KAPITULLI III<br>DETYRIMI PËR REGJISTRIM, PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR** | **CHAPTER III<br>MANDATORY REGISTRATION AND AUTHORIZED REPRESENTATIVES** | **POGLAVLJE III<br>OBAVEZE ZA REGISTRACIJU, OVLAŠĆENA OSOBA ZA REGISTRACIJU I REGISTROVANA KANCELARIJA** |
| **Neni 23<br>Detyrimi për Regjistrim** | **Article 23<br>Mandatory Registration** | **Član 23<br>Obaveze za registraciju** |
| 1. Shoqëritë Tregtare vijuese janë të detyruara të regjistrohen në Regjistër janë: | 1. The following Business Organizations are required to register in the Registry: | 1. Poslovna društva obavezna da se registruju u Registru su: |
| 1.1. Bizneset Individuale; | 1.1. Individual Businesses; | 1.1.Samostalno preduzeće; |
| 1.2. Ortakëritë e Përgjithshme; | 1.2. General Partnerships; | 1.2.Generalno partnerstvo; |
| 1.3. Ortakëritë e Kufizuara; | 1.3. Limited Partnerships; | 1.3.Ograničeno partnerstvo; |
| 4. Nëse Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve aprovon ankesën e parashtruesit të ankesës në shkallë të dytë administrative, ai do të kërkojë nga Drejtori i Përgjithshëm i ARBK që të ndërmarrë veprimet përkatëse për korrigjimin e shkeljes administrative. | 4. If the Commission for Reviewing Business Registration Complaints approves the complaint of the claimant in the second administrative instance, it shall require from the General Director of KBRA to take relevant action to correct the administrative infringement. | 4. Ukoliko Komisija za razmatranje žalbi povodom registracije preduzeća usvoji žalbu, podnosilac drugostepene administrativne žalbe, u tom slučaju će on tražiti od opšteg direktora KARP-a da preduzme odgovarajuće postupke za ispravku administrativne povrede. |
| 5. Nëse Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve refuzon ankesën e palës apo nuk përgjigjet në ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dorëzimi i ankesës, parashtruesi i ankesës mund t’i drejtohet gjykatës kompetente sipas ligjit në fuqi për konfliktin administrativ. | 5. If the Commission for Reviewing Business Registration Complaints rejects the complaint of the claimant, or does not respond to the complaint within fifteen (15) days from the submission of the complaint, the complainant may resort to a competent court in compliance with the law in force on administrative conflicts. | 5. Ukoliko Komisija za razmatranje žalbi povodom registracije preduzeća odbije žalbu stranke ili ne odgovori na žalbu u roku od petnaest (15) dana od podnošenja žalbe, podnosilac žalbe može istu uputiti nadležnom sudu u skladu sa zakonom na snazi o administrativnom sukobu. |
| 6. Për të gjitha çështjet lidhur me ankesat administrative që nuk janë të rregulluara në këtë ligj, aplikohen dispozitat përkatëse të ligjit në fuqi për procedurën administrative. | 6. The relevant applicable provisions on the administrative procedure shall apply to all the issues related to administrative complaints which have not been regulated in this law. | 6. Za sva pitanja u vezi sa administrativnim zabranama koja nisu regulisana ovim zakonom, primenjuju se odgovarajuće odredbe zakona na snazi o administrativnim procedurama. |

| PJESA E TRETË<br>BIZNESI INDIVIDUAL<br><br>Neni 48<br>Përgjegjësia e Pakufizuar, nuk është Person Juridik | PART THREE<br>INDIVIDUAL BUSINESS<br><br>Article 48<br>Unlimited Liability, No Legal Personality | TREĆI DEO<br>INDIVIDUALNO PREDUZEĆE<br><br>Član 48<br>Neograničena odgovornost, nije pravno lice |
|---|---|---|
| 1. Një person mund të ketë vetëm një Biznes Individual. Personi i cili është pronar i një Biznesi Individual, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë, në një Biznes Individual. Kjo përgjegjësi është e pa-kufizuar dhe përfshin tërë pronën dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të këtij Personi, pavarësisht nga fakti se nëse prona ose asetet e tilla shfrytëzohen për qëllime afariste, personale apo shtëpiake, përveç pronës ose aseteve të përcaktuara në ligjin në fuqi për procedurën përmbarimore, dhe kur:<br><br>1.1.kontrata e cila e ka krijuar këtë përgjegjësi shprehimisht e përjashton nga përgjegjësia pronën ose asetet;<br><br>1.2. personi ose shoqëria tregtare që ka pretendime është pajtuar që këto asetet ose prona të mos i nënshtrohen pretendimeve të tij.<br><br>2. Prona ose asetet konsiderohen se janë në | 1. A Person may have only one Individual Business. A Person who is the owner of an Individual Business, shall have unlimited personal liability for all debts and other obligations incurred or imposed by Law or a contract, on the Individual Business. This liability is unlimited and extends to all property and assets of any type directly or indirectly owned by this Person, regardless of whether such property/assets are used for business purposes or for personal or household purposes, except for the property and assets specified by the applicable law on enforcement procedure, and when:<br><br>1.1. a contract which has created the liability expressly excludes properties or assets from liability;<br><br>1.2. the Person or Business Organization who has claims has agreed that such assets or property are not subject to such claims.<br><br>2. Property or assets shall be considered to | 1.Jedna osoba može imati samo jedno individualno preduzeće. Osoba koja je vlasnik individualnog preduzeća ima neograničenu ličnu odgovornost za sve dugove i druge obaveze prouzrokovane ili nametnute nekim zakonom ili ugovorom u jednom individualnom preduzeću. Ova odgovornost je neograničena i uključuje vlasništvo i sredstva svake vrste koja su u direktnom ili indirektnom vlasništvu ove osobe, bez obzira na činjenicu da li imovinu ili druga sredstva koristi za poslovne, lične ili kućne ciljeve, osim imovine i sredstava utvrđenih zakonom na snazi o izvršnom postupku i kada:<br><br>1.1.ugovor koji je stvorio ovu odgovornost izričito oslobađa od odgovornosti ovu imovinu ili sredstva;<br><br>1.2.osoba ili poslovno društvo koje ima pretenzije je saglasno da ova sredstva ili imovina ne podležu njegovim pretenzijama.<br><br>2.Imovina ili sredstva za koje se smatra da |

| | | |
|---|---|---|
| pronësi të tërthortë të një personi që është pronar i Biznesit Individual nëse: | be indirectly owned by a person who owns an Individual Business if: | su u indirektnom vlasništvu osobe koja je vlasnik individualnog preduzeća ukoliko: |
| 2.1. ky person ka mundësi që të kontrollojë shfrytëzimin dhe disponimin e këtyre pronave ose aseteve; dhe | 2.1. this person can control the use or disposition of such property or assets; and | 2.1.ova osoba ima mogućnost da kontroliše i raspolaže ovom imovinom i sredstvima; i |
| 2.2. ka dëshmi të mjaftueshme për të konkluduar se një person ose Shoqëri tjetër Tregtare është emëruar formalisht si pronar kryesor me qëllim të mbrojtjes së pronës ose aseteve nga përgjegjësia e pronarit të biznesit individual. | 2.2. there is sufficient evidence to conclude that another Person or Business Organization has been formally named as the principal owner for the purpose of protecting property or assets from exposure to liability of the person owning an individual business. | 2.2. ima dovoljan dokaz da se zaključi daje jedna osoba ili poslovno društvo formalno imenovano kao glavni vlasnik sa ciljem zaštite imovine ili sredstava vlasnika individualnog preduzeća. |
| 3. Biznesi Individual nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ai mund të lidhë kontratë, të ketë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë i paditur, në emrin e Biznesit Individual apo të pronarit. | 3. An Individual Business is not a legal person. Nevertheless, it may enter into a contract, own property and sue or be sued in its own name or in the name of its owner. | 3. Individualno preduzeće nije pravno lice. Bez obzira na ovo, može sklapati ugovore, imati imovinu, podnositi tužbu ili biti tužen, u ime individualnog preduzeća ili vlasnika. |
| 4. Biznesi Individual mund të ushtrojë veprimtarinë ekonomike në një ose më shumë lokacione. | 4. An Individual Business may conduct its Business Activities in one or more locations. | 4. Individualno preduzeće može obavljati privrednu delatnost na jednoj ili više lokacija. |
| **PJESA E KATËRT**<br>**ORTAKËRIA E PËRGJITHSHME** | **PART FOUR**<br>**GENERAL PARTNERSHIP** | **ČETVRTI DEO**<br>**GENERALNO PARTNERSTVO** |
| **Neni 49**<br>**Natyra e Ortakërisë së Përgjithshme** | **Article 49**<br>**Nature of a General Partnership** | **Član 49**<br>**Priroda generalnog partnerstva** |
| 1. Ortakëria e Përgjithshme është Shoqëri | 1. A General Partnership is a Business | 1.Generalno partnerstvo je poslovno |

| | | |
|---|---|---|
| Tregtare e cila themelohet përmes regjistrimit në ARBK sipas këtij ligji.<br><br>2. Ortakët e Përgjithshëm të Ortakërisë së Përgjithshme janë personat fizik ose juridik dhe/ose Shoqëritë Tregtare të përcaktuara në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme.<br><br>3. Ortakëria e Përgjithshme nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ajo mund të lidhë kontratë, të ketë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë e paditur, në emrin e saj.<br><br>**Neni 50**<br>**Marrëveshja e Ortakërisë së Përgjithshme**<br><br>1. Marrëveshja e Ortakërisë së Përgjithshme ka përmbajtjen e përcaktuar në nenin 31 të këtij ligji.<br><br>2. Përveç siç është përcaktuar në nenin 31 të këtij ligji, Ortakët e Përgjithshëm në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme mund të përfshijnë ose ndryshojnë cilëndo nga dispozitat e kësaj Pjese të cilat i rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet vetë Ortakëve të Përgjithshëm. Në rast të konfliktit ndërmjet dispozitave të Pjesës sëKatërt të këtij ligji dhe një dispozite të Marrëveshjes së Ortakërisë së Përgjithshme që rregullon marrëdhëniet mes Ortakëve të | Organization established after registration at KBRA in accordance with this law.<br><br>2. The General Partners of a General Partnership are natural or legal persons and/or Business Organizations specified in the General Partnership Agreement.<br><br>3. A General Partnership is not a legal person. Nevertheless, it may enter into a contract, own property and sue or be sued in its own name.<br><br>**Article 50**<br>**General Partnership Agreement**<br><br>1. A General Partnership Agreement shall have the contents provided in Article 31 of this Law.<br><br>2. Except as provided in Article 31 of this Law, the General Partners in a General Partnership Agreement may include or amend any of the provisions in this Part regulating the relationship between the General Partners themselves. In case of any conflict between provisions of Part Four of this law and a provision in the General Partnership Agreement on the relationships between the General Partners, the provisions of the General | društvo koje se osniva putem registracije u KARP-u u skladu sa ovim zakonom.<br><br>2.Generalni ortaci generalnog partnerstva su fizička ili pravna lica i/ili poslovna društva utvrđene Sporazumom o generalnom partnerstvu.<br><br>3.Generalno partnerstvo nije pravno lice. Bez obzira na ovo, ono može sklapati ugovore, imati imovinu, podnositi tužbu ili biti tuženo, u njegovo ime.<br><br>**Član 50**<br>**Sporazum o generalnom partnerstvu**<br><br>1.Sporazum o generalnom partnerstvu ima sadržaj utvrđen članom 31. ovog zakona.<br><br>2.Osim kao što je predviđeno članom 31 ovog zakona, generalni ortaci u Sporazumu o generalnom partnerstvu mogu obuhvatiti ili izmeniti bilo koju od odredbi ovog dela koje regulišu odnose između generalnih ortaka. U slučaju sukoba između odredbi četvrtog del ovog zakona i neke odredbe Sporazuma o generalnom partnerstvu koja reguliše odnose među generalnim ortacima, odredba Sporazuma o opštem partnerstvima prednost. |

| | | |
|---|---|---|
| Përgjithshëm, dispozitat e Marrëveshjes së Ortakërisë së Përgjithshme kanë përparësi. | Partnership Agreement shall prevail. | |
| **Neni 51**<br>**Natyra e Kuotës në Ortakërinë e Përgjithshme** | **Article 51**<br>**Nature of Partnership Interest in a General Partnership** | **Član 51**<br>**Priroda udela u generalnom partnerstvu** |
| 1. Kuota e një ortaku të përgjithshëm në Ortakërinë e Përgjithshme: | 1. The Partnership Interest of a General Partner in the General Partnership: | 1.Udeo jednog opšteg ortaka u generalnom partnerstvu: |
| 1.1 përfshin të drejtën e ndarjes së fitimit dhe shpërndarjes se dividendit, si dhe të drejtat e tjera të ortakut të përgjithshëm, dhe | 1.1. includes the right to distribution of profits and dividends, and other rights of a General Partner, and | 1.1.obuhvata pravo podele dobiti raspodele dividendi, kao i druga prava opšteg ortaka |
| 1.2 përfshin të drejtat dhe detyrimet e ortakut të përgjithshëm, të përcaktuara të gjitha në këtë pjesë. | 1.2. includes the rights and obligations of a General Partner, specified in this section. | 1.2.obuhvata prava i obaveze opšteg ortaka koja su utvrđena u ovom delu. |
| **Neni 52**<br>**Numri i Ortakëve të Përgjithshëm** | **Article 52**<br>**The Number of General Partners** | **Član 52**<br>**Broj generalnih ortaka** |
| Ortakëria e Përgjithshme mund të ketë dy ose më shumë persona fizik ose juridik dhe/ose Shoqëri Tregtare si Ortak të Përgjithshëm, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ligj të veçantë. | A General Partnership may have two or more natural or legal persons and/or Business Organizations as General Partners, unless otherwise stipulated by special legislation. | Generalno partnerstvo može imati dva ili više fizičkih ili pravnih lica i/ili poslovnih društava u svojstvu opšteg ortaka, osim ako drugačije nije utvrđeno posebnim zakonom. |
| **Neni 53**<br>**Parimi i Përgjegjësisë** | **Article 53**<br>**Principle of Liability** | **Član 53**<br>**Princip odgovornosti** |
| 1. Ortakët e Përgjithshëm janë individualisht dhe kolektivisht përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera | 1. General Partners are jointly and severally liable for all debts and other obligations incurred by or imposed by Law | 1. Generalni ortaci su individualno i kolektivno odgovorni za sve dugove i druge ugovorne ili zakonske obaveze generalnog |

| | | |
|---|---|---|
| kontraktuese ose ligjore të Ortakërisë së Përgjithshme. Kjo përgjegjësi është e pakufizuar dhe përfshin të gjithë pasurinë dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një Ortaku të Përgjithshëm, përveç pasurisë ose aseteve të përcaktuara në ligjin në fuqi për procedurën përmbarimore, dhe kur | or contract on the General Partnership. This liability is unlimited and shall extend to all property and assets of any type directly or indirectly owned by a General Partner, except for the property and assets specified in the applicable legislation on enforcement procedure, and when: | partnerstva. Ova odgovornost je neograničena i obuhvata svu imovinu i sredstva svake vrste koja su u direktnom ili indirektnom vlasništvu nekog od generalnih ortaka, osim imovine i sredstava utvrđenih zakonom na snazi o izvršnom postupku, i kada: |
| 1.1. kontrata e cila e ka krijuar këtë përgjegjësi shprehimisht e përjashton nga përgjegjësia pronën ose asetet; | 1.1. a contract which has created the liability expressly excludes properties or assets from liability; | 1.1.ugovor koji je napravio ovu odgovornost izričito isključuje odgovornost vlasništva ili sredstava; |
| 1.2. personi ose Shoqëria Tregtare që ka pretendime është pajtuar që këto asetet ose prona të mos i nënshtrohen pretendimeve të tij. | 1.2. the Person or Business Organization who has claims has agreed that such assets or property are not subject to such claims. | 1.2.osoba ili poslovno društvo koje ima pretenzije je saglasno da ova sredstva ili imovina ne podležu njegovim pretenzijama. |
| 2. Personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqëria Tregtare, duke përfshirë Shoqërinë Tregtare, që pranohet si ortak i përgjithshëm në një Ortakëri të Përgjithshme ekzistuese, merr mbi vete përgjegjësi individuale dhe kolektive për të gjitha borxhet dhe detyrimet e Ortakërisë së Përgjithshme, duke përfshire edhe detyrimet paraprake, në të njëjtën shkallë sikurse ortakët e përgjithshëm ekzistues. | 2. A natural or Legal Person and/or Business Organization, including a Business Organization, which is admitted as a General Partner into an existing General Partnership assumes joint and several liability for all debts and obligations of the General Partnership, including pre-existing obligations, to the same extent as all the existing General Partners. | 2. Fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo, uključujući i poslovno društvo koje se priznaje kao generalni ortak u jednom postojećem generalnom partnerstvu, uzme iznad svoje individualne ili kolektivne odgovornosti sve dugove i obaveze generalnog partnerstva uključujući i prethodne obaveze, u istom stepenu kao i postojeći generalni ortak. |
| 3. Nëse një marrëveshje ndërmjet ortakëve të përgjithshëm përmban dispozita që janë në kundërshtim me paragrafët1 dhe 2 të këtij neni, këto dispozita nuk ndikojnë në të drejtat e një pale të tretë, përveç nëse pala e | 3. If an agreement among the General Partners contains any provisions which are contrary to paragraph 1 and 2 of this Article, such provisions shall not affect the rights of a third party unless the third party | 3. Ukoliko neki sporazum između generalnih ortaka sadrži odredbe koje su u suprotnosti sa stavom 1. i 2. ovog člana, ove odredbe ne utiču na prava treće strane, osim ukoliko se treća strana izričito slaže sa |

| | | |
|---|---|---|
| tretë shprehimisht pajtohet ndryshe. Sidoqoftë, Marrëveshja e Ortakërisë së Përgjithshme dhe dispozitat në fjalë, janë të vlefshme dhe zbatohen për të gjithë ortakët e përgjithshë.<br><br>4. Prona ose asetet konsiderohet se janë në pronësi të tërthortë të një ortaku të përgjithshëm nëse:<br><br>4.1. ortaku i përgjithshëm ka mundësi të kontrollojë shfrytëzimin ose të disponojë me këtë pronë ose këto asete; dhe<br><br>4.2. ka arsye të mjaftueshme për të konkluduar se një person ose organizatë tjetër është emëruar formalisht si ortak i përgjithshëm, me qëllim të mbrojtjes së pronës ose aseteve nga përgjegjësia e ortakut të përgjithshëm.<br><br>**Neni 54**<br>**Llojet e Kontributeve**<br><br>1. Kontributi i ortakut të përgjithshëm në Ortakëri të Përgjithshme mund të bëhet:<br><br>1.1. në të holla ose pasuri tjetër, punë ose shërbime që tashmë janë kryer ose siguruar për Ortakërinë e Përgjithshme; ose | specifically agrees otherwise. In any case, the Agreement of the General Partnership and such provisions shall be effective and apply to all the General Partners.<br><br>4. Property or assets shall be considered to be indirectly owned by a General Partner if:<br><br>4.1. the General Partner can control the use or disposition of such property or assets, and<br><br>4.2. there is sufficient reason to conclude that another person or organization has been formally named as the principal owner for the purpose of protecting such property or assets from exposure to the liability of the General Partner.<br><br>**Article 54**<br>**Types of Contributions**<br><br>1. A General Partner’s Contribution to the General Partnership can be made:<br><br>1.1. in the form of money or other property, labour or services already executed or performed for the General Partnership, or | drugim. Ipak, Sporazum o generalnom partnerstvu i odredbe o kojima je reč, su važeće i primenjuju se u odnosu na sve generalne ortake.<br><br>4. Imovina ili sredstva se smatraju indirektnim vlasništvom jednog opšteg ortaka ukoliko:<br><br>4.1.generalni ortak ima mogućnost da kontroliše ili raspolaže ovom imovinom i sredstvima; i<br><br>4.2.ima dovoljno razloga da zaključi da jedna osoba ili neka druga organizacija je formalno imenovana kao generalni ortak, sa ciljem zaštite imovine ili sredstava od odgovornosti opšteg ortaka.<br><br>**Član 54**<br>**Vrste doprinosa**<br><br>1. Doprinos opšteg ortaka u generalnom partnerstvu može činiti:<br><br>1.1. u gotovini ili drugoj imovini, poslu ili usluge koje su sada obavljene ili obezbeđene za generalno partnerstvo; ili |

| | | |
|---|---|---|
| 1.2. në formë të detyrimit ligjor për ofrimin e të hollave, pasurisë apo për kryerjen e punëve ose shërbimeve për Ortakërinë e Përgjithshme në të ardhmen. Vlera e kontributeve jo-monetare përcaktohet nga ortakët e përgjithshëm në përputhje me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Ortakërisë së Përgjithshme. | 1.2.in the form of a legally binding obligation to provide such money, property, labour or services to the General Partnership in the future. The value of non-monetary Contributions shall be determined by the General Partners in accordance with the applicable provisions of the General Partnership Agreement. | 1.2.u obliku pravne obaveze za pružanje novca, imovine ili za obavljanje posla ili usluga za generalno partnerstvo u budućnosti. Vrednost ne novčanih doprinosa se utvrđuje od strane opšteg ortaka u skladu sa odredbama Sporazuma o generalnom partnerstvu. |
| **Neni 55**<br>**Fitimet, humbjet, alokimet dhe shpërndarja e dividendit** | **Article 55**<br>**Profits, Losses, Allocations and Distributions of Dividends** | **Član 55**<br>**Dobit, gubici, alokacije i podela dividendi** |
| 1. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme, të gjithë ortakët e përgjithshëm kanë të drejtë në një ndarje të barabartë të të gjitha fitimeve, humbjeve, alokimeve dhe shpërndarjeve të dividendëve të Ortakërisë së Përgjithshme. | 1. Unless the General Partnership Agreement specifies otherwise, all the General Partners have the right to an equal Share of all profits, losses, allocations and dividend distributions of the General Partnership. | 1. Osim ako nije drugačije utvrđeno Sporazumom o generalnom partnerstvu, svi generalni ortaci imaju pravo na jednaku podelu svake dobiti, gubitaka, alokacije i podelu dividendi generalnog partnerstva. |
| 2. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga përfundimi i çdo viti kalendarik, Ortakëria e Përgjithshme duhet që të llogarisë dhe regjistrojë të gjitha fitimet apo humbjet e bëra në atë vit, dhe të bëjë ndarjen e përqindjeve të fitimeve ose humbjeve në llogaritë e ortakëve të përgjithshëm. | 2. Unless the General Partnership Agreement specifies otherwise, within the period of thirty (30) days from the end of each calendar year, the General Partnership must formally calculate and record all the profits or losses incurred in that year and divide the percentage of profits or losses in the accounts of the General Partners. | 2. Osim ako nije drugačije utvrđeno Sporazumom o generalnom partnerstvu, u roku od trideset (30) dana od završetka svake kalendarske godine, generalno partnerstvo treba da obračuna i registruje svaku dobit ili gubitak ostvaren u toku te godine, kao i da napravi procentualnu podelu dobiti ili gubitaka u obračunu generalnih ortaka. |

| Neni 56<br>**Përgjegjësia për Humbjet** | Article 56<br>**Responsibility for Losses** | Član 56<br>**Odgovornost za gubitke** |
|---|---|---|
| 1. Çdo ortak i përgjithshëm i Ortakërisë së Përgjithshme duhet të japë kontributin e tij për mbulimin e barabartë të humbjeve që rrjedhin nga Veprimtaria Ekonomike e Ortakërisë së Përgjithshme, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme. | 1. Unless the General Partnership Agreement specifies otherwise, each General Partner of the General Partnership must give his contribution in order to equally cover the losses of the General Partnership resulting from the Business Activity of the General Partnership. | 1. Svaki generalni ortak generalnog partnerstva treba da da svoj doprinos za jednako pokrivanje gubitaka koji proizilaze iz privredne delatnosti generalnog partnerstva, osim ukoliko drugačije nije određeno Sporazumom o generalnom partnerstvu. |
| 2. Të gjithë ortakët e përgjithshëm duhet të bëjnë kontribute të barabarta për të mbuluar humbjet,menjëherë pasi që ato të bëhen të ditura për ta, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme. | 2. Unless the General Partnership Agreement specifies otherwise, all the General Partners must make equal contributions in order to cover losses immediately after the losses are known to the General Partners. | 2. Svi generalni ortaci treba da daju jednak doprinos za pokrivanje gubitaka odmah po saznanju o istima, osim ukoliko drugačije nije određeno Sporazumom o generalnom partnerstvu. |
| 3. Pas shpërbërjes së Ortakërisë së Përgjithshme, të gjithë ortakët e përgjithshëm duhet të japin kontribute të barabarta për përmbushjen e kërkesave të palëve të treta dhe për mbulimin e humbjeve të tjera. | 3. After the dissolution of the General Partnership all the General Partners must make equal contributions to fulfil the requests of third parties and to cover other losses. | 3. Nakon raspuštanja generalnog partnerstva, svi generalni ortaci treba da daju jednak doprinos za ispunjavanje zahteva trećih strana i pokrivanju drugih gubitaka. |
| **Neni 57**<br>**Autorizimi i Ortakut të Përgjithshëm për të Vepruar në Emër të Ortakërisë së Përgjithshme** | **Article 57**<br>**Authority of a General Partner to Act for the General Partnership** | **Član 57**<br>**Ovlašćivanje opšteg ortaka da postupa u ime generalnog partnerstva** |
| 1. Të gjitha veprimet e një ortaku të përgjithshëm që bëhen me qëllim të ushtrimit të Veprimtarisë Ekonomike të zakonshme të Ortakërisë së Përgjithshme e | 1. All actions of a General Partner conducted for the purpose of carrying on the usual Business Activities of the General Partnership are binding on the | 1. Svako postupanje jednog generalnog ortaka se vrši sa ciljem obavljanja privredne delatnosti generalnog partnerstva i ostalih generalnih ortaka. Ipak, ovo pravilo se neće |

| | | |
|---|---|---|
| detyrojnë Ortakërinë e Përgjithshme dhe ortakët e tjerë të përgjithshëm. Sidoqoftë, ky rregull nuk do të zbatohet nëse: | General Partnership and the other General Partners. However, this rule shall not apply if: | sprovoditi ukoliko: |
| 1.1. ortaku i përgjithshëm përkatës nuk është i autorizuar që të veprojë në emër të Ortakërisë së Përgjithshme për atë çështje të caktuar; dhe | 1.1. the concerned General Partner had no authority to act for the General Partnership in that particular matter; and | 1.1.odgovarajući generalni ortak nije ovlašćen da postupa u ime generalnog partnerstva po tom određenom pitanju; i |
| 1.2. personi ose organizata me të cilin ortaku i përgjithshëm ka zhvilluar atë Veprimtari Ekonomike ka qenë në dijeni se ortakut të përgjithshëm përkatës i mungon autorizimi i nevojshëm. | 1.2. the person or organization with whom the General Partner has conducted the Business Activity was aware of the fact that the General Partner lacked the necessary authorization. | 1.2.je osoba ili organizacija sa kojom je generalni ortak razvio privrednu delatnost bila svesna da određeni generalni ortak ne poseduje neophodno ovlašćenje. |
| 2. Të gjitha veprimet e një ortaku të përgjithshëm që nuk bëhen me qëllim të ushtrimit të Veprimtarisë Ekonomike të zakonshme të Ortakërisë së Përgjithshme, nuk do ta detyrojë Ortakërinë e Përgjithshme ose ortakët tjerë, përveç nëse ky veprim është shprehimisht i autorizuar nga ortakët e tjerë të përgjithshëm. | 2. Any action of a General Partner that is not conducted for the purpose of carrying on the usual Business Activities of the General Partnership is not binding on the General Partnership or the other General Partners unless the concerned action was expressly authorized by the other General Partners. | 2.Svi postupci jednog generalnog ortaka koji ne postupa sa ciljem obavljanja uobičajene privredne delatnosti, ne obavezuju generalno partnerstvo ili druge ortake, osim ukoliko nije izričito ovlašćen od ostalih generalnih ortaka. |
| 3. Marrëveshja e Ortakërisë së Përgjithshme mund të përcaktojë që Ortakëria e Përgjithshme përfaqësohet nga të gjithë apo disa prej ortakëve bashkërisht. Ortakët mund të autorizojnë njërin apo disa ortakë mes vete për të kryer një transaksion apo akt të caktuar. Çdo ortak që jep autorizimin mund të anulojë atë autorizim. Përfaqësimi i përbashkët vlen ndaj palëve | 3. The General Partnership Agreement may provide that the General Partnership shall be represented by all or some of the partners jointly. The partners may authorise one or several partners among themselves to perform a certain transaction or act. Each partner who grants an authorisation may cancel the authorisation. Joint representation shall apply with | 3.Sporazum o generalnom partnerstvu može urediti da generalno partnerstvo bude predstavljeno od svih ili nekih partnera zajednički. Partneri mogu da ovlaste jednog ili više partnera među sobom da izvrše neku transakciju ili akt. Svaki partner koji daje ovlašćenje može i da ga otkaže. Zajedničko predstavljanje važi u pogledu trećih lica samo ako je uneto u registar i objavljeno od |

| | | |
|---|---|---|
| të treta vetëm nëse është shënuar në Regjistër dhe publikuar nga ARBK-ja. | regard to third persons only if it is entered in the Registry and published by the KBRA. | KARP. |
| **Neni 58**<br>**Qeverisja dhe Menaxhimi** | **Article 58**<br>**Governance and management** | **Član 58**<br>**Upravljanje i menadžment** |
| 1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme, të drejtat e ortakëve të përgjithshëm në votim dhe menaxhim të Ortakërisë së Përgjithshme janë të barabarta. | 1. Unless the General Partnership Agreement provides otherwise, the voting and management rights of the General Partners in the General Partnership are equal. | 1. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno Sporazumom o generalnom partnerstvu, prava generalnih ortaka u glasanju i upravljanju generalnim partnerstvom su jednaka. |
| 2. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme, vendimet e Ortakërisë së Përgjithshme merren me shumicë të thjeshtë të votave. | 2. Unless the General Partnership Agreement provides otherwise, the decisions of the General Partnerships are made by a simple majority of the votes. | 2. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno Sporazumom o generalnom partnerstvu, odluke generalnog partnerstva se donose jednostavnom većinom glasova. |
| 3. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, për veprimet në vijim kërkohet vota unanime e të gjithë ortakëve të përgjithshëm: | 3. Notwithstanding paragraph 2 of this Article, the following actions shall require the unanimous vote of all General Partners: | 3. Nezavisno od stava 2. ovog člana, za sledeća delovanja je potrebno jednoglasno donošenje odluke od strane svih ortaka: |
| 3.1.miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Marrëveshjen e Ortakërisë Përgjithshme; | 3.1. the adoption of amendments to the General Partnership Agreement; | 3.1.usvajanje izmena i dopuna u Sporazuma o generalnom partnerstvu, |
| 3.2. shpërndarjet e dividendëve; | 3.2. the distribution of dividends; | 3.2.podela dividendi; |
| 3.3.pranimi i një Ortaku të Përgjithshëm të ri; dhe | 3.3. the admission of a new General Partner; and | 3.3.prihvatanje novog opšteg ortaka; i |
| 3.4.vendimi për shpërbërjen dhe çregjistrimin e Ortakërisë së | 3.4. a decision to dissolve or deregister the General Partnership or a decision to | 3.4.donošenja odluke o odjavi i raspuštanju generalnog partnerstva ili |

| | | |
|---|---|---|
| Përgjithshme ose vendimin për inicimin e procedurave sipas ligjit të aplikueshëm për falimentimin e Ortakërisë së Përgjithshme, shitjen e një pjese substanciale të aseteve të saj ose ndryshimin e natyrës së Veprimtarisë Ekonomike. | initiate procedures pursuant to applicable law on bankruptcy of a General Partnership, to sell a substantially part of its assets, or to change the nature of its Business Activities. | odluke o pokretanju procedura u skladu sa primenljivim zakonom o stečaju generalnog partnerstva, prodaji znatnog dela sredstava partnerstva ili izmeni prirode privredne delatnosti. |
| 4. Në marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme mund të krijohen kategori të ndryshme të Ortakëve të Përgjithshëm, mund t'u epen të drejta të ndryshme të votimit dhe menaxhimit të Ortakërisë së Përgjithshme, mund ti mohohet cilitdo ortak e drejtën e votimit në cilëndo çështje ose në të gjitha çështjet, dhe mund të kërkohen forma tjera të shumicës përveç shumicës së thjeshtë ose unanime për vendosjen e një çështje. | 4. The General Partnership Agreement can establish different categories of General Partners, it can assign different voting and management rights to different General Partners, it can deny any General Partner the right to vote on any matter or all matters, and it can require different forms of majority voting other than simple majority or unanimous vote to decide on a matter. | 4. U Sporazumu o generalnom partnerstvu mogu biti kreirane različite kategorije generalnih ortaka, mogu im biti dodeljena različita prava glasa i upravljanja generalnim partnerstvom, svakom od generalnih ortaka može biti uskraćeno pravo glasa po pitanju bilo kog ili po pitanju svih pitanja, kao i što se mogu zahtevati drugi oblici većine osim jednostavne većine ili jednoglasnosti za donošenje odluke po nekom pitanju. |
| 5. Votimi i ortakëve mund të bëhet me çfarëdo metode e cila ju siguron të gjithë ortakëve njoftim të arsyeshëm mbi votimin dhe mbi çështjen për të cilën votohet. | 5. The voting of the General Partners may be done through any method which provides all General Partners reasonable notice of the vote and the subject matter of the vote. | 5. Glasanje ortaka može se obavljati bilo kojom metodom koja osigurava svim ortacima objašnjenje o glasanju i o pitanju o kojem se glasa. |
| 6. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme, ortaku i përgjithshëm mund ta bartë kuotën e tij, duke përfshirë të drejtën për pjesëmarrje në fitimet dhe shpërndarjet e dividendëve të Ortakërisë së Përgjithshme, një ortaku tjetër të përgjithshëm ose trashëgimtarëve të tij/saj pas vdekjes. Në të | 6. Unless the General Partnership Agreement provides otherwise, a General Partner may transfer his Partnership Interest in a General Partnership, including his rights to receive a Share in the profits or receive distributions of dividends of the General Partnership, to another General Partner or to his/her heirs after his death. | 6. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno Sporazumom o generalnom partnerstvu, generalni ortak može preneti svoju kvotu, uključujući i pravo za učešće u dobiti i podeli dividendi generalnog partnerstva, nekom drugom opštem ortaku ili njegovim naslednicima nakon njegove smrti. U svim drugim slučajevima, generalni ortak ne |

| | | |
|---|---|---|
| gjitha rastet e tjera, ortaku i përgjithshëm nuk mund ta bartë kuotën e tij pa pëlqimin e të gjithë ortakëve tjerë. | In all the other cases, a General Partner may not transfer his Partnership Interest without the consent of all other partners. | može preneti njegovu kvotu bez saglasnosti svih ostalih ortaka. |
| **Neni 59**<br>**Të Drejtat dhe Detyrimet Reciproke të Ortakëve të Përgjithshëm** | **Article 59**<br>**Mutual Rights and Obligations of General Partners** | **Član 59**<br>**Međusobna prava i obaveze generalnih ortaka** |
| 1. Çdo ortak i përgjithshëm është i detyruar ndaj çdo ortaku tjetër të përgjithshëm qëtë shkëmbejë të dhënat financiare lidhur me Veprimtarinë Ekonomike të Ortakërisë së Përgjithshme. | 1. Every General Partner is obligated to Share with every other General Partner the financial information related to the Business Activities of the General Partnership. | 1. Svaki generalni ortak ima obavezu prema svakom drugom generalnom ortaku kada je u pitanju razmena finansijskih podataka u vezi sa privrednom delatnošću generalnog partnerstva. |
| 2. Përveç nëse është dakorduar ndryshe me ortakët e tjerë, ortaku i përgjithshëm që jep dorëheqje ose largohet nga Ortakëria e Përgjithshme, mbetet përgjegjës para palëve të treta për të gjitha borxhet dhe detyrimet e Ortakërisë së Përgjithshme që janë bërë ose janë krijuar para datës së tërheqjes ose largimit të tij nga Ortakëria e Përgjithshme. Përgjegjësia ndërmjet vetë ortakëve do të zgjidhet në bazë të Marrëveshjes mbi Ortakërinë e Përgjithshme. | 2. Unless otherwise agreed with the other partners, a General Partner who resigns or otherwise leaves the General Partnership shall be liable to third parties for all debts and obligations of the General Partnership incurred or created before the date on which he resigns or otherwise leaves the General Partnership. Liability between the partners themselves shall be resolved based on the Partnership Agreement. | 2. Osim ukoliko nije drugačije dogovoreno sa ostalim ortacima, generalni ortak koji da ostavku ili se udalji iz generalnog partnerstva, ostaje odgovoran prema trećim stranama po pitanju svih dugova i obaveza generalnog partnerstva koje su načinjene ili su stvorene pre datuma njegove ostavke ili istupanja iz generalnog partnerstva. Odgovornost među samim ortacima biće utvrđena na osnovu Sporazuma o generalnom partnerstvu. |
| 3. Ortakëria e Përgjithshme duhet ta kompensojë ortakun e përgjithshëm për pagesat e bëra dhe përgjegjësinë e ndërmarrë, nëse pagesat dhe përgjegjësia e tillë është bërë nga ortaku i përgjithshëm: | 3. The General Partnership must compensate the General Partner for payments made and for liabilities incurred if such payments were made or such liabilities were incurred by the General Partner: | 3. Generalno partnerstvo treba da nadoknadi generalnom ortaku obavljene isplate i preduzete odgovornosti, ukoliko su isplate i odgovornosti tog tipa preduzete od strane generalnog ortaka: |

| | | |
|---|---|---|
| 3.1. gjatë ushtrimit apo avancimit të Veprimtarisë Ekonomike të zakonshme të Ortakërisë së Përgjithshme; ose | 3.1. in the conduct or furtherance of the usual Business Activities of the General Partnership or | 3.1.tokom obavljanja ili unapređivanja uobičajene privredne delatnosti generalnog partnerstva; ili |
| 3.2. për mbrojtjen e Veprimtarisë Ekonomike ose pasurisë së Ortakërisë së Përgjithshme. | 3.2. for the protection of the Business Activities of the General Partnership or the assets of the General Partnership. | 3.2.za zaštitu privredne delatnosti ili imovine generalnog partnerstva. |
| **Neni 60**<br>**E Drejta e Padisë për Shkelje të Marrëveshjes së Ortakërisë së Përgjithshme** | **Article 60**<br>**Right to Sue for Breach of the General Partnership Agreement** | **Član 60**<br>**Pravo na podnošenje tužbe zbog kršenja Sporazuma o generalnom partnerstvu** |
| 1. Ortakëria e Përgjithshme mund të padit një Ortak të Përgjithshëm për shkeljen e Marrëveshjes së Ortakërisë së Përgjithshme ose për shkeljen e detyrimeve ndaj Ortakërisë së Përgjithshme të cilat i kanë shkaktuar dëm ortakërisë së përgjithshme. Ortaku i Përgjithshëm mund ta padisë Ortakërinë e Përgjithshme ose një ortak tjetër për përmbarimin e të drejtave të tij që dalin nga Marrëveshja e Ortakërisë së Përgjithshme ose nga ky ligj. | 1. The General Partnership may sue a General Partner for breach of the General Partnership Agreement or for the violation of obligations toward the General Partnership which have caused harm to the General Partnership. A General Partner may sue the General Partnership or another General Partner to enforce the General Partner's rights under the General Partnership Agreement or this Law. | 1. Generalno partnerstvo može tužiti nekog od generalnih ortaka za kršenje Sporazuma o generalnom partnerstvu ili za kršenje obaveza prema generalnom partnerstvu koje su uzrokovale štetu generalnom partnerstvu. Generalni ortak može tužiti generalno partnerstvo ili nekog drugog generalnog ortaka za ostvarivanje njegovih prava koja proističu iz Sporazuma o generalnom partnerstvu ili iz ovog zakona. |
| 2. Bazat për ngritjen e padisë në rastet e transaksioneve me konflikt interesit janë përcaktuar në Pjesën e Dhjetë të këtij ligji. | 2. The grounds for suits related to conflict of interest transactions are provided in Part Ten of this Law. | 2. Osnova za podizanje tužbe u slučajevima transakcija sa sukobom interesa su utvrđene u Desetom delu ovog zakona. |

| Neni 61<br>Pasuria e Ortakërisë së Përgjithshme | Article 61<br>Assets of the General Partnership | Član 61<br>Imovina generalnog partnerstva |
|---|---|---|
| 1. Pasuria e Ortakërisë së Përgjithshme përfshin paratë e gatshme ose pasurinë tjetër që: | 1. The assets of the General Partnership include cash or other asset that is: | 1. Imovina generalnog partnerstva obuhvata gotovinu ili drugu imovinu koja: |
| 1.1. është dhënë si kontribut nga një ortak i përgjithshëm në Ortakërinë e Përgjithshme; | 1.1. given as a Contribution by a General Partner to the General Partnership; | 1.1. je data kao doprinos nekog od generalnih ortaka u generalnom partnerstvu; |
| 1.2. pasurinë që është fituar nga asetet ekzistuese të Ortakërisë së Përgjithshme ose si rezultat i ushtrimit të Veprimtarisë Ekonomike; dhe | 1.2. acquired through the existing assets of the General Partnership or as a result of the conduct of Business Activities; and | 1.2. imovina koja je dobijena od postojećih sredstava generalnog partnerstva ili kao rezultat privredne delatnosti; i |
| 1.3. pasurinë e fituar në emër të Ortakërisë së Përgjithshme ose në emrin e njërit nga ortakët e përgjithshëm për përfitime të Ortakërisë së Përgjithshme. | 1.3. assets acquired in the name of the General Partnership or in the name of one of the General Partners for the benefit of the General Partnership. | 1.3. imovina dobijena na ime generalnog partnerstva ili na ime nekog od generalnih ortaka za dobiti generalnog partnerstva. |
| 2. Ortaku i përgjithshëm nuk është bashkëpronar i pasurisë së Ortakërisë së Përgjithshme. | 2. The General Partner is not a co-owner of the assets of the General Partnership. | 2.Generalni ortak nije suvlasnik imovine generalnog partnerstva. |
| **Neni 62**<br>**Tërheqja e një Ortaku të Përgjithshëm** | **Article 62**<br>**Withdrawal of a General Partner** | **Član 62**<br>**Povlačenje jednog od generalnih ortaka** |
| 1. Ortaku i përgjithshëm mund të tërhiqet nga Ortakëria e Përgjithshme në çdo kohë duke dorëzuar një njoftim me shkrim për të gjithë Ortakët e Përgjithshëm të tjerë, por nëse tërheqja shkelë Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme, Ortakëria e | 1. A General Partner may withdraw from a General Partnership at any time by giving written notice to the other General Partners, but if the withdrawal violates the General Partnership Agreement, the General Partnership may require | 1. Generalni ortak se može povući iz generalnog partnerstva u svakom momentu podnoseći pisano obaveštenje namenjeno drugim generalnim ortacima, ali ukoliko povlačenje krši Sporazum o generalnom partnerstvu, generalno partnerstvo može |

| | | |
|---|---|---|
| Përgjithshme mund të kërkojë kompensim nga ortaku i përgjithshëm për shkelje të marrëveshjes.<br><br>2. Ortaku i përgjithshëm që tërhiqet nga Ortakëria e Përgjithshme pa bërë shkeljen e Marrëveshjes së Ortakërisë së Përgjithshme ka të drejtë në fitime, sipas Marrëveshjes së Ortakërisë së Përgjithshme. Përveç nëse Marrëveshja e Ortakërisë së Përgjithshme përcakton ndryshe, ortaku i përgjithshëm i cili tërhiqet ka të drejtë në tërheqjen e kuotës së tij në Ortakërinë e Përgjithshme brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga tërheqja. Ky detyrim është një detyrim që ka Ortakëria e Përgjithshme ndaj ortakut të përgjithshëm i cili tërhiqet; dhe ortakët e tjerë të përgjithshëm janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi, njëlloj sikurse edhe me detyrimet e tjera të Ortakërisë së Përgjithshme.<br><br>3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme, Ortaku i Përgjithshëm konsiderohet sipas veprimit të ligjit se është tërhequr nga Ortakëria e Përgjithshme nëse:<br><br>3.1. ortaku i përgjithshëm nuk paguan me kohë kontributin e tij ndaj Ortakërisë së Përgjithshme;<br><br>3.2. ortaku i përgjithshëm i informon | compensation from the withdrawing partner for breach of the General Partnership Agreement.<br><br>2. A General Partner who withdraws from the General Partnership without violating the General Partnership Agreement has the right to receive any profits under the General Partnership Agreement. If the General Partnership Agreement does not provide otherwise, the withdrawing General Partner is entitled to receive from the General Partnership, within ninety (90) days from the withdrawal, the fair value of his interest in the General Partnership. This obligation is an obligation owed by the General Partnership to the withdrawing General Partner; and the other General Partners are, as with other obligations of the General Partnership, also jointly and severally liable therefore.<br><br>3. Unless the General Partnership Agreement provides otherwise, a General Partner is considered to have withdrawn by effect of the law from the General Partnership if:<br><br>3.1. the General Partner fails to timely pay his Contribution to the General Partnership;<br><br>3.2. the General Partner informs the | tražiti nadoknadu od generalnog ortaka za povredu sporazuma.<br><br>2. Generalni ortak koji se povlači iz generalnog partnerstva bez kršenja Sporazuma o generalnom partnerstvu ima pravo na dobiti, u skladu sa Sporazumom o generalnom partnerstvu. Osim ukoliko Sporazum o generalnom partnerstvu ne određuje drugačije, generalni ortak koji se povlači ima pravo na povlačenje njegove kvote u generalnom partnerstvu u roku od devedeset (90) dana od njegovog povlačenja. Ovo je obaveza koju generalno partnerstvo ima u odnosu na generalnog ortaka koji se povlači; a ostali generalni ortaci su kolektivno i pojedinačno odgovorni za ispunjavanje ove obaveze, na isti način kao i prema drugim obavezama generalnog partnerstva.<br><br>3. Osim ukoliko u Sporazumu o generalnom partnerstvu nije određeno drugačije, smatra se da se generalni ortak povukao iz generalnog partnerstva u skladu sa zakonom ukoliko:<br><br>3.1.generalni ortak ne plaća na vreme njegove doprinose prema generalnom partnerstvu;<br><br>3.2.generalni ortak pisanim putem |

| | | |
|---|---|---|
| ortakët tjetër të përgjithshëm me shkrim se ai është tërhequr nga Ortakëria e Përgjithshme;<br><br>3.3. ortaku i përgjithshëm kërkon vullnetarisht mbrojtje formale juridike nga kreditorët e tij, ose me vendim të gjykatës është shpallur insolvent për t'i shlyer borxhet sipas ligjit në fuqi për falimentimin; ose<br><br>3.4. një ortak i përgjithshëm që është Shoqëri Tregtare ose person fizik ose juridik përfundon së ekzistuari.<br><br>**Neni 63**<br>**Shpërbërja e Ortakërisë së Përgjithshme**<br><br>1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme, Ortakëria e Përgjithshme shpërbëhet:<br><br>1.1. pas skadimit të afatit të caktuar për ekzistimin e Ortakërisë së Përgjithshme, nëse afati është përcaktuar në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme;<br><br>1.2. me vendim të të gjithë Ortakëve të Përgjithshëm;<br><br>1.3. pas vdekjes së njërit prej Ortakëve të Përgjithshëm; | other General Partners in writing that he has withdrawn from the General Partnership;<br><br>3.3 the General Partner voluntarily seeks formal legal protection from his creditors or he has been declared through a court decision as insolvent to pay his debts pursuant to the applicable law on bankruptcy; or<br><br>3.4. a General Partner who is a Business Organization or legal person ceases to exist.<br><br>**Article 63**<br>**Dissolution of a General Partnership**<br><br>1. Unless the General Partnership Agreement provides otherwise, a General Partnership shall be dissolved:<br><br>1.1. after the expiry of the duration of the General Partnership, if the duration is established in the General Partnership Agreement;<br><br>1.2. by a decision of all General Partners;<br><br>1.3 after the death of one of the General Partner; | obavesti ostale generalne ortake da se povukao iz generalnog partnerstva;<br><br>3.3.generalni partner zahteva formalnu pravnu zaštitu od njegovih poverilaca, ili je odlukom suda objavljen bankrot zbog dugovanja u skladu sa zakonom na snazi o stečajnom postupku; ili<br><br>3.4.jedan generalni ortak koji je poslovno društvo ili pravno lice prestaje da postoji.<br><br>**Član 63**<br>**Raspuštanje generalnog partnerstva**<br><br>1. Osim ukoliko u Sporazumu o generalnom partnerstvu nije određeno drugačije, generalno partnerstvo se raspušta:<br><br>1.1.nakon isteka roka određenog za postojanje generalnog partnerstva, ili roka određenog u Sporazumu o generalnom partnerstvu;<br><br>1.2.odlukom svih generalnih ortaka;<br><br>1.3.nakon smrti jednog od generalnih ortaka; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.4. Shpërbërjes Vullnetare ose falimentimit të njërit Ortak të Përgjithshëm që është Shoqëri Tregtare ose person juridik;<br><br>1.5. pas tërheqjes ose përjashtimit të cilitdo Ortak të Përgjithshëm;<br><br>1.6. me vendim të gjykatës;<br><br>1.7. në rastet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme; | 1.4. the voluntary dissolution or bankruptcy of one of the General Partners who is a Business Organization or legal person;<br><br>1.5. after withdrawal or expulsion of any General Partner;<br><br>1.6. through a court decision;<br><br>1.7. other cases as provided in the General Partnership Agreement; | 1.4.dobrovoljno raspuštanje ili bankrota jednog od generalnih ortaka koji je poslovno društvo ili pravno lice;<br><br>1.5. nakon povlačenja ili isključivanja bilo kojeg generalnog ortaka;<br><br>1.6.odlukom suda;<br><br>1.7.u drugim slučajevima utvrđenim Sporazumom o generalnom partnerstvu; |
| 2. Shpërbërja e Ortakërisë së Përgjithshme kërkon shpërndarjen e fitimeve dhe pronës, nëse ka të këtilla, tek Ortakët e Përgjithshëm. | 2. The dissolution of a General Partnership requires the distribution of its profits and property, if any, to the General Partners. | 2. Raspuštanje generalnog partnerstva zahteva raspodelu dobiti i imovine, ukoliko postoji, među generalnim ortacima. |
| 3. Shpërbërja e Ortakërisë së Përgjithshme nuk i shuan kërkesat e kreditorëve kundër Ortakëve të Përgjithshëm, dhe as që i shuan pretendimet e një Ortaku të Përgjithshëm ndaj një Ortaku tjetër të Përgjithshëm. Pas shpërbërjes së Ortakërisë së Përgjithshme, të gjithë ortakët e përgjithshëm duhet ti përmbushin kushtet e parapara në paragrafin 3 të nenit 56 të këtij ligji. | 3. The dissolution of a General Partnership shall not extinguish the claims of creditors against the General Partners, nor shall it extinguish the claim of any General Partner against another General Partner. After the dissolution of a General Partnership all the General Partners must fulfil the conditions set out in paragraph 3 of Article 56 of this Law. | 3. Raspuštanje generalnog partnerstva ne ukida zahteve poverilaca u odnosu na generalne partnere, kao što i ne ukida pretenzije jednog generalnog ortaka prema nekom drugom generalnom ortaku. Nakon raspuštanja generalnog partnerstva, svi generalni ortaci treba da ispunjavaju uslove predviđene stavom 3. člana 56. ovog zakona. |
| 4. Nëse Ortakëria e Përgjithshme duhet të shpërbëhet për shkaqet e përmendura në nën-paragrafin 1.3 ose 1.4 të paragrafit 1 të këtij neni, e tërë prona e Ortakërisë së | 4. If the General Partnership must be dissolved due to reasons set out in sub-paragraphs 1.3 or 1.4 of paragraph 1 of this Article, all the property of the General | 4. Ukoliko generalno partnerstvo treba da se raspusti zbog razloga pomenutih u tačkama 1.3 ili 1.4 stava 1. ovog člana, celokupna imovina generalnog partnerstva |

| | | |
|---|---|---|
| Përgjithshme i nënshtrohet procedurave ligjore të parapara me ligj, me qëllim të përcaktimit të mënyrës së shpërndarjes së pronës së ortakut të vdekur ose shpërbërë vullnetarisht apo të falimentuar; me kusht që, ortakët e përgjithshëm të mbetur në Ortakërinë e Përgjithshme të kenë të drejtë të lidhin marrëveshje me gjykatën ose Përfaqësuesin e Autorizuar në Procedurë të Falimentimit ne lidhje me: | Partnership is subject to the legal proceedings provided by Law, for the purpose of determining the method of distribution of the property of the deceased or voluntarily dissolved or bankrupt General Partner; provided, however, that the General Partnership's remaining General Partners have the right to enter into an agreement with the Court or the Authorized Representative in a Bankruptcy Procedureregarding: | podleže pravnim procedurama predviđenim zakonom, sa ciljem utvrđivanja načina raspodele imovine preminulog ortaka bili dobrovoljnog raspuštanja ili pak bankrota; pod uslovom da generalni ortaci koji ostaju u generalnom partnerstvu imaju pravo da sklope sporazum sa sudom ili ovlašćenim predstavnikom u stečajnom postupku u vezi sa: |
| 4.1. formimin e Ortakërisë së re të Përgjithshme; dhe | 4.1. the formation of a new General Partnership; and | 4.1.formiranjem novog generalnog partnerstva; i |
| 4.2. disponimin me kuotën e ortakut të vdekur, të shpërbërë vullnetarisht apo të falimentuar në Ortakërinë e Përgjithshme. | 4.2. the disposition of the Partnership Interest of the deceased, voluntarily dissolved or bankrupt General Partner in the General Partnership. | 4.2.raspolaganja sa kvotom preminulog generalnog ortaka, dobrovoljno raspuštenog ili pak bankrotiranog u generalnom partnerstvu. |
| **PJESA E PESTË<br>ORTAKËRIA E KUFIZUAR** | **PART FIVE<br>LIMITED PARTNERSHIP** | **PETI DEO<br>OGRANIČENO PARTNERSTVO** |
| **Neni 64<br>Natyra e Ortakërisë së Kufizuar** | **Article 64<br>Nature of a Limited Partnership** | **Član 64<br>Priroda ograničenog partnerstva** |
| 1. Ortakëria e Kufizuar është Shoqëri Tregtare që përbëhet nga: | 1. A Limited Partnership is a Business Organization which is composed of: | 1.Ograničeno partnerstvo je poslovno društvo koje se sastoji od: |
| 1.2. së paku një ortak i përgjithshëm; dhe | 1.1. at least one General Partner; and | 1.1.najmanje jednog generalnog ortaka; i |
| 1.2. së paku një ortak i kufizuar. | 1.2. at least one Limited Partner. | 1.2.najmanje jednog ograničenog |

| | | |
|---|---|---|
| | | ortaka. |
| 2. Ortakëria e Kufizuar nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë e paditur në emrin e saj. | 2. A Limited Partnership is not a legal person. Nevertheless, it shall have the right to enter into a contract, own property and sue or be sued in its own name. | 2.Ograničeno partnerstvo nije pravno lice. Nezavisno od ovoga ono može sklapati ugovore, posedovati imovinu, pokretati tužbe i biti tuženo u njegovo ime. |
| 3. Cilido person fizik ose juridik dhe/ose Shoqëri Tregtare mund të jetë ortak i përgjithshëm ose i kufizuar i Ortakërisë së Kufizuar. | 3. Any natural or legal person and/or Business Organization may be a General Partner or a Limited Partner of a Limited Partnership. | 3.Bilo koje fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo, može biti generalni ili ograničeni ortak u ograničenom partnerstvu. |
| 4. Ortaku i Përgjithshëm në Ortakërinë e Kufizuar është individualisht dhe kolektivisht me Ortakët tjerë të Përgjithshëm, përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet e Ortakërisë së Kufizuar. | 4. A General Partner in a Limited Partnership is jointly and severally liable, together with the other General Partners, for the debts and obligations of the Limited Partnership. | 4.Generalni ortak u ograničenom partnerstvu je individualno i kolektivno sa ostalim generalnim ortacima odgovoran za sve dugove ili obaveze ograničenog partnerstva. |
| 5. Ortaku i Përgjithshëm në Ortakërinë e Kufizuar është individualisht dhe kolektivisht përgjegjës me Ortakët tjerë të Përgjithshëm për të siguruar respektimin nga Ortakëria e Kufizuar të të gjitha detyrimeve që burojnë nga ligjet e zbatueshme në Kosovë, duke përfshirë këtë ligj. | 5. A General Partner in a Limited Partnership is also jointly and severally responsible, together with the other General Partners, to ensure compliance of the Limited Partnership with the obligations stemming from applicable laws in Kosovo, including this Law. | 5.Generalni ortak u ograničenom partnerstvu je individualno i kolektivno sa ostalim generalnim ortacima odgovoran za poštovanje svih obaveza koje proizilaze iz zakona koji se primenjuju na Kosovu, uključujući i ovaj zakon, od strane ograničenog partnerstva. |
| 6. Ortaku i Kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e tjera të Ortakërisë së Kufizuar përveç siç është përcaktuar në nenin 68 të këtij ligji. | 6. A Limited Partner is not liable for any debts or other obligations of the Limited Partnership except as provided in Article 68 of this Law. | 6.Ograničeni ortak nije odgovoran za dugove i obaveze drugih ograničenih ortaka, osim kao što je utvrđeno članom 68. ovog zakona. |

| | | |
|---|---|---|
| 7. Dispozitat e Pjesës së Katërt të këtij ligji që rregullojnë Ortakërinë e Përgjithshme do të zbatohen në mënyrë analoge edhe për Ortakërinë e Kufizuar, përveç nëse shprehimisht është përcaktuar ndryshe në një dispozitë të Pjesës së Pestë të këtij ligji. | 7. The provisions set forth in Part Four of this Law which regulate the General Partnership shall be applied by analogy to Limited Partnerships, unless expressly provided otherwise in a provision of Part Five of this law. | 7.Odredbe Četvrtog dela ovog zakona koje regulišu generalno partnerstvo će se sprovoditi na isti način i za ograničeno partnerstvo, osim ukoliko nije izričito utvrđeno drugačije nekom od odredbi petog dela ovog zakona. |
| **Neni 65**<br>**Marrëveshja e Ortakërisë së Kufizuar** | **Article 65**<br>**Limited Partnership Agreement** | **Član 65**<br>**Sporazum o ograničenom partnerstvu** |
| 1. Çdo Ortakëri e Kufizuar duhet të ketë Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar me përmbajtjen e përcaktuar në nenin 32 të këtij ligji. | 1. Every Limited Partnership must have a Limited Partnership Agreement with the contents set forth in Article 32 of this Law. | 1.Svako ograničeno partnerstvo treba da ima Sporazum o ograničenom partnerstvu sa sadržajem utvrđenim u članu 32. ovog zakona. |
| 2. Secili Ortak në Ortakërinë e Kufizuar është i detyruar që ta zbatojë Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme në të duhet të theksojë se a e ka nënshkruar atë si Ortak i Përgjithshëm apo Ortak i Kufizuar. | 2. Every partner of the Limited Partnership is required to execute the Limited Partnership Agreement and to indicate whether they have signing it as a General Partner or a Limited Partner. | 2.Svaki ortak u ograničenom partnerstvu je obavezan da sprovodi Sporazum o ograničenom partnerstvu u kojem treba da bude naglašeno da li je isti potpisao kao generalni ortak ili ograničeni ortak. |
| **Neni 66**<br>**Të dhënat që Ortakëria e Kufizuar duhet ti ruajë dhe ti bëjë të disponueshme** | **Article 66**<br>**Records Which a Limited Partnership Must Keep and Make Available** | **Član 66**<br>**Podaci koje ograničeno partnerstvo treba da čuva i stavi na raspolaganje** |
| 1. Të gjitha Ortakëritë e Kufizuara duhet në çdo kohë, të mbajnë në adresën ose në vendin e ushtrimit të Veprimtarisë Ekonomike kryesore: | 1. Every Limited Partnership must at all times maintain at its address or place where the main Business Activity is conducted: | 1.Sva ograničena partnerstva treba da u svakom momentu u adresi ili mestu obavljanja glavne privredne delatnosti drže: |
| 1.1. një kopje të Marrëveshjes së Ortakërisë së Kufizuar, me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e saj të cilat | 1.1. a copy of its Limited Partnership Agreement, including any and all of its amendments which have been | 1.1.jednu kopiju Sporazuma o ograničenom partnerstvu, sa svim njenim izmenama i dopunama koje su |

| | | |
|---|---|---|
| janë regjistruar në ARBK;<br><br>1.2. një listë në të cilët evidentohen:<br><br>1.2.1. emrat dhe adresat e secilit ortak, duke theksuar në secilin rast se a është ortak i përgjithshëm apo i kufizuar,<br><br>1.2.2. datën kur është bërë ortak; dhe<br><br>1.2.3. një përshkrim të vlerës monetare, pronës ose artikujve tjerë me vlerë që ortaku në fjalë ka kontribuar ose është i detyruar ti kontribuojë në Ortakërinë e Kufizuar.<br><br>1.3. një listë të të gjitha bartjeve, pengjeve dhe fletëngarkesave të ngarkuara në Kuota të Ortakërisë së Kufizuar ose të lejuara nga një ortak;<br><br>1.4. kopje të dokumenteve financiare, si vijon:<br><br>1.4.1. pasqyrat financiare;<br><br>1.4.2. deklarata për të hyrat;<br><br>1.4.3. deklarata tjera financiare; dhe<br><br>1.4.4. fletëparaqitjet tatimore të | registered at KBRA;<br><br>1.2. a list which identifies:<br><br>1.2.1. the names and addresses of each partner, stating in each case whether such partner is a General Partner or a Limited Partner;<br><br>1.2.2. the date on which such partner became a partner, and<br><br>1.2.3. a description of the monetary value, property or other items of value that such partner has contributed or is obligated to contribute to the Limited Partnership.<br><br>1.3. a list of all transfers and pledges of, and encumbrances placed on, any Partnership Interest of the Limited Partnership or permitted by a partner;<br><br>1.4. copies of the following financial documents:<br><br>1.4.1. financial statements;<br><br>1.4.2. income statements;<br><br>1.4.3. other financial statements, and<br><br>1.4.4. tax returns of the Limited | registrovane u KARP-u;<br><br>1.2.jedan spisak u kojem je evidentirano:<br>1.2.1.imena i adrese svakog ortaka, naglašavajući u svakom slučaju da li se radi o generalnom ili ograničenom ortaku,<br><br>1.2.2.datum kada je postao ortak, i<br><br>1.2.3.opis novčane vrednosti, imovine ili drugih artikala od vrednosti kojima je ortak o kojem je reč doprineo ili je obavezan da doprinese ograničenom partnerstvu.<br><br>1.3.spisak svih prenosa, zaloga i opštih troškova na teretu kvota ograničenog partnerstva ili dozvoljenih od strane jednog od ortaka;<br><br>1.4.kopije finansijskih dokumenata kao što sledi:<br><br>1.4.1.finansijske izveštaje;<br><br>1.4.2.izveštaje o prihodima;<br><br>1.4.3.ostale finansijske izveštaje; i<br><br>1.4.4.poreske prijave ograničenog |

| | | |
|---|---|---|
| Ortakërisë së Kufizuar. | partnership. | partnerstva. |
| 1.5. Këto kërkesa zbatohen për dokumentet që kanë të bëjnë me vitin vijues, por vetëm deri në atë masë sa këto dokumente janë përgatitur. | 1.5. These requirements shall apply to documents relating to the current year, but only to the extent such documents have been prepared. | 1.5.Ovi zahtevi se odnose na dokumenta koja se tiču naredne godine, ali samo u onoj meri u kojoj su ova dokumenta pripremljena. |
| 1.6. Këto kërkesa po ashtu zbatohen për të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me secilin nga tri (3) vitet e kaluara; nëse Ortakëria e Kufizuar është themeluar më pak se tri (3) vite më parë, atëherë këto kërkesa zbatohen për të gjitha dokumentet e tilla. | 1.6. These requirements shall also apply to all documents relating to each of the previous three (3) years; if the Limited Partnership has been established for less than three (3) years, these requirements shall apply to all such documents. | 1.6.Ovi zahtevi se takođe odnose i na sva dokumenta koja se tiču svake od protekle tri (3) godine; ukoliko je ograničeno partnerstvo osnovano pre manje od tri (3) godine, u tom slučaju ovi zahtevi se odnose na sva dokumenta tog tipa. |
| 2. Secila Ortakëri e Kufizuar duhet që t'i vendosë këto të dhëna në dispozicion për secilin ortak dhe secilit ish-ortak për periudhën në të cilën ai ishte ortak, për inspektim dhe kopjim gjatë orarit të zakonshëm të punës. | 2. Every Limited Partnership must make these records available to any partner, and to any former partner with respect to the period when he was a partner, for inspection and copying during usual business hours. | 2.Svako ograničeno partnerstvo treba da stavi ove podatke na raspolaganje, svakom ortaku kao i svakom bivšem ortaku za period u kojem je bio ortak, na pregled i eventualno kopiranje u toku uobičajenog radnog vremena. |
| 3. Nëse Ortakëria e Kufizuar refuzon t'i lejojë një ortaku ose ish-ortaku që të marrë apo të inspektojë këto të dhëna, ose nëse nuk përgjigjet pas kërkesës më shkrim brenda pesë (5) ditëve pasi që kërkesa i është dorëzuar Ortakërisë së Kufizuar, ortaku që ka paraqitur kërkesën mund ti drejtohet gjykatës dhe të kërkoj nga ajo që të nxjerrë vendim për të pasur qasje në dokumentacion. Gjykata është e autorizuar të vendosë nëse paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në këtë qasje si dhe është e | 3. If a Limited Partnership refuses to permit a partner or former partner to obtain or examine these records or does not reply to a written demand within five (5) days after the demand was delivered to the Limited Partnership, the demanding partner may resort to the Court and demand for it to issue a decision to allow access to the records. The Court shall have authority to determine whether the claimant has the right to access and to order the Limited Partnership to provide | 3. Ukoliko ograničeno partnerstvo odbija da dozvoli nekom ortaku ili bivšem ortaku da uzme ili ispita ove podatke, ili ukoliko ne odgovore na zahtev pisanim putem u roku od pet (5) dana nakon što je zahtev podnesen ograničenom partnerstvu, ortak koji je podneo zahtev može uputiti sudu i tražiti od njega da donese odluku za omogućavanje pristupa dokumentaciji. Sud je ovlašćen da odluči da li podnosilac zahteva ima pravo na ovaj pristup kao što je i ovlašćen da naredi ograničenom |

| | | |
|---|---|---|
| autorizuar që të urdhërojë Ortakërinë e Kufizuar që ta sigurojë këtë informatë. | the information. | partnerstvu da obezbedi ove informacije. |
| 4. Asnjëra nga dispozitat e këtij neni nuk i paragjykon të drejtat shtesë të Ortakut ose ish Ortakut për qasje në dokumentacionin e Ortakërisë së Kufizuar në rastet e transaksioneve me konflikt interesi sipas Pjesës së Dhjetë të këtij ligji | 4. No provisions of this Article shall prejudice the additional rights of the Partner or former Partner to access the documents of the Limited Partnership in cases of conflict of interest transactions according to Part Ten of this law. | 4. Nijedna odredba ovog zakona ne prejudicira dodatna prava ortaka ili bivšeg ortaka za uvid u dokumenta ograničenog partnerstva u slučajevima transakcija sa sukobom interesa prema Delu deset ovo zakona. |
| **Neni 67**<br>**Kontributet e Ortakëve të Kufizuar** | **Article 67**<br>**Contributions of Limited Partners** | **Član 67**<br>**Doprinosi ograničenih ortaka** |
| 1. Secili ortak i kufizuar duhet të paguaj ose të dorëzojë në tërësi kontributin e tij në kohën e regjistrimit të Marrëveshjes të Ortakërisë së Kufizuar. | 1. Each Limited Partner must fully pay or submit his contribution at the time of registration of the Limited Partnership Agreement. | 1. Svaki ograničeni ortak treba da plati ili u potpunosti preda svoj doprinos u toku registracije Sporazuma o ograničenom partnerstvu. |
| 2. Ortaku i përgjithshëm është i autorizuar të paraqesë padi në emër të Ortakërisë së Kufizuar dhe ortakëve të saj, për ta detyruar një ortak të kufizuar që të paguajë ose dorëzojë kontributin e tij. | 2. A General Partner shall have the authority to file a Lawsuit on behalf of the Limited Partnership and its partners to compel a Limited Partner to pay or to submit his contribution. | 2. Generalni partner ima ovlašćenje da podnese tužbu u ime ograničenog partnerstva i njegovih partnera da bi prinudio ograničenog partnera da plati ili podnese svoj doprinos. |
| 3. Ortaku i kufizuar i cili nuk e ka paguar ose dorëzuar kontributin e tij deri në datën e regjistrimit të Marrëveshjes të Ortakërisë së Kufizuar, i bart të gjitha shpenzimet që ka bërë Ortakëria e Kufizuar apo ortakët e saj të përgjithshëm ose të kufizuar duke përfshirë edhe kompensimin për avokat, të bëra nga Ortakëria e Kufizuar ose ndonjë ortak i përgjithshëm ose i kufizuar gjatë | 3. The Limited Partner who has failed to pay or submit his contribution up to the date of the registration of the Limited Partnership Agreement is liable for all expenses made by the Limited Partnership or the General or Limited Partners, including compensation for lawyers' fees, incurred by the Limited Partnership and/or any General or Limited Partner during | 3. Ograničeni ortak koji nije platio ili predao njegov doprinos do datuma registracije Sporazuma o ograničenom partnerstvu, snosi sve troškove koje je načinilo ograničeno partnerstvo ili njegovi generalni ili ograničeni ortaci, uključujući i nadoknadu za advokata, načinjene od strane ograničenog partnerstva ili nekog generalnog ili ograničenog ortaka tokom |

| | | |
|---|---|---|
| kryerjes së këtij detyrimi. | performance of this obligation. | obavljanja ove obaveze. |
| **Neni 68**<br>**Kufizimi në përgjegjësinë e Ortakëve të Kufizuar** | **Article 68**<br>**Restrictions on Liability of Limited Partners** | **Član 68**<br>**Ograničenja u odgovornosti ograničenih ortaka** |
| 1. Asnjë person ose organizatë, përveç një ortaku të përgjithshëm, nuk është e autorizuar të veprojnë në emër të Ortakërisë së Kufizuar ose të krijojë detyrime për të. | 1. No person or organization, other than a General Partner, shall be authorized to act on behalf of a Limited Partnership or to create obligations on behalf of the Limited Partnership. | 1.Nijedna osoba ili organizacija, osim jednog generalnog ortaka, nije ovlašćena da postupa u ime ograničenog partnerstva ili da stvara obaveze za njega. |
| 2. Shprehimisht përcaktohet se ortaku i kufizuar nuk është i autorizuar të veprojë në emër të Ortakërisë së Kufizuar ose të krijojë detyrime për të. Asnjë kreditor nuk duhet të mbështetet në veprimet ose paraqitjet e një ortaku të kufizuar me qëllim të detyrimit të Ortakërisë së Kufizuar. | 2. It is expressly provided that a Limited Partner is not authorized to act on behalf of a Limited Partnership or to create obligations on its behalf. No creditor may rely on the acts or representations of a Limited Partner to establish any liability on the Limited Partnership. | 2. Izričito se utvrđuje da ograničeni ortak nije ovlašćen da postupa u ime ograničenog partnerstva ili da stvara obaveze za njega, Nijedan poverilac ne treba da podržava u postupanju ili predstavljanju nekog od ograničenih ortaka sa ciljem obavezivanja ograničenog partnerstva. |
| 3. Nëse një ose më shumë ortak të kufizuar, bëjnë një transaksion në të cilin ortakët e kufizuar përpiqen, pa autorizim, të krijojnë detyrime për Ortakërinë e Kufizuar, atëherë transaksioni dhe detyrimi përkatës nuk zbatohet ndaj Ortakërisë së Kufizuar, përveç nëse ky transaksion formalisht me shkrim vërtetohet nga një ortak i përgjithshëm në emër të Ortakërisë së Kufizuar. | 3. If one or more Limited Partners engage in a transaction in which the Limited Partner(s) attempt, without authorization, to create obligations for the Limited Partnership, the transaction and its respective obligations shall not be enforced against the Limited Partnership, unless a General Partner of the Limited Partnership formally and in writing ratifies the transaction on behalf of the Limited Partnership. | 3. Ukoliko jedan ili više ograničenih ortaka načine neku transakciju kojom ograničeni ortaci pokušavaju da bez ovlašćenja stvore obaveze za ograničeno partnerstvo, u tom slučaju transakcija i odgovarajuća obaveza se ne primenjuju na ograničeno partnerstvo, osim ukoliko je ova transakcija formalno u pisanom obliku potvrđena od strane jednog od generalnih ortaka u ime ograničenog partnerstva. |
| 4. Nëse transaksioni nuk vërtetohet nga një | 4. If a General Partner has not ratified the | 4.Ukoliko transakcija nije potvrđena od |

| | | |
|---|---|---|
| ortak i përgjithshëm, atëherë ortakët përkatës të kufizuar janë personalisht përgjegjës ndaj palës tjetër për këtë transaksion, dhe pala tjetër nuk ka kurrfarë të drejtash apo pretendimesh ndaj Ortakërisë së Kufizuar si rezultat i këtij transaksioni; me kusht që, pala tjetër ta ketë të drejtën të kërkojë kompensim nga ose të kërkojë përmbarimin nga Ortakëria e Kufizuar nëse një ortak i përgjithshëm me qëllim ose nga neglizhenca ka bërë paraqitje të cilat kanë ndikuar që pala tjetër me arsye të besojë se ortaku i kufizuar ose ortakët e kufizuar kanë pasur autorizim për të vepruar në emër të Ortakërisë së Kufizuar në lidhje me transaksionin në fjalë. | transaction, the concerned Limited Partner(s) are solely liable to the other party for this transaction, and that other party has no rights or claims against the Limited Partnership as a result of that transaction; provided, however, that the other party has the right to claim compensation from or to require performance by the Limited Partnership if, and only if, a General Partner intentionally or negligently made representations that caused the other party to reasonably believe that the concerned Limited Partner(s) had the authority to act on behalf of the Limited Partnership with respect to the concerned transaction. | strane nekog od generalnih ortaka, u tom slučaju je odgovarajući ograničeni ortak lično odgovoran prema drugoj strani za ovu transakciju, i druga strana nema nikakvo pravo ili pretenzije prema ograničenom partnerstvu kao rezultat ove transakcije; pod uslovom da druga strana ima pravo da traži nadoknadu od ili da traži izvršenje od strane ograničenog partnerstva ukoliko jedan generalni ortak sa ciljem ili iz neznanja načini predstavljanja koja su uticala da druga strana sa razlogom veruje da je ograničeni ortak ili ograničeni ortaci imali ovlašćenje da postupaju u ime ograničenog partnerstva u vezi transakcije o kojoj je reč. |
| 5. Ortakut të kufizuar i ndalohet pjesëmarrja në kontrollimin ose menaxhimin e Veprimtarisë Ekonomike ose aktiviteteve të Ortakërisë së Kufizuar. Megjithatë, shprehimisht përcaktohet se aktivitetet në vijim nuk përbëjnë shkelje të ndalesës së sipër cekur nëse: | 5. A Limited Partner is prohibited from participating in the control or management of the Business Activities or operations of the Limited Partnership. It is, however, expressly provided that the following activities do not constitute a violation of the foregoing prohibition: | 5. Ograničenom ortaku je zabranjeno učešće u kontrolisanju ili upravljanju privrednom delatnošću ili aktivnostima ograničenog partnerstva. Međutim, izričito se utvrđuje da sledeće aktivnosti ne krše gore pomenutu zabranu ukoliko: |
| 5.1. është punëtor ose kontraktues i Ortakërisë së Kufizuar ose një ortaku të përgjithshëm; | 5.1. being an employee or contractor of the Limited Partnership or of a General Partner; | 5.1.je radnik ili angažovan od strane ograničenog partnerstva ili jednog generalnog ortaka; |
| 5.2. është ortak, pronar, menaxher, aksionar, drejtor ose zyrtarë i një ortaku të përgjithshëm i cili është Shoqëri Tregtare ose person juridik; | 5.2. being a partner, owner, manager, Shareholder, director or officer of a General Partner that is a Business Organization or legal person; | 5.2.je ortak, vlasnik, menadžer, deoničar, direktor ili službenik nekog od generalnih ortaka koji je poslovno društvo ili pravno lice; |

| | | |
|---|---|---|
| 5.3. voton për miratimin e një ndryshimi ose plotësimi të Marrëveshjes së Ortakërisë së Kufizuar, kur ortaku i kufizuar ka të drejtë vote për miratimin e këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve;<br><br>5.4. voton për shpërbërjen ose jo të Ortakërisë së Kufizuar, kur ortaku i kufizuar ka të drejtë vote mbi këtë çështje, ose<br><br>5.5. ndërmerr masa për zbatimin ose mbrojtjen e të drejtave të ortakëve të kufizuar. | 5.3. voting on an amendment of the Limited Partnership Agreement, if the Limited Partner has the right to vote on such amendment;<br><br>5.4. voting on a decision as to whether or not to dissolve the Limited Partnership, if the Limited Partner has the right to vote on such decision, or<br><br>5.5. taking any action to enforce or defend the rights of Limited Partners. | 5.3.glasa za usvajanje neke izmene ili dopune Sporazuma ograničenog partnerstva, kada ograničeni ortak ima pravo glasa za usvajanje ovih izmena i dopuna;<br><br>5.4.glasa za raspuštanje ili ne ograničenog partnerstva kada ograničeni ortak ima pravo glasa povodom ovog pitanja, ili<br><br>5.5.preduzima mere za sprovođenje ili zaštitu prava ograničenih ortaka. |
| 6. Ortaku i kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet dhe detyrimet tjera të Ortakërisë së Kufizuar. Sidoqoftë, nëse ortaku i kufizuar i shkel ndalesat e paragrafit 5 të këtij neni duke marrë pjesë në kontrollin ose menaxhimin e Veprimtarisë Ekonomike ose aktiviteteve të Ortakërisë së Kufizuar, ortaku i kufizuar do të jetë përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të Ortakërisë së Kufizuar në shkallë të njëjtë sikurse ortakët e përgjithshëm. | 6. A Limited Partner is not liable for the debts and other obligations of a Limited Partnership. However, if a Limited Partner violates the prohibition of paragraph 5 of this Article by participating in the control or management of the Business Activities or operations of the Limited Partnership, such Limited Partner shall become liable for the debts and other obligations of the Limited Partnership to the same extent as a General Partner. | 6.Ograničeni ortak nije odgovoran za dugove i ostale obaveze ograničenog partnerstva. Ipak, ukoliko ograničeni ortak krši zabrane stava 5. ovog člana uzimajući deo pod kontrolu ili na upravljanje privrednom delatnošću ili aktivnosti ograničenog partnerstva, ograničeni ortak će biti odgovoran za sve dugove i druge obaveze ograničenog partnerstva u istom stepenu kao i generalni ortak. |

| **Neni 69**<br>**Bartja e Kuotës në Ortakërinë e Kufizuar** | **Article 69**<br>**Transfer of Limited Partnership Interest** | **Član 69**<br>**Prenos kvota u ograničenom partnerstvu** |
|---|---|---|
| 1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar, ortaku i kufizuar mundtë bartë Kuotën e tij në Ortakërinë e Kufizuar pas miratimit të të gjithë ortakëve të përgjithshëm. Bartja e Kuotës në Ortakërinë e Kufizuar përfshin edhe bartjen e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të ortakut të kufizuar. | 1. Unless the Limited Partnership Agreement provides otherwise, a Limited Partner may transfer his Partnership Interest in the Limited Partnership only after the approval of all General Partners. The transfer of a Partnership Interest includes the transfer of all rights and obligations of the Limited Partner. | 1. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno u Sporazumu o ograničenom partnerstvu, ograničeni ortak može da prenese svoju kvotu u ograničenom partnerstvu nakon usvajanja od strane svih generalnih ortaka. Prenos kvota u ograničenom partnerstvu obuhvata i prenos svih prava i obaveza ograničenog ortaka. |
| 2. Nëse kërkohet në bazë të një urdhri të gjykatës, ortakët e përgjithshëm të Ortakërisë së Kufizuar duhet të bëjnë bartjen e Kuotës së ortakut të kufizuar në Ortakërinë e Kufizuar tek një person fizik ose juridik dhe/ose Shoqëri Tregtare. | 2. If required by Court decision, the General Partner(s) of a Limited Partnership must conduct the transfer of the Partnership Interest of the Limited Partner in the Limited Partnership to another natural or legal person and/or Business Organization. | 2. Ukoliko se traži na osnovu nekog sudskog naloga, generalni ortaci ograničenog partnerstva treba načini prenos kvota ograničenog ortaka u ograničenom partnerstvu nekom drugom fizičkom ili pravnom licu i/ili poslovnom društvu. |
| 3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar, me vdekjen e ortakut të kufizuar, i cili është person fizik, Kuota e tij në Ortakërinë e Kufizuar kalon te trashëgimtarët e tij/saj ligjor. Në rast të shpërbërjes së një ortaku të kufizuar i cili është Shoqëri Tregtare, Kuota e ortakut në fjalë në Ortakërinë e Kufizuar bartet në përputhje me ligjin sipas të cilit bëhet shpërbërja e organizatës së tillë. | 3. Unless the Limited Partnership Agreement provides otherwise, a Partnership Interest is transferred to the lawful heirs of a Limited Partner who is a natural person, after the death of such Limited Partner. If a Limited Partner is a Business Organization and is dissolved, the Partnership Interest of such Limited Partner in the Limited Partnership is transferred in accordance with the Law under which the dissolution of such organization occurs. | 3. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno u Sporazumu o ograničenom partnerstvu, smrću nekog ograničenog ortaka koji je fizičko lice, njegova kvota u ograničenom partnerstvu prelazi na njegove zakonske naslednike. U slučaju raspuštanja nekog ograničenog ortaka koji je poslovno društvo, kvota ortaka o kojem je reč u ograničenom partnerstvu prenosi se u skladu sa zakonom u skladu sa kojim se čini raspuštanje organizacije tog tipa. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 70**<br>**Pranimi i Ortakëve Tjerë të Përgjithshëm**<br><br>1. Ortakëria e Kufizuar mund të pranojë Ortakë të Përgjithshëm shtesë:<br><br>1.1. në bazë të kushteve dhe procedurave të përcaktuara në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar; ose<br><br>1.2. nëse kushtet dhe procedurat përkatëse nuk janë përcaktuar në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar, pas pëlqimit me shkrim të të gjithë ortakëve të përgjithshëm dhe të kufizuar.<br><br>**Neni 71**<br>**Fitimet dhe Humbjet**<br><br>Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar, fitimet do të shpërndahet dhe humbjet do të ndahen njëlloj ndërmjet ortakëve të përgjithshëm dhe të kufizuar, në bazë të vlerës së kontributeve të tyre përkatëse.<br><br>**Neni 72**<br>**Tërheqja e Ortakut të Kufizuar**<br><br>1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar, | **Article 70**<br>**Admission of Additional General Partners**<br><br>1. Additional General Partners may be admitted to the Limited Partnership:<br><br>1.1. in accordance with the procedures and conditions specified in the Limited Partnership Agreement, or<br><br>1.2. if the Limited Partnership Agreement does not specify the respective procedures and conditions, after a written consent of all the General Partners and Limited Partners.<br><br>**Article 71**<br>**Profits and Losses**<br><br>Unless the Limited Partnership Agreement provides otherwise, profits shall be distributed and losses shall be shared among Limited Partners and General Partners on the basis of the value of their respective contributions.<br><br>**Article 72**<br>**Withdrawal of a Limited Partner**<br><br>1. Unless the Limited Partnership Agreement provides otherwise, a Limited | **Član 70**<br>**Prihvatanje drugih generalnih ortaka**<br><br>1. Ograničeno partnerstvo može prihvatiti dodate generalne ortake:<br><br>1.1.na osnovu uslova i procedura utvrđenih Sporazumom o ograničenom partnerstvu; ili<br><br>1.2.ukoliko uslovi i odgovarajuće procedure nisu utvrđene Sporazumom o ograničenom partnerstvu, nakon pisane saglasnosti svih generalnih i ograničenih ortaka.<br><br>**Član 71**<br>**Dobiti i gubici**<br><br>Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno u Sporazumu o ograničenom partnerstvu, dobiti i gubici će se deliti ravnopravno između generalnih i ograničenih ortaka na osnovu vrednosti njihovih odgovarajućih doprinosa.<br><br>**Član 72**<br>**Povlačenje ograničenog ortaka**<br><br>1. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno u Sporazumu o ograničenom partnerstvu, |

| | | |
|---|---|---|
| ortaku i kufizuar mund të tërhiqet nga Ortakëria e Kufizuar pas dorëzimit të një njoftimi me shkrim të gjithë ortakëve të përgjithshëm brenda një afati prej jo më pak se nëntëdhjetë (90) ditësh para kohës së tërheqjes. E drejta e ortakut të kufizuar në shpërndarje të dividendëve pas tërheqjes, është njëjtë me të drejtën e një ortaku të përgjithshëm të ortakërisë së përgjithshme, siç është përcaktuar në nenin 62 të këtij ligji.<br><br>2. Tërheqja e një ortaku të kufizuar nuk kërkon shpërbërjen e Ortakërisë së Kufizuar, përveç nëse si rezultat i tërheqjes, Ortakëria e Kufizuar mbetet pa ortakë të kufizuar.<br><br>**Neni 73**<br>**Shpërbërja dhe Përmbyllja e Veprimtarisë Ekonomike**<br><br>1. Ortakëria e Kufizuar mund të vazhdojë veprimtarinë përderisa së paku një ortak i përgjithshëm dhe një ortak i kufizuar mbeten në Ortakërinë e Kufizuar. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar, ortaku i kufizuar nuk është i autorizuar ta bëjë shpërbërjen e Ortakërisë së Kufizuar.<br><br>2. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar, gjatë shpërndarjes së aseteve të Ortakërisë | Partner may withdraw from a Limited Partnership after submitting a written notice to all General Partners within a period of no less than (90) ninety days before the time of withdrawal. The right of the Limited Partner to a distribution of dividends after withdrawal is the same as the right of a General Partner of the General Partnership as provided in Article 62 of this Law.<br><br>2. Withdrawal of a Limited Partner does not require the dissolution of the Limited Partnership, unless the withdrawal results in the Limited Partnership having no Limited Partners.<br><br>**Article 73**<br>**Dissolution and Conclusion of Business Activity**<br><br>1. A Limited Partnership may continue its activity so long as at least one General Partner and one Limited Partner remain in the Limited Partnership. Unless the Limited Partnership Agreement provides otherwise, a Limited Partner has no authorization to dissolve the Limited Partnership.<br><br>2. Unless the Limited Partnership Agreement provides otherwise, during the distribution of the assets of a Limited | ograničeni ortak se može povući iz ograničenog partnerstva nakon podnošenja pisanog obaveštenja svih generalnih ortaka u roku ne manje od devedeset (90) dana pre vremena povlačenja. Pravo ograničenog ortaka u podeli dividendi nakon povlačenja je jednako pravu jednog generalnog ortaka generalnog partnerstva, kao što je utvrđeno članom 62. ovog zakona.<br><br>2. Povlačenje ograničenog ortaka ne zahteva raspuštanje ograničenog partnerstva, osim ako rezultat povlačenja nije ostajanje ograničenog partnerstva bez ograničenih ortaka.<br><br>**Član 73**<br>**Raspuštanje i prestanak privredne delatnosti**<br><br>1. Ograničeno partnerstvo može da nastavi delatnost sve dok u ograničenom partnerstvu ne ostanu jedan generalni ortak i jedan ograničeni ortak. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno u Sporazumu o ograničenom partnerstvu, ograničeni ortak nije ovlašćen da vrši raspuštanje ograničenog partnerstva.<br><br>2. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno u Sporazumu o ograničenom partnerstvu, tokom raspodele sredstava ograničenog |

| | | |
|---|---|---|
| së Kufizuar, neto asetet e Ortakërisë së Kufizuar u shpërndahet në mënyrë të barabartë ortakëve të kufizuar dhe atyre të përgjithshëm. | Partnership, the net assets of the Limited Partnership shall be distributed equally to Limited Partners and to General Partners. | partnerstva, neto sredstva ograničenog partnerstva se dele na jednak način između generalnih i ograničenih ortaka. |
| 3. Shpërbërja e Ortakërisë së Kufizuar nuk i shuan pretendimet e kreditorëve kundër ortakëve të përgjithshëm në Ortakërinë e Kufizuar, dhe as që i shuan pretendimet e një ortaku të përgjithshëm ndaj një ortaku tjetër të përgjithshëm në Ortakërinë e Kufizuar. Pas shpërbërjes së Ortakërisë së Kufizuar, të gjithë ortakët e përgjithshëm duhet ti përmbushin kushtet e përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 56 të këtij ligji. | 3. The dissolution of a Limited Partnership does not extinguish creditor claims against General Partners in a Limited Partnership, and neither does it extinguish any claim of a General Partner against another General Partner in the Limited Partnership. Upon the dissolution of the Limited Partnership, all the General Partners shall execute the requirements specified in paragraph 3 of Article 56 of this Law. | 3. Raspuštanje ograničenog partnerstva ne eliminiše potraživanja poverilaca od generalnih ortaka ograničenog partnerstva, kao što ne eliminiše pretenzije jednog od generalnih ortaka prema nekom drugom generalnom ortaku ograničenog partnerstva. Nakon raspuštanja ograničenog partnerstva, svi generalni ortaci treba da ispune uslove određene stavom 3. člana 56 ovog zakona. |
| **Neni 74**<br>**Shkaqet e Shpërbërjes dhe Përmbylljes së Veprimtarisë Ekonomike** | **Article 74**<br>**Events Causing Dissolution and Requiring Conclusion of Business Activity** | **Član 74**<br>**Razlozi raspuštanja i prestanak privredne delatnosti** |
| 1. Ortakëria e Kufizuar e ndërprenë Veprimtarinë Ekonomike dhe duhet të shpërbëhet, për këto shkaqe: | 1. The Limited Partnership shall cease its Business Activity and shall be dissolved for the following reasons: | 1. Ograničeno partnerstvo prekida privrednu delatnost i treba da se raspusti zbog sledećih razloga: |
| 1.1. pas skadimit të afatit të Ortakërisë së Kufizuar, nëse afati është përcaktuar në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar; | 1.1. the expiration of the term or duration of the Limited Partnership, if such a term or duration is specified in its Limited Partnership Agreement; | 1.1.isteka roka ograničenog partnerstva, ukoliko je rok utvrđen Sporazumom o ograničenom partnerstvu; |
| 1.2. pas tërheqjes së të gjithë Ortakëve të Përgjithshëm, ose Ortakëve të Kufizuar; | 1.2. withdrawal of all General Partners, or all Limited Partners; | 1.2.povlačenja svih generalnih ortaka ili svih ograničenih ortaka; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.3. pas vdekjes së Ortakut të vetëm të Përgjithshëm, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar; | 1.3. the death of the only General Partner, unless the Limited Partnership Agreement provides otherwise; | 1.3.smrti jedinog generalnog ortaka, osim ukoliko nije drugačije utvrđeno u Sporazumu o ograničenom partnerstvu; |
| 1.4. pas një vendimi të Ortakëve për shpërbërjen e Ortakërisë së Kufizuar, në përputhje me Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar; | 1.4. a decision by the partners, in accordance with the Limited Partnership Agreement, to dissolve the Limited Partnership; | 1.4.odluke ortaka o raspuštanju ograničenog partnerstva, u skladu sa Sporazumom o ograničenom partnerstvu; |
| 1.5. me vendim të gjykatës, duke përfshirë shpërbërjen pas përmbylljes së procedurës së falimentimit ndaj Ortakërisë së Kufizuar; | 1.5. a Court decision, including dissolution upon completion of the bankruptcy procedure of the Limited Partnership; | 1.5.zbog sudske odluke, obuhvatajući i raspuštanje nakon završetka procedure stečajnog postupka ograničenog partnerstva; |
| 1.6. në rastet tjera të përcaktuara në Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar. | 1.6. other cases as specified with the Limited Partnership Agreement. | 1.6.u drugim slučajevima utvrđenim Sporazumom o ograničenom partnerstvu. |
| **PJESA E GJASHTË**<br>**SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR** | **PART SIX**<br>**LIMITED LIABILITY COMPANY** | **ŠESTI DEO**<br>**DRUŠTVO SA OGRANIČENOM ODGOVORNOŠĆU** |
| **KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME** | **CHAPTER I - GENERAL PROVISIONS** | **POGLAVLJE I - OPŠTE ODREDBE** |
| **Neni 75**<br>**Natyra e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe e Aksionit** | **Article 75**<br>**Nature of a Limited Liability Company and Shares** | **Član 75**<br>**Priroda društva sa ograničenom odgovornošću** |
| 1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është vetvetiu | 1. A Limited Liability Company is a legal person that is legally separate and distinct from its Shareholders. Limited Liability Company is itself the holder of rights and | 1. Društvo sa ograničenom odgovornošću je pravno lice koje je zakonski odvojeno od njegovih deoničara. Društvo sa ograničenom odgovornošću samo po sebi je |

| | | |
|---|---|---|
| bartëse e te drejtave dhe obligimeve. | obligations. | nosilac prava i obaveza. |
| 2. Aksionet në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar janë njësitë në bazë të të cilave bëhet ndarja e pronësisë në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 2. Shares of a Limited Liability Company are the units into which the ownership of the Limited Liability Company is divided. | 2. Deonice u društvu sa ograničenom odgovornošću su jedinice na osnovu kojih se vrši podela imovine u društvu sa ograničenom odgovornošću. |
| 3. Një aksion në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar është pronë personale e aksionarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë ligj dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Statut. | 3. A Share in a Limited Liability Company is the personal property of the Shareholder and it may be transferred in whole or in part, subject to applicable restrictions stated in the present Law and any restrictions stated in the Charter. | 3. Jedna deonica društva sa ograničenom odgovornošću je lično vlasništvo deoničara i može se prenositi delimično ili u potpunosti, u zavisnosti od ograničenja predviđenih ovim zakonom kao i drugih ograničenja predviđenih Statutom. |
| 4. Në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mund, por nuk është e detyrueshme, të parashihet që aksionet të dëshmohen përmes certifikatave të lëshuara nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar. | 4. The Charter of the Limited Liability Company may, but need not, provide that Shares be evidenced by a certificate issued by the Limited Liability Company. | 4. U Statutu društva sa ograničenom odgovornošću se može, ali nije obavezno, predvideti da se deonice potvrđuju putem uverenja izdatih od strane društva sa ograničenom odgovornošću. |
| **Neni 76**<br>**Parimi i Përgjegjësisë** | **Article 76**<br>**Principle of Liability** | **Član 76**<br>**Princip odgovornosti** |
| 1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është përgjegjëse për të gjitha borxhet e saj dhe detyrimet tjera metë gjitha asetet e saj. | 1. A Limited Liability Company is liable for all of its debts and other obligations with all of its assets. | 1. Društvo sa ograničenom odgovornošću je odgovorno za sve dugove i druge obaveze svim sa svim svojim sredstvima. |
| 2. Një aksionar i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar vetëm për arsye se është aksionar. | 2. A Shareholder of a Limited Liability Company is not liable for any debts or obligations of the Limited Liability Company solely by reason of being a Shareholder. | 2. Jedan deoničar društva sa ograničenom odgovornošću nije odgovoran za dugove ili obaveze društva sa ograničenom odgovornošću samo zato što je deoničar. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 77**<br>**Përgjegjësia për Veprimet e Themeluesve Para Regjistrimit**<br><br>1. Nëse një ose më shumë themelues dhe/ose persona të tjerë kryejnë veprim në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar para regjistrimit të saj, duke përfshirë, por pa u kufizuar në hapjen e xhirollogarive bankare, blerjen apo dhënien me qira të pronës, apo lidhjen e kontratave apo krijimin e detyrimeve të tjera, personat që ndërmarrin veprimet e tilla janë personalisht dhe bashkërisht përgjegjës për kërkesat dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve, përveç nëse është arritur marrëveshje tjetër me palët e treta.<br><br>2. Pas regjistrimit në ARBK, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund të marrë përsipër përgjegjësinë për këto kërkesa dhe detyrime. Në raste të këtilla, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është e vetmja palë përgjegjëse për kërkesat dhe detyrimet. | **Article 77**<br>**Liability for Actions of the Founder Prior to Registration**<br><br>1. If one or more founders and/or other persons take action on behalf of a Limited Liability Company before it is registered including, but not limited to, opening bank accounts, purchasing or leasing property, or entering into contracts or other obligations, the persons taking such action shall be jointly and personally liable for claims and obligations arising out of such actions, unless a different agreement was reached with the concerned third parties.<br><br>2. After registration at KBRA, the Limited Liability Company may assume liability for all such claims and obligations. In this case, the Limited Liability Company shall be solely liable for the claims or obligations. | **Član 77**<br>**Odgovornost za akcije osnivača pre registracije**<br><br>1. Ako jedan ili više osnivača i/ili drugih lica preduzmu akciju u ime društva sa ograničenom odgovornošću pre nego što je registrovano, uključujući, ali ne ograničavajući se na, otvaranje računa u banci, nabavku ili zakup imovine, ili stupanje u ugovore ili druge obaveze, lica koja preduzmu takve akcije su zajednički i lično odgovorna za zahteve i obaveze koje proističu iz tih akcija, osim ako je postignut drugačiji dogovor sa dotičnim trećim stranama.<br><br>2. Nakon registracije u KARP, društvo sa ograničenom odgovornošču može preuzeti odgovornost za sve takve zahteve i obaveze. U tom slučaju, društvo sa ograničenom odgovornošču je isključivo odgovorno za te zahteve ili obaveze. |
| **Neni 78**<br>**Të Drejtat dhe Detyrimet e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**<br><br>1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka të drejtat dhe detyrimet në vijim për ushtrimin e Veprimtarisë Ekonomike të saj, | **Article 78**<br>**Rights and Obligations of a Limited Liability Company**<br><br>1. A Limited Liability Company has the following rights and obligations to conduct its Business Activities including, but not | **Član 78**<br>**Prava i obaveze društva sa ograničenom odgovornošću**<br><br>1. Društvo sa ograničenom odgovornošću ima sledeća prava i obaveze povodom obavljanja sopstvene privredne delatnosti, |

| | | |
|---|---|---|
| duke përfshirë, por pa u kufizuar:<br><br>1.1.të ushtrojë padi ose të jetë e paditur;<br><br>1.2. të lidh kontrata, të huazojë para dhe të marrë borxhe apo të krijojë detyrime të tjera;<br><br>1.3. të fitojë, posedojë, të japë me qira, të lërë peng ose hipotekë, ose në mënyrë tjetër të disponojë ose të punojë me pasurinë e saj;<br><br>1.4. të fitojë, posedojë, japë me qira, të vejë peng, votojë, shesë ose në mënyrë tjetër të disponojë me Aksionin ose Kuotën në një Shoqëri tjetër Tregtare, përveç Biznesit Individual; dhe<br><br>1.5. të zgjedhë ose emërojë menaxherët, punonjësit dhe agjentët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe të përcaktojë detyrat dhe kompensimin e tyre.<br>**Neni 79**<br>**Kohëzgjatja**<br><br>Kohëzgjatja e Shoqërisë më Përgjegjësi të Kufizuar është e pakufizuar, përveç nëse parashihet ndryshe në Statutin e saj. | limited to:<br><br>1.1. to sue and be sued;<br><br>1.2. to enter into contracts, borrow money, and incur other debts and obligations;<br><br>1.3. to acquire, possess, lease, pledge or mortgage, or otherwise dispose of or deal with its assets;<br><br>1.4. to acquire, possess, lease, pledge, vote, sell, or otherwise dispose of Shares or Partnership Interest in another Business Organization, except Individual Businesses; and<br><br>1.5. to elect or appoint managers, employees and agents of the Limited Liability Company and to fix their duties and compensation.<br><br>**Article 79**<br>**Duration**<br><br>The duration of a Limited Liability Company is unlimited, unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise. | uključujući ali i ne i bez ograničenja:<br><br>1.1.pokretanje tužbi ali i da bude tuženo;<br><br>1.2.da sklapa ugovore, vrši novčane pozajmice da preuzima dugove ili stvara druge obaveze;<br><br>1.3.da profitira, poseduje, uzima pod zakup, uzima ili stavlja pod hipoteku, ili na neki drugi način raspolaže i radi sa sopstvenom imovinom;<br><br>1.4.da profitira, daje pod zakup, stavlja hipoteku, glasa proda ili na neki drugi način raspolaže deonicama ili kvotom u nekom drugom poslovnom društvu, osim individualnog preduzeća; i<br><br>1.5.da bira ili imenuje menadžere, zaposlene i agente društva sa ograničenom odgovornošću kao i da utvrđuje njihove zadatke i nadoknade.<br><br>**Član 79**<br>**Trajanje**<br><br>Trajanje društva sa ograničenom odgovornošću je neograničeno, osim ukoliko nije predviđeno drugačije u Statutu društva sa ograničenom odgovornošću. |

| Neni 80<br>Aksionarët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar | Article 80<br>Shareholders of a Limited Liability Company | Član 80<br>Deoničari društva sa ograničenom odgovornošću |
|---|---|---|
| 1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund të ketë për aksionarë një ose më shumë persona fizik ose juridik dhe/ose Shoqëri Tregtare, por jo më shumë se pesëdhjetë (50) aksionarë. Organizat joqeveritare nuk mund të jenë aksionar, përveç nëse parashihet me ligj të veçant. | 1. A Limited Liability Company may have as Shareholders one or more natural or legal persons and/or Business Organizations, but not more than (50) Shareholders. Non- Government organizations can not be shareholders, except if it is allowed by special law. | 1. Društvo sa ograničenom odgovornošću može imati deoničare u vidu jedne ili više fizičkih ili pravnih lica i/ili poslovnih društava, ali ne više od pedeset (50) deoničara. Nevladine organizacije ne mogu biti akcionar, osim ako to nije predviđeno posebnim zakonom. |
| 2. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka numër më të madh pronarëve se sa është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, atëherë Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar shndërrohet në Shoqëri Aksionare. | 2. If a Limited Liability Company has more Shareholders than the number of Shareholders provided in paragraph 1 of this Article, the Limited Liability Company shall be transformed into a Joint Stock Company. | 2. Ukoliko društvo sa ograničenom odgovornošću ima veći broj vlasnika nego što je to predviđeno stavom 1. ovog člana, u tom slučaju društvo sa ograničenom odgovornošću se transformiše u deoničarsko društvo. |
| 3. Drejtori(ët) Menaxhues mbajnë një listë të Aksionarëve që përmban emrat, adresat dhe vlerën nominale të aksioneve të tyre, ose përqindjen e aksioneve të mbajtura si dhe datën në të cilën janë bërë aksionarë. | 3. The Managing Director(s) shall keep a list of Shareholders which shall set out the names, addresses and the nominal value of their shares or the percentage of their shareholding and the date on which they became a Shareholder. | 3. Upravni direktor vodi listu deoničara u kojoj su imena, adrese i nominalna vrednost njihovih deonica ili procenat njihovog udela i datum kada su postali deoničari. |

| KAPITULLI II - STATUTI DHE MEMORANDUMI I INKORPORIMIT | CHAPTER II - CHARTER AND MEMORANDUM OF INCORPORATION | POGLAVLJE II - STATUT I MEMORANDUM O INKORPORACIJI |
|---|---|---|
| **Neni 81**<br>**Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**<br><br>1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar themelohet vetëm pas regjistrimit të statutit me përmbajtjen e përcaktuar në nenin 33 të këtij ligji.<br><br>2. Statuti është dokumenti konstituiv i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe ka përmbajtjen e përcaktuar në nenin 33 të këtij ligji.<br><br>**Neni 82**<br>**Memorandumi i Inkorporimit**<br><br>1. Çdo Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar duhet po ashtu të ketë Memorandumin e Inkorporimit.<br><br>2. Memorandumi i Inkorporimit është dokumenti themelues i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, me përmbajtjen e përcaktuar në nenin 33 të këtij ligji. | **Article 81**<br>**Charter of a Limited Liability Company**<br><br>1. A Limited Liability Company is established only after the registration of its Charter in accordance with Article 33 of this Law.<br><br>2. The Charter is the constitutive document of a Limited Liability Company, with contents as specified in the Article 33 of this Law.<br><br>**Article 82**<br>**Memorandum of Incorporation**<br><br>1. Every Limited Liability Company shall also have a Memorandum of Incorporation.<br><br>2. The Memorandum of Incorporation is the founding document of a Limited Liability Company, with the content specified in Article 33 of this Law. | **Član 81**<br>**Statut društva sa ograničenom odgovornošću**<br><br>1. Društvo sa ograničenom odgovornošću se osniva nakon registracije statuta sa sadržajem određenom u članu 33. ovog zakona.<br><br>2. Statut je ustavni dokument društva sa ograničenom odgovornošću i ima sadržaj određen u članu 33. ovog zakona.<br><br>**Član 82**<br>**Sporazum o društvu sa ograničenom odgovornošću**<br><br>1.Svako društvo sa ograničenom odgovornošću takođe treba da poseduje i Memorandum o Inkororaciji.<br><br>2.Memorandum o Inkorporaciji je dokument osnivanja Društva sa ograničenom odgovornošću, sa sadržajem određenom u članu 33 ovog zakona. |

| KAPITULLI III – RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT NGA SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR | CHAPTER III – RECORD KEEPING BY THE LIMITED LIABILITY COMPANY | POGLAVLJE III – ČUVANJE SLUŽBENE DOKUMENTACIJE OD DRUŠTVA SA OGRANIČENOM ODGOVORNOŠĆU |
|---|---|---|
| **Neni 83**<br>**Ruajtja e Dokumentacionit nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar** | **Article 83**<br>**Record Keeping by the Limited Liability Company** | **Član 83**<br>**Čuvanje službene dokumentacije od društva sa ograničenom odgovornošću** |
| 1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar në çdo kohë duhet të mbajë në adresën e regjistruar, si vijon: | 1. The Limited Liability Company must keep at its registered address, at all times, the following: | 1.Društvo sa ograničenom odgovornošću u svakom momentu treba da ima u registrovanoj adresi sledeće: |
| 1.1. një kopje të Statutit, duke përfshirë ndryshimet dhe plotësimet eventuale të statutit që janë regjistruar në ARBK; | 1.1 a copy of the Charter, including its amendments which have been registered at KBRA; | 1.1.kopiju Statuta, uključujući i eventualne izmene i dopune statuta koje su registrovane u KARP-u; |
| 1.2. një listë të Aksionarëve, e cila duhet të përmbajë emrat dhe adresat si dhe vlerën nominale të aksioneve apo përqindjen e aksioneve të mbajtura, si dhe datën në të cilën ata janë bërë aksionar; | 1.2 a list of Shareholders, which shall set out the names, addresses and the nominal value of their shares or the percentage of their shareholdingand the date on which they became a Shareholder; | 1.2.spisak deoničara, koji sadrži imena i adrese i nominalnu vrednost deonice svakog deoničara ili procenat njihovog udela i datum kada su postali deoničari; |
| 1.3. nëse ka Aksione me më shumë se një Aksionar, një listë të emrave dhe adresave të të gjithë bashkë-pronarëve dhe dokumentet të cilat e emërojnë përfaqësuesin e përbashkët të bashkë-pronarëve, nëse këta të fundit kanë përfaqësues ose nëse duhet ta kenë atë sipas nenit 91të këtij ligji. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund ta | 1.3 if Shares are owned by more than one Shareholder, a list of the names and addresses of each co-owner and the document(s) naming and designating the co-owners' joint representative if they have, or are required by Article 91 of this Law to have, such a representative. The Limited Liability Company may | 1.3.ukoliko postoje deonice sa više od jednog deoničara, spisak imena i adresa svih suvlasnika i dokumenta koja imenuju zajedničkog predstavnika tih suvlasnika, ukoliko imaju predstavnika ili ukoliko je potrebno da ga imaju u skladu sa članom 91. ovog zakona. Društvo sa ograničenom odgovornošću može kombinovati ovaj |

| | | |
|---|---|---|
| kombinojë këtë listë me listën e theksuar në nën-paragrafin 1.2 të paragrafit 1 të këtij neni. | combine this list with the list required by sub-paragraph 1.2 of paragraph 1 of this Article. | spisak sa spiskom navedenim u tački 1.2. stava 1. ovog člana. |
| 1.4. një listë të emrave dhe adresave të të gjithë Menaxherëve Drejtues dhe nëse është e aplikueshme, anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; | 1.4. a list of the names and addresses of all Managing Directors and, if applicable, members of the Board of Directors of the Limited Liability Company; | 1.4.spisak imena i adresa svih ključnih upravnih direktora i, ako je primenjivo, članova Odbora direktora društva sa ograničenom odgovornošću; |
| 1.5. një listë të të gjitha bartjeve dhe pengjeve apo barrave të tjera që i përkasin një Aksioni të bërë ose të lejuar nga një aksionar; dhe | 1.5. a list describing all transfers and pledges of, and encumbrances placed on, any Share, made or permitted by a Shareholder; and | 1.5.Spisak sa svih transakcija i zaloga i drugih opterećenja koje se tiču neke radnje obavljene ili dozvoljene od strane nekog deoničara; i |
| 1.6. kopjet e të gjitha dokumenteve financiare në vijim: | 1.6. copies of the following financial documents: | 1.6.kopije svih finansijskih dokumenata, prema sledećem: |
| 1.6.1. pasqyrat financiare; | 1.6.1. financial statements; | 1.6.1.finansijske izveštaje; |
| 1.6.2. deklaratat tatimore; | 1.6.2. tax returns; | 1.6.2.poreske prijave; |
| 1.6.3. deklarata tjera financiare; dhe | 1.6.3 other financial statements; and | 1.6.3.druge finansijske izjave, i |
| 1.6.4. raportet e auditimit. | 1.6.4 audit reports. | 1.6.4.izveštaje o reviziji. |
| 1.7 Këto kërkesa zbatohen për dokumentet që kanë të bëjnë me vitin aktual. Këto kërkesa po ashtu zbatohen për të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me secilin nga tri (3) vitet e kaluara kalendarike; nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është themeluar më pak se tri (3) vite më | 1.7 These requirements shall apply to records relating to the current year. These requirements shall also apply to all such documents relating to each of the previous three (3) calendar years; if the Limited Liability Company has been established in less than three (3) years, these requirements shall apply | 1.7.Ovi zahtevi se takođe odnose i na sva dokumenta koja se tiču tekuće godine. Ovi zahtevi se takođe odnose i na sva dokumenta koja se tiču svake od protekle tri (3) kalendarske godine; ukoliko je društvo sa ograničenom odgovornošću osnovano pre manje od tri (3) godine, u tom slučaju ovi zahtevi |

| | | |
|---|---|---|
| parë, atëherë këto kërkesa zbatohen për të gjitha dokumentet gjatë periudhës së ekzistimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | to all such documents throughout the existence of the Limited Liability Company. | se odnose na sva dokumenta tog tipa tokom perioda postojanja društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 2. Drejtori(ët) Menaxhues të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mbajnë një listë të përditësuar të Aksionarëve të saj, e cila: | 2. The Managing Director(s) of the Limited Liability Company shall keep an updated list of its Shareholders which: | 2.Upravni direktor(i) društva sa ograničenom odgovornošću vode ažuriran spisak svojih deoničara koji: |
| 2.1. përmban emrin dhe adresën e secilit Aksionar aktual dhe vlerën nominale të Aksioneve që aktualisht mbahen nga Aksionarët; si dhe | 2.1. includes the name and address of each current Shareholder and nominal value of the Shares currently held by Shareholders; and | 2.1sadrži ime i adresu svakog trenutnog deoničara i nominalnu vrednost koju trenutno drže deoničari; i |
| 2.2. ofron informata të tjera për Aksionarët të cilat sipas këtij ligji duhen regjistruar në listë. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar duhet të regjistrojë menjëherë informatat në këtë listë. | 2.2. provides other Shareholder information which according to this law must be registered in this list. The Limited Liability Company must immediately register this information in this list. | 2.2.pruža druge informacije o deoničarima koje po ovom zakonu moraju biti registrovane na ovom spisku. Društvo sa ograničenom odgovornošću mora odmah registrovati ove informacije na svom spisku. |
| 3. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar i ka lëshuar një Aksion një Aksionari, atëherë Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar duhet që menjëherë të regjistrojë informatat e tij në këtë listë. | 3. If the Limited Liability Company has issued a Share to a Shareholder, then the Limited Liability Company must immediately register his information in the list. | 3.Ako je društvo sa ograničenom odgovornošću izdalo deonicu deoničaru, onda Društvo sa ograničenom odgovornošću mora odmah registrovati ovu informaciju na svojoj listi. |
| 4. Nëse Aksionari ka pranuar një Aksion nga një Aksionar tjetër, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar duhet të regjistrojë informatat e duhura jo më vonë se tri (3) ditë pas pranimit të njoftimit të bartjes së atij Aksioni dhe identitetin e bartësit dhe pranuesit. Ndryshimet në listën e | 4. If the Shareholder has received a Share from another Shareholder, the Limited Liability Company must register the required information, not less than three (3) days after receiving notice of the transfer of that Share, and the identity of both the transferor and the transferee. The | 4.Ako je deoničar dobio deonicu od drugog deoničara, Društvo sa ograničenom odgovornošću mora da registruje traženu informaciju, ne manje od tri (3) dana od dobijanja obaveštenja o prenosu te deonice, uz identitet oba deoničara. Izmene u listi deoničara se vrše na osnovu potpisane |

| | | |
|---|---|---|
| Aksionarëve duhen bërë në bazë të një deklarate të nënshkruar nga bartësi e cila thekson se bartësi e ka bartur Aksionin tek pranuesi. | amendments in the list of shareholders shall be made based on a signed declaration by the transferor stating that the transferor has transferred the Share to the transferee. | izjave prenosioca kojom se kaže da je prenosilac preneo deonicu primaocu. |
| 5. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar dështon apo refuzon të regjistrojë informatat e obligueshme për Aksionarin brenda afatit të përcaktuar kohor, personi fizik apo juridik në fjalë dhe/apo Shoqëria Tregtare mund të parashtrojë padi në gjykatën kompetente për të obliguar Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar që të regjistrojë këto informata dhe që formalisht të njohë statusin e personit fizik apo juridik dhe/apo Shoqërisë Tregtare si Aksionar. Pas dorëzimit të padisë nga personi fizik apo juridik dhe/apo Shoqëria Tregtare që kërkon statusin e Aksionarit, ose pas padisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, Gjykata kompetente është e autorizuar dhe kompetente që të: | 5. If the Limited Liability Company fails or refuses to register the required Shareholder information in the list of Shareholders within the specified time limit, the concerned natural or legal person and/or Business Organization may file suit before the competent court to compel the Limited Liability Company to register this information and to formally recognize the status of the natural or legal person and/or Business Organization as a Shareholder. The competent court, after submission of the claim by a natural or legal person and/or Business Organization requesting Shareholder status, or after the claim of the Limited Liability Company, is competent and authorized to: | 5.Ako društvo sa ograničenom odgovornošću propusti ili odbije da registruje potrebne informacije deoničara u listi deoničara u preciziranom roku, odgovarajuće fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo može podneti tužbu pred nadležnim sudom kako bi prinudilo društvo sa ograničenom odgovornošću da registruje ovu informaciju i formalno prizna status fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo kao deoničara. Nadležni sud, nakon podnošenja zahteva od fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo za status deoničara, ili nakon zahteva društva sa ograničenom odgovornošću, nadležan je i ovlašćen da: |
| 5.1. përcaktojë pronarin e vërtetë të Aksionit dhe të përcaktojë datën në të cilën pronari është dashur të regjistrohet në listën e Aksionarëve; | 5.1. determine the real owner of the Share and to establish the day on which the owner should have been registered in the list of Shareholder; | 5.1.odredi stvarnog vlasnika deonice i utvrdi dan kada vlasnik treba da bude registrovan u listi deoničara; |
| 5.2. urdhërojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar të regjistrojë informatat e Aksionarit në listën e Aksionarëve; dhe | 5.2. order the Limited Liability Company to register the shareholder's information in the list of Shareholders; and | 5.2.naloži društvu sa ograničenom odgovornošću da registruje podatke deoničara u listi deoničara; i |
| 5.3. kompensojë dëmet që gjykata i | 5.3. compensate damage which the | 5.3.nadoknadi štetu koju sud smatra |

| | | |
|---|---|---|
| konsideron të përshtatshme; nëse gjykata vendos në favor të pranuesit, kompensimi mund të përfshijë kompensimin për dëmet që Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuari i ka shkaktuar pranuesit si pasojë e refuzimit të saj për të regjistruar menjëherë informatat e pranuesit në listën e Aksionarëve, duke përfshirë dëmet e shkaktuara si pasojë e pamundësisë së pranuesit për të votuar apo për të pranuar dividendat apo për të transferuar aksionin. | court deems appropriate; if the court decides in favour of the transferee such compensation may include compensation for damages that the Limited Liability Company caused to the transferee as a result of its refusal to promptly register transferee's information in the list of Shareholder, including any damages caused as a result of the inability of the transferee to vote or receive dividends or to transfer the Share. | prikladnom; ako sud odluči u korist primaoca ovakva nadoknada može da sadrži nadoknadu štete koju je društvo sa ograničenom odgovornošću nanelo primaocu kao rezultat odbijanja da odmah registruje podatke primaoca u listi deoničara, uključujući i bilo koju štetu nastalu kao rezultat nesposobnosti primaoca da glasa ili primi dividende ili prenese deonicu. |
| 6. Transferi i Aksionit konsiderohet të ketë efekt dhe Aksionari konsiderohet të ketë ndërruar në lidhje me Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar pas njoftimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar për transferimin e aksionit dhe vërtetimit të transferimit të Aksionit. | 6. The transfer of a share is deemed to be effected and a shareholder is deemed to have changed with respect to the Limited Liability Company after notification of the Limited Liability Company of the transfer of the share and certification of the transfer of the share. | 6. Prenos deonice se smatra izvršenim i smatra se da se deoničar promenio u pogledu društva sa ograničenom odgovornošću nakon obaveštenja društva sa ograničenom odgovornošću o prenosu deonice i potvrde prenosa deonice. |
| **Neni 84**<br>**Qasja e Aksionarëve në Dokumentacionin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar** | **Article 84**<br>**Shareholder Access to Records of a Limited Liability Company** | **Član 84**<br>**Pristup deoničara dokumentaciji društva sa ograničenom odgovornošću** |
| 1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar duhet të vendosë në dispozicion të secilit Aksionar dhe ish Aksionar, për periudhën sa ai/ajo ka qenë aksionar, tërë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 83 të këtij ligji për inspektim dhe kopjim gjatë | 1. The Limited Liability Company must make all the records as provided by Article 83 of this Law available to any Shareholder, and to any former Shareholder during the time he/she was a Shareholder, for inspection and copying | 1. Društvo sa ograničenom odgovornošću treba da stavi ove podatke na raspolaganje, svakom deoničaru kao i svakom bivšem deoničaru za period u kojem je bio deoničar, kompletnu dokumentaciju utvrđenu članom 83. na pregled i |

| | | |
|---|---|---|
| orarit të rregullt të punës. | during usual business hours. | eventualno kopiranje u toku uobičajenog radnog vremena. |
| 2. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar refuzon të lejojë qasjen e një Aksionari ose ish Aksionari, për periudhën sa ai ka qenë aksionar, në dokumentacionin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar sipas nenit 83 të këtij ligji, ose nuk përgjigjet në kërkesën e aksionarit në fjalë brenda pesë (5) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës, aksionari ose ish-aksionari ka të drejtë të paraqesë kërkesë pranë gjykatës kompetente për ta urdhëruar Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar që të lejojë qasjen në dokumentacion. | 2. If a Limited Liability Company refuses to allow access of a Shareholder or a former Shareholder during the time he/she was a Shareholder to the records of the Limited Liability Company according to Article 83 of this law, or if it does not respond to the request of the respective Shareholder within 5 days after the request was submitted, the demanding Shareholder or former Shareholder may petition the Court to allow access to such records. | 2. Ukoliko društvo sa ograničenom odgovornošću odbija da dozvoli pristup nekom deoničaru ili bivšem deoničaru, za period u kojem je bio deoničar, dokumentaciji utvrđenoj članom 83. ovog zakona, ili ukoliko ne odgovore na zahtev deoničara o kojem je reč pisanim putem u roku od pet (5) dana nakon što je zahtev podnesen, deoničar ili bivši deoničar ima pravo da uputi zahtev nadležnom sudu da naloži društvu sa ograničenom odgovornošću da dozvoli pristup dokumentaciji. |
| 3. Gjykata kompetente vendos nëse pala kërkuese ka te drejtë në qasjen e kërkuar si dhe ta detyrojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar për ta lejuar qasjen. Gjykata mund t'ia refuzojë Aksionarit lejimin e qasjes në informatat apo dokumentet vetëm nëse ka bazë për të supozuar se kjo qasje mund t'i shkaktojë dëm të konsiderueshëm interesave të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 3. The competent Court shall decide whether the claimant has the right to the access sought and to order the Limited Liability Company to allow access. The court can only refuse to grant the access to information or documents to Shareholder if there is a basis to presume that this may cause significant damage to the interests of the Limited Liability Company. | 3. Nadležni sud odlučuje da li strana koja zahteva pristup ima pravo traženog pristupa ali i obavezuje društvo sa ograničenom odgovornošću da dozvoli pristup. Sud može samo odbiti da dodeli pristup informacijama ili dokumentima deoničaru ako postoji osnova da se pretpostavi da će to izazvati značajnu štetu interesima društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 4. Dispozitat e këtij neni dhe nenit 83 të këtij ligji nuk i paragjykojnë të drejtat shtesë të Aksionarit ose ish-Aksionarit për qasje në dokumentacionin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në rastet e transaksioneve me konflikt interesi sipas | 4. Provisionins of this article and article 83 of this Law shall not prejudice additional rights of a Shareholder or a former Shareholder to access the records of the Limited Liability Company in cases of conflict of interest transactions according | 4. Odredbe ovog člana i člana 83 ovog zakona ne utiču na prava deoničara ili bivšeg deoničara da pristupi dokumentaciji društva sa ograničenom odgovornošću u slučajevima prenosa sa sukobom interesa u skladu sa delom Deset ovog zakona. |

| | | |
|---|---|---|
| Pjesës së Dhjetë të këtij ligji. | to Part Ten of this Law. | |
| **KAPITULLI IV - KONTRIBUTET E AKSIONARËVE** | **CHAPTER IV - SHAREHOLDER CONTRIBUTIONS** | **POGLAVLJE IV - DOPRINOSI DEONIČARA** |
| **Neni 85**<br>**Forma e Kontributeve** | **Article 85**<br>**Form of Contributions** | **Član 85**<br>**Vrste doprinosa** |
| 1. Kontributi i një aksionari në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar në shkëmbim me një Aksion, mund të bëhet në: | 1. The Contribution of a Shareholder to a Limited Liability Company in exchange for a Share may be made in the form of: | 1. Doprinos jednog deoničara društvu sa ograničenom odgovornošću u zamenu za deonicu može biti: |
| 1.1. të holla; | 1.1. cash; | 1.1.novčani; |
| 1.2. pronë tjetër, materiale ose jo-materiale; | 1.2. other tangible or intangible property; | 1.2.druga imovina, materijalna ili nematerijalna; |
| 1.3. me punë ose shërbime të ekzekutuara; | 1.3.labour or services already performed; | 1.3.u vidu posla ili obavljenih usluga; |
| 2. Premtimi për kryerjen e punëve ose shërbimeve në të ardhmen nuk kualifikohet si kontribut i vlefshëm dhe nuk kompensohet me aksione. | 2. Promise to provide future labour or services shall not qualify as valid contribution, and shall not be compensated in Shares. | 2. Obećanje za izvršene poslove ili usluge u budućnosti ne procenjuje se kao važeći doprinos i ne nadoknađuju se akcijama. |
| 3. Vlera e kontributeve jo-monetare përcaktohet: | 3. The value of non-monetary Contributions shall be determined: | 3.Vrednost ne novčanih doprinosa utvrđuje se: |
| 3.1 në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; ose | 3.1 in accordance with the applicable provisions of the Limited Liability Company Charter; or | 3.1.na osnovu primenjivih odredbi Statuta o društvu sa ograničenom odgovornošću; ili |
| 3.2 nëse Statuti i Shoqërisë me | 3.2. if the Limited Liability Company | 3.2.ukoliko Statut o društvu sa |

| | | |
|---|---|---|
| Përgjegjësi të Kufizuar nuk përmban dispozita për vlerësimin e kontributeve jo-monetare, sipas marrëveshjes unanime të të gjithë Aksionarëve. | Charter does not contain provisions applicable to the determination of non-monetary contributions, according to the unanimous agreement of all the Shareholders. | ograničenom odgovornošću ne sadrži odredbe za ocenjivanje ne novčanih doprinosa, u skladu sa jednoglasnim sporazumom svih deoničara. |
| **Neni 86**<br>**Përgjegjësia për Kontributet e Dakorduara** | **Article 86**<br>**Liability for Agreed Contributions** | **Član 86**<br>**Odgovornost za dogovorene doprinose** |
| Aksionari është i detyruar që Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar t'ia paguajë të gjitha kontributet me afat, sipas Statutit apo Marrëveshjes së Inkorporimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar apo sipas ndonjë marrëveshje tjetër të Aksionarëve. Ky detyrim nuk mund të arsyetohet për shkak të vdekjes, paaftësimit, ose paaftësisë tjetër për pagim të Aksionarit. | The Shareholder is obligated to pay to the Limited Liability Company all the Contribution(s) in due time, as specified by the Charter or Agreementof Incorporation of the Limited Liability Company, or by another agreement between Shareholders. Such obligation is not excused by the owner's death, disability or other inability to pay. | Deoničar je obavezan da društvu sa ograničenom odgovornošću plaća sve doprinose na vreme, u skladu sa Statutom ili Sporazumomo inkorporaciji društva sa ograničenom odgovornošću ili u skladu sa nekim drugim sporazumom deoničara. Ova obaveza se ne može opravdati smrću, invaliditetom, ili drugim vrstama nesposobnosti za plaćanje deoničara. |
| **Neni 87**<br>**Dënimet për Shkak të Mos-pagesës së Kontributeve të Dakorduara** | **Article 87**<br>**Penalties for Failure to Make Agreed Contributions** | **Član 87**<br>**Kazne zbog neplaćanja dogovorenih doprinosa** |
| 1. Memorandumi i Inkorporimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mund të përcaktojë dënime dhe pasoja të tjera për Aksionarët të cilët nuk paguajnë kontributin e dakorduar. Këto dënime të cilat përcaktohen në Memorandumin e Inkorporimit të Shoqërisë më Përgjegjësi të Kufizuar, mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, si vijon: | 1. The Limited Liability Company Memorandum of Incorporation may establish penalties or other consequences for Shareholders who fail to pay an agreed contribution. The provisions in the Limited Liability Company Memorandum of Incorporation may include, but is not limited to: | 1. Memorandum o inkorporaciji društva sa ograničenom odgovornošću može predvideti kazne i druge posledice za deoničara u slučaju neplaćanja dogovorenih doprinosa. Ove kazne, koje utvrđuje Memorandum o inkorporaciji društva sa ograničenom odgovornošću, mogu obuhvatati ali ne i ograničavati, prema sledećem: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. zvogëlimin proporcional të Aksionit të Aksionarit në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar; | 1.1. the proportional reduction of the Shareholder's Share in the Limited Liability Company; | 1.1.proporcionalno smanjenje deonica deoničaru u društvu sa ograničenom odgovornošću; |
| 1.2. subordinimin e të drejtës së Aksionarit në pjesën e tij gjatë shpërndarjeve të dividendëve për aksionarët e tjerë që kanë dhënë kontributet e tyre, | 1.2. the subordination of the Shareholder's right to distributions to those of Shareholders who have made their required contributions; | 1.2.podređenost prava deoničara njegovog dela tokom raspodele dividendi u odnosu na druge deoničare koji su dali svoje doprinose, |
| 1.3. shitjen e detyruar të Aksioneve të Aksionarit në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, | 1.3. the forced sale of the Shareholder's Shares to the Limited Liability Company; | 1.3.obavezno prodavanje deonica deoničara društvu sa ograničenom odgovornošću; |
| 1.4. humbjen e Aksionit të Aksionarit në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar; ose | 1.4. the forfeiture of the Shareholder's Share to the Limited Liability Company, or | 1.4.gubitak deonica deoničara u društvu sa ograničenom odgovornošću; |
| 1.5. përcaktimit, në bazë të një vlerësimi profesional ose formule, të vlerës së cilësdo pjesë të Aksionit të Aksionarit që është paguar, dhe shitjen e detyruar të asaj pjese në vlerën e përcaktuar. | 1.5 the determination, by appraisal or formula, of the value of any part of the Shareholder's Share that has been paid for, and the mandatory sale of that part at the value so determined. | 1.5.utvrđivanje na osnovu neke profesionalne procene ili formule, vrednost bilo kojeg dela deonica deoničara koji je plaćen, kao obaveznu prodaju njegovog dela u određenoj vrednosti. |
| **KAPITULLI V - SHPËRNDARJA E DIVIDENDËVE TEK AKSIONARËT** | **CHAPTER V - DISTRIBUTION OF DIVIDENDS TO SHAREHOLDERS** | **POGLAVLJE V - RASPODELA DIVIDENDI ZA DEONIČARE** |
| **Neni 88**<br>**Shpërndarja e Dividendëve tek Aksionarët** | **Article 88**<br>**Distributions of Dividends to Shareholders** | **Član 88**<br>**Raspodela dividendi za deoničare** |

| | | |
|---|---|---|
| 1. Dividendët mund t'i paguhen Aksionarëve nga fitimi neto ose nga fitimi i ruajtur nga vitet e kaluara, prej të cilit janë zbritur humbjet nga vitet e kaluara, në bazë të raportit vjetor të miratuar. | 1. Dividends may be paid to the shareholders from net profit or from retained profit from previous years from which losses from previous years have been deducted, on the basis of the approved annual report. | 1. Dividende se mogu platiti deoničarima iz neto profita ili zadržanog profita iz prethodnih godina za koje su oduzeti gubici iz prethodnih godina, na osnovu usvojenog godišnjeg izveštaja. |
| 2. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar, mund ta bëjë shpërndarjen e dividendëve për Aksionarët e saj në çdo kohë me miratimin unanim të aksionarëve ose me metodë tjetër votimi që kërkon numër më të vogël të votave, siç parashihet në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar sipas nenit105 të këtij ligji. | 2. The Limited Liability Company may make distributions to its Shareholders at any time with the unanimous consent of the Shareholders or with another voting method requiring a smaller number of votes as specified in the Charter of the Limited Liability Company in accordance with Article 105 of this Law. | 2. Društvo sa ograničenom odgovornošću može vršiti raspodelu dividendi za svoje deoničare u svakom momentu jednoglasnim usvajanjem deoničara ili drugim metodama glasanja koje traži najmanji broj glasova, kao što je predviđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću u skladu sa članom 105 ovog zakona. |
| 3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, çdo shpërndarje e dividendëve për Aksionarët, duhet të jetë e barabartë për të gjithë. | 3. Unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise, any distribution of dividends to Shareholders shall be equal for all. | 3. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, svaka raspodela dividendi za deoničare treba da bude jednaka za sve. |
| 4. Kur Aksionari fiton të drejtën për marrjen e dividendit, ai bëhet kreditor i pa siguruar i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në raport me dividendin. | 4. When a Shareholder gains the right to receive a dividend, that Shareholder becomes an unsecured creditor of the Limited Liability Company with respect to that dividend. | 4. Kada deoničar dobije pravo da uzme dividendu, on postaje neosigurani poverilac društva sa ograničenom odgovornošću, u izveštaju o dividendi. |
| 5. Afati për shpërndarjen e dividendave për Aksionarët nuk mund të jetë më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e njoftimit për shpërndarjen. | 5. The time limit for distribution of dividends to Shareholders may not be longer than ninety (90) days from the date of notice of distribution. | 5. Rok za raspodelu dividendi za deoničare ne sme biti duži od devedeset (90) dana od datuma obaveštavanja o raspodeli. |
| 6. Së paku gjysma e fitimeve të periudhës | 6. At least one half of the profits of the | 6. Najmanje polovina profita za finansijski |

| | | |
|---|---|---|
| financiare, nga të cilat zbriten shumat që nuk mund të shpërndahen sipas Statutit, shpërndahet si dividendë, nëse kërkesa me këtë bazë i bëhet Kuvendit të përgjithshëm të Aksionarëve nga Aksionarët me së paku një të dhjetën (1/10) e të gjitha Aksioneve para se të merret vendimi për përdorimin e fitimeve. | financial period, less the amounts not to be distributed under the Charter, shall be distributed as dividend, if a demand to this effect is made at a general Shareholder Assembly by shareholders with at least one tenth (1/10) of all Shares before the decision on the use of the profits has been made. | period, osim sume koja se po statutu ne distribuira, deli se kao dividenda, ako se potražnja ove vrste izvrši na generalnoj skupštini deoničara sa najmanje jednom desetinom (1/10) od svih deonica pre odluke o korišćenju profita. |
| **Neni 89**<br>**Kufizimet gjatë shpërndarjes së dividendëve** | **Article 89**<br>**Restrictions on Distribution of Dividends** | **Član 89**<br>**Ograničenja tokom raspodele dividendi** |
| 1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar nuk do ta bëjë shpërndarjen e dividendëve për Aksionarët nëse si rezultat i shpërndarjes, pasuria e përgjithshme e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar do të jetë më e vogël se sa detyrimet e përgjithshme ose nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar nuk do të jetë e aftë për pagimin e borxheve ose detyrimeve të tjera të cilat maturohen gjatë Veprimtarisë të saj të rregullt Ekonomike. | 1. A Limited Liability Company may not make a distribution to Shareholders if as a result of the Distribution, the Limited Liability Company's total assets would be less than its total liabilities or the Limited Liability Company would be unable to pay its debts and other obligations as they become due in the ordinary course of the Business Activity of the Limited Liability Company. | 1. Društvo sa ograničenom odgovornošću neće vršiti raspodelu dividendi deoničarima kao rezultat raspodele, ako će opšta imovine društva sa ograničenom odgovornošću će biti manja od opštih obaveza ili ako društvo sa ograničenom odgovornošću neće biti sposobno da plati dugove ili druge obaveze koje dospevaju tokom redovne privredne delatnosti društva sa ograničenom ogovornošću. |
| 2. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar që dëshiron të bëjë një shpërndarje të dividendëve, duhet së pari të vendosë se kjo shpërndarje nuk është e ndaluar sipas paragrafit 1 të këtij neni. Ky vendim duhet të bazohet në pasqyrat financiare të përgatitura në pajtim me ligjet në fuqi që | 2. If a Limited Liability Company wants to make a Distribution, it shall first make a formal decision that such Distribution is not prohibited by paragraph 1 of the present Article. This decision must be based on financial statements prepared in accordance with applicable Laws on | 2. Društvo sa ograničenom odgovornošću koje želi da vrši raspodelu dividendi, treba pre svega da ustanovi da li ova raspodela nije zabranjena stavom 1. ovog člana. Ova odluka treba da se zasniva na finansijskim izveštajima pripremljenim u skladu sa zakonima na snazi koji utvrđuju standarde i |

| | | |
|---|---|---|
| përcaktojnë standardet dhe parimet e kontabilitetit që janë të vlefshme në ato rrethana. Në rast të vlerësimit të pasurisë jo-monetare, vendimi duhet të bazohet në një vlerësim të drejtë dhe të pavarur që është i vlefshëm nën ato rrethana. | accounting standards and on accounting principles that are reasonable in the circumstances. In the case of valuation of non-monetary assets, the decision must be based on a fair and independent valuation that is reasonable under the circumstances. | principe računovodstva koje je važeće u tim okolnostima. U slučajevima procenjivanja ne novčane imovine, odluka treba da se zasniva na proceni pravoj i nezavisnoj proceni koja je važeća u tim okolnostima. |
| **Neni 90**<br>**Përgjegjësia Personale për Shpërndarjet e Ndaluara të Dividendëve** | **Article 90**<br>**Personal Liability for Prohibited Distribution of Dividends** | **Član 90**<br>**Lična odgovornost za zabranu raspodele dividendi** |
| 1. Një aksionar që pranon një shpërndarje të ndaluar të dividendëve sipas paragrafit 1 të nenit 89 të këtij ligji dhe i cili ka qenë në dijeni ose është dashur të ketë qenë në dijeni në atë kohë se shpërndarja ka qenë në kundërshtim me neni 89 të këtij ligji, është personalisht përgjegjës ndaj Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar për kthimin e shumës së marrë të shpërndarjes. | 1. A Shareholder who receives a prohibited Distribution of dividends specified in paragraph 1 of Article 89 and who knew or should have known at the time that such distribution was prohibited by Article 89 of this Law, is personally liable to the Limited Liability Company for the return of the amount of the Distribution. | 1.Deoničar koji prihvata zabranu raspodele dividendi u skladu sa stavom 1 člana 89. ovog zakona i koji je bio svestan ili je želeo da bude svestan da je u to vreme raspodela bila u suprotnosti sa članom 89. ovog zakona, je lično odgovorna prema Društvo sa ograničenom odgovornošću za povraćaj sume uzete prilikom raspodele. |
| 2. Një Aksionar, menaxher ose një person tjetër që bën shpërndarjen e ndaluar të dividendëve, dhe i cili në atë kohë ka qenë në dijeni se shpërndarja është bërë në kundërshtim me nenin89 të këtij ligji, është personalisht përgjegjës ndaj Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar për kthimin e shumës së marrë të të gjitha shpërndarjeve të tilla. | 2. A Shareholder, manager or other person who makes a prohibited Distribution of dividends, and who knew at the time that the Distribution was prohibited by Article 89 of this Law, is also personally liable to the Limited Liability Company for the return of the amount of all such Distributions. | 2.Jedan deoničar, menadžer ili neka druga osoba koja vrši zabranjenu raspodelu dividendi, i koja je u to vreme bila svesna da je raspodela u suprotnosti sa članom 89. ovog zakona, je lično odgovorna prema Društvo sa ograničenom odgovornošću za povraćaj sume uzete prilikom raspodele. |
| 3. Nëse më shumë se një aksionar dhe/ose persona mbajnë përgjegjësi për kthimin e një shpërndarje sipas paragrafit 1 dhe/ose 2 | 3. If more than one Shareholder and/or person are liable for the return of a Distribution under paragraph 1 and/or 2 of | 3.Ukoliko je vise od jednog deoničara i/ili osoba odgovorno za povraćaj neke raspodele u skladu sa stavom 1 i/ili 2 ovog |

| | | |
|---|---|---|
| të këtij neni, atëherë përgjegjësia është përbashkët dhe individuale. | this Article, their liability shall be joint and several. | člana, u tom slučaju je odgovornost i kolektivna i individualna. |
| **KAPITULLI VI - BASHKË-PRONËSIA DHE BARTJA E AKSIONEVE** | **CHAPTER VI - CO-OWNERSHIP AND TRANSFER OF SHARES** | **POGLAVLJE VI - SUVLASNIŠTVO I PRENOS DEONICA** |
| **Neni 91**<br>**Bashkë-Pronësia e një Aksioni** | **Article 91**<br>**Co-ownership of a Share** | **Član 91**<br>**Suvlasništvo i prenos deonica** |
| 1. Një aksion mund të jetë në pronësi të më shumë se një aksionari. | 1. A Share may be owned by more than one Shareholder. | 1. Jedna deonica može biti vlasništvo jednog ili vise deoničara. |
| 2. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, të gjithë bashkë-pronarët e një aksioni i ushtrojë të drejtat e tyre të votimit dhe të drejtat e tjera në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar përmes një përfaqësuesi të vetëm të përbashkët, mirëpo ata janë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Aksioni. | 2. Unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise, all co-owners of a Share shall exercise their voting and other rights in the Limited Liability Company only through a single joint representative but they are jointly and severally liable for all obligations respecting the Share. | 2. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, svi suvlasnici jedne deonice koji obavljaju njihovo pravo glasa i druga prava u društvu sa ograničenom odgovornošću putem jednog zajedničkog predstavnika, međutim oni su kolektivno i pojedinačno odgovorni za sve obaveze koje proizilaze iz deonica. |
| 3. Kur aksioni është në pronësi të më shumë se një personi, secili bashkë-pronar duhet t'i dorëzojë Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar emrin dhe adresën e tij, për ruajtje në arkivën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 3. When a Share is owned by more than one person, each co-owner must provide the Limited Liability Company with the co-owner's own name and address to be kept with the Limited Liability Company's records. | 3. Kada je deonica vlasništvo vise od jedne osobe, svaki suvlasnik treba da podnese društvu sa ograničenom odgovornošću svoju adresu, kako bi se čuvala u arhivi društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 4. Kur bashkë-pronarët kanë ose duhet ta kenë një përfaqësues të përbashkët, të gjithë bashkë-pronarët duhet të | 4. When co-owners have or are required to have a joint representative, all of the co-owners must execute a written declaration | 4. Kada suvlasnici imaju ili žele da imaju zajedničkog predstavnika, svi suvlasnici potpisuju pisanu izjavu o „utvrđivanju |

| | | |
|---|---|---|
| nënshkruajnë një deklaratë me shkrim për "caktimin e përfaqësuesit të përbashkët" dhe të i'a dorëzojnë atë Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, e cila duhet ta ruajë deklaratën në adresën e regjistruar siç është përcaktuar në nenin 83 të këtij ligji. Të gjitha njoftimet që i dërgohen përfaqësuesit nga ana e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar konsiderohet se u janë dërguar të gjithë bashkë-pronarëve. Nëse bashkë-pronarët nuk e nënshkruajnë deklaratën e paraparë në këtë nen, njoftimi që i dërgohet një bashkë-pronari konsiderohet se u është dërguar të gjithë bashkë-pronarëve. | on "designation of the joint representative" and to submit it to the Limited Liability Company, which must store the declaration in registered address, as specified by Article 83 of this Law. Any notice delivered by the Limited Liability Company to the representative shall be deemed to have been delivered to all the concerned co-owners. If the co-owners do not sign the declaration provided in this article, any notice delivered by the Limited Liability Company to one co-owner shall be deemed to have been delivered to all co-owners. | zajedničkog predstavnika" i predaju je društvu sa ograničenom odgovornošću, koje treba da čuva izjavu u registrovanoj adresi kao što je određeno članom 83. ovog zakona. Sva obaveštenja koja se šalju predstavniku od strane društva sa ograničenom odgovornošću, smatraju se poslatim i svim suvlasnicima. Ukoliko suvlasnici ne potpišu izjavu predviđenu ovim članom, obaveštenje poslato nekom od suvlasnika se smatra poslatim svim suvlasnicima. |
| **Neni 92**<br>**Bartja e Aksioneve** | **Article 92**<br>**Transfer of Shares** | **Član 92**<br>**Prenos deonica** |
| 1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, çdo Aksionar mund të bëjë bartjen e aksionit të tij, plotësisht ose pjesërisht përmes shitjes, pengut, dhurimit, trashëgimisë ose ndonjë forme tjetër të bartjes; me kusht që, ky paragraf të mos interpretohet ose zbatohet në një mënyrë që ka për qëllim pengimin e veprimit të një ligji i cili rregullon transaksionet e letrave me vlerë. | 1. Unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise, any Shareholder may transfer his Shares, in whole or in part, by sale, pledge, gift, inheritance or other form of transfer; provided, however, that this paragraph is not interpreted or applied in any manner which aims to impair the operation of any Law regulating transactions with securities. | 1. Osim ukoliko nije drugačije utvrđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, svaki deoničar može vršiti prenos svojih deonica, delimično ili u potpunosti putem prodaje, zaloga, poklona, nasledstva ili nekog drugog oblika prenošenja; pod uslovom da se ovaj stav ne tumači ili ne sprovodi na način koji ima za cilj kršenje nekog od zakona koji reguliše prenos hartija od vrednosti. |
| 2. Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mund të vendosë kufizime për bartjen aksioneve, duke përfshirë, por pa u | 2. The Charter of the Limited Liability Company may impose restrictions on the transfer of Shares including but not limited | 2. Statut društva sa ograničenom odgovornošću može da ustanovi ograničenja o prenosu deonica, uključujući, |

| | | |
|---|---|---|
| kufizuar, në kufizimet e përcaktuara në nenet 93 dhe 94 të këtij ligji.<br><br>3. Të drejtat dhe detyrimet e pranuesit të një Aksioni rregullohen sipas neneve 95 dhe 96 të këtij ligji.<br><br>**Neni 93**<br>**Dispozitat Fakultative për Kufizimin e Bartjes**<br><br>1. Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mund të përfshijë një ose më shumë kufizime për bartjen e Aksioneve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni ose kufizime të ngjashme. Nëse këto kufizime përcaktohen në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, atëherë dispozitat në bazë të të cilave përcaktohen këto kufizime ose kufizimet e ngjashme mund të formulohen në çfarëdo mënyrë që është e pranueshme për aksionarët. Këto kufizime ose kufizimet e ngjashme mbi bartjen nuk zbatohen nëse nuk janë përfshirë shprehimisht në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.<br><br>2. Në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mund të përcaktohet që një Aksion nuk mund të bartet apo të vihet peng vullnetarisht ose jo-vullnetarisht, përveç kur:<br><br>2.1. bartja është autorizuar me shkrim | to the restrictions stated in Article 93 and 94 of this Law.<br><br>3. The rights and obligations of a transferee of a Share are regulated by Articles 95 and 96 of this Law.<br><br>**Article 93**<br>**Optional Provisions on Restrictions of a Transfer**<br><br>1. The Charter of the Limited Liability Company may include, one or more of the restrictions on the transfer of Shares specified in paragraph 2 of this Article or similar restrictions. If these restrictions are included in the Charter of the Limited Liability Company, the provisions establishing these restrictions or similar restrictions may be worded in any manner acceptable to the Shareholders. These restrictions or similar restrictions on the transfer are not enforced unless they are expressly incorporated into the Charter of the Limited Liability Company.<br><br>2. The Charter of the Limited Liability Company may provide that a Share must not be voluntarily or involuntarily transferred or pledged except when:<br><br>2.1. the transfer has been approved in | ali ne i ograničavajući, u vidu ograničenja predviđenih članom 93. i 94. ovog zakona.<br><br>3. Prava i obaveze vlasnika deonica regulišu se u skladu sa članovima 95. i 96. ovog zakona.<br><br>**Član 93**<br>**Fakultativne odredbe o ograničavanju prenosa**<br><br>1. Statut društva sa ograničenom odgovornošću može obuhvati jedno ili više ograničenja povodom prenosa deonica utvrđenih stavom 2. ovog člana ili slična ograničenja. Ukoliko su ova ograničenja utvrđena Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, u tom slučaju odredbe na osnovu kojih se utvrđuju ova ili slična ograničenja mogu biti formulisana na bilo koji način prihvatljiv deoničarima. Ova ili slična ograničenja o prenosu ne sprovode se ukoliko nisu obuhvaćena izričito obuhvaćena Statutom društva sa ograničenom odgovornošću.<br><br>2. U Statutu društva sa ograničenom odgovornošću može biti utvrđeno da jedna deonica može biti preneta ili zalog dobrovoljno ili protiv volje, osim ako:<br><br>2.1.prenos je ovlašćen u pisanom obliku |

| | | |
|---|---|---|
| nga të gjithë Aksionarët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; | writing by all of the Shareholders of the Limited Liability Company; | od strane svih deoničara društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 2.2. bartja i bëhet Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ose një Aksionari tjetër ekzistues; | 2.2. the transfer is made to the Limited Liability Company or another existing Shareholder; | 2.2. prenos vrši društvo sa ograničenom odgovornošću ili neki postojeći deoničar; |
| 2.3. bartja i bëhet bashkëshortit/es, prindit, trashëgimtarëve linear ose bashkëshortit/es të trashëgimtarëve linear, vëllezërve ose motrave; | 2.3. the transfer is made to the spouse, parents, legal heirs or the spouse of any legal heirs, or brothers or sisters; | 2.3.prenos vrši suprug/a, roditelj, naslednik ili supružnik naslednika, braća ili sestre; |
| 2.4. bartja i bëhet një përfaqësuesi ligjor të Aksionarit, pas vdekjes së Aksionarit, ose pas shpërbërjes së Aksionarit kur është Shoqëri Tregtare apo person juridik; | 2.4. the transfer is made to a legal representative of the Shareholder upon the Shareholder's death, or upon dissolution when the Shareholder is a Business Organization or legal person; | 2.4.prenos vrši pravni zastupnik deoničara, nakon smrti ili raspuštanja, kada je u pitanju poslovno društvo ili pravno lice; |
| 2.5. bartja i bëhet një Përfaqësuesi të Autorizuar në Procedurë të Falimentimit; | 2.5. the transfer is made to an Authorized Representative in a Bankruptcy Procedure; | 2.5.prenos vrši ovlašćeni predstavnik u stečajnom postupku, |
| 2.6. bartja bëhet në rast të ekzistimit të pengu në aksion si sigurim për huan ose detyrim tjetër të aksionarit, nëse marrëveshja e pengut: | 2.6. the transfer is made based on the existence of a pledge on the Share as security for a loan or other obligation of the Shareholder, if the pledge agreement; | 2.6.prenos vrši u slučaju postojanja zaloga u vidu osiguravanja pozajmice ili neke druge obaveze deoničara, ukoliko sporazum o zalogu: |
| 2.6.1. shprehimisht përcakton se pengmarrësi nuk ka të drejtë votimi ose menaxhimi të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ose kompetenca të tjera që rrjedhin nga | 2.6.1. expressly provides that the pledgee has no voting or management rights in the Limited Liability Company or other competences established from the | 2.6.1.izričito utvrđuje da zajmodavac nema pravo glasa ili upravljanja društvom o ograničenoj odgovornosti ili druge nadležnosti koje proizilaze iz zajma; |

| | | |
|---|---|---|
| pengu;<br><br>2.6.2. përfshin pajtimin me shkrim të pengmarrësit se ai do ti nënshtrohet Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nëse bëhet pronar i aksionit të vënë peng; dhe<br><br>2.6.3. nëse është miratuar nga të gjithë Aksionarët tjerë;<br><br>2.7. bartja bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar e cila përfshin dispozitat e përcaktuara ose të lejuara sipas nenit 94 të këtij ligji; ose<br><br>2.8. bartja bëhet në rast të bashkimit, sipas Pjesës Tetë të këtij ligji. | pledge,<br><br>2.6.2. contains a written agreement by the pledgee that he is subject to the Charter of the Limited Liability Company if he becomes the owner of the pledged Share; and<br><br>2.6.3. it has been approved by all the other Shareholders;<br><br>2.7. the transfer is made in compliance with the provisions of the Charter of the Limited Liability Company which includes the provisions specified or permitted by Article 94 of this Law; or<br><br>2.8. the transfer is made in case of a merger, according to Part Eight of this Law. | 2.6.2.obuhvata pisanu saglasnost zajmodavca da će on podlegati nadležnosti Statuta društva sa ograničenom odgovornošću ukoliko postaje vlasnik deonice što proizilazi iz zajma; i<br><br>2.6.3.ukoliko je usvojen od strane svih drugih deoničara;<br><br>2.7.prenos vrši u skladu odredbe Statuta društva sa ograničenom odgovornošću koje uključuju utvrđene odredbe ili dozvoljene u skladu sa članom 94. ovog zakona; ili<br><br>2.8.prenos vrši u slučaju ujedinjenja u skladu sa Delom osam ovog zakona. |
| **Neni 94**<br>**Dispozita Fakultative për të kërkuar Ofertën e Parë të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar** | **Article 94**<br>**Optional Provision to Require the First Offer to the Limited Liability Company** | **Član 94**<br>**Fakultativne odredbe za zahtevanje prve ponude društva sa ograničenom odgovornošću** |
| 1. Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mund të përfshijë përmbajtjen e paragrafit2 të këtij neni me formulimin e saktë të paragrafit 2 të këtij neni ose me çfarëdo ndryshimi të dëshiruar. Këto dispozita zbatohen vetëm nëse janë përfshirë shprehimisht në Statutin e | 1. The Charter of the Limited Liability Company may incorporate the contents of paragraph 2 of this Article with the precise wording stated in paragraph 2 of this Law or with any desired changes to that wording. These provisions shall be enforced only if expressly incorporated in | 1.Statut društva sa ograničenom odgovornošću može sadržati sadržaj stava 2. ovog člana u formulaciji koja tačno odgovara stavu 2. ovog člana ili sa bilo kojom željenom izmenom. Ove odredbe se sprovode samo ukoliko su izričito obuhvaćene Statutom društva sa |

| | | |
|---|---|---|
| Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | the Charter of the Limited Liability Company. | ograničenom odgovornošću. |
| 2. Një aksionar i cili dëshiron të bëjë bartjen e Aksionit të tij tek një person fizik ose juridik dhe/ose Shoqëri Tregtare, mund ta bëjë këtë bartje në mënyrën e përcaktuar më poshtë; me kusht që, kufizimet e parapara të mos zbatohen nëse bartja përjashtohet nga kufizimet sipas një dispozitë tjetër të Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar: | 2. A Shareholder who wishes to transfer his Share to another natural or legal person and/or Business Organization may make the transfer in the manner specified below; provided, however, that the specified restrictions are not enforced if the transfer is exempted from such restriction according to another provision of the Charter of the Limited Liability Company: | 2.Jedan deoničar koji želi da obavi prenos deonica nekom fizičkom ili pravnom licu i/ili poslovnom društvu, može ovo obaviti na način utvrđen ispod pod uslovom da se predviđena ograničenja ne sprovode ukoliko se prenos izostavlja od strane ograničenja u skladu sa nekom drugom odredbom Sporazuma društva sa ograničenom odgovornošću: |
| 2.1. Aksionari së pari duhet të marrë një ofertë të pa-revokueshme, në mirëbesim dhe me shkrim për blerjen e aksionit që përcakton emrin e ofertuesit, adresën, çmimin e ofruar si dhe çfarëdo pagese ose kushte tjera të ofertës; | 2.1. The Shareholder must first obtain an irrevocable, written and in good faith offer to purchase the Share which specifies the offerors name, address, offered price, and any other payment or condition of the offer; | 2.1.deoničar pre svega treba da dobije neopozivu ponudu, u poverenju i pisanom obliku o kupovini deonica, koja predstavlja ime ponuđača, adresu, ponuđenu cenu kao i svaki oblik plaćanja ili druge uslove ponude; |
| 2.2. Aksionari përkatës më pas ia dorëzon Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ofertën e palës së tretë, dhe me këtë, Aksionari i ofron Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar shitjen, me çmimin dhe kushtet e cekura në ofertë. Brenda tri (3) ditëve nga pranimi i ofertës, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar duhet t'u dërgojë të gjithë aksionarëve një njoftim me shkrim ku: | 2.2. The Shareholder must then deliver the third person's offer to the Limited Liability Company, and by doing so the Shareholder offers to sell the concerned Share to the Limited Liability Company at the price and terms stated in the offer. Within three (3) days after receiving the offer, the Limited Liability Company shall deliver a written notice to all Shareholder: | 2.2.odgovarajući deoničar nakon podnošenja ponude treće strane društvu sa ograničenom odgovornošću, i sa ovim, deoničar nudi strane društvu sa ograničenom odgovornošću prodaju, sa cenom i utvrđenim uslovima u ponudi. U roku od tri (3) dana od prihvatanja ponude, društvo sa ograničenom odgovornošću treba da pošalje svim deoničarima pisano obaveštenje gde: |

| | | |
|---|---|---|
| 2.2.1. informohen të gjithë Aksionarët në lidhje me ofertën;<br><br>2.2.2. Thirret Kuvendi i Aksionarëve, i cili mund të mbahet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve por jo më shumë se tridhjetë (30) ditë nga dërgimi i njoftimit;<br><br>2.2.3. informohen të gjithë Aksionarët se Kuvendi i Aksionarëve thirret për të vendosur nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar do të blejë Aksionin e Aksionarit që dëshiron ta shesë atë, me kushtet e parapara në ofertën e palës së tretë<br><br>2.2.4. Vendimi për blerjen e aksionit duhet të miratohet me shumicën e votave të të gjitha Aksioneve me të drejtë vote, pa përfshirë këtu aksionarin shitës. Për këtë qëllim, votimi bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse edhe për veprimet e tjera të aksionarëve.<br><br>2.3. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar duhet t'i dorëzojë Aksionarit përkatës një njoftim me shkrim për pranimin e saj brenda dyzet(40) ditëve nga pranimi i ofertës ose oferta konsiderohet se është refuzuar. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar dëshiron, ajo mund të bëjë një kundër- | 2.2.1. informing all Shareholders of the offer;<br><br>2.2.2. convening the Shareholder Assembly, which may be held within the period of fifteen (15) days but not more than thirty (30) days after delivery of the notice;<br><br>2.2.3. informing all Shareholders that the Shareholder Assembly shall be held to decide whether the Limited Liability Company shall purchase the Share from the Shareholder who wishes to sell it, based on the terms specified in the third party's offer;<br><br>2.2.4. A decision to purchase the Share must be approved by a majority vote of all the Shares with voting rights, excluding the Shareholder who makes the sale. For this purpose, voting shall done in the same manner as for the other Shareholder actions.<br><br>2.3. The Limited Liability Company must deliver a written notice of acceptance to the concerned Shareholder within a period of forty (40) days after receipt of the offer, or otherwise the offer is considered to have been rejected. If the Limited Liability Company so wishes, it may | 2.2.1.obaveštava sve deoničare u vezi sa ponudom;<br><br>2.2.2. poziva skupštinu deoničara koja može biti održana u roku od petnaest (15) dana ali ne vise od trideset (30) dana od slanja obaveštenja;<br><br>2.2.3.obaveštava sve deoničare da se saziva skupština deoničara za odlučivanje da li će društvo sa ograničenom odgovornošću kupiti deonice deoničara koji želi da ih proda, pod uslovima predviđenim ponudom treće strane;<br><br>2.2.4.odluka o kupovini deonica treba da bude usvojena većinom glasova svih deoničara sa pravom glasa, bez deoničara koji prodaje deonice. Povodom ovog cilja, glasanje se vrši na isti način kao i za druga delovanja deoničara.<br><br>2.3. Društvo sa ograničenom odgovornošću treba da preda odgovarajućem deoničaru pisano obaveštenje o prihvatanju u roku od četrdeset (40) dana od prihvatanja ponude ili ako ne da je ponuda odbijena. Ukoliko društvo sa ograničenom odgovornošću želi, može |

| | | |
|---|---|---|
| ofertë brenda afatit të paraparë prej dyzet (40) ditësh. Në këtë rast, aksionari gjegjës duhet t'i dorëzojë Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar një njoftim me shkrim për pranimin e saj brenda tri (3) ditëve pas marrjes së kundër-ofertës ose kundër-oferta konsiderohet së është refuzuar. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar e pranon ofertën e parë ose aksionari përkatës e pranon kundër-ofertën, shitja do të bëhet brenda tri (3) ditëve nga pranimi; | make a counter-offer within the prescribed forty (40) day period. In this case, the concerned Shareholder must deliver to the Limited Liability Company a written notice of acceptance within three (3) days after receipt of the counter offer, or otherwise the counteroffer is considered to have been rejected. If the Limited Liability Company accepts the original offer, or if the concerned Shareholder accepts the counteroffer, the sale must be made within three (3) days after the acceptance; | napraviti kontra ponudu u roku od četrdeset (40) dana. U tom slučaju, odgovarajući deoničar treba da preda društvu sa ograničenom odgovornošću pisano obaveštenje o njenom prihvatanju u roku od tri (3) dana od dobijanja kontra ponude ili ako ne da je kontra ponuda bila odbijena. Ukoliko društvo sa ograničenom odgovornošću prihvata prvu ponudu ili odgovarajući deoničar prihvata kontra ponudu, prodaja se vrši u roku od tri (3) dana od prihvatanja; |
| 2.4. nëse oferta e aksionarit për Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar refuzohet nga kjo e fundit, aksionari në fjalë, brenda tridhjetë (30) ditëve pasi që Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar e refuzon ose konsiderohet se e ka refuzuar ofertën, do të pranojë ofertën e palës së tretë me kushtet e njëjta sikurse oferta e refuzuar nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar; | 2.4. If the offer of the concerned Shareholder to the Limited Liability Company is rejected by the latter, the concerned Shareholder shall, within thirty (30) days after the Limited Liability Company rejected or is considered to have rejected the offer, accept the offer of the third party with the exact conditions as the offer that was rejected by the Limited Liability Company; | 2.4. Ukoliko ponuda deoničara društvu sa ograničenom odgovornošću bude odbijena zbog poslednjeg navedenog, u roku od trideset (30) dana nakon što društvo sa ograničenom odgovornošću odbije ili se smatra da je odbilo ponudu, prihvata ponudu treće strane pod istim uslovima pod kojim je ponuda odbijena od strane društva sa ograničenom odgovornošću; |
| 2.5. Nëse Aksionari nuk e përmbush detyrimin e tij për shitje, sipas nën-paragrafit 2.4 të paragrafit 2 të këtij neni, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mundet, në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga mos-përmbushja e këtillë, të anulojë | 2.5. If the concerned Shareholder fails to comply with his obligation to sell under sub-paragraph 2.4, paragraph 2 of this Article, the Limited Liability Company may, within ninety (90) days after such failure, cancel the concerned Share if the Limited Liability Company | 2.5.Ukoliko jedan od deoničara ne ispunjava svoje obaveze za prodaju, u skladu sa tačkom 2.4. stava 2. ovog člana, društvo sa ograničenom odgovornošću može u roku od devedeset (90) dana od neispunjavanja, da poništi odgovarajuće mere ukoliko |

| | | |
|---|---|---|
| Aksionin përkatës nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar i dërgon Aksionarit një shumë parash që është e barabartë me vlerën e Aksionit të pranuar nga blerësi i pavarur ose në pajtim me një formulë të dakorduar paraprakisht dhe të përcaktuar në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | delivers to the concerned Shareholder an amount of money that is equal to the value of that Share as determined by an independent appraiser or in accordance with any pre-agreed formula that is specified in the Charter of the Limited Liability Company. | društvo sa ograničenom odgovornošću pošalje deoničaru sumu novca čija vrednost odgovara vrednosti deonica prihvaćenih od strane nezavisnog kupca ili u skladu sa nekom od unapred dogovorenih formula u Statutu društva sa ograničenom odgovornošću. |
| **Neni 95**<br>**Kushtet për Zotërimin e Aksionit nga Pranuesi** | **Article 95**<br>**Conditions of Acquisition of Shares by the Transferee** | **Član 95**<br>**Uslovi za posedovanje deonica od strane kupca** |
| 1. Pranuesi mund ta zotërojë Aksionin dhe të bëhet pronar i tij vetëm nëse të gjithë Aksionarët pajtohen me këtë zotërim, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; dhe | 1. A transferee may acquire a Share and become its owner only if all of the Shareholders have consented to the acquisition, unless otherwise provided in the Charter of the Limited Liability Company. | 1. Kupac može posedovati deonice i biti njihov vlasnik samo ukoliko su se svi deoničari saglasili sa akvizicijom, osim ako je drugačije dato u statutu društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 2.Nëse plotësohen kushtet nga ky nen, pranuesi i bartjes i fiton të gjitha të drejtat e Aksionarit pas pranimit të aksionit.<br>2. | 2. If the conditions provided in this Article are fulfilled, the transferee shall have all the rights of a Shareholder after receiving the Share. | 2. Ukoliko ispunjava uslove ovog člana, kupac prenosa dobija sva prava deoničara nakon dobijanja deonica. |
| **Neni 96**<br>**Të Drejtat dhe Detyrimet Tjera të Bartësit dhe Pranuesit të Aksionit** | **Article 96**<br>**Other Rights and Obligations of a Transferor and Transferee of a Share** | **Član 96**<br>**Druga prava i obaveze prenosioca i primaoca deonica** |
| 1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, pranuesi i një aksioni është përgjegjës për të gjitha detyrimet e bartësit | 1. Unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise, a transferee of a Share shall be liable for all of the obligations of the transferor | 1.Ukoliko nije drugačije utvrđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, primalac deonice je odgovoran za sve obaveze prenosioca uključujući i davanje |

| | | |
|---|---|---|
| duke përfshirë dhënien e kontributeve sipas nenit 86 dhe kthimin e shpërndarjeve të dividendëve të ndaluara sipas nenit 90 të këtij ligji; me kusht që, pranuesi i bartjes të mos jetë përgjegjës për detyrimet e bartësit: | including the contributions specified in Article 86 and to return the prohibited distributions in Article 90 of this Law; provided, however, that the transferee is not liable for obligations of the transferor: | doprinosa u skladu sa članom 86. i vraćanja zabranjene raspodele dividendi u skladu sa članom 90. ovog zakona; pod uslovom da primaoc prenosa ne bude odgovoran za obaveze prenosioca. |
| 1.1. për të cilat pranuesi nuk ka pasur njohuri në kohën kur është bërë aksionar; dhe | 1.1. for which that the transferee did not know at the time when he became a Shareholder; and | 1.1.sa kojima primaoc nije bio upoznat u vreme kada je postao deoničar; i |
| 1.2. për të cilat pranuesi nuk do të kishte mundur të informohet edhe pas shqyrtimit të hollësishëm të Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 1.2. for which the transferee could not have been informed on even after a thorough review of the Charter of the Limited Liability Company. | 1.2.o kojima primaoc nije mogao biti obavešten i nakon kompletnog razmatranja Statuta društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 2. Pas bartjes, dhe përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar bartësi i aksionit ende mbetet përgjegjës për detyrimet e tij sipas nenit 86 dhe 90 të këtij ligji para bartjes. Bartësi vazhdon të jetë përgjegjës për detyrimet e tij para bartjes, derisa këto detyrime të përmbushen. | 2. After the transfer, and unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise, the transferor of the Share shall remain liable to the Limited Liability Company for his obligations according to Articles 86 and 90 of this Law that accrued before the transfer. The transferor shall continue to remain liable for his obligations before the transfer, until these obligations are met. | 2.Nakon prenosa, i osim ukoliko nije drugačije utvrđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću prenosilac deonica još uvek ostaje odgovoran za njegove obaveze u skladu sa članom 86. i 90. ovog zakona pre prenosa. Prenosilac nastavlja da bude odgovoran za njegove obaveze pre prenosa sve dok ne ispuni ove obaveze. |
| 3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, aksionari bartës pushon së qeni aksionar dhe t'i gëzojë të drejtat e aksionarit në kohën e kryerjes së bartjes, përveç në rastin kur aksioni është objekt i pengut, me ç'rast bartësi nuk pushon së qeni aksionar derisa pengmarrësi ose një | 3. Unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise, the transferring Shareholder shall cease to be a Shareholder or to enjoy any of the rights of a Shareholder at the time the transfer is made; except in cases where the Share is object to a pledge in which case the transferor shall not cease to be a | 3.Ukoliko nije drugačije utvrđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, deoničar prenosilac prestaje da bude deoničar i da uživa prava deoničara prilikom završetka prenosa, osim u slučaju kada je deonica predmet zaloga, i u tom slučaju prenosilac ne prestaje da bude deoničar sve dok zajmodavac ili neka treća |

| | | |
|---|---|---|
| palë e tretë nuk bëhet pronar i aksionit. | Shareholder until the pledgee or another third party becomes the owner of that Share. | strana ne postane vlasnik deonice. |
| 4. Nëse një Aksionar vdes ose shpërbëhet, përfaqësuesi ligjor ose administratori i pasurisë së aksionarit mund të ushtrojë të gjitha të drejtat dhe kompetencat e aksionarit për administrimin e pasurisë. | 4. If a Shareholder dies or is dissolved, the legal representative or administrator of the Shareholder's assets may exercise all of the Shareholder's rights and competences for the administration of the assets. | 4.Ukoliko jedan od deoničara umre ili se povuče, pravni zastupnik ili upravnik imovinom deoničara može obavljati sva prava i nadležnosti deoničara povodom upravljanja imovinom. |
| 5. Një aksionar i cili vullnetarisht bën bartjen ose propozon bartjen e një aksioni në mënyrën e lejuar me këtë ligji dhe në përputhje me Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, duhet që paraprakisht ta njoftojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar mbi këtë bartje. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar nuk ka nevoje të miratojë bartjen para pranimit të njoftimit për bartje, por ajo duhet të miratojë menjëherë të gjitha bartjet e rregullta për të cilat është dorëzuar njoftimi dhe është regjistruar në arkivin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 5. A Shareholder who voluntarily transfers or proposes to transfer a Share in compliance with this Law and the Charter of the Limited Liability Company must first notify the Limited Liability Company on this transfer. The Limited Liability Company need not approve the transfer until it has received notice of the transfer, but it must immediately approve all the lawful transfers for which a notice was submitted and recorded in the Limited Liability Company records. | 5.Jedan deoničar koji dobrovoljno vrši prenos ili predlaže prenos neke deonice na način koji je dozvoljen ovim zakonom i u skladu je sa Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, treba unapred da obavesti društvo sa ograničenom odgovornošću o ovom prenosu. Društvo sa ograničenom odgovornošću nema potrebu da usvoji prenos pre primanja obaveštenja o prenosu, ali treba da usvoji odmah sve prenose koji su regularni i za koje je obaveštenje predato i registrovano u arhivi društva sa ograničenom odgovornošću. |
| **Neni 97**<br>**Bartja e ndaluar është e pavlefshme** | **Article 97**<br>**Prohibited Transfer is Void** | **Član 97**<br>**Zabranjen prenos je nevažeći** |
| Çdo bartje ose përpjekje për bartjen e një aksioni që bëhet në kundërshtim me një kufizim ose ndalesë të përcaktuar në këtë ligj ose në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, ose në një ligj i cili rregullon transaksionet në letra me vlerë, është nule, e pavlefshme dhe e | Any transfer or attempt to transfer a Share contrary to a restriction or prohibition specified in this Law, or in the Charter of the Limited Liability Company or another law regulating transactions with securities is null, void and unenforceable. | Svaki pokušaj prenosa deonica koji se vrši u suprotnosti sa nekim ograničenjem ili zabranom predviđenom ovim zakonom ili Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, ili nekim od zakona koji regulišu prenos hartija od vrednosti, je ništavan, nevažeći i neizvršiv. |

| | | |
|---|---|---|
| pazbatueshme.<br><br>**Neni 98**<br>**Blerja e Aksioneve të Veta nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar**<br><br>1. Përveç nëse Marrëveshja e Inkorporimit e kufizon të drejtën e saj për blerjen e aksioneve të papaguara, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund të blejë pjesërisht ose plotësisht, në çdo kohë, një ose më shumë nga Aksionet e saj të papaguara.<br><br>2. Megjithatë, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar nuk mund të blejë Aksionet e saj të papaguara nëse për shkak të kësaj blerje, asetet e përgjithshme të saj do të reduktohen deri në atë shkallë sa vlera e tyre e përgjithshme është më të ulët se shuma e përgjithshme e borxheve dhe detyrimeve të saj ose nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar nuk do të jetë në gjendje që t'i paguajë borxhet dhe detyrimet e tjera të cilat maturohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së zakonshme ekonomike.<br><br>3. Para se të blejë aksionet e saj të papaguara, Shoqëria me përgjegjësi të Kufizuar së pari duhet të vendosë më shkrim se blerja nuk është e ndalur sipas paragrafit 2 të këtij neni. Ky vendim duhet | **Article 98**<br>**Acquisition of the Limited Liability Company's Own Shares**<br><br>1. Unless the Agreement of Incorporation restricts the right of the Limited Liability Company to acquire its own outstanding Shares, the Limited Liability Company may acquire one or more of its outstanding Shares, in whole or in part, at any time.<br><br>2. However, the Limited Liability Company cannot acquire any of its outstanding Shares if, as a result of this acquisition, the Limited Liability Company's total assets are reduced to such a degree that their total value is less than the total amount of the debts and obligations of the Limited Liability Company or if the Limited Liability Company will be unable to pay its debts and other obligations as they become due in the ordinary course of the Business Activity of the Limited Liability Company.<br><br>3. Before it acquires its own outstanding Shares, the Limited Liability Company must first make a written decision that this acquisition is not prohibited by paragraph 2 of this Article. This decision must be | **Član 98**<br>**Kupovina sopstvenih deonica od društva sa ograničenom odgovornošću**<br><br>1. Osim ukoliko Sporazum o inkorporaciji ograničava pravo na kupovinu ne plaćenih deonica, društvo sa ograničenom odgovornošću može kupovati delimično ili u potpunosti, u svakom momentu, jednu ili više njegovih neplaćenih deonica.<br><br>2.Međutim, društvo sa ograničenom odgovornošću ne može kupovati njegove neplaćene deonice ako će zbog te kupovine njegova opšta sredstva biti smanjena do onog stepena njegove opšte vrednosti koja je niža od vrednosti njegovih opštih dugova i obaveza ili ukoliko društvo sa ograničenom odgovornošću neće biti u stanju da plati dugove i druge obaveze koje dospevaju tokom obavljanja uobičajene privredne delatnosti.<br><br>3.Pre kupovine neplaćenih deonica, društvo sa ograničenom odgovornošću pre svega treba da utvrdi u pisanom obliku da kupovina nije zabranjena u skladu sa stavom 2. ovog člana. Ova odluka treba da |

| | | |
|---|---|---|
| të bazohet në pasqyrat financiare të përgatitura në pajtim me ligjet në fuqi që përcaktojnë standardet dhe parimet e kontabilitetit, dhe në rast të vlerësimit të aseteve jo-monetare, në bazë të një vlerësimi të pavarur. | based on financial statements prepared in accordance with applicable laws on accounting standards and principles, and in the case of valuation of non-monetary assets, based on an independent valuation. | se zasniva na finansijskim izveštajima pripremljenim u skladu sa zakonima na snazi koji utvrđuju standarde i principe računovodstva, i u slučajevima procenjivanja ne novčanih sredstava, na osnovu nezavisne procene. |
| 4. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar blen ose mban ndonjë aksion të saj, ajo mund ta anulojë aksionin. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar nuk e anulon këtë aksion, ajo duhet ta mbajë atë në thesarin e saj. | 4. If a Limited Liability Company acquires or holds any of its own Shares, it may cancel such Shares. If the Limited Liability Company does not cancel such Shares, the Limited Liability Company is required to hold those Shares in its treasury. | 4.Ukoliko društvo sa ograničenom odgovornošću kupuje ili poseduje neku svoju deonicu, ono može poništiti takve deonice. Ukoliko društvo sa ograničenom odgovornošću ne poništi te deonice, društvo sa ograničenom odgovornošću je dužno da ih čuva u svom trezoru. |
| 5. Aksionet që mbahen në thesarin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar: | 5. The Shares held in the treasury of the Limited Liability Company: | 5.Deonice koje ostaju u posedu društva sa ograničenom odgovornošću: |
| 5.1. nuk kanë kurrfarë te drejte të votës; | 5.1. have no voting rights whatsoever; | 5.1.nemaju nikako pravo glasa; |
| 5.2. nuk numërohen për çfarëdo qëllimi, duke përfshirë gjatë përcaktimit të kuorumit ose përcaktimit të numrit të aksioneve të papaguara ose Aksioneve me të drejtë vote; dhe | 5.2. are not counted for any purpose, including during the determination of the quorum or the determination of the number of outstanding Shares or the Shares with voting rights, and | 5.2.ne računaju se po pitanju bilo kojeg cilja, uključujući i tokom utvrđivanja kvoruma ili utvrđivanja broja neplaćenih deonica sa pravom glasa; i |
| 5.3. nuk kanë të drejtë, dhe nuk marrin pjesë në shpërndarjet e dividendëve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 5.3. have no right to receive, and shall not receive, any Distributions of dividends of the Limited Liability Company. | 5.3.nisu imale pravo, i ne uzimaju deo prilikom raspodele dividendi društva sa ograničenom odgovornošću. |

| KAPITULLI VII - PËRFUNDIMI I PRONËSISË MBI AKSIONIN | CHAPTER VII -TERMINATION OF OWNERSHIP OF SHARES | POGLAVLJE VII - ZAVRŠETAK POSEDOVANJA DEONICA |
|---|---|---|
| **Neni 99**<br>**Përfundimi i Pronësisë mbi Aksionin** | **Article 99**<br>**Termination of Ownership of Shares** | **Član 99**<br>**Završetak posedovanja deonica** |
| 1. Një person fizik ose juridik dhe/ose Shoqëri Tregtare përfundon të jetë Aksionar në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar: | 1.A natural or legal person and/or Business Organization ceases to be a Shareholder of a Limited Liability Company: | 1. Fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo prestaje da bude deoničar u društvu sa ograničenom odgovornošću: |
| 1.1. në rast të vdekjes ose shuarjes së personit fizik ose juridik dhe/ose Shoqërisë Tregtare; | 1.1. upon the death or dissolution of natural or legal person and/or Business Organization; | 1.1.u slučaju smrti ili nestanka fizičkog ili pravnog lica i/ili poslovnog društva |
| 1.2. në rast të tërheqjes vullnetare të personit fizik ose juridik dhe/ose Shoqërisë Tregtare; | 1.2. upon voluntary withdrawal of the natural or legal person and/or Business Organization; | 1.2.u slučaju dobrovoljnog povlačenja fizičkog ili pravnog lica i/ili poslovnog društva; |
| 1.3. në rast të përjashtimit të personit fizik ose juridik dhe/ose Shoqërisë Tregtare; | 1.3. upon expulsion of the natural or legal person and/or Business Organization; | 1.3.u slučaju isključenja fizičkog ili pravnog lica i/ili poslovnog društva; |
| 1.4. siç përcaktohet në ligjin në fuqi për falimentimin; | 1.4. as specified by the applicable law on bankruptcy; | 1.4.kao što je predviđeno zakonom na snazi o stečajnom postupku; |
| 1.5. në rast se personi fizik ose juridik ose Shoqëria Tregtare nuk mban më aksione në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar; ose | 1.5. when the natural or legal person and/or Business Organization ceases to own Shares in the Limited Liability Company; or | 1.5.u slučaju kada pravno ili fizičko lice i/ili poslovno društvo ne poseduje deonice u društvu sa ograničenom odgovornošću |
| 1.6. në rastet tjera të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të cilat kërkojnë përfundimin e | 1.6. upon other cases specified in the Charter of the Limited Liability Company, which require the | 1.6.u drugim slučajevima utvrđenim u Statutu društva sa ograničenom odgovornošću koje zahtevaju |

| | | |
|---|---|---|
| pronësisë së personit fizik ose juridik dhe/ose Shoqërisë Tregtare. | termination of ownership by the natural or legal person and/or Business Organization. | prestanak posedovanja fizičkog ili pravnog lica i/ili poslovnog društva. |
| **Neni 100**<br>**Tërheqja ose Përjashtimi i një Aksionari** | **Article 100**<br>**Withdrawal or Expulsion of a Shareholder** | **Član 100**<br>**Povlačenje ili isključivanje nekog deoničara** |
| 1. Aksionari mund të tërhiqet nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar në çdo kohë pas dorëzimit Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe të gjithë aksionarëve të tjerë të një njoftimi me shkrim; me kusht që, nëse tërheqja e shkel Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund të kërkojë dëmshpërblim nga aksionari i cili tërhiqet, për shkelje të Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 1. A Shareholder may withdraw from a Limited Liability Company at any time after submission of a written notice to the Limited Liability Company and to all the other Shareholders; provided, however, that if the withdrawal violates the Charter of the Limited Liability Company, the Limited Liability Company may recover damages from the withdrawing Shareholder for breach of the Charter of the Limited Liability Company. | 1.Deoničar može da se povuče iz društva sa ograničenom odgovornošću u svakom momentu nakon podnošenja društvu sa ograničenom odgovornošću i svim drugim deoničarima pisanog obaveštenja, pod uslovom da ukoliko povlačenje krši Statut društva sa ograničenom odgovornošću, društvo sa ograničenom odgovornošću može zahtevati odštetu od deoničara koji se povlači zbog kršenja Statuta društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 2. Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mundet: | 2. The Charter of the Limited Liability Company may: | 2.Statut društva sa ograničenom odgovornošću, može: |
| 2.1. të përcaktojë kushtet për tërheqjen ose përjashtimin e një Aksionari; | 2.1. specify the conditions for the withdrawal or expulsion of a Shareholder; | 2.1.utvrđivati uslove povlačenja ili isključivanja deoničara; |
| 2.2. të përcaktojë procedurën e aplikueshme për tërheqje ose përjashtim; dhe | 2.2. specify the applicable procedure for withdrawal or expulsion; and | 2.2.da utvrdi primenjive procedure za povlačenje ili isključivanje; i |
| 2.3. të përcaktojë pasojat të cilat janë rezultat i tërheqjes ose përjashtimit, duke përfshirë përgjegjësinë për dënime ose dëmshpërblim nëse | 2.3. specify the consequences following a withdrawal or expulsion, including the liability for sanctions or compensation if the withdrawal was | 2.3.da utvrdi posledice koje su rezultat povlačenja ili isključivanja, uključujući odgovornost za kazne i odštete ukoliko je povlačenje |

| | | |
|---|---|---|
| tërheqja është bërë në kundërshtim me Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | made in violation of the Charter of the Limited Liability Company. | načinjeno u suprotnosti sa Statutom društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 3. Në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mund të parashihet se një Aksionar nuk mund të tërhiqet ose ta bartë aksionin e tij. | 3. The Charter of the Limited Liability Company may provide that a Shareholder cannot withdraw or transfer his Share. | 3.U Statutu društva sa ograničenom odgovornošću može biti predviđeno da jedan deoničar ne može da se povuče ili prenese svoje deonice. |
| 4. Pavarësisht nga çdo gjë në këtë ligj ose në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në të kundërtën, gjykata mund të nxjerrë një vendim se: | 4. Notwithstanding anything in this Law or the Charter of the Limited Liability Company to the contrary, the Court may issue a decision stating that: | 4.Bez obzira na sve što je u ovom zakonu ili Statutu društva sa ograničenom odgovornošću naprotiv, sud može da donese odluku da: |
| 4.1. aksionari në fjalë mund të tërhiqet ose se tërheqja e tij ka qenë e ligjshme nëse: | 4.1. a Shareholder can withdraw or that his withdrawal was lawful if: | 4.1.deoničar o kojem je reč može da se povuče ili je njegovo povlačenje legalno ukoliko: |
| 4.1.1. Aksionari paraqet kërkesë në gjykatë për nxjerrjen e këtij vendimi; dhe | 4.1.1 the Shareholder files a claim in the Court asking for this decision; and | 4.1.1.deoničar podnese zahtev sudu za povlačenje ove odluke; i |
| 4.1.2. Aksionari paraqet fakte bindëse se atij i janë shkaktuar dëme substanciale si pasojë e veprimeve dëmshme të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ose aksionarëve të tjerë. "Veprimet e dëmshme" përfshijnë shkeljet e këtij ligji, Statutit së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ose të drejtave të Aksionarit përkatës. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka të drejtë ta kontestojë kërkesën e Aksionarit në fjalë në Gjykatë. | 4.1.2. the Shareholder presents convincing evidence that the Shareholder has incurred substantial damage as a consequence of the wrongful actions of the Limited Liability Company or the other Shareholders. "Wrongful actions" involve violations of the present Law, the Charter of the Limited Liability Company or the rights of the respective Shareholder. The Limited Liability Company shall have the right to oppose the Shareholder's | 4.1.2.deoničar podnese uverljive dokaze da mu je uzrokovana značajna šteta kao posledica pogrešnog postupanja društva sa ograničenom odgovornošću ili drugih deoničara. "Štetna dela" obuhvataju kršenje ovog zakona, Statuta društva sa ograničenom odgovornošću ili prava odgovarajućeg deoničara. Društvo sa ograničenom odgovornošću ima pravo da odgovori na tvrdnje deoničara o kojem je reč pred |

| | | |
|---|---|---|
| | claim in the Court. | sudom. |
| 4.2. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund ta përjashtojë një Aksionar ose të argumentojë se përjashtimi ka qenë i arsyeshëm nëse: | 4.2. a Limited Liability Company may expel a Shareholder or arguing that the expulsion was reasonable if: | 4.2.Društvo sa ograničenom odgovornošću može isključiti nekog od deoničara ili da argumentuje da je njegovo isključenje: |
| 4.2.1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar paraqet kërkesë në gjykatë për një vendim të tillë; dhe | 4.2.1. the Limited Liability Company files a claim in Court asking for this decision; and | 4.2.1.Društvo sa ograničenom odgovornošću podnese zahtev sudu povodom odluke tog tipa, i |
| 4.2.2. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar paraqet fakte bindëse se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ose një aksionar tjetër është duke u dëmtuar ose tashme është dëmtuar nga veprimet e dëmshme të aksionarit. “Veprimet e dëmshme” përfshijnë shkeljet e qëllimshme ose të përsëritura të këtij ligji, Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ose të drejtave të një aksionari tjetër ose nëse veprimet e tilla pengojnë në masë substanciale aftësinë e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar për vazhdimin e veprimtarisë ekonomike ose marrëdhënies me aksionarin gjegjës, Aksionari gjegjës ka të drejtë ta kontestojë kërkesën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në Gjykatë. | 4.2.2. the Limited Liability Company presents convincing evidence that the Limited Liability Company or another Shareholder of the Limited Liability Company is incurring or has incurred substantial damage as a result of the wrongful actions of the Shareholder. “Wrongful Actions” involves the wilful and repeated violation of this Law, or the Charter of the Limited Liability Company or another Shareholder’s rights, or actions which substantially prohibit the ability of the Limited Liability Company to carry on its Business Activities or the relationship with the concerned Shareholder. The concerned Shareholder shall have the right to oppose the Limited Liability Company’s claim in the Court. | 4.2.2.Društvo sa ograničenom odgovornošću predstavi uverljive činjenice da je društvo sa ograničenom odgovornošću ili neki od drugih deoničara bio oštećen ili sada trpi oštećenje zbog vršenja štetnih dela od strane odgovarajućeg deoničara. “Štetna dela” obuhvataju namerno ili ponovljeno kršenje ovog zakona, Statuta društva sa ograničenom odgovornošću ili prava nekog drugog deoničara, ili ukoliko takva dela u značajnoj meri ometaju sposobnost društva sa ograničenom odgovornošću da nastavi ekonomsku delatnost ili odnose sa odgovarajućim deoničarem, odgovarajući deoničar ima pravo da odgovori na zahteve društva sa ograničenom odgovornošću pred sudom. |

| Neni 101<br>**Efektet e tërheqjes ose përjashtimit** | Article 101<br>**Effect of Withdrawal or Expulsion** | Član 101<br>**Posledice povlačenja ili isključenja** |
|---|---|---|
| 1. Pas tërheqjes, përjashtimit ose përfundimit të pronësisë për çfarëdo arsye tjetër, personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqëria Tregtare pushon të ketë të drejtat e Aksionarit, duke përfshirë por pa u kufizuar në të drejtën e pjesëmarrjes në qeverisjen ose menaxhimin e Veprimtarisë Ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 1. Upon withdrawal, or expulsion of a Shareholder or termination of ownership for any other reason, the natural or legal person and/or Business Organization ceases to have the rights of a Shareholder, including but not limited to the right to participate in the governance or management of the Business Activity of the Limited Liability Company. | 1.Nakon povlačenja, isključenja ili završetka posedovanja iz bilo kog drugog razloga, fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo prestaje da ima prava deoničara, uključujući ali ne i ograničavajući se na pravo učešća u upravljanju ili rukovođenju privrednom delatnošću društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 2. Varësisht nga paragrafi 3 i këtij neni, kur personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqëria Tregtare përfundon së qeni aksionar, ky person fizik juridik ose kjo Shoqëri Tregtare brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga përfundimi ka të drejtë të pranojë: | 2. Subject to paragraph 3 of this Article, when a natural or legal person and/or Business Organization ceases to be a Shareholder, this natural or legal person and/or Business Organization within ninety (90) days from termination, has the right to receive: | 2.U zavisnosti od stava 3. ovog člana, kada fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo prestane da bude deoničar, ovo fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo u roku od devedeset (90) dana od prestanka ima pravo da prihvati: |
| 2.1.çfarëdo pagese ose shpërndarje e dividendëve për të cilën person fizik ose juridik dhe/ose Shoqëri Tregtare ka të drejtë pjesëmarrje sipas Statutit së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; dhe | 2.1. any payment or Distribution of Dividends for which this natural or legal person and/or Business Organization has the right to participate according to the Charter of the Limited Liability Company; and | 2.1.bilo koje plaćanje ili raspodelu dividendi u kojoj ovo fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo ima pravo učešća u skladu sa Statutom društva sa ograničenom odgovornošću; i |
| 2.2.nëse nuk është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, vlerën e drejtë të Aksionarit në shumën e përcaktuar në datën e përfundimit të pronësisë. nga data kur personi fizik ose juridik dhe/ose | 2.2. if it is not specified in the Charter of the Limited Liability Company, the fair value of the Shareholder of the sum specified on the date of termination of the ownership. as of the date the natural or legal person | 2.2.ukoliko nije određeno u Statutu društva sa ograničenom odgovornošću, vrednost prava deoničara u određenoj sumi na dan završetka posedovanja na datum fizičkog ili pravnog lica ili poslovnog društva. Ukoliko se fizičko |

| | | |
|---|---|---|
| Shoqëria Tregtare nuk ishte më Aksionar. Nëse personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqëria Tregtare është tërhequr në mënyrë të kundërligjshme ose është përjashtuar, shumat që Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar i'a ka borxh zvogëlohet në masën e nevojshme për kompensimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e tërheqjes ose përjashtimit, duke përfshirë dëmet e shkaktuar nga veprimet për të cilat personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqëria Tregtare është përjashtuar. | and/or Business Organization ceased to be a Shareholder. If the natural or legal person and/or Business Organization has unlawfully withdrawn or has been expelled, the amount that the Limited Liability Company owes to is reduced to the necessary amount to compensate for damage caused as a result of the withdrawal or expulsion, including damages caused from actions for which the natural or legal person and/or Business Organization was expelled. | ili pravno lice i/ili poslovno društvo povukla na nezakonit način ili je isključena, suma koju društvo sa ograničenom odgovornošću duguje se umanjuje u potrebnoj meri sa ciljem nadoknade troškova nastalih kao posledica povlačenja ili isključenja, uključujući i troškove uzrokovane delima zbog kojih je fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo isključeno. |
| 3. E drejta për marrjen e vlerës së drejtë të aksionarit të specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni nuk zbatohet për aksionet që:<br><br>3.1. i janë bartur një personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqërie Tregtare me marrëveshje,<br>ose<br><br>3.2. i janë bartur një pasardhësi, trashëgimtari, administratori ose përfaqësuesi ligjor si rezultat i vdekjes së aksionarit ose shpërbërjes, nëse është Shoqëri Tregtare apo person juridik, dhe pasardhësi, trashëgimtari, administratori ose përfaqësuesi i tillë ligjor ushtron një të drejtë sipas Statutit të Shoqërisë Tregtare ose ligjit të zbatueshëm për tu bërë Aksionar. | 3. The right of the Shareholder to receive the fair value specified in paragraph 2 of this Article shall not apply to Shares which were:<br>3.1. transferred to another natural or legal person and/or Business Organization through an agreement, or<br><br>3.2. transferred to a successor, heir, administrator or legal representative as a result of the Shareholder's death or dissolution in the case of a Business Organization or legal person, and the successor, heir, administrator or legal representatives exercises a right provided in the Charter of the Limited Liability Company, or the applicable law, to | 3.Pravo za uzimanje prave vrednosti deoničara utvrđenog stavom 2. ovog člana neće se primenjivati na deonice koje su:<br><br>3.1.prenete nekom fizičkom ili pravnom licu i/ili poslovnom društvu sporazumom, ili<br><br>3.2.su prenete nekom nasledniku, naslednicima, upravnicima ili pravnim predstavnicima kao rezultat smrti ili nestanka deoničara, ukoliko poslovno društvo ili pravno lice i naslednik, naslednici, upravnika ili pravni predstavnik obavlja neko od prava u skladu sa Statutom poslovnog društva ili zakonom na osnovu kojeg je postao deoničar. |

| | | |
|---|---|---|
| | become a Shareholder. | |
| 4. Gjatë përcaktimit të vlerës së drejtë të një aksioni, personi(at) ose organizata që bën përcaktimin e tillë duhen, përveç tjerash, të marrin parasysh: | 4. During the determination of the fair value of a Share, the person(s) or organization making such a determination must, inter alia, taking into consideration: | 4.Tokom utvrđivanja prave vrednosti jedne deonice, osoba(e) ili organizacija koja vrši takvu procenu, treba između ostalog da uzme u obzir: |
| 4.1. vlerën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar si veprimtari e pandërprerë ekonomike, duke përfshirë edhe perspektivën e saj në të ardhmen; | 4.1. the value of the Limited Liability Company as an on-going Business Activity, including its reasonably foreseeable future prospects; | 4.1.Vrednost društva sa ograničenom odgovornošću kao vrednost privredne delatnosti, uključujući i njegovu perspektivu u budućnosti; |
| 4.2. çfarëdo marrëveshje ndërmjet aksionarëve duke përfshirë Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar që përcaktojnë çmimin ose formulën për përcaktimin e çmimit për aksionet; | 4.2. any agreement among the Shareholders, including the Charter of the Limited Liability Company, specifying the price, or the formula for establishing the price, of the Shares; | 4.2.Svaki sporazum između deoničara, uključujući i Statut društva sa ograničenom odgovornošću koji određuje cenu ili formulu za određivanje cene deonica; |
| 4.3. rekomandimet e një vlerësuesi, nëse një i tillë është angazhuar; dhe | 4.3. the recommendations of an appraiser, if one is engaged; and | 4.3.Procene procenjivača, ukoliko je neko takav angažovan; i |
| 4.4. cilido kufizime ligjor mbi vlerën e tregut ose bartjen e aksionit. Në rast të kontestit, vlera e drejtë e aksionit përcaktohet nga gjykata kompetente. | 4.4. any legal restrictions on the market value or transfer of the Share. In the event of a dispute the fair value of the Share is determined by the competent Court. | 4.4.Svaka pravna ograničenja o vrednosti tržišta ili prenosu deonica. U slučaju spora, pravu vrednost deonica utvrđuje nadležni sud. |
| 5. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar dhe aksionari paraprak nuk pajtohen në lidhje me vlerën e drejtë të aksionit ose shumën e dëmeve, nëse ka të tilla, të parapara në paragrafin 2 të këtij | 5. If the Limited Liability Company and the previous Shareholder cannot agree on the fair value of the Share or the amount of the damages, if any, referred to in paragraph 2 of this Article, they may by | 5.Ukoliko se društvo sa ograničenom odgovornošću i prethodni deoničar ne slažu u vezi sa vrednošću deonica ili sume odštete, ukoliko takva postoji, stavom 2. ovog člana je predviđeno da sporazumno |

| | | |
|---|---|---|
| neni, ata munden me marrëveshje ta paraqesin çështjen në arbitrazh. Çështja paraqitet në arbitrazh edhe nëse një gjë e tillë kërkohet nga Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. Nëse marrëveshja për paraqitjen në arbitrazh nuk ekziston, atëherë secila palë ka të drejtë për paraqitjen e rastit në gjykatë, me ç'rast gjykata është kompetente dhe është e autorizuar që të vendosë mbi rastin. | mutual agreement submit this matter to arbitration. The matter is submitted to arbitration if it is required by the Charter of the Limited Liability Company. If there is no agreement to submit the matter to arbitration, either party shall have the right to submit a claim in the Court, and the Court is competent and authorized to decide on the case. | mogu podneti slučaj arbitraži. Pitanje podneto arbitraži ili jedna takva stvar proizilazi iz Statuta društva sa ograničenom odgovornošću. Ukoliko sporazum za podnošenje arbitraži ne postoji, u tom slučaju svaka strana ima pravo da podnese slučaj sudu, i tom prilikom sud je kompetentan i ovlašćen da donese odluku o tom slučaju. |
| **KAPITULLI VIII - QEVERISJA DHE MENAXHIMI** | **CHAPTER VIII - GOVERNANCE AND MANAGEMENT** | **POGLAVLJE VIII - UPRAVLJANJE I MENADŽMENT** |
| **Neni 102**<br>**Kuvendi i Aksionarëve** | **Article 102**<br>**Shareholder Assembly** | **Član 102**<br>**Skupština deoničara** |
| 1. Kuvendi i Aksionarëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 1. The Shareholder Assembly is the highest decision-making body of the Limited Liability Company. | 1. Skupština deoničara je najviši organ za donošenje odluka u društvu sa ograničenom odgovornošću. |
| 2. Kuvendi i Aksionarëve ka kompetencat në vijim: | 2. The Shareholder Assembly shall have the following competences: | 2. Skupština deoničara ima sledeće nadležnosti: |
| 2.1 ndryshimin dhe plotësimi e Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; | 2.1. amendment of the Charter of the Limited Liability Company; | 2.1. izmenu i dopunu Statuta društva sa ograničenom odgovornošću; |
| 2.2. zvogëlimin ose lirimin nga detyrimi të një pronari për pagimin e plotë të kontributeve të dakorduara sipas nenit 86 të këtij ligji; | 2.2 reduction of or exemption from the obligation of a Shareholder to fully pay agreed contributions under Article 86 of this Law; | 2.2. smanjenje i oslobađanje vlasnika od obaveze za punu isplatu doprinosa dogovorenu prema članu 86. ovog Zakona; |
| 2.3. autorizimin e shpërndarjeve, duke | 2.3. authorization of Distributions, | 2.3. ovlašćenje raspodela, uključujući |

| | | |
|---|---|---|
| përfshirë blerjen ose riblerjen e një aksioni të një aksionari nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar; | including purchase or repurchase of a Share from a Shareholder by the Limited Liability Company; | kupovinu ili ponovnu kupovinu deonice jednog deoničara u društvu sa ograničenom odgovornošću; |
| 2.4. zvogëlimin ose lirimin nga detyrimi të një aksionari për kthimin e shpërndarjeve ose shumave të tjera që i janë paguar atij në kundërshtim me nenin 90 të këtij ligji; | 2.4. reduction of or exemption from the obligation of a Shareholder to return Distributions or other amounts which were paid to him in violation of Article 90 of this Law; | 2.4. smanjenje ili oslobađanje od obaveze određenog deoničara za povraćaj raspodela ili drugih iznosa koji su mu isplaženi u suprotnosti sa članom 90. ovog Zakona; |
| 2.5. lëshimin e aksioneve të reja, bartjen e aksioneve, apo pranimin e aksionareve të rinj; | 2.5. issuance of new Shares, transfer of shares or admission of new Shareholders; | 2.5. izdavanje novih deonica, transfer deonica ili prihvatanje novih deoničara; |
| 2.6. vendimin për shpërbërjen e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ose dërgim në procedurë të falimentimit; | 2.6. a decision to dissolve the Limited Liability Company or to initiate a bankruptcy procedure; | 2.6. odluku o raspuštanju društva sa ograničenom odgovornošću ili upućivanje na stečajni postupak; |
| 2.7. vendimin për bashkimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar sipas Pjesës Tetë të këtij ligji; | 2.7. a decision to merge the Limited Liability Company under Part Eight of this Law, or | 2.7. odluku o udruženju sa društvom sa ograničenom odgovornošću u skladu sa Delom osam ovog Zakona; |
| 2.8. shitjen, qiradhënien, pengun, hipotekën ose bartjet tjera ose disponimi me pesëdhjetë e një (51%) ose më shumë të vlerës së përgjithshme të aseteve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; | 2.8. the sale, lease, pledge, mortgage or other transfer or disposition of fifty one (51%) or more of the total value of the assets of the Limited Liability Company. | 2.8.prodaju, izdavanje, zalaganje, hipoteku ili druge prenose ili raspolaganje sa pedeset i jedan (51%) ili više ukupne vrednosti imovine društva sa ograničenom odgovornostima; |
| 2.9. vendimin për të zgjedhur apo shkarkuar personin apo personat që mbajnë pozitën e Drejtorit Menaxhues; | 2.9. decision to elect or remove the person or persons holding the position of Managing Director; | 2.9.Odluka da se izabere ili smeni lice ili lica koja drže poziciju direktora; |
| 2.10 vendimin për të zgjedhur apo shkarkuar anëtarët e Bordit të | 2.10. decision to elect or remove members of the Board of Directors, if | 2.10.odluka da se izaberu ili smene članovi Odbora direktora, ako društvo |

| | | |
|---|---|---|
| Drejtorëve, nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka Bord Menaxhues sipas Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; | the Limited Liability Company has a Management Board according to the Charter of the Limited Liability Company; | sa ograničenom odgovornošću ima upravni odbor shodno statutu društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 2.11. kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj, në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 2.11. other competences established by law or Charter of the Limited Liability Company. | 2.11.druga ovlašćenja utvrđena Zakonom ili Statutom društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 3. Me lëshimin e aksioneve të reja, Aksionari ka të drejtë përparësie ashtu siç përcaktohet me nenin 149 të këtij ligji, përveç nëse Aksionarët unanimisht vendosin ndryshe. | 3. Upon issuance of new shares, a Shareholder has the pre-emptive right as prescribed in article 149 of this law, unless the Shareholders unanimously decide otherwise. | 3. Nakon izdavanja novih deonica, a Akcionar ima pravo preče kupovine kao što je propisano u članu 149 ovog zakona, osim ako akcionari jednoglasno odluče drukčije. |
| 4.Kuvendi i Aksionarëve mund të miratojë edhe vendime për çështje nën kompetencën e Drejtorit(ëve) Menaxhues apo Bordit të Drejtorëve. Në rastin e tillë, Aksionarët mbajnë përgjegjësi në të njëjtën mënyrë si Drejtori(ët) Menaxhues ose Bordi i Drejtorëve. | 4. The Shareholder Assembly may also adopt decisions on matters within the competence of the Managing Director(s) or Board of Directors. In such case, the Shareholders shall be liable in the same manner as the Managing Director (s) or Board of Directors. | 4. Skupština akcionara može doneti odluke o pitanjima iz nadležnosti opšteg direktora ili Odbora direktora. U tom slučaju, akcionari će biti odgovorni na isti način kao i generalni direktor ili Odbora direktora. |
| 5. Vendimi i Aksionarëve është i pavlefshëm nëse shkel një dispozitë ligji të vendosur për mbrojtjen e kreditorëve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ose për shkak të ndonjë interesi tjetër publik, ose nëse është në kundërshtim me moralin, ose nëse procedura për thirrjen e Kuvendit të Aksionarëve që ka marrë vendimin ose nëse vendim-marrja është bërë ka pasur me shkelje materiale. Vendimi është i pavlefshëm edhe në raste të tjera të | 5. A decision of the Shareholders is void if it violates a provision of law established for the protection of the creditors of the Limited Liability Company or due to other public interest, or if it is contrary to good morals, or if the procedure for calling the Shareholder Assembly which made the decision was materially violated. A decision is also void in other cases provided by law. The nullity of a decision may be relied on in court proceedings by | 5. Odluka deoničara je ništavna ako prekrši odredbe zakona za zaštitu poverioca društva sa ograničenom odgovornošću ili zbog drugih javnih interesa, ili ako je to u suprotnosti sa dobrim moralom, ili ako je postupak za sazivanje Skupštine akcionara koja je donela odluku ili donosi odluku materijalno prekršen. Odluka je nevažeća u drugim slučajevima predviđenim zakonom. Ništavost odluke može se pozvati u sudskom postupku podnošenjem tužbe ili |

| | | |
|---|---|---|
| përcaktuara me ligj. Pavlefshmëria e vendimit të tillë mund të kërkohet në procedurë gjyqësore me parashtrim të padisë ose prapësimit. | filing a suit or an objection. | prigovora. |
| 6. Pavlefshmëria e vendimit nuk mund të pretendohet nëse është bërë regjistrimi në Regjistër në bazë të vendimit dhe kanë kaluar dy vjet nga data e atij regjistrimi. | 6. The nullity of a decision cannot be relied upon if an entry has been made in the Registry based on the decision and two years have passed from the date of the entry. | 6. Na ništavosti odluke ne može se osloniti ako je učinjen unos u Registar na osnovu odluke i dve godine je prošlo od dana unosa. |
| 7. Në bazë të padisë së parashtruar ndaj Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, gjykata mund të revokojë vendimin e Aksionarëve që është në kundërshtim me ligjin, ose Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. Periudha e parashkrimit për padi është tre (3) muaj pas datës së miratimit të vendimit të Aksionarëve. | 7. Based on a suit filed against a Limited Liability Company, a court may revoke a decision of shareholders which is in conflict with the law or the Charter of Limited Liability Company. The limitation period for the claim is three (3) months after the date of adoption of the Shareholder decision. | 7. Na osnovu tužbe protiv društva sa ograničenom odgovornošću, sud može opozvati odluku deoničara koji je u sukobu sa zakonom ili Statutom Društva sa ograničenom odgovornošću. Period zastarenja za zahtev je tri (3) meseca nakon datuma donošenja odluke deoničara. |
| 8. Revokimi i vendimit nuk mund të kërkohet nëse Aksionarët kanë miratuar vendimin me vendim të ri, ndërsa padia e përcaktuar në paragrafin 7 të këtij neni nuk është parashtruar kundër vendimit të ri brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 7 të këtij neni. | 8. Revocation of a decision cannot be demanded if the shareholders have approved the decision by a new decision and the action specified in paragraph 7 of this Article has not been filed against the new decision within the term specified in paragraph 7 of this Article. | 8. Opoziv odluke ne može se tražiti ako su deoničari odobrili odluku novom odlukom i zahtev iz stava 7. ovog člana nije podnesen protiv nove odluke u roku iz stava 7. ovog člana. |
| 9. Revokimi i vendimit të Aksionarëve mund të kërkohet nga Drejtori(ët) Menaxhues apo Bordi i Drejtorëvesi dhe nga një Aksionar që nuk ka marrë pjesë në miratimin e vendimit nëse, me zbatimin e | 9. Revocation of a decision of shareholders may be demanded by the Managing Director(s) or the Board of Directors, or by a shareholder who did not participate in passing the decision, if, by | 9. Opoziv odluke deoničara može biti zahtevan od strane opšteg direktora ili Odbora direktora, ako obavljanjem odluka, krivično delo ili prekršaj bi bili počinjeni ili ako bi izvršenje odluke jasno dovelo u |

| | | |
|---|---|---|
| vendimit do të kryhej një kundërvajtje apo vepër penale, ose nëse zbatimi i vendimit qartësisht do të shkaktonte detyrimin për kompensimim të dëmeve. Aksionari që ka marrë pjesë në miratimin e vendimit mund të kërkojë revokimin e vendimit vetëm nëse kundërshtimi i atij Aksionari ndaj vendimit është shënuar në procesverbal. | performing the decision, an offence or misdemeanour would be committed or if performance of the decision would clearly result in an obligation to compensate for damage. A shareholder who participated in the adoption of a decision may demand the revocation of the decision only if the shareholder's objection to the decision has been entered in the minutes. | obavezu za nadoknadu štete, i od deoničara koji nije učestvovao u donošenju odluka. Akcionari koji su učestvovali u donošenju odluke mogu zahtevati ukidanje odluke samo ako je unet prigovor akcionara na odluku u zapisniku. |
| 10. Nëse parashtrohet padia, gjykata nuk e shqyrton çështjen para skadimit të afatit të përcaktuar me paragrafin 7 të këtij neni. Paditë e ndryshme të parashtruara për revokimin e të njëjtit vendim bashkohen dhe shqyrtohen në një procedurë. | 10. If a suit is filed, the court shall not hear the matter before the expiry of the term specified in paragraph 7 of this Article. Different suits filed in order to revoke the same decision shall be joined and heard in one proceeding. | 10. Ako je podneta tužba, sud neće raspravljati pitanje pre isteka roka iz stava 7. ovog člana. Različite tužbe podnete radi ukidanja iste odluke se združuju i rešavaju u jednom postupku. |
| 11. Aktgjykimi gjyqësor për revokimin e vendimit të Aksionarëve vlen për të gjithë Aksionarët dhe Drejtorin(ët) Menaxhues dhe Bordin e Drejtorëve , pa marrë parasysh nëse ata kanë marrë pjesë në procedurën gjyqësore apo jo. | 11. A court judgment for revocation of a decision of the shareholders applies to all shareholders and Managing Director(s) and Board of Directors regardless of whether or not they participated in the court proceeding. | 11. Sudska presuda za opoziv odluke deoničara odnosi se na sve deoničare i izvršnog direktora i Odbora direktora, bez obzira na to da li su ili nisu oni učestvovali u sudskom postupku. |
| 12. Nëse është bërë regjistrimi në Regjistër në bazë të vendimit të revokuar, gjykata i dorëzon kopjen e aktgjykimit ARBK-së për ndryshim të atij regjistrimi. | 12. If an entry has been made in the Registry based on a revoked decision, the court shall send a copy of the judgment to the KBRA for amendment of the entry. | 12. Ako je došlo do upisa u Registar na osnovu poništene odluke, sud će poslati kopiju presude KARP za izmenu unosa. |
| **Neni 103**<br>**Mbledhjet e Kuvendit të Aksionarëve** | **Article 103**<br>**Shareholder Assembly Meetings** | **Član 103**<br>**Sednice Skupštine deoničara** |
| 1.Mbledhja e përgjithshme e Kuvendit të Aksionarëve thirret së paku një(1) herë në | 1. The general meeting of the Shareholder Assembly shall be convened at least once | 1. Generalna sednica Skupštine deoničara se saziva najmanje jednom (1) godišnje |

| | | |
|---|---|---|
| vit përmes një njoftimi me shkrim ose, nëse parashikohet në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkrim apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes së përgjithshme dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë aksionarëve, jo më pak se tridhjetë (30) ditë para datës së parashikuar për mbledhjen e përgjithshme të Kuvendit të Aksionarëve. | (1) a year by written notice, or if specified in the Charter of the Limited Liability Company, by electronic mail notification. The written or electronic mail notification must contain the location, date, and hour of the general meeting and the agenda thereof, and shall be sent to all Shareholders, not less than thirty (30) days before the date scheduled for the general meeting of the Shareholder Assembly. | pismenim saopštenjem ili, ukoliko je propisano Statutom društva sa ograničenim društvom, saopštenjem preko elektronske pošte. Pismeno saopštenje ili elektronskom porukom treba da sadrži mesto, datum, vreme generalne sednice i dnevni red koji se šalje svim deoničarima ne manje od trideset (30) dana pre predviđenog dana održavanja generalne sednice Skupštine deoničara. |
| 2. Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendi të Aksionarëve mund të thirret sipas nevojës nga Drejtori Menaxhues i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, ose kur Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka themeluar Bordin e Drejtorëvenga Kryetari i Bordit të Drejtorëve. Mbledhja e Jashtëzakonshme gjithashtu mund të thirret nëse kërkohet nga bartësit e së paku 10% të të gjitha votave që kanë të drejtë të hidhen për një çështje në mbledhjen e propozuar nënshkruajnë, e vendosin datën dhe i dorëzojë Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar një kërkesë me shkrim për mbajtjen e një mbledhje. Në kërkesën për mbledhje ata duhet ta theksojnë emrin dhe adresën e tyre si dhe numrin e aksioneve të cilat i mbajnë, qëllimin ose qëllimet për të cilat duhet mbajtur mbledhja, dhe rendin e ditës së mbledhjes. Njoftimi për Mbledhjen e Jashtëzakonshme duhet të bëhet me shkrim ose, nëse parashikohet në Statutin e | 2. An extraordinary meeting of the Shareholder Assembly may be convened as needed by the Managing Director of the Limited Liability Company, or when a Limited Liability Company has established a Board of Directors, by the Chair of the Board of Directors. An extraordinary meeting may also be convened if it is requested by those who hold at least 10% of all votes that may be cast on a matter in a proposed meeting, if they sign, date, and submit to the Limited Liability Company a written request to convene a meeting. In the request to convene a meeting, they must state their names and addresses as well as the number of Shares they hold, the purpose or purposes for which the meeting must be held, and the proposed agenda for the meeting. The notice for the extraordinary meeting, must be in written or if specified by the Charter of the Limited Liability Company, by electronic | 2. Vanredna sednica Skupštine deoničara može biti sazvana po potrebi od strane upravnog direktora društva sa ograničenom odgovornošću ili, kada društvo sa ograničenom odgovornošću ima osnovan Odbor direktora, od strane predsedavajućeg Odbora direktora. Vanredna sednica takođe može biti sazvana ukoliko istu zahteva najmanje 10% nosilaca svih glasova koji imaju pravo glasa za pitanje na predloženoj sednici koji potpisuju, određuju datum i podnose društvu sa ograničenom odgovornošću zahtev u pisanom obliku za održavanje sednice. U zahtevu za održavanje sednice oni trebaju da navedu njihovo ime i adresu kao i broj deonica koje drže, cilj ili ciljeve zašto treba održati sednicu kao i dnevni red sednice. Saopštenje o vanrednoj sednici, treba biti sačinjeno u pisanom obliku ili, ukoliko je predviđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, obaveštenjem |

| | | |
|---|---|---|
| Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, me njoftim përmes postës elektronike. Njoftimi me shkrim apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes së jashtëzakonshëm edhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë aksionarëve, jo më pak se shtatë (7) ditë para datës së parashikuar për mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Aksionarëve. | mail notification. The written notification or the electronic mail notification must contain the location, date, and hour of the extraordinary meeting and agenda thereof, and shall be sent to all Shareholders, not less than seven (7) days before the scheduled date for the extraordinary meeting of the Shareholder Assembly. | preko elektronske pošte. Pismeno saopštenje ili preko elektronske pošte treba da sadrži mesto, datum, vreme vanredne sednice i dnevni red koji se šalje svim deoničarima ne manje od sedam (7) dana pre predviđenog dana održavanja vanredne sednice Skupštine deoničara. |
| 3. Nëse kërkesat e ligjit apo Statutit shkelen materialisht me thirrjen e Kuvendit të Aksionarëve, Kuvendi i Aksionarëve nuk ka të drejtë të miratojë vendime, përveç nëse të gjithë Aksionarët marrin pjesë apo janë të përfaqësuar në Kuvendin e Aksionarëve. Vendimet e miratuara në takimin e tillë janë të pavlefshme përveç nëse Aksionarët në lidhje me të cilët procedura e thirrjes së mbledhjes është shkelur pajtohen me vendimet. | 3.If the requirements of law or the Charter are materially violated in calling a Shareholder Assembly, the Shareholder Assembly shall not have the right to adopt decisions except if all shareholders participate in or are represented at the Shareholder Assembly. Decisions adopted at such meeting are void unless the shareholders with respect to whom the procedure for calling the meeting was violated approve of the decisions. | 3. Ako se materijalno krše zahtevi zakona ili Statuta pri sazivanju Skupštine akcionara, Skupština akcionara neće imati pravo da donosi odluke, osim ako svi akcionari učestvuju u ili su zastupljeni u Skupštini akcionara. Odluke usvojene na takvom sastanku su nevažeće, osim ako deoničari u vezi sa kojima je prekršena procedura za raspisivanje sastanak odobre odluku. |
| 4. Aksionari ose Aksionarët në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar të cilët individualisht ose së bashku mbajnë së paku 5% të të gjitha votave kanë të drejtë të paraqesin kërkesë me shkrim për përfshirjen e një ose më shumë çështjeve në rendin e ditës në kuvendin e Aksionarëve. | 4. A Shareholder or Shareholders in a Limited Liability Company who individually or jointly hold at least 5% of all votes have the right to file a written request to include one or more matters in the agenda of a Shareholder Assembly. | 4. Deoničar ili deoničari društva sa ograničenom odgovornošću koji zajednički ili pojedinačno drže najmanje 5% svih glasova imaju pravo da podnesu zahtev u pisanom obliku za uključenje jedne ili više stvari u dnevni red Skupštine deoničara. |

| Neni 104<br>**Aktivitetet pa mbajtjen e kuvendit** | Article 104<br>**Actions that do not Require a Meeting** | Član 104<br>**Aktivnosti bez držanja Skupštine** |
|---|---|---|
| 1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, cilido veprim për te cilin nevojitet votimi i pronarëve mund të bëhet pa mbajtjen e një kuvendi të aksionarëve, nëse: | 1. Unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise, any action requiring a vote by the Shareholders may be taken without holding a Shareholder Assembly if: | 1. Izuzev ako je drugačije predviđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, bilo koja radnja za koju je potrebno glasanje vlasnika se može izvršiti bez održavanja Skupštine deoničara ukoliko: |
| 1.1. secili Aksionar njoftohet me shkrim për çështjen; dhe | 1.1. every Shareholder is first notified in writing regarding the matter; and | 1.1 svaki deoničar bude napismeno obavešten i stvari; i |
| 1.2. secili aksionar ka në dispozicion së paku tri (3) ditë pune pas pranimit të njoftimit për të paraqitur votën e tij me shkrim mbi këtë çështje ose Aksionari pajtohet me shkrim për njoftim më të shkurtër ose periudhë për vendim. | 1.2. each Shareholder has at least three (3) working days, after receipt of the notice, to submit his written vote on this matter, or the Shareholder consents to being notified in a shorter amount of time or to have a shorter decision period. | 1.2 svaki deoničar ima na raspolaganju najmanje tri (3) radna dana, nakon primanja saopštenja, za podnošenje svog glasa u pisanom obliku o navedenoj stvari ili ukoliko se deoničar saglasi napismeno kratkim obaveštenjem ili vremenom za odluku. |
| **Neni 105**<br>**Të Drejtat e Votimit** | **Article 105**<br>**Voting Rights** | **Član 105**<br>**Prava glasanja** |
| 1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar: | 1. Unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise: | 1.Izuzev ako je drugačije predviđeno statutom društva sa ograničenom odgovornošću: |
| 1.1. të gjitha të drejtat e votimit të Aksionarëve në Kuvendin e Aksionarëve janë të barabarta; dhe | 1.1. all of the voting rights of Shareholders in the Shareholder Assembly are equal; and | 1.1.sva prava glasanja deoničara na Skupštini deoničara su ravnopravna; i |
| 1.2. përveç siç është përcaktuar në | 1.2. except as provided by paragraphs | 1.2.izuzev kao što je drugačije propisano |

| | | |
|---|---|---|
| paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni dhe përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, të gjitha vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave. | 2 and 3 of the present Article, and unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise, all decision are made by a simple majority vote. | u stavovima 2 i 3 ovog člana i izuzev ako je drugačije propisano statutom o društvu sa ograničenom odgovornošću, sve se odluke donose prostom većinom glasova. |
| 2. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ose në Pjesën e Dhjetë të këtij ligji, për vendosjen e çështjeve të përcaktuara në nën-paragrafët 2.1 deri 2.8 të nenit 102 të këtij ligji kërkohet vota unanime e të gjithë Aksionarëve në Kuvendin e Aksionarëve. | 2. Unless it is provided otherwise in the Charter of the Limited Liability Company or in Part Ten of this Law, the unanimous vote of all of the Shareholders in the Shareholder Assembly is required to make a decision on matters listed in sub-paragraphs 2.1 to 2.8 of Article 102 of this Law. | 2.Izuzev ako je drugačije propisano u statutu društva sa ograničenom odgovornošću ili u Delu deset ovog Zakona, u odlučivanju za stvari utvrđene u pod-stavovima 2.1 do 2.8 člana 102. ovog Zakona, potrebno je jednoglasno glasanje svih deoničara na Skupštini deoničara. |
| 3.Shprehimisht përcaktohet se nëse në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar përcaktohet një shumicë tjetër e votave nga shumica unanime e kërkuar në paragrafin 2 të këtij neni për vendosjen e çështjeve të përcaktuara në nën-paragrafët 2.1 deri 2.8 të nenit 102 të këtij ligji, atëherë Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar detyrimisht duhet të përmbajë dispozita të cilat nuk e lejojnë: | 3. It is expressly provided that if the Charter of the Limited Liability Company specifies a majority other than the unanimous vote required in paragraph 2 of this Article in order to make a decision on matters specified in sub-paragraphs 2.1 to 2.8 of Article 102 of this Law, then the Charter of the Limited Liability Company shall contain provisions that in no way allow: | 3.Izričito se određuje da ukoliko se u statutu društva sa ograničenom odgovornošću određuje neka druga većina glasova u odnosu na jednoglasnu većinu propisanu u stavu 2 ovog člana uza odlučivanje stvari navedenih u pod-stavovima 2.1 do 2.8 člana 102 ovog Zakona, u tim slučajevima statut društva sa ograničenom odgovornošću izričito mora da sadrži odredbe koje ne dozvoljavaju: |
| 3.1. vendosjen e çështjeve në fjalë me një metodë që kërkon më pak se votën pohuese të shumicës së thjeshtë të Aksioneve të papaguara të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; | 3.1. decision on those matters through a method which requires less than the affirmative vote of the simple majority of outstanding Shares in the Limited Liability Company; | 3.1.odlučivanje u navedenim stvarima drugom metodom koja zahteva manje od potvrdnog glasa proste većine neisplaćenih deonica društva sa ograničenom odgovornošću; |
| 3.2. miratimin e një ndryshimi në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të | 3.2. approval of amendments to the Charter of the Limited Liability | 3.2.odobrenje izmene u Statutu društva sa ograničenom odgovornošću kojim se |

| | | |
|---|---|---|
| Kufizuar që i rrit detyrimet e një Aksionari për dhënien e kontributeve ose i eliminon apo zvogëlon të drejtat e tij; përveç nëse secili Aksionar i ndikuar voton me shkrim në favor të një ndryshimi të këtillë. | Company which increase a Shareholder's obligation to make contributions or eliminates or reduces a Shareholder's rights, unless every affected Shareholder has specifically and in writing voted in favour of that amendment. | povećavaju obaveze deoničara u davanju doprinosa ili se poništavaju ili smanjuju njegova prava; osim ukoliko svaki pogođeni deoničar napismeno glasa u korist jedne takve promene. |
| **Neni 106**<br>**Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me një Aksionar** | **Article 106**<br>**Limited Liability Company with a Single Shareholder** | **Član 106**<br>**Društvo sa ograničenom odgovornošću sa jednim deoničarom** |
| Në rastet kur Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka vetëm një aksionar, të gjitha kompetencat e Kuvendit të Aksionarëve ushtrohen nga aksionari i vetëm, i cili të gjitha vendimet për ushtrimin e këtyre kompetencave i nxjerr me shkrim dhe i regjistron në një regjistër të vendimeve. | Whenever the Limited Liability Company has only one Shareholder, all competences of the Shareholder Assembly shall be exercised by the sole Shareholder, who shall issue all decisions exercising such competences in writing and records them in a decisions registry. | U slučajevima kada društvo sa ograničenom odgovornošću ima samo jednog deoničara, sve nadležnosti Skupštine deoničara vrši jedan deoničar, koji sve svoje odluke o vršenju ovih nadležnosti donosi u pisanom obliku i upisuje ih u registar odluka. |
| **Neni 107**<br>**Drejtorët Menaxhues** | **Article 107**<br>**Managing Directors** | **Član 107**<br>**Upravni direktori** |
| 1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar menaxhohet nga së paku një drejtor menaxhues. | 1. A Limited Liability Company shall be managed by at least one Managing Director. | 1. Društvom sa ograničenom odgovornošću upravlja najmanje jedan upravni direktor. |
| 2. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mund të krijojë një Bord të Drejtorëve nëse kjo është e rregulluar me Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar krijon Bordin e drejtorëve autorizimet e tij, numrin e anëtarëve, mënyrën e zgjedhjes, | 2. A Limited Liability Company may also establish a Board of Directors, if it is regulated in the Charter of the Limited Liability Company. If the Limited Liability Company establishes a Board of Directors, its authorizations, number of members, manner of appointment, term | 2. Društvo sa ograničenom odgovornošću može osnovati i održavati Odbor direktora ukoliko je to uređeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću i Statutom. Ukoliko društvo sa ograničenom odgovornošću osnuje Odbor direktora, ovlašćenja istog, broj članova, način izbora, |

| | | |
|---|---|---|
| kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë si dhe mënyrën e votimit në Bord do ta përcaktojë Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. Dispozitat në lidhje me Bordin e Drejtorëve të Shoqërisë Aksionare aplikohen respektivisht. | and voting method in the Board shall be provided in the Charter of the Limited Liability Company. The provisions regarding the Board of Directors of Joint Stock Company apply respectively. | trajanje njihovog mandata kao i način izbora u Odbor će biti utvrđeni u Sporazumu i Statutu društva sa ograničenom odgovornošću. Odredbe koje se odnose na Upravni odbor Akcionarskog društva primenjuju se na odgovarajući način. |
| 3. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është e paaftë për pagesa, dhe paaftësia e pagesave, për shkak të gjendjes ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, nuk është e përkohshme, Drejtori(ët) Menaxhues ose Bordi i Drejtorëve menjëherë pasi të kenë marrë njohuri për paaftësinë e pagesave do t'i njoftojnë Aksionarët. | 3. If a Limited Liability Company is insolvent and the insolvency, due to the Limited Liability Company's economic situation, is not temporary, the Managing Director(s) or Board of Directors shall promptly after the insolvency became evident, notify the Shareholders. | 3.Ako je društvo sa ograničenom odgovornošću nesolventno i nelikvidno, zbog ekonomske situacije društvo sa ograničenom odgovornošću, i nije privremeno, generalni direktor(i) ili Odbor direktora odmah nakon stečaj postane evidentan, obaveštava deoničare. |
| 4. Pasi Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar të jetë e paaftë për pagesa, Drejtori(ët) Menaxhues ose anëtarët e Bordit të Drejtorëve nuk mund të bëjnë më pagesa në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, përveç në rastin kur kryerja e pagesave në gjendjen e paaftësisë së pagesës përputhet me procedurën e kujdesit dhe vëmendjes së domosdoshme. Drejtori(ët) Menaxhues bashkërisht kompensojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar për pagesat e bëra nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar pasi paaftësia e pagesës është bërë evidente, pagesa këto të cilat në rrethanat në fjalë, nuk janë bërë me kujdesin e vëmendjen e duhur. | 4. After the Limited Liability Company has become insolvent, the members of the Managing Director(s) or Board of Directors shall no longer make payments on behalf of the Limited Liability Company, except in the case where making the payments in the situation of insolvency conforms to the due diligence requirements. The Managing Director(s) shall jointly compensate to the Limited Liability Company for any payments made by the Limited Liability Company after the insolvency of the company became evident which, under the circumstances in question, were not made with due diligence. | 4.Nakon što je društvo sa ograničenom odgovornošću je postalo insolventno, direktori ili članovi Odbor direktoraviše ne vrše plaćanje u ime društva sa ograničenom odgovornošću, osim u slučaju kada odluka o plaćanju u situaciji nelikvidnosti u skladu sa savesnim poslovanjem. Generalni direktor(i) zajednički će nadoknaditi društvu sa ograničenom odgovornošću za sva plaćanja od strane društva sa ograničenom odgovornošću nakon što je nelikvidnost društva postala evidentna, a, s obzirom na okolnosti u pitanju, nije ispoštovano sa dužnom savesnošću. |

| Neni 108<br>Emërimi dhe Shkarkimi i Drejtorëve Menaxhues | Article 108<br>Appointment and Removal of Managing Directors | Član 108<br>Imenovanje i razrešenje upravnih direktora |
|---|---|---|
| 1. Aksionarët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, ose Bordi i Drejtorëve, do të përcaktojnë personin ose personat e caktuar për të shërbyer si drejtorë menaxhues. Personi/at në fjalë kanë kompetencat e përcaktuara në nenin 109 të këtij ligji. Kur ka më shumë se një drejtor menaxhues, Aksionarët ose Bordi i Drejtorëve mund të përcaktojnë tituj, detyra dhe autorizime të ndryshme për secilin prej tyre. Drejtori menaxhues mund të caktohet, largohet ose zëvendësohet vetëm në bazë të votës së Aksionarëve ose të Bordit të Drejtorëve. Drejtori menaxhues nuk ka nevojë të jetë Aksionar. Drejtori menaxhues duhet të jetë person fizik. | 1. The Shareholders of a Limited Liability Company, or the Board of Directors, shall designate the specific person or persons holding the position of Managing Director. Such person(s) shall have the competences stated in Article 109 of this Law. If there is more than one managing director, the Shareholders or the Board of Directors shall specify different titles, duties and authorizations for each of them. The managing director may only be designated, removed or replaced by a vote of the Shareholders or the Board of Directors. A managing director need not be a Shareholder. A managing director must be a natural person. | 1. Deoničari društva sa ograničenom odgovornošću ili upravni odbor će odrediti lice ili lica imenovana da služe kao upravni direktori. Navedeno lice/a imaju ovlašćenja utvrđena u članu 109. ovog Zakona. Kada ima više od jednog upravnog direktora, deoničari ili upravni odbor mogu odrediti različite nazive, zadatke ili ovlašćenja za svakog od njih. Upravni direktor može biti imenovan, razređen ili zamenjen samo na osnovu glasova deoničara ili upravnog odbora. Upravni direktor ne treba biti deoničar. Upravni direktor mora da bude fizičko lice. |
| 2. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, drejtori i zgjedhur menaxhues vazhdon të mbetet në këtë detyrë përderisa të shkarkohet ose zëvendësohet me votën e Aksionarëve, ose derisa të japë dorëheqje, cilado që ndodh më herët. | 2. Unless the Charter of the Limited Liability Company provides otherwise, a managing director who has been appointed shall continue to be a managing director until he is removed or replaced by a vote of the Shareholders or until he resigns, whichever occurs first. | 2. Izuzev ako je drugačije predviđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, izabrani upravni direktor nastavlja da obavlja ovu dužnost sve dok ne bude razrešen ili zamenjen glasovima deoničara ili dok ne da ostavku, koja god se dogodi ranije. |
| 3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, drejtori menaxhues shkarkohet me votën e aksionarëve ose Bordit të | 3. Unless otherwise provided in the Charter of the Limited Liability Company, a managing director may be removed by a vote of the Shareholders or the Board of | 3. Izuzev ako je drugačije predviđeno Statutom društva sa ograničenom odgovornošću, upravi direktor se može razrešiti glasovima deoničara ili upravnog |

| | | |
|---|---|---|
| Drejtorëve. Aksionarët apo Bordi i Drejtorëve nuk kanë nevojë të deklarojnë arsyen për shkarkimin e tij, dhe personi i shkarkuar nuk ka të drejtë të kërkojë nga Aksionarët ose Bordi i Drejtorëve arsyen për shkarkimin e tij/saj. | Directors. The Shareholders or the Board of Directors are not required to state a reason for such removal, and the removed person has no right to demand or require the Shareholders or the Board of Directors to state a reason for his/her removal. | odbora. Deoničari ili upravni odbor nemaju potrebe da obrazlažu razlog njegovog razrešenja i razrešeno lice nema pravo da od deoničara ili upravnog odbora traži razlog za njegovo/njeno razrešenje. |
| 4. Paga dhe kompensimi i Drejtorëve Menaxhues ose Personave të Ngarkuar sipas këtij neni përcaktohen nga Aksionarët apo Bordi i Drejtorëve, si dhe duhet të paraqiten në kuadër të raporteve vjetore të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar që dorëzohen sipas ligjit në fuqi për raportim financiar. | 4. Salaries and compensation of Managing Directors or designated persons in this Article shall be be determined by Shareholders or the Board of Directors and must be stated in annual reports of the Limited Liability Company submitted for financial reporting according to applicable legislation. | 4. Lični dohodak i naknade upravnih direktora ili vršilaca dužnosti prema ovom članu će se odrediti od deoničara ili upravnog odbora i biće predstavljen u okviru godišnjih izveštaja društva sa ograničenom odgovornošću koji se podnose u skladu sa zakonima na snazi o finansijskom izveštavanju. |
| 5. Me krijimin e procedurës për pagat dhe kompensimin e Drejtorëve Menaxhues dhe shumave të tarifave dhe benefiteve të tjera, si dhe lidhjen e kontratave me Drejtorët Menaxhues, Aksionarët ose Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojnë që shuma totale e pagesave të bëra nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar tek Drejtorët Menaxhues është në proporcion të arsyeshëm me detyrimet e anëtarëve të Drejtorëve Menaxhues dhe gjendjes ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 5. Upon establishing the procedure for salaries and compensation of the members of the Managing Directors and the amount of fees and other benefits, and entry into contracts with the Managing Directors, the Shareholders or the Board of Directors shall ensure that the total amount of the payments made by the Limited Liability Company to the Managing Directors are in reasonable proportion to the duties of the members of the Management Directors and the economic situation of the Limited Liability Company. | 5. Nakon utvrđivanja procedura za plate i naknade članovima Upravnog odbora i visine naknada i drugih davanja, i potpisivanja ugovora sa generalnim direktorima, akcionari i Upravni odbor će osigurati da ukupni iznos uplata društva sa ograničenom odgovornošću za direktore bude u razumnom odnosu prema dužnostima članova upravnih direktora i ekonomske situacije društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 6. Nëse gjendja ekonomike e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në masë të konsiderueshme përkeqësohet, dhe pagesat e mëtutjeshme për Drejtorët Menaxhues si | 6. If the economic situation of a Limited Liability Company significantly deteriorates and further payment to Managing Directors of the salaries and | 6. Ako se ekonomska situacija društva sa ograničenom odgovornošću značajno pogoršava i dalje plaćanje direktorskih plata koje su utvrđene ili dogovorene za |

| | | |
|---|---|---|
| paga e kompensime të vendosura apo të miratuara me Drejtorët Menaxhues, apo lejimi i mëtutjeshëm i benefiteve të tjera për Drejtorët Menaxhues do të ishte tejet e padrejtë për Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, atëherë Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar mundet që me vendim të Aksionarëve të ulë pagat dhe kompensimet. | compensation established for or agreed upon with the Managing Directors, or further allowing of other benefits to the Managing Directors would be extremely unfair to the Limited Liability Company, the Limited Liability Company may, with the decision of Shareholders, decrease the salaries and compensation. | opšteg direktora, ili dalje omogućavanje drugih pogodnosti za opšteg direktora, bilo bi izuzetno nepravedno prema društvu sa ograničenom odgovornošću, onda društvo sa ograničenom odgovornošću može odlukom deoničara da smanji plate i naknade |
| **Neni 109**<br>**Autorizimi i Drejtorit Menaxhues për të Vepruar në Emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar** | **Article 109**<br>**Authorization of Managing Director to Act for the Limited Liability Company** | **Član 109**<br>**Ovlašćenje upravnog direktora u ime društva sa ograničenom odgovornošću** |
| 1. Secili drejtor menaxhues është i autorizuar që ta përfaqësojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar si Përfaqësues i Autorizuar gjatë ushtrimit të Veprimtarisë së saj Ekonomike, duke përfshirë edhe autorizimin: | 1. Every managing director is authorized to represent the Limited Liability Company as Authorized Representative in the conduct of its Business Activities, including the authorization to: | 1. Svaki upravni direktor je ovlašćen da zastupa društvo sa ograničenom odgovornošću kao ovlašćen predstavnik tokom obavljanja svoje privredne delatnosti, uključujući i ovlašćenje: |
| 1.1. për udhëheqjen e Veprimtarisë së zakonshme Ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; dhe | 1.1. conduct the ordinary Business Activities of the Limited Liability Company and | 1.1. za upravljanje uobičajenim privrednim delatnostima društva sa ograničenom odgovornošću; i |
| 1.2. për nënshkrimin e marrëveshjeve ose dokumenteve tjera të nevojshme për ushtrimin e Veprimtarisë Ekonomike në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nëse ky nënshkrim ndërlidhet në masë të arsyeshme me ushtrimin e Veprimtarisë së zakonshme Ekonomike të Shoqërisë me | 1.2. sign an agreement, or other documents necessary to exercise Business Activity, on behalf of the Limited Liability Company if the signing of the agreement or document is reasonably related to the conduct of the ordinary Business Activities of the Limited Liability Company. Any such action by a managing director is | 1.2. za potpisivanje sporazuma i drugih dokumenata neophodnih za obavljanje privredne delatnosti u ime društva sa ograničenom odgovornošću ukoliko se taj potpis u opravdanoj meri povezuje obavljanjem uobičajene privredne delatnosti društva sa ograničenom odgovornošću. Ove radnje upravnih direktora obavezuju društvo sa |

| | | |
|---|---|---|
| Përgjegjësi të Kufizuar. Cilido prej atyre veprime të drejtorëve menaxhues e obligojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, përveç nëse Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar përcakton që disa ose të gjithë Drejtorët Menaxhues do të përfaqësojnë bashkërisht Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar. Përfaqësimi i përbashkët vlen ndaj palëve të treta vetëm nëse publikohet nga ARBK-ja sipas nenit 22 të këtij ligji. | binding on the Limited Liability Company unless the Charter of the Limited Liability Company prescribes that some or all of managing directors shall represent the Limited Liability Company jointly. Joint representation shall apply with regard to third persons only if it is published by the KBRA according to article 22 of this Law. | ograničenom odgovornošću, osim ukoliko statut deoničarskog društva propisuje da neki ili svi direktori predstavljaju deoničarsko društvo zajednički. Zajedničko predstavljanje važi u pogledu trećih lica samo ako je objavljeno u KARP shodno članu 22 ovog zakona: |
| 2. Me kryerjen e transaksioneve në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, sa i përket Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, drejtorët menaxhues janë të obliguar të zbatojnë kufizimet e përcaktuara me Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar apo vendosur me votën e Aksionarëve apo Bordit të Drejtorëve. Kufizimi i të drejtës së përfaqësimit nuk vlen ndaj palëve të treta. | 2. Upon the conclusion of transactions on behalf of a Limited Liability Company, the managing directors are required to adhere, with respect to the Limited Liability Company, to the restrictions prescribed by the Charter of the Limited Liability Company or established by the Shareholders or the Board of Directors. A restriction on the right of representation does not apply with regard to third persons. | 2. Po zaključenju transakcije u ime deoničarskog društva direktori moraju da se pridržavaju, u pogledu deoničarskog društva, ograničenja propisanih Statutom deoničarskog društva koji su uspostavili akcionari ili odbor direktora. Ograničenje prava predstavljanja ne važi u pogledu trećih lica. |
| 3. Cilido person, përfshirë drejtorin menaxhues, i cili me dijeni pretenedon se vepron në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në shkelje të detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, është personalisht përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nga këto veprime. | 3. Any person, including a managing director, who knowingly purports to act on behalf of the Limited Liability Company in violation of the obligations specified in paragraph 2 of this Article, is personally liable for all damages caused to the Limited Liability Company from these actions. | 3. Svako lice, uključujući upravnog direktora, koje se namerno pretvara da postupa u ime društva sa ograničenom odgovornošću uz kršenje neophodnih obaveza odredjenih u stavu 2 ovog člana, je lično odgovorno za svu štetu prouzrokovanu ovim akcijama društvu sa ograničenom odgovornošću. |

| Neni 110<br>Detyrimi për Mbajtjen e Librave dhe Arkivës dhe Sigurimi i Qasjes | Article 110<br>Duty to Maintain Books and Records and Provide Access | Član 110<br>Obaveza držanja knjiga i arhive i osiguranje pristupa |
|---|---|---|
| 1.Drejtorët menaxhues të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar janë të detyruar që: | 1. The managing directors of a Limited Liability Company shall have the duty to: | 1. Upravni direktori društva sa ograničenom odgovornošću su dužna da: |
| 1.1. të përgatisin dhe mbajnë librat dhe arkivën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi; | 1.1. to prepare and maintain the books and records of the Limited Liability Company in accordance with all applicable laws and sub-legal acts; | 1.1. pripremaju i održavaju knjige i arhivu društva sa ograničenom odgovornošću u skladu sa zakonima i podzakonskim aktima na snazi; |
| 1. Varësisht nga paragrafi 2 i këtij neni si dhe ndalesat apo kufizimet e përcaktuara në statutin e Shoqërisë Aksionare, Shoqëria Aksionare mund të krijojë dhe emetojë letra të tjera me vlerë përveç aksioneve: | 1. Subject to paragraph 2 of this Article and any prohibition or restriction specified in the Charter of the Joint Stock Company, the Joint Stock Company may create or issue securities other than Shares: | 1. Shodno stavu 2 ovog člana kao i zabranama i ograničenjima propisanim statutom deoničarskog društva, deoničarsko društvo može stvarati i izdavati druge hartije od vrednosti, izuzev deonica: |
| 1.1.bonde; | 1.1. bonds; | 1.1. obveznice; |
| 1.2. letra me vlerë të konvertueshme në aksione; dhe | 1.2. securities that are convertible into Shares; and | 1.2. hartije od vrednosti pretvorive u deonice; i |

| | | |
|---|---|---|
| 1.3. mundësinë për blerjen e aksioneve. Mundësia për blerjen enjë aksioni është letër me vlerë që i jep pronarit të drejtën për blerjen e një numri të caktuar të një lloji apo kategorie të aksioneve me një çmim të caktuar brenda një afati të caktuar kohor. | 1.3. options to acquire Shares. An option to acquire Share is a security that gives to its owner the right to acquire a specific number of Shares of a specific type and class at a specific price within a specific period of time. | 1.3. mogućnost kupovine deonica. Mogućnost kupovine deonice podrazumeva hartiju od vrednosti koja imaocu daje pravo da kupi određeni broj deonica određene vrste ili klase, po određenoj ceni, u unapred utvrđenom vremenskom periodu. |
| 2. Letrat me vlerë të konvertueshme në aksione si dhe mundësia për blerjen e aksioneve nuk mund të emetohen nëse numri i autorizuar i aksioneve përkatëse, siç përcaktohet në statutin e Shoqërisë Aksionare, nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar: | 2. Securities which can be converted into Shares as well as the option to acquire Shares may not be issued if the authorized number of the concerned Shares, as specified in the Charter of the Joint Stock Company, is not sufficient to cover: | 2. Hartije od vrednosti pretvorive u deonice kao i mogućnost kupovine deonice ne mogu se izdavati ukoliko ovlašćeni broj datih deonica, propisan statutom deoničarskog društva, nije dovoljan da pokrije: |
| 2.1. emetimin e ardhshëm të aksioneve të tjera të atij lloji; | 2.1. the future issuance of other Shares of that type, | 2.1. narednu emisiju drugih deonice te vrste; |
| 2.2. emetimin e aksioneve të tjera sipas letrave të tjera me vlerë apo mundësive të blerjes tashmë të emetuara; dhe | 2.2. the issuance of Shares, based on other securities or options to purchase Shares which have already been issued; | 2.2. emisiju drugih deonica shodno drugim hartijama od vrednosti ili mogućnosti kupovine već izdatih deonica; i |
| 2.3. të gjitha aksionet e tjera të cilat tashmë janë emetuar. | 2.3. all other Shares which have already issued. | 2.3. sve druge deonice, koje su već izdate. |
| 3. Kurdo që Shoqëria Aksionare emeton letra me vlerë të konvertueshme në aksione ose mundësi për blerjen e aksioneve, Shoqëri Aksionare duhet ta regjistrojë në listën e aksionarëve emrin dhe adresën e | 3. Whenever the Joint Stock Company issues securities that are convertible into Shares or options to acquire Shares, the Joint Stock Company must register in the list of Shareholders the name and address | 3. Deoničarsko društvo je dužno da svaki put kada izda hartije od vrednosti pretvorive u deonice ili mogućnost za kupovinu deonica, upiše u spisak deoničara ime i adresu svakog vlasnika hartije od |

| | | |
|---|---|---|
| secilit pronar të letrës me vlerë apo mundësisë për blerje si dhe numrin e aksioneve të autorizuara për të cilat Shoqëria Aksionare duhet të respektojë të drejtën e pronarit për konvertim. Deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së këtyre të drejtave, Shoqëria Aksionare duhet të mbajë në thesarin e saj, atë numër të aksioneve të autorizuara për sigurimin e të drejtave të këtilla. | of each owner of a security or option to acquire Shares as well as the number of authorized Shares for which the Joint Stock Company must observe the right of the owner for conversion. Until the expiration of the period of validity of these rights, the Joint Stock Company must maintain in its treasury the number of authorized Shares needed to ensure those rights. | vrednosti ili mogućnosti kupovine kao i broj overenih deonica u kojima deoničarsko društvo mora ispoštovati pravo imaoca na pretvaranje deonica. Deoničarsko društvo je do isteka roka važenja ovih prava dužno da u svom trezoru drži dati broj deonica, sa ciljem da obezbedi ostvarivanje ovih prava. |
| 4. Vendimi për emetimin e letrave me vlerë ose mundësisë për blerje të përcaktuar në këtë nen, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e paragrafit 5 të nenit 133 të këtij ligji. | 4. The decision to issue securities, or options to purchase, specified in this Article, must be in accordance with the requirements of paragraph 5 of Article 133 of this Law. | 4. Odluka o emisiji hartija o vrednosti ili mogućnosti kupovine propisana ovim članom, treba da bude u skladu sa zahtevima stava 5 člana 133 ovog zakona. |
| **Neni 140**<br>**Pagesa për Aksione dhe Letra me Vlerë** | **Article 140**<br>**Payment for Shares and Securities** | **Član 140**<br>**Isplata na ime deonice i hartija od vrednosti** |
| 1. Përveç se në relacion me skemën e aksioneve të punonjësve, një Shoqëri Aksionare nuk duhet të emetojë ose shesë aksionet ose letrat e saj me vlerë, përveç në një transaksion ku Shoqëria Aksionare menjëherë merr: | 1. Except as related to employee Share schemes, a Joint Stock Company must not issue or sell any of its Shares or Securities except in a transaction where the Joint Stock Company immediately receives: | 1. Izuzev u vezi sa šemom deonica zaposlenih, deoničarsko društvo ne treba da izdaje ili prodaje svoje deonice ili hartije od vrednosti, sem ukoliko se radi o prometu u kome deoničarsko društvo odmah ostvaruje: |
| 1.1. pagesën e plotë sipas çmimit të parapaguar; ose | 1.1. full payment of based on the subscription price or; or | 1.1. potpunu isplatu, shodno pretplaćenoj sumi; ili |
| 1.2. pagesën e pjesërishme sipas nenit 141 të këtij ligji. | 1.2. partial payment in accordance with Article 141 of this Law. | 1.2. delimičnu isplatu, shodno članu 141. ovog zakona. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Përveç nëse parashihet ndryshe në Skemën e Aksioneve të Punonjësve të miratuar sipas këtij ligji, çmimi parapagues mund të paguhet me para të gatshme ose me pronë tjetër materiale ose jo-materiale ose të drejta me vlerë. | 2. Except as may otherwise be provided in the Employee Share Scheme adopted in accordance with this Law, the subscription price may be paid cash or with other tangible or intangible property or rights of value. | 2. Izuzev ukoliko drukčije propisuje Šema deonica zaposlenih usvojena shodno ovom zakonu, pretplatna cena isplaćuje se u gotovini ili u vidu druge materijalne ili nematerijalne imovine ili pravima od vrednosti. |
| 3. Nëse pagesa bëhet në forma të tjera përveç parave, aksionari i ardhshëm i Shoqërisë Aksionare është i detyruar qe të angazhojë një vlerësues të jashtëm, të pavarur dhe të autorizuar i cili do të mbledh dhe dorëzoj para Bordit të Drejtorëve një raport për vlerësimin e drejt dhe të arsyeshëm të vlerës së pasurisë së ofruar në formë pagese si dhe një mendim formal se kjo vlerë është e mjaftueshme për të mbuluar çmimin blerës të aksionit ose letrës me vlerë e cila do të emetohet ose shitet. Raporti do të përmbaj së paku: | 3. If payment is made in any form other than money, the prospective Shareholder of the Joint Stock Company has an obligation to engage an outside, independent, authorized appraiser who shall compile and deliver to the board of directors a report assessing the fair and reasonable value of the property offered as payment and giving a formal opinion as to whether such value is at least sufficient to cover the purchase price of the Share or security to be issued or sold. The report shall contain at least: | 3. Ukoliko je isplata načinjena u drugim oblicima sem novčanog, budući deoničar deoničarskog društva u obavezu je da angažuje nezavisnog i ovlašćenog spoljnog procenjivača, koji će sastaviti i podneti odboru direktora izveštaj o pravičnoj i razumnoj proceni vrednosti imovine date na ime isplate zajedno sa formalnim mišljenjem o dovoljnosti ove vrednosti za naknadu cene koštanja deonice ili hartije od vrednosti koja se pušta u emisiju ili prodaje. Izveštaj će najmanje sadržati: |
| 3.1. Një përshkrim të pasurisë ose të drejtave që ofrohen si pagesë; | 3.1. a description of the property or rights being offered as payment, | 3.1. opis imovine ili prava ponuđenih na ime isplate; |
| 3.2. Një përshkrim të metodës së vlerësimit e cila është përdorur nga vlerësuesi; dhe | 3.2. a description of the methods of evaluation used by the appraiser; and | 3.2. opis metode procene koju je procenjivač upotrebio; i |
| 3.3. Një deklaratë nga vlerësuesi se shuma e arritur përmes kësaj metode është më së paku e barabartë me çmimin parapagues. | 3.3. a statement by the appraiser that the value attained by such methods is at least equal to the subscription price. | 3.3. izjavu procenjivača da je iznos ostvaren ovom metodom barem jednak pretplaćenoj ceni. |
| 4. Ky raport duhet të sigurohet dhe të | 4. This report shall be filed with and | 4. Odbor direktora treba da obezbedi i |

| | | |
|---|---|---|
| miratohet nga Bordi i Drejtorëve para se aksionet të mund të emetohen.<br><br>5. Përveç nëse parashihet ndryshe në Skemën e Aksioneve të Punonjësve të miratuar sipas këtij ligji, një Shoqëri Aksionare nuk mund të pranojë punë ose shërbime, qoftë të kryera apo që duhet të kryhen, si kompensim të pjesshëm ose të plotë për një aksion ose letër me vlerë.<br><br>**Neni 141**<br>**Pagesat e Pjesërishme për Aksione**<br><br>1. Brenda tridhjetë (30) ditëve të para pas regjistrimit fillestar në ARBK, Shoqëria Aksionare mund të emetojë të gjitha aksionet apo një pjesë të tyre në këmbim me një kompensim të pjesshëm, por vetëm nëse ka marrëveshje midis aksionarëve dhe Shoqërisë Aksionare që parasheh:<br><br>1.1. ndonjë apo të gjitha pagesat për aksione të tilla duhet të bëhen në para të gatshme dhe jo ndryshe;<br><br>1.2. jo më pak se 25% për vlerën nominale të aksioneve duhet të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve pas regjistrimit fillestar të Shoqërisë Aksionare; dhe<br><br>1.3. bilanci i papaguar duhet të paguhet në një datë e cila nuk mund të | approved by the Board of Directors before the Shares may be issued.<br><br>5. Except as may otherwise be provided in an Employee Share Scheme adopted in accordance with this Law, a Joint Stock Company may not accept labour or services, whether performed in the past or to be performed in the future, as payment, in whole or in part, for a Share or security.<br><br>**Article 141**<br>**Partial Payment for Shares**<br><br>1. Within the first 30 days following its initial registration at KBRA, the Joint Stock Company may issue all or any part of its Shares in return for partial payment, but only if there is a written agreement between the Shareholder and the Joint Stock Company which provides that:<br><br>1.1. any and all payments for such Shares must be made in cash and not in another way;<br><br>1.2. not less than 25% of the Par value of the Shares must be paid within thirty (30) days afterthe initial registration of the Joint Stock Company; and<br><br>1.3. the unpaid balance must be paid by a date that is no more than two (2) | usvoji ovaj izveštaj pre nego što se dozvoli emisija deonica.<br><br>5. Izuzev ukoliko drukčije propisuje Šema deonica zaposlenih usvojena shodno ovom zakonu, deoničarsko društvo ne može primati poslove ili usluge, bilo pružene ili one koje će biti pružene, na ime delimične ili potpune naknade za deonicu ili hartiju od vrednosti.<br><br>**Član 141**<br>**Delimično uplaćene deonice**<br><br>1. U roku od trideset (30) dana pre prve registracije pri KARP-u, deoničarsko društvo može pustiti u emisiju sve deonice ili jedan deo istih u zamenu za delimičnu naknadu, ali samo ukoliko između deoničara i deoničarskog društva postoji sporazum koji propisuje:<br><br>1.1. da se bilo koja ili sve uplate na ime datih deonica vrše u gotovini i ni na koji drugi način;<br><br>1.2. da se najmanje 25% nominalne vrednosti deonica isplaćuje u roku od trideset (30) dana od prve registracije deoničarskog društva; i<br><br>1.3. ne izmireni saldo treba da se izmiri do datuma koji ne sme da |

| | | |
|---|---|---|
| jetë më shumë se dy (2) vite nga dita e regjistrimit fillestar të Shoqërisë Aksionare në ARBK. | years from the date of the initial registration of the Joint Stock Company at KBRA. | premaši period od dve (2) godine od dana prve registracije deoničarskog društva u KARP-u. |
| 2. Përveç në rast të aksioneve të emetuara sipas Skemës së Aksioneve të Punonjësve të miratuar në pajtim më këtë ligj, aksionet e lëshuara në kursin e rritur në kapital themelor duhet të paguhen në tërësi dhe nuk mund të emetohen si aksione pjesërisht të paguara. | 2. Except in the case of Shares issued pursuant to an Employee Share Scheme adopted in accordance with the present Law, Shares issued in the course of an increase in charter capital must be paid up in full and may not be issued as partly paid Shares. | 2. Izuzev u slučaju deonica izdatih prema Šemi deonica zaposlenih usvojenoj u skladu sa ovim zakonom, deonice izdate po višem kursu u osnovnom kapitalu isplaćuju se u celosti i ne mogu se izdavati kao delimično uplaćene deonice. |
| 3. Në lidhje me aksionet e paguara pjesërisht, të dhënat në vijim duhet të regjistrohen në regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë Aksionare dhe nëse aksioni i tillë është certifikuar, në certifikatën e aksionit, nëse ka të tillë: | 3. With respect to any partly paid Share, the following data shall be registered in the list of Shareholder of the Joint Stock Company, and if this Share is certified, in the Share certificate, if there is one: | 3. U vezi sa delimično uplaćenim deonicama, podaci u nastavku upisuju se u registar deoničara deoničarskog društva i ukoliko je ovakva deonica overena, u potvrdu o registrovanom vlasniku deonice, ukoliko postoji: |
| 3.1.shuma e përgjithshme e çmimit të aksionit; | 3.1. the total amount of the purchase price of such Share; | 3.1. ukupan iznos cene deonice; |
| 3.2. shumën e paguar në kohën e emetimit; dhe | 3.2. the amount that has been paid at the time of issuance, and | 3.2. iznos uplaćen u vreme emisije; i |
| 3.3. të gjitha shumat që janë paguar nga koha e emitimit dhe koha e pagesës. | 3.3. all amounts that have been paid at the time of issuance and time of such payment. | 3.3. svi iznosi uplaćeni od vremena emisije do vremena uplate. |
| 4. Të drejtat e votimit dhe të drejtat e tjera të aksionit të paguar pjesërisht, duke përfshirë të drejtat në dividente dhe shpërndarje, duhet të reduktohen në masën e nevojshme për të pasqyruar shumën e cila | 4. The voting rights and all other rights of a partly paid Share, including rights to receive dividends and distributions, must be reduced to the necessary amount to reflect the amount which has not yet been | 4. Prava glasa i ostala prava uz delimično uplaćenu deonicu, uključujući prava na dividendu i raspodelu, treba svesti na minimum u mogućoj meri kako bi se odrazila svota koja nije uplaćena za |

| | | |
|---|---|---|
| nuk është paguar për aksionin. | paid for that Share. | deonicu. |
| 5. Pa paragjykuar aplikimin e përgjithshëm të paragrafit 4 të këtij neni, në rast se Shoqëria Aksionare shpall një divident për një lloj apo kategori të caktuar të aksioneve, Shoqëria Aksionare duhet që njëkohësisht të shpallë divident edhe për aksionet e atij lloji apo kategori që nuk janë paguar plotësisht, por dividenti i pagueshëm për këtë lloj të aksioneve duhet të reduktohet në masën e nevojshme për të pasqyruar shumën e cila ende nuk është paguar për atë aksion. Në raste të tilla Shoqëria Aksionare ka të drejtën që: | 5. Without prejudice to the general applicability of paragraph 4 of this Article, if a Joint Stock Company declares a dividend for a type or class of Share, the Joint Stock Company must at the same time declare a dividend on the partly paid Shares of that type or class of Share, but the dividend payable on the partly paid Shares must be reduced to the necessary amount to reflect the amount that has not yet been paid for that Share. In this case the Joint Stock Company shall have the right to: | 5. Ne prejudicirajući opštu primenu stava 4 ovog člana, u slučaju da deoničarsko društvo objavi dividendu za određenu vrstu ili klasu deonica, deoničarsko društvo istovremeno treba da objavi dividendu za sve deonice date vrste ili klase koje nisu u potpunosti uplaćene, ali isplativa dividenda za ovu vrstu deonica treba da se smanji u potrebnoj meri kako bi odrazila iznos koji još uvek nije uplaćen za datu deonicu. U datim slučajevima deoničarsko društvo ima pravo da: |
| 5.1. të paguajë dividentin për aksionarin në fjalë; ose | 5.1.end to the concerned Shareholder; or | 5.1. isplati dividendu datom deoničaru; ili |
| 5.2. të bëjë shpërndarjen e dividentit duke ia ndalur shumën e pa-paguar të aksionit | 5.2. distribute the dividend while retaining the amount not payed for that Share. | 5.2. izvrši raspodelu dividende, odbijanjem neuplaćenog iznosa deonice. |
| **Neni 142**<br>**Përgjegjësitë e Pronarëve të Aksioneve të Paguara Pjesërisht** | **Article 142**<br>**Liability of Owners of Partly Paid Shares** | **Član 142**<br>**Odgovornosti vlasnika delimično uplaćenih deonica** |
| 1. Secili pronar/debitor i aksionit të paguar pjesërisht është personalisht përgjegjës ndaj Shoqërisë Aksionare për bilancin e mbetur. | 1. Each owner/debtor of a partly paid Share is personally liable to the Joint Stock Company for the unpaid balance. | 1. Svaki imalac/dužnik delimično uplaćene deonice lično je odgovoran deoničarskom društvu za neizmireni deo uplate. |
| 2. Nëse pronari/debitori i aksioneve të paguara pjesërisht dështon që menjëherë të paguaj ndonjë këst të maturuar sipas | 2. If a owner/debtor of the partly paid Shares fails to immediately pay any amount when due under the written | 2. U slučaju da imalac/dužnik delimično uplaćenih deonica ne uplati odmah neku dospelu ratu, shodno sporazumu u pismenoj |

| | | |
|---|---|---|
| marrëveshjes me shkrim të paraparë në paragrafin 1 të neni 141 të këtij ligji, Shoqëria Aksionare mundet të deklaroj marrjen e aksioneve në tërësi apo pjesërisht, përveç nëse kjo ndikon negativisht në një person i cili ka blerë disa aksione ose të gjitha aksionet pa qenë në dijeni për statusin e tyre si aksione pjesërisht të paguara dhe/ose menjëherë të kërkojë pagimin e bilancit të mbetur përmes paraqitjes së padisë në gjykatë kundër aksionarit për shumën e mbetur. “shuma e mbetur” përfshin: | agreement required by paragraph 1 of Article 141 of this Law, the Joint Stock Company may declare the forfeiture of the Shares in whole or in part, unless this would negatively affect a person who has acquired some or all of the Shares without knowing of their partly paid status, and/or immediately request payment of the unpaid balance by filing a claim with the Court against the Shareholder for the amount due. The “amount due” shall include: | formi propisanom stavom 1, član 141. ovog zakona, deoničarsko društvo može proglasiti oduzimanje deonica u celosti ili delimično, izuzev u slučajevima u kojima ovo utiče negativno na osobu koja je kupila nekoliko ili sve deonice a koja nije bila upoznata o njihovom statusu delimično uplaćenih deonica i/ili odmah tražiti uplatu preostalog dela uplate, podnošenjem tužbe na sudu protiv deoničara za preostali iznos. “Preostali iznos” obuhvata: |
| 2.1. kamatën në shumën e mbetur, duke përfshirë ndonjë kamatë të maturuar e cila nuk është paguar, të cilën pronari/debitori ka dështuar ta paguaj, si shkallë e llogaritur nga Banka Qendrore e Kosovës dhe e publikuar; dhe | 2.1. interest on the amount due, including any due but unpaid interest, that the holder/debtor failed to pay, such rate calculated and published by the Central Bank of Kosovo; and | 2.1. kamatu na preostali iznos, uključujući i svaku dospelu kamatu koja nije uplaćena, koju vlasnik/dužnik nije uspeo da plati, po stopi koju obračunava i objavljuje Centralna banka Kosova; i |
| 2.2. të gjitha shpenzimet e arsyeshme që janë bërë nga Shoqëria Aksionare gjatë përgatitjes, dorëzimit dhe procedurës kontestimore ose gjatë shitjes. | 2.2. all expenses reasonably incurred by the Joint Stock Company in preparing, filing and the contested procedure or in conducting the sale. | 2.2. sve druge razumne troškove koje je deoničarsko društvo načinilo tokom pripreme, podnošenja i realizovanja parničnog ili prodajnog postupka. |
| 3. Personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqëria Tregtare që ka blerë aksionin e paguar pjesërisht është personalisht dhe bashkërisht përgjegjës së bashku me pronarin/debitorin e aksioneve për shumën e papaguar. Nëse blerësi nuk ka qenë në | 3. The natural or legal person and/or Business Organization that has acquired partly paid Shares shall be jointly and severally liable with the original owner/debtor of the Shares for the unpaid amount. If the acquirer did not have such | 3. Fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo koje kupi delimično uplaćenu deonicu, je lično i zajednički sa vlasnikom /dužnikom deonica odgovoran za neizmireni iznos. U slučaju da kupac nije bio upoznat sa ovom činjenicom, |

| | | |
|---|---|---|
| dijeni mbi këtë fakt, aksionari/debitori mbetet pala e vetme plotësisht përgjegjëse për shumën e papaguar. | notice or knowledge on this fact, the Shareholder/debtor shall remain the only party fully liable for the unpaid amount. | deoničar/dužnik ostaje jedina stranka koja je u potpunosti odgovorna za neizmireni iznos. |
| 4. Pengmarrësi i aksioneve të paguara pjesërisht, nuk është përgjegjës si rezultat i statusit të tij si pengmarrës. Sidoqoftë, nëse pengmarrësi bën blerjen e aksioneve të paguara pjesërisht, normat e parapara në paragrafin 3 të këtij neni merren parasysh gjatë përcaktimit të përgjegjësisë së pengmarrësit për shumën e papaguar. | 4. The pledgee of partly paid Shares shall not be liable for the unpaid amount simply because of the pledgee's status as pledgee. If, however, the pledgee acquires the partly paid Shares, the rules of paragraph 3 of this Article are taken into consideration during the determination of pledgee's liability for the unpaid amount. | 4. Žirant delimično uplaćenih deonica, nije odgovoran usled svog statusa žiranta. U slučaju da žirant otkupi delimično uplaćene deonice, uzimaju se u obzir stope propisane stavom 3 ovog člana prilikom utvrđivanja odgovornosti žiranta za neuplaćeni deo. |
| **Neni 143**<br>**E Drejta e Përparësisë në Aksionet e Reja** | **Article 143**<br>**Preemptive Rights to New Shares** | **Član 143**<br>**Pravo preče kupovine novih deonica** |
| 1. Sipas këtij neni, dhe përveç në relacion me Skemën e Aksioneve të Punonjësve, aksionarët e Shoqërisë Aksionare kanë të drejtën e përparësisë për blerjen e aksioneve të reja të të njëjtit lloj – ose nëse është e aplikueshme të të njëjtës kategori, kurdo që Shoqëria Aksionare emeton aksione të reja të llojit përkatës. | 1. As provided in this Article and except in relation to an Employee Share Scheme, the Shareholders of a Joint Stock Company shall have preemptive rights to acquire new Shares of the same type - and, if applicable the same class - of Shares whenever the Joint Stock Company issues new Shares of the respective type. | 1. Shodno ovom članu i izuzev u vezi sa Šemom deonica zaposlenih, deoničari deoničarskog društva imaju pravo preče kupovine novih deonica iste vrste – ili ukoliko je primenjivo iste klase, svaki put kada deoničarsko društvo izdaje nove deonice date vrste. |
| 2. E drejta e përparësisë së një aksionari sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk është e pakufizuar. Kjo e drejtë mund të ushtrohet nga aksionari vetëm në lidhje me atë përqindje të aksioneve të reja që është e barabartë me përqindjen aktuale të pronësisë së aksionarit në aksionet tashmë të emetuara dhe ato të papaguara të të njëjtit lloj dhe kategori. Aksionari mund ta | 2. The preemptive rights of a Shareholder according to paragraph 1 of this Article are not unlimited. These rights must be exercised by the Shareholder only with respect to that percentage of the new Shares that is equal to the Shareholder's current percentage of ownership of the already issued and the outstanding Shares of the same type and class. A Shareholder | 2. Pravo preče kupovine deoničara shodno stavu 1 ovog člana nije neograničeno. Ovo pravo može ostvarivati jedan deoničar, samo u vezi sa onim procentom novih deonica koji odgovara aktuelnom procentu vlasništva deoničara na već izdate deonice i na neizmirene deonice iste vrste i klase. Deoničar može koristiti pravo preče kupovine, delimično ili u celosti. |

| | | |
|---|---|---|
| shfrytëzojë të drejtën e përparësisë pjesërisht ose plotësisht.<br><br>3. E drejta e përparësisë e përcaktuar në këtë nen nuk mund të kufizohet ose revokohet me statut, megjithatë kjo e drejtë mund të kufizohet ose të revokohet në bazë të një vendimi të aksionarëve i cili është miratuar me së paku dy të tretat e votave të aksionarëve të të njëjtit lloj dhe kategori të aksioneve. Ky votim duhet të bëhet pas paraqitjes së një raporti nga drejtorët ku përcaktohen:<br>3.1. arsyet për kufizimin ose për revokimin e së drejtës së përparësisë; dhe<br><br>3.2. arsyetimi i përdorur nga Bordi i Drejtorëve për përcaktimin e çmimit të aksioneve që do të emetohen. Ky raport duhet të përgatitet nga një vlerësues i pavarur.<br><br>4. E drejta e përparësisë e themeluar sipas këtij neni zbatohet vetëm për aksionarët ekzistues që mbajnë aksione të regjistruara në listën e aksionarëve të Shoqërisë Aksionare. Shprehimisht përcaktohet se pronësia ndaj një mundësie për blerjen e një aksioni ose letre me vlerë e cila konvertohet në aksion nuk jep shkas për çfarë do të drejtë të përparësisë e cila është krijuar sipas këtij neni. | may exercise his pre-emptive rights in whole or in part.<br><br>3. The preemptive rights established in this Article may not be restricted or revoked by the Charter, however the rights may be restricted or revoked based on a Decision by the Shareholder which is adopted by at least two thirds the Shareholder votes of the concerned type and class of Share. This vote shall take place after a report has been presented by the directors setting out:<br>3.1. the reasons for the restriction or revocation of the preemption rights; and<br><br>3.2. the reasoning used by the board of directors in determining the price for the Shares which will be issued. This report shall be drawn up by an independent valuation expert.<br><br>4. The preemptive rights established in this Article are applicable only to existing Shareholders who have Shares registered in the list of Shareholder of the Joint Stock Company. It is expressly provided that ownership of an option to acquire a Share or a security that is convertible into a Share does not give rise to any preemptive rights created by this Article. | <br><br>3. Pravo preče kupovine propisano ovim članom ne može se ograničavati ili ukidati statutom, međutim ovo pravo se može ograničavati ili opozivati na osnovu odluke deoničara, usvojene sa najmanje dvotrećinskom većinom glasova deoničara iste vrste i klase deonica. Ovo glasanje obavlja se nakon što direktori podnesu izveštaj koji navodi:<br>3.1. razloge za ograničavanje ili za opoziv prava preče kupovine; i<br><br>3.2. obrazloženje Odbora Direktora o određivanju cene deonica koje će biti puštene u emisiju. Ovaj izveštaj priprema nezavisan procenjivač.<br><br>4. Pravo preče kupovine propisano ovim članom primenjuje se samo za postojeće deoničare čije se deonice vode na spisku deoničara deoničarskog društva. Izričito se predviđa da vlasništvo nad deonicom ili hartijom od vrednosti koja se konvertuje u deonicu, nije povod za dodelu prava preče kupovine propisanog ovim članom. |

| | | |
|---|---|---|
| 5. Kur propozohet një emetim i ri, Shoqëria Aksionare paraprakisht do t'u dorëzojë të gjithë aksionarëve një njoftim për emetimin e propozuar të aksioneve, të cilët duhet të përfshihet në minimum:<br><br>5.1. numrin e aksioneve që do të emetohen;<br><br>5.2. çmimin e propozuar ose metodën e përcaktimit të çmimit; dhe<br><br>5.3. periudhën dhe procedurat e ushtrimit të drejtave të përparësisë, me kusht që kjo periudhë të mos jetë më pak se njëzetenjë (21) ditë. Të gjitha rregullat dhe procedurat me të cilat rregullohet ushtrimi i të drejtave të përparësisë duhet të jenë të barabarta për të gjithë aksionarët të cilët i kanë këto të drejta. | 5. Whenever a new issue is proposed, the Joint Stock Company must first give each existing Shareholder an advance notice of the proposed issuance of Shares, which must state at a minimum:<br><br>5.1. the number of Shares to be issued;<br><br>5.2. the proposed price or method of determining the price of issuance; and<br>5.3. the period and procedure for exercising the preemptive rights, provided that such period is not less than twenty one (21) days. All rules and procedures governing the exercise of preemptive rights must be equal for all Shareholders having such rights. | 5. Svaki put kada se predlaže nova emisija, deoničarsko društvo na samom početku upućuje svim deoničarima obaveštenje o predloženoj emisiji deonica, koje u najmanjem treba da navodi:<br><br>5.1. broj deonica koje će biti puštene u emisiju;<br><br>5.2. predloženu cenu ili metodu za određivanje cene; i<br><br>5.3. period i postupke za ostvarivanje prečeg prava, pod uslovom da ovaj period ne iznosi manje od dvadeset jedan (21) dan. Sva pravila i postupci kojima se uređuje ostvarivanje prava preče kupovine treba da su jednaka za sve deoničare koji ova prava ostvaruju. |
| 6. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në statutin e Shoqërisë Aksionare, rregullat mbi të drejtat e përparësisë nuk do të aplikohen për sa vijon:<br><br>6.1. emetimi i aksioneve të privilegjuara, përveç aksioneve të privilegjuara të cilat mund të konvertohen në aksione të thjeshta ose që e kanë të drejtën për blerjen e aksioneve të thjeshta; | 6. Unless the Charter of the Joint Stock Company provides otherwise, the rules on preemptive rights shall not apply to the following:<br><br>6.1. the issuance of the preferred shares, except for preferred Shares which are convertible to common Shares or which have the right to acquire common Shares; | 6. Izuzev ukoliko statut deoničarskog društva propisuje drukčije, pravila o pravu preče kupovine ne važe u sledećim slučajevima:<br><br>6.1. emisija preferencijalnih deonica, sem preferencijalnih deonica koje se mogu konvertovati u obične deonice ili koje nose pravo kupovine običnih deonica; |

| | | |
|---|---|---|
| 6.2. cilado aksione të autorizuara në statutin e Shoqërisë Aksionare që janë emetuar brenda gjashtë muajve pas regjistrimit fillestar të Shoqërisë Aksionare;<br><br>6.3. cilado aksione të emetuara në relacion me Skemën e Aksioneve të Punëtorëve të miratuar sipas kërkesave të këtij ligji; dhe<br><br>6.4. aksionet e emetuara në relacion me Skemën e Aksioneve të Punëtorëve të miratuar sipas kërkesave të këtij ligji. | 6.2. whichever authorized Shares in the Charter of the Joint Stock Company which have been issued within six months after the initial registration of the Joint Stock Company;<br>6.3. whichever issued Shares in relation to an Employee Share Scheme adopted in accordance with the requirements of this law; and<br><br>6.4. Shares issued in relation to an Employee Share Scheme adopted in accordance with the requirements of this Law. | 6.2. svih deonica ovlašćenih statutom deoničarskog društva u emisiji u roku od šest meseci od prve registracije deoničarskog društva;<br><br>6.3. svih deonica u emisiji u vezi sa Šemom deonica zaposlenih, usvojenih u skladu sa zahtevima ovog zakona; i<br><br>6.4. deonice u emisiji u vezi sa Šemom deonica zaposlenih usvojenih shodno zahtevima ovog zakona. |
| 7. Aksionet që i nënshtrohen të drejtës së përparësisë dhe që nuk janë blerë nga aksionarët ekzistues sipas kësaj të drejte, mund t'i emetohen cilitdo person pas një periudhe një (1) vjeçare pasi që këto aksione u janë ofruar aksionarëve ekzistues sipas këtij neni. Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë Aksionare do të përcaktojë çmimin emetues që nuk duhet të jetë më i ulët se 90% e çmimit që paraprakisht është caktuar për ushtrimin e të drejtave të përparësisë. Nëse Bordi i Drejtorëve dëshiron të emetojë aksione për një çmim më të ulët apo të emetojë aksione pas skadimit të periudhës një vjeçare, atëherë e drejta e përparësisë e përcaktuar në këtë nen zbatohet plotësisht. | 7. Shares subject to preemptive rights that have not been acquired by existing Shareholders pursuant to such rights may be issued to any person within a period of one (1) year after these Shares have been offered to the existing Shareholders in accordance with this Article. The board of directors of the Joint Stock Company shall establish the issue price which must not be lower than 90% of the price previously established for the exercise of preemptive rights. If the board of directors wishes to issue Shares for a lower price or to issue Shares after the expiry of the one year period, then the preemptive rights provided for in this Article shall apply in full | 7. Deonice koje podlažu pravu preče kupovine koje postojeći deoničari nisu kupili shodno ovom pravu, mogu se izdati bilo kom licu nakon jednogodišnjeg (1) perioda, nakon što su ove deonice ponuđene postojećim deoničarima shodno ovom članu. Odbor direktora deoničarskog društva propisuje emisionu cenu koja ne sme da bude niža od 90% cene koja je prethodno određena za ostvarivanje prava preče kupovine. Ukoliko odbor direktora želi da pusti u emisiju deonice po nižoj ceni ili nakon isteka jednogodišnjeg perioda, pravo preče kupovine, propisano ovim članom, sprovodi se u celosti. |

| Neni 144<br>**Kufizimet në Transferimin e Aksioneve** | Article 144<br>**Restrictions in Share Transfer** | Član 144<br>**Ograničenja na prenos deonica** |
|---|---|---|
| Korporata mund të vendosë kufizime për transferimin e aksioneve të Korporatës duke përfshirë kufizime të llojit të referuara në nenet 88, 89, 90 të këtij ligji. Çdo kufizim i tillë duhet të përcaktohet në statutin e Korporatës. | A Corporation may establish restrictions on transfers of Shares of the Corporation, including restrictions of type specified in Articles 88, 89, 90 of this Law. Any such restriction shall be provided for in the Charter of the Corporation. | Korporacija može doneti ograničenja na prenos deonica korporacije, uključujući ograničenja u vrsti propisana članovima 88, 89, 90. ovog zakona. Svako ograničenje tog tipa treba propisati statutom korporacije. |
| **KAPITULLI IV<br>KAPITALI THEMELTAR** | **CHAPTER IV<br>CHARTER CAPITAL** | **POGLAVLJE IV<br>OSNOVNI KAPITAL** |
| **Neni 145<br>Shuma, Parapagimi dhe Pagimi; Raporti me Vlerën Nominale** | **Article 145<br>Amount, Subscription and Payment; Relationship to Par Value** | **Član 145<br>Iznos, pretplata i uplata; odnos prema nominalnoj vrednosti** |
| 1. Kapitali themeltar paraqet shumën minimale që është në dispozicion për përmbushjen e kërkesave të kreditorëve. | 1.Charter Capital represents the minimum amount that is available for the satisfaction of the creditor claims. | 1. Osnovni kapital predstavlja minimalni iznos na raspolaganju za namirivanje potraživanja poverilaca. |
| 2. Kapitali Themeltar fillestar i një Shoqërie Aksionare është, cilado që është më e madhe: | 2. The Charter Capital of a Joint Stock Company is, whichever is greater: | 2. Osnovni kapital deoničarskog društva iznosi, šta god da je veće: |
| 2.1. Dhjetë mijë (10,000) Euro; ose<br>2.2. shuma e përgjithshme e vlerës nominale të të gjitha aksioneve, të emetuara nga Shoqëria Aksionare në kohën e regjistrimit fillestar në ARBK. | 2.1Ten thousand (10,000) Euros; or<br>2.2. the total amount of the par value of all the Shares issued by the Joint Stock Company at the time of its initial registration at KBRA. | 2.1. deset hiljada (10,000) evra; ili<br>2.2. ukupan iznos nominalne vrednosti svih deonica, koje je deoničarsko društvo izdalo u vreme prve registracije pri KARP-u. |
| 3. Nëse me ligj të veçantë përcaktohet ose shprehimisht lejohet një autoritet publik që të përcaktojë një kapital më të madh | 3. If a special law establishes or expressly authorizes a public authority to establish a higher charter capital for banks, financial | 3. Ukoliko se posebnim zakonom propiše ili izričito dozvoli javnom organu da propiše veći osnovni kapital za banke, |

| | | |
|---|---|---|
| themeltar për banka, institucione financiare apo institucione të sigurimeve atëherë dispozitat e ligjit të veçantë mbizotërojnë. | institutions or insurance institutions, the provisions of that special law shall prevail. | finansijske institucije ili institucije obezbeđenja, onda imaju prednost odredbe posebnog zakona. |
| 4. Shoqëria Aksionare mund të emetojë aksione me vlerë më të madhe në vlera nominale, me ç'rast shuma e tepërt nuk është kapital themeltar por do të jetë premium i aksionit i cili regjistrohet nga Shoqëria Aksionare në llogarinë e premiumeve të Shoqërisë Aksionare. Shoqëria Aksionare nuk mund të emetojë aksione vlera e të cilave është më e ulët se vlera nominale. | 4. A Joint Stock Company may issue Shares of higher value in par value, in which case the excess amount shall not be charter capital but shall be a Share premium which is registered by the Joint Stock Company in a Share premium account of the Joint Stock Company. A Joint Stock Company may not issue a Share, the value of which is lower than its par value. | 4. Deoničarsko društvo može izdavati deonice velike nominalne vrednosti, i u tom slučaju višak vrednosti ne čini osnovni kapital već premiju na deonicu registrovanu od strane deoničarskog društva na račun premija deoničarskog društva. Deoničarsko društvo ne može izdavati deonice vrednosti manje od nominalne. |
| 5. Nuk mund të bëhet asnjë ofertë publike për aksionet e Shoqërisë Aksionare përderisa të mos jetë paguar në tërësi kapitali themeltar. Asnjë aksionar nuk mund të lirohet nga detyrimi për të paguar aksionin, përveç përmes procedurave dhe rregullave që kanë të bëjnë me zvogëlimin e kapitalit. | 5. No public offering of the Shares of a Joint Stock Company may be made until the Charter Capital has been fully paid. No Shareholder may be released from the obligation to pay for Shares except via the procedures and rules relating to a decrease of capital. | 5. Ne može se davati nikakva javna ponuda za deonice deoničarskog društva sve dok osnovni kapital ne bude uplaćen u celosti. Nijedan deoničar ne može se osloboditi obaveze da plati deonicu, sem postupcima i pravilima koja uređuju smanjenje kapitala. |
| **Neni 146**<br>**Rritja e Kapitalit Themeltar** | **Article 146**<br>**Increase of Charter Capital** | **Član 146**<br>**Porast osnovnog kapitala** |
| 1 Shoqëria Aksionare mund ta rrisë kapitalin e saj themeltar përmes ndryshimit të statutit në pajtim me këtë ligj. Shoqëria Aksionare mund ta rrisë kapitalin themeltar përmes: | 1. A Joint Stock Company may increase its charter capital by amending its charter in accordance with this law. The Joint Stock Company may increase its charter capital by: | 1. Deoničarsko društvo može povećati svoj osnovni kapital izmenom statuta u skladu sa ovim zakonom. Deoničarsko društvo može podići osnovni kapital: |
| 1.1. ndryshimit të mëtejmë të statutit | 1.1. further amending the charter to | 1.1.daljom izmenom statuta o |

| | | |
|---|---|---|
| për rritjen e vlerës të caktuar nominale të aksioneve të thjeshta dhe/ose një ose më shumë nga kategoritë e aksioneve të privilegjuara, nëse ajo është e autorizuar të emetojë aksione të privilegjuara; ose | increase the specified par value of its common Shares and/or one or more classes of its preferred Shares, if it is authorized to issue such preferred Shares, or | podizanju određene nominalne vrednosti običnih deonica i/ili jedne ili više iz kategorija preferencijalnih deonica, ukoliko je ovlašćena da izdaje preferencijalne deonice; ili |
| 1.2. emetimit të aksioneve shtesë, në bazë të numrit maksimal të përcaktuar në statut, për kompensim të ligjshëm dhe adekuat. Shoqëria Aksionare mund ta rritë kapitalin e saj themeltar vetëm pasi që kapitali themeltar fillestar të jetë paguar në tërësi. | 1.2. by issuing additional Shares, subject to the authorized maximum number specified in the Charter, for lawful and adequate compensation. A Joint Stock Company may increase its charter capital only after the initial charter capital has been fully paid. | 1.2.izdavanjem dodatnih deonica, na osnovu maksimalnog broja propisanog statutom, za zakonitu i adekvatnu naknadu. Deoničarsko društvo može podići iznos svog osnovnog kapitala nakon što osnovni kapital bude isplaćen u celosti. |
| 2. Vlera nominale e aksioneve të emetuara mund të rritet pa e bërë rritjen gjegjëse të kompensimit nga aksionarët, nëse ka kapital të mjaftueshëm në llogarinë premisë të aksionit. Llogaria e premisë së aksionit të Shoqërisë Aksionare pastaj reduktohet në mënyrë proporcionale me rritjen e vlerës nominale të aksioneve përkatëse. | 2. The par value of issued Shares may be increased without corresponding increase of consideration from Shareholders provided there is sufficient capital in the Share premium account. The Share premium account of the Joint Stock Company shall then be reduced by an amount that is equivalent to the increase in the par value of the concerned Shares. | 2. Nominalna vrednost izdatih deonica može se podići bez podizanja odnosne naknade deoničara, ukoliko postoji dovoljan kapital na računu premije deonice. Račun premije deonice deoničarskog društva zatim se smanjuje srazmerno sa porastom nominalne vrednosti odnosnih deonica. |
| 3. Varësisht nga kufizimet dhe kushtet e përcaktuara në statut, vendimet që kanë të bëjnë me emetimin e aksioneve shtesë dhe/ose përcaktimi i numrit, kohës dhe kushteve të tjera të emetimit, mund të bëhet vetëm nga aksionarët e Shoqërisë Aksionare, përveç dhe deri në shkallën sa me statut shprehimisht ky autorizim lejohet | 3. Subject to the limitations and conditions established in the Charter, decisions relating to the issuance of additional Shares and/or the determination of the number, time and other conditions of such issuance, may be made only by the Shareholders of the Joint Stock Company, unless and except to the extent that the | 3. U zavisnosti od ograničenja i uslova propisanih statutom, odluke u vezi sa emisijom dodatnih deonica i/ili određivanjem broja, vremena i drugih uslova za izdavanje, mogu doneti samo deoničari deoničarskog društva, osim i do stepena u kome statut izričito za to ovlašćuju odbor direktora. Ukoliko statut |

| | | |
|---|---|---|
| që të ushtrohet nga Bordi i Drejtorëve. Nëse në statut kërkohet që aksionarët së pari të miratojnë një vendim i cili e autorizon Bordin e Drejtorëve që të emetojë aksione shtesë, atëherë autorizimi i dhënë në bazë të vendimit, sipas veprimit të ligjit, skadon një vit nga data e miratimit të vendimit, përveç nëse në vendim përcaktohet një kohë më e shkurtër për skadimin e këtij autorizimi. Ky autorizim mund të vazhdohet një ose më shumë herë nga aksionarët. Kur ky autorizim bartet në Bordin e Drejtorëve sipas një vendimi të aksionarëve, atëherë do të mbahet edhe një votimi ndarë nga të gjitha kategoritë e aksionarëve të cilët preken nga emetimi. | Charter specifically confers such authority on the board of directors. If the Charter requires the Shareholders to first adopt a decision which authorizes the board of directors to issue such additional Shares, the authorization provided by this decision shall, by law, expire within one year from the date the decision was adopted, unless the decision established a shorter period for the expiration of the authorization. This authorization may be renewed one or more times by the Shareholders. When this authorization is conferred to the Board of Directors by the decision of the Shareholders, there shall be a separate Shareholder vote for each class of Shareholders affected by the issuance. | propisuje da su deoničari dužni da prvo usvoje odluke kojom ovlašćuju odbor direktora da izda dodatne deonice, ovlašćenje dato odlukom, u skladu sa zakonom na snazi, ističe godinu dana od dana usvajanja odluke, izuzev ukoliko sama odluka propisuje kraći rok za istek ovog ovlašćenja. Deoničari mogu produžiti ovo ovlašćenje jednom ili u nekoliko navrata. Kada se ovo ovlašćenje prenese na odbor direktora, shodno odluci deoničara, održava se odvojeno glasanje svih kategorija deoničara pogođenih datim izdavanjem deonica. |
| 4. Nëse aksionet plotësuese nuk janë parapaguar në tërësi, kapitali i aksioneve duhet të rritet nga vlera e parapagimit të pranuar, por vetëm nëse shprehimisht është paraparë dhe lejuar në kushtet emetimit. | 4. If the additional Shares are not fully subscribed, the Share capital shall be increased only by the amount of the subscriptions actually received, but only if this was specifically foreseen and permitted by the conditions of issue. | 4. Ukoliko dopunske deonice nisu u celosti uplaćene, akcioni kapital treba povećati za vrednost primljene pretplate, međutim samo ukoliko je to izričito predviđeno i dozvoljeno uslovima za izdavanje deonica. |
| 5. Asnjë rritje e numrit të aksioneve të autorizuara ose e vlerës nominale të aksioneve të autorizuara ose të emetuara nuk mund të bëhet pa ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Shoqërisë Aksionare që është miratuar në mënyrë të rregullt nga aksionarët. Ky ndryshim dhe plotësim hyn në fuqi vetëm pas regjistrimit dhe publikimit nga ARBK sipas paragrafit 4 te | 5. No increase in the number of authorized Shares or in the par value of authorized or issued Shares shall be made without a prior amendment to Charter of the Joint Stock Company that has been duly adopted and approved by the Shareholders. Such an amendment shall be effective only upon registration and publication by KBRA in accordance with paragraph 4 of | 5. Ne može se načiniti nikakav porast u broju ovlašćenih deonica ili nominalne vrednosti ovlašćenih ili izdatih deonica bez izmene i dopune statuta deoničarskog društva, koga su deoničari usvojili u redovnom postupku. Ova izmena i dopuna stupa na snagu tek po registraciji i objavljivanju u KARP-u shodno stavu 4, člana 41. i člana 22. ovog zakona. |

| | | |
|---|---|---|
| nenit 41 dhe nenit 22 të këtij ligji.<br><br>6. Nëse me ligj të veçantë i cili i rregullon bankat, institucionet financiare dhe/ose ato të sigurimeve shprehimisht përcaktohen procedura dhe rregulla të tjera për ndryshimin e kapitalit themeltar të këtyre institucioneve, atëherë për këto institucione zbatohen rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin e veçantë.<br><br>7. Nenet 140–145 të këtij ligji do të aplikohen *mutatis mutandis*.<br><br>**Neni 147**<br>**Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**<br><br>1. Varësisht nga minimumi i përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 145 të këtij ligji dhe, sipas rastit, të paragrafit 3 të po atij neni, një Shoqëri Aksionare mund ta zvogëlojë kapitalin e saj themeltar përmes ndryshimit dhe plotësimit të statutit të saj sipas këtij ligji. Shoqëria Aksionare mund ta bëjë zvogëlimin me:<br><br>1.1. ndryshimin dhe plotësimin e statutit për të zvogëluar vlerën nominale të aksioneve të saj të thjeshta dhe/ose një ose me shumë llojeve të aksioneve të saj të privilegjuara; ose<br><br>1.2. përmes riblerjes dhe anulimit të | Article 41 and Article 22 of this Law.<br><br>6. If a special law governing banks, financial and/or insurance institutions specifically establishes other procedures and rules governing changes to the charter capital of such institutions, such special procedures and rules established by the special law shall be applicable for such institutions.<br><br>7. Articles 140 – 145 of this Law shall apply *mutatis mutandis.*<br><br>**Article 147**<br>**Decrease of Charter Capital**<br><br>1. Subject to the minimum specified in paragraphs 1 and 2 of Article 145 of this Law, and if applicable, paragraph 3 of the same Article, a Joint Stock Company may decrease its charter capital by amending its charter in accordance with this law. The Joint Stock Company may make the decrease by:<br><br>1.1. amending the Charter to decrease the par value of its common Shares and/or one or more classes of its preferred Shares; or<br><br>1.2. by reacquiring and then | <br><br>6. Ukoliko poseban zakon koji uređuje banke, finansijske i/ili institucije za obezbeđenje propiše izričito postupke i druga pravila za izmenu osnovnog kapitala ovih institucija, onda na ove institucije važe pravila i postupci propisani posebnim zakonom.<br><br>7. Članovi 140 – 145 ovog zakona važe *mutatis mutandis*.<br><br>**Član 147**<br>**Smanjenje osnovnog kapitala**<br><br>1. U zavisnosti od minimuma propisanog stavovima 1 i 2 člana 145. ovog zakona i, po potrebi, stavom 3 istog člana, deoničarsko društvo može smanjiti svoj osnovni kapital izmenom i dopunom svog statuta, u skladu sa ovim zakonom. Deoničarsko društvo može izvršiti smanjenje:<br><br>1.1.izmenom i dopunom statuta, kojom smanjuje nominalnu vrednost svojih običnih deonica i/ili jedne ili više vrsta svojih preferencijalnih deonica; ili<br><br>1.2.otkupom i poništavanjem |

| | | |
|---|---|---|
| Bordit të Drejtorëve, mund të blejë një numër më të madh të aksioneve, deri në numrin e përgjithshëm të ofruar për shitje nga aksionarët. | directors may acquire a larger number of shares up to the total number offered for sale by the shareholders. | direktora može da otkupi veći broj deonica do opšteg broja ponuđenog na otkup od strane deoničara. |
| 3. Nëse numri i përgjithshëm i aksioneve të cilat i ofrohen për shitje Shoqërisë Aksionare e tejkalon numrin e aksioneve që Shoqëria Aksionare do ti blejë, Shoqëria Aksionare do të blejë aksione nga secili aksionar në proporcion me numrin e aksioneve të cilin aksionari ka ofruar ta shesë, përveç kur është e nevojshme që të evitohet blerja e aksioneve të përgjysmuara (në fraksione). | 3. If the total number of shares offered for sale to the Joint Stock Company exceeds the number of shares that the Joint Stock Company will acquire, the Joint Stock Company shall acquire shares from each shareholder in proportion to the number of shares that that shareholder offers for sale, except where necessary to avoid acquiring fractional shares. | 3. Ukoliko je ukupni broj deonica koje budu ponuđene na otkup deoničarskom društvu veći od broja deonica koje je deoničarsko društvo ponudilo da otkupi, deoničarsko društvo će otkupiti od svakog deoničara u srazmeri sa brojem deonica koji je deoničar ponudi ona otkup, izuzev kada je neophodno izbeći otkup delimičnih deonica (u delovima). |
| **Neni 155**<br>**Statusi i Aksioneve të Riblera** | **Article 155**<br>**Status of Reacquired Shares** | **Član 155**<br>**Status otkupljenih deonica** |
| 1. Aksionet e ri-blera nga Shoqëria Aksionare janë në pronësi të Shoqërisë Aksionare dhe mund t'u emetohen palëve të treta sipas këtij ligji, përveç dhe përderisa ato të jenë anuluar, dhe numri i aksioneve të lejuara dhe kapitali themeltar të jenë zvogëluar respektivisht, përmes një ndryshimi dhe plotësimi të statutit të Shoqërisë Aksionare. | 1. Shares reacquired by a Joint Stock Company are owned by the Joint Stock Company and may be reissued to third parties by the Joint Stock Company in accordance with the present Law, until and unless they are cancelled and the number of authorized shares and the charter capital accordingly reduced, by amendment of the Joint Stock Company's charter. | 1. Deonice koje deoničarsko društvo otkupi su u vlasništvu deoničarskog društva i ne mogu se emitovati trećim stranama prema ovom zakonu, izuzev i sve dok su iste poništene i broj dozvoljenih deonica i osnivački kapital smanjeni srazmerno, kroz izmenu i dopunu statuta deoničarskog društva. |
| 2. Gjatë kohës sa këto aksione janë në pronësi të Shoqërisë Aksionare: | 2. While such shares are owned by the Joint Stock Company: | 2. Tokom vremena dok su deonice u vlasništvu deoničarskog društva: |
| 2.1. ato nuk kanë të drejtë vote dhe nuk do të numërohen me qëllim të | 2.1. they will not be entitled to vote or be counted toward a quorum in a | 2.1. iste nemaju pravo glasa i neće biti brojane u cilju postizanja |

| | | |
|---|---|---|
| arritjes së kuorumit në kuvendin e aksionarëve;<br><br>2.2. nuk kanë të drejtë të pranojnë dividenda ose shpërndarje tjera ose të numërohen gjatë llogaritjes së vlerës për secilin aksion të dividendave ose shpërndarjeve të tjera në të cilat kanë të drejtë aksionarët.<br><br>3. Çdo aksion i blerë në kundërshtim me nenin 152 dhe 153 të këtij ligji brenda një viti pas blerjes ose:<br><br>3.1 do të shitet; ose<br><br>3.2 do të anulohet, sipas cilës do procedurë të zbatueshme për zbritjen e kapitalit të Shoqërisë Aksionare.<br><br>**Neni 156**<br>**Kufizimet në Pagimin e Dividendave dhe Pagesat për Blerjen e Aksioneve të Veta**<br><br>1. Shoqëria Aksionare nuk mund të paguajë një dividendë në aksionet e thjeshta ose të privilegjuara, dhe nuk mund të paguajë ndonjë shumë për blerjen e aksioneve të veta apo mundësitë për blerjen e aksioneve ose letrave me vlerë të konvertueshme në aksione, ose të bëjë çfarëdo shpërndarje të aksionarëve në cilësinë e tyre si aksionarë, nëse: | shareholder assembly;<br><br>2.2. they will not be entitled to receive dividends or other distributions or to be counted in calculating the per-share amount of any dividends or other distributions to which shareholders are entitled.<br><br>3. Any shares acquired in breach of Articles 152 and 153 of this Law shall, within one year of their acquisition either:<br><br>3.1. be disposed of; or<br><br>3.2. cancelled by following any applicable procedures regarding a decrease in the Joint Stock Company's capital.<br><br>**Article 156**<br>**Restrictions on Distributions and Payments for Acquisition of Own Stock**<br><br>1. A Joint Stock Company may not pay a dividend on its common or preferred stock, and may not pay any amount to acquire any of its stock or any options to acquire its stock or securities convertible into its stock, or undertaken any other distribution to shareholders in their capacity of shareholders, if either: | kvoruma na skupštini deoničara;<br><br>2.2. nemaju pravo da primaju dividende ili druge raspodele ili biti brojane tokom računanja vrednosti svake deonice dividendi ili drugih raspodela na koja deoničari imaju pravo.<br><br>3. Svaka deonica otkupljena u suprotnosti sa članovima 152. i 153. ovog zakona u roku od jedne godine nakon kupovine će:<br><br>3.1. biti prodata; ili<br><br>3.2. poništena u skladu sa primenjivim postupkom za smanjenje kapitala deoničarskog društva.<br><br>**Član 156**<br>**Ograničenja za isplatu dividendi i isplate za otkup sopstvenih deonica**<br><br>1. Deoničarsko društvo ne može isplatiti dividendu na obične ili privilegovane deonice i ne može isplatiti određeni iznos za otkup sopstvenih deonica, mogućnosti za otkup deonica ili hartija od vrednosti koje se mogu preobratiti u deonice ili izvršiti bilo kakvu raspodelu deonica u njihovom svojstvu kao deoničari ukoliko: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. pas kryerjes së pagesës, asetet neto të Shoqërisë Aksionare janë më të vogla se shuma e parapaguar dhe e paguar e kapitalit themeltar të Shoqërisë Aksionare, i cili për këtë qëllim përfshin edhe shumat e paguara në llogarinë e premiumeve të Shoqërisë Aksionare, nëse ka të tillë, plus çfarëdo rezerva që nuk mund t'iu shpërndahen aksionarëve sipas ligjit ose statutit të Shoqërisë Aksionare; ose | 1.1. after giving effect to the payment, the net assets of the Joint Stock Company would be less than the sum of the Joint Stock Company's subscribed and paid in charter capital, which for this purpose includes paid-in amounts in the joint stock company's share premium account, if any, plus any reserves which may not be distributed to shareholders under law or the Joint Stock Company's charter; or | 1.1 nakon izvršenja isplate, neto imovina deoničarskog društva je manja od pretplaćenog i isplaćenog iznosa osnivačkog kapitala deoničarskog društva, koje za ove svrhe obuhvata i plaćene iznose na račun premija deoničarskog društva, ukoliko takve postoje, bilo kakve rezerve koje se ne mogu raspodeliti deoničarima prema zakonu ili statutu deoničarskog društva; ili |
| 1.2. Pas kryerjes së pagesës, asetet totale të Shoqërisë Aksionare janë më të vogla se detyrimet e Shoqërisë Aksionare ose nuk është në gjendje për t'i paguar borxhet ose detyrimet e tjera në afat përderisa ato maturohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së zakonshme ekonomike të Shoqërisë Aksionare; ose | 1.2. after giving effect to the payment, total assets of the Joint Stock Company are lesser than the liabilities of the Joint Stock Company, or the company would be insolvent or unable to pay its debts and other obligations as they become due in the ordinary course of the Joint Stock Company's business activities; or | 1.2. Nakon izvršenja isplate, ukupna imovina deoničarskog društva je manja od obaveza deoničarskog društva ili nije u stanju da isplati svoja dugovanja ili druge obaveze u roku sve dok iste dospevaju tokom obavljanja uobičajene privredne delatnosti deoničarskog društva; ili |
| 1.3. pagesa e tejkalon shumën e fitimeve të Shoqërisë Aksionare në vitin paraprak fiskal plus përfitimet tjera të sjellura më parë dhe shumat e nxjerra nga rezervat që janë në dispozicion për këtë qëllim, minus të gjitha humbjeve të sjellura më parë dhe shumave të nxjerra nga rezervat | 1.3. the payment would exceed the amount of the Joint Stock Company's profits in the immediately preceding financial year plus any profits brought forward and sums drawn from reserves available for this purpose, | 1.3. isplata je veća od profita deoničarskog društva u prethodnoj fiskalnoj godini plus drugi profit koji je stečen ranije i iznos izveden iz rezervi koje su na raspolaganju za ove svrhe, minus svi gubici koji su ranije stečeni i iznosi izvedeni iz |

| | | |
|---|---|---|
| sipas këtij ligji ose statutit të Shoqërisë Aksionare. | less any losses brought forward and sums placed in reserves in accordance with the present law or the Joint Stock Company's charter. | rezervi prema ovom zakonu ili statutu deoničarskog društva. |
| 2. Vendimi për pagimin e dividendës sipas këtij neni duhet të bazohet në pasqyrat financiare të përgatitura në pajtim me ligjet e zbatueshme mbi standardet e kontabilitetit dhe me parimet e kontabilitetit që janë të arsyeshme sipas rrethanave dhe, në rast të vlerësimit të aseteve jo-monetare, në një vlerësim të pavarur dhe të drejtë që është i arsyeshëm sipas rrethanave. Në rast të dividendeve të përkohshme, duhet të përgatiten pasqyra të përkohshme financiare. | 2. A determination for the payment of a dividend under this Article must be based on financial statements prepared in accordance with applicable laws on accounting standards and on accounting principles that are reasonable in the circumstances and, in the case of valuation of non-monetary assets, on a fair and independent valuation that is reasonable under the circumstances. In the case of interim dividends, interim financial statements should be prepared. | 2. Odluka za isplatu dividende prema ovom članu mora da bude zasnovana na finansijskim izveštajima koji su izrađeni u skladu sa primenjivim standardima računovodstva i načelima računovodstva koja su opravdana prema okolnostima i, u slučaju ocene ne novčane imovine, nezavisnoj i pravičnoj oceni koja je opravdana u okolnostima. U slučaju privremenih dividendi, treba pripremiti privremene finansijske izveštaje. |
| **Neni 157**<br>**Përgjegjësia Personale e Aksionarëve dhe Drejtorëve për Pagimin e Dividendave të Ndaluara** | **Article 157**<br>**Personal Liability of Shareholders and Directors for Prohibited Payments of Dividends** | **Član 157**<br>**Lična odgovornost deoničara i direktora za isplatu zabranjenih dividendi** |
| 1. Aksionari që pranon një dividendë të ndaluar dhe i cili në atë kohë ka qenë në njohuri se dividenda ka qenë e ndaluar apo ka mundur të dijë në bazë të informacionit të kuptueshëm dhe në dispozicion, është personalisht përgjegjës ndaj Shoqërisë Aksionare për kthimin e shumës së dividendës. | 1. A shareholder who receives a prohibited dividend and who knew at the time that such dividend was prohibited or could have been assumed to know by virtue of readily available and understandable information, shall be personally liable to the Joint Stock Company for return of the amount of the dividend. | 1. Deoničar koji primi zabranjenu raspodelu i koji u to vreme bio upoznat da je dividenda bila zabranjena ili je mogao da zna na osnovu lako dostupne i razumne informacije, snosi ličnu odgovornost prema deoničarskom društvu za povraćaj iznosa dividende. |
| 2. Drejtorët e Shoqërisë Aksionare që kanë votuar ose e kanë lejuar dividendën e | 2. The directors of a Joint Stock Company who vote for or assent to any prohibited | 2. Direktori deoničarskog društva koji su glasali ili dozvolili zabranjenu raspodelu |

| | | |
|---|---|---|
| ndaluar janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës ndaj Shoqërisë Aksionare për shumën e dividendës. | dividend shall be jointly and severally liable to the Joint Stock Company for the amount of the distribution. | snose zajedničku i individualnu odgovornost prema deoničarskom društvu za iznos dividende. |
| **Neni 158**<br>**Shoqëria nuk duhet të Financojë Blerjen e Letrave të Veta me Vlerë** | **Article 158**<br>**Company not to Finance Acquisition of its Own Securities** | **Član 158**<br>**Društvo ne treba da finansira otkup sopstvenih hartija od vrednosti** |
| 1. Një Shoqëri Aksionare nuk mund të jap hua ose çfarëdo lloj kredie, duke përfshirë pengun e aksioneve të veta me të cilat disponon, ndonjë personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqërie Tregtare me qëllim të krijimit të mundësisë atij personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqërie Tregtare për t'i blerë ose përvetësuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, qoftë nga Shoqëria Aksionare ose një palë e tretë, ndonjë aksion apo letër me vlerë të Shoqërisë aksionare. | 1. A Joint Stock Company may not lend or provide money or any type of credit, including pledging its own shares which it is holding, to any natural or legal person and/or Business Organization for the purpose of enabling that natural or legal person and/or Business Organization to purchase or acquire, directly or indirectly, whether from the Joint Stock company or a third party, any share of stock or other security of the Joint Stock Company. | 1. Deoničarsko društvo neće davati zajam ili bilo kakvu vrstu kredita, uključujući i zalog sopstvenih deonica sa kojima raspolaže, fizičkom ili pravnom licu i/ili poslovnom društvu u cilju stvaranja mogućnosti za to fizičko ili pravno lice i/ili poslovno društvo da kupi ili stekne, direktno ili indirektno, bilo od deoničarskog društva ili treće strane određenu deonicu ili druge hartije od vrednosti deoničarskog društva. |
| 2. Kjo ndalesë nuk do të zbatohet për transaksionet e lidhura nga bankat ose institucioneve tjera financiare në vazhdën e veprimtarisë së tyre të zakonshme ekonomike, dhe as për transaksionet që kanë të bëjnë me Skemën e Aksioneve të Punonjësve, me kusht që blerja të mos rezultojë në atë që net asetet të bëhen më të vogla se sa kapitali themeltar plus rezervat e pa-shpërndashme. | 2. This prohibition shall not apply to transactions concluded by banks and other financial institutions in the normal course of business activities, nor to transactions relating to an Employee Shares Scheme, provided that the acquisition would not lead to the net assets becoming less than the charter capital plus non-distributable reserves. | 2. Ova zabrana se ne primenjuje na povezane transakcije sklopljene sa bankama ili drugim finansijskim institucijama u okviru njihove uobičajene privredne delatnosti niti za transakcije koje se odnose na shemu deonica zaposlenih, pod uslovom da kupovina ne rezultuje time da neto imovina bude manja od osnovnog kapitala plus ne-raspodeljive rezerve. |
| 3. Shoqëria Aksionare nuk i pranon aksionet e veta si garanci për ndonjë detyrim që një person ose Shoqëri Tregtare | 3. A Joint Stock Company shall not accept its own shares as security for any obligation owed to the Joint Stock | 3. Deoničarsko društvo ne prihvata svoje deonice kao garanciju za bilo koju obavezu koju određeno lice ili deoničarsko ima |

| | | |
|---|---|---|
| e ka ndaj Shoqërisë Aksionare. | Company by another person or Business Organization. | prema deoničarskom društvu. |
| **KAPITULLI VI - BORDI I DREJTORËVE DHE ZYRTARËT** | **CHAPTER VI - BOARD OF DIRECTORS AND OFFICERS** | **POGLAVLJE VI - ODBOR DIREKTORA I SLUŽBENICI** |
| **Neni 159**<br>**Bordi i Drejtorëve** | **Article 159**<br>**Board of Directors** | **Član 159**<br>**Odbor direktora** |
| Çdo Shoqëri Aksionare duhet të ketë Bordin e Drejtorëve. Veprimtaria ekonomike e Shoqërisë Aksionare menaxhohet nga Bordi i Drejtorëve ose sipas udhëzimeve të Bordit të Drejtorëve sipas këtij Kapitulli. | Every Joint Stock Company shall have a board of directors. The business activity of a Joint Stock Company shall be managed by or under the direction of its board of directors as provided in this Chapter. | Svako deoničarsko društvo treba da ima odbor direktora. Privrednu delatnost deoničarskog društva rukovodi odbor direktora ili prema uputstvima odbora direktora kao što je propisano u ovom poglavlju. |
| **Neni 160**<br>**Kualifikimet e Drejtorëve** | **Article 160**<br>**Qualifications of Directors** | **Član 160**<br>**Kvalifikacije direktora** |
| Çdo drejtor duhet të jetë person fizik. Statuti i Shoqërisë Aksionare mund të përcaktojë kushtet tjera për kualifikimin e drejtorit. Drejtori nuk është e detyrueshme që të jetë banor i Kosovës, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në statutin e Shoqërisë Aksionare. Nuk është e nevojshme që Drejtori të jetë aksionar i Shoqërisë Aksionare, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në statutin e Shoqërisë Aksionare. | Every director shall be a natural person. A Joint Stock Company's charter may prescribe other requirements for qualification as a director. A director need not be a resident of Kosovo, unless the Joint Stock Company's charter so prescribes. A director need not be a shareholder of the Joint Stock Company unless the Joint Stock Company's charter so prescribes. | Svaki direktor treba da bude fizičko lice. Statut društva može propisati ostale uslove za kvalifikacije direktora. Nije obavezujuće da direktor bude stanovnik Kosova, izuzev ako to nije drugačije propisano u statutu deoničarskog društva. Nije neophodno da direktor bude deoničar deoničarskog društva, izuzev ako to nije drugačije propisano u statutu deoničarskog društva. |

| Neni 161<br>Kompensimi dhe Huatë për Drejtorët | Article 161<br>Compensation and loans to Directors | Član 161<br>Naknada i zajmovi za direktora |
|---|---|---|
| 1. Shoqëria Aksionare mund t'i paguajë pagën drejtorëve dhe t'i kompensojë shpenzimet e arsyeshme që ata i bëjnë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si drejtor të Shoqërisë Aksionare. Vendimi për pagë si dhe miratimi i shumës dhe kushteve kryesore mund të merret vetëm nga aksionarët. Kjo duhet të bëhet për çdo vazhdim ose ndryshim të kushteve të drejtorëve. | 1. A Joint Stock Company may pay compensation to directors and reimburse directors for their reasonable expenses in serving the Joint Stock Company as its directors. A decision to provide such compensation or reimbursement and approval of the amount and main conditions thereof may only be made by the shareholders. This shall be done for each renewal or change of the directors' terms. | 1. Društvo može da isplaćuje platu direktorima i nadoknadi opravdane troškove koje imaju zbog obavljanja svoje dužnosti kao direktora deoničarskog društva. Odluku o plati i odobrenje iznosa i glavnih uslova mogu doneti samo deoničari. Ovo se mora učiniti za svako produženje ili promenu uslova za direktore. |
| 2. Shoqëria Aksionare nuk mund t'i japë kredi ose hua një drejtori, me përjashtim të shumave minimale në lidhje me Veprimtarinë Ekonomike të Shoqërisë Aksionare, përveç nëse parashihet ndryshe me ligjin në fuqi. | 2. A Joint Stock Company may not extend a loan or credit to a director, excluding minimum amounts related to Business Activities of the Joint Stock Company, unless otherwise stated by applicable law. | 2. Deoničarsko društvo ne može da da kredit ili zajam jednom direktoru, izuzev minimalnih iznosa u vezi privredne delatnosti deoničarskog društva, osim ako je drugačije uređeno važećim zakonom. |
| 3. Paga dhe kompensimi i Drejtorëve të Bordit dhe zyrtarëve të tjerë të lartë të Shoqërisë Aksionare duhet të zbulohet në kuadër të raporteve vjetore të Shoqërisë Aksionare që dorëzohen sipas ligjit në fuqi për raportim financiar | 3. Wages and reimbursements of Board Directors and other senior officers of the Joint Stock Company shall be disclosed in annual reports of the Joint Stock Company, filed in compliance with applicable legislation on financial reporting. | 3. Plata i nadoknada direktora odbora i drugih viših službenika deoničarskog društva se treba objaviti u okviru godišnjih izveštaja deoničarskog društva, koja se dostavljaju prema zakonu na snazi o finansijskom izveštavanju. |

| Neni 162<br>Autoriteti dhe Kompetencat e Bordit të Drejtorëve | Article 162<br>Authority and Competence of the Board of Directors | Član 162<br>Ovlašćenja i nadležnost odbora direktora |
|---|---|---|
| 1. Kompetencat e Bordit të Drejtorëve përfshijnë marrjen e vendimeve mbi të gjitha çështjet përveç vendimeve të cilat u janë rezervuar aksionarëve me ligj ose me statutin e Shoqërisë Aksionare. Duke marrë parasysh rezervimet e lartpërmendura, çështjet në vijim që bien nën fushëveprimin e Bordit të Drejtorëve: | 1. The competence of a board of directors shall include making decisions on all matters except decisions which are reserved for the shareholders by law or by the Joint Stock Company's charter. Subject to such reservations, the following matters are included within the exclusive competence of the board of directors: | 1. Nadležnost odbora direktora obuhvata donošenje odluka o svim pitanjima osim odluke koje su zakonom ili statutom deoničarskog društva rezervisane za deoničare. Uzimajući u obzir gore navedene rezerve, sledeća pitanja su isključiva nadležnost odbora direktora: |
| 1.1. miratimi i planeve gjithëpërfshirëse afariste strategjike të Shoqërisë Aksionare, kontrollet e brendshme, auditimin, si dhe procedurat e menaxhimit të riskut; | 1.1. approving overall business strategy plans for the Joint Stock Company, its internal control, audit and risk management procedures; | 1.1. usvajanje sveobuhvatnih strateških planova poslovanja deoničarskog društva, njegove kontrole, revizije i procedure upravljanja rizikom; |
| 1.2. thirrja e kuvendeve vjetore dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve; | 1.2.convening annual and extraordinary shareholder assembly sessions; | 1.2. sazivanje godišnjih i vanrednih sednica deoničara; |
| 1.3. përgatitja e agjendës fillestare të kuvendit të aksionarëve; | 1.3. preparing the initial agenda of a shareholder assembly; | 1.3. pripremanje početnog dnevnog reda za sednice deoničara; |
| 1.4. përcaktimi i datës për listën e aksionarëve që kanë të drejtë të marrin pjesë në kuvendin e aksionarëve; | 1.4. determining the record date for the list of shareholders entitled to participate in a shareholder assembly; | 1.4. utvrđivanje datuma za spisak deoničara koji imaju pravo da učestvuju na sednici deoničara; |
| 1.5. emetimi i aksioneve brenda kufizimeve të përcaktuara në statutin e Shoqërisë Aksionare apo në vendimet e aksionarëve për secilin | 1.5. issuance of shares within the limits stated in the Joint Stock Company's charter or by shareholder decision for each type | 1.5. emisiju deonica u okviru granica utvrđenih u statutu deoničarskog društva ili odlukama deoničara za svaku vrstu i |

| | | |
|---|---|---|
| lloj dhe kategori të aksionit, kur autorizimi në fjalë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me statutin e Shoqërisë Aksionare apo me vendim të aksionarëve; | and class of shares, when that power is conferred on the board of directors in the Joint Stock Company's charter or by shareholder decision; | kategoriju deonice, kada je navedeno ovlašćenje dodeljeno odboru direktora u statutu društva ili odlukom deoničara; |
| 1.6. emetimi i bondeve, mundësive për blerjen e aksioneve dhe letrave tjera me vlerë, kur ajo kompetencë i është dhënë Bordit të Drejtorëve me Statut të Shoqërisë Aksionare apo me vendim të Aksionarëve; | 1.6. issuance of bonds, options to acquire shares and other securities, when that power is conferred on the board of directors in the Joint Stock Company's charter or by shareholder decision; | 1.6. emisiju menica, opcija za otkup deonica i drugih hartija od vrednosti, kada je to ovlašćenje preneto na odbor direktora u statutu deoničarskog društva ili odlukom deoničara; |
| 1.7. punësimi i zyrtarëve/menaxherëve të lartë të Shoqërisë Aksionare dhe miratimi i kushteve të marrëveshjeve ndërmjet menaxhmentit të lartë dhe Shoqërisë Aksionare; | 1.7. hiring officers/senior managers of the Joint Stock Company, approval of the terms of agreements between such senior managers and the Joint Stock Company, | 1.7. zapošljavanje službenika/menadžera deoničarskog društva i usvajanje uslova sporazuma između više uprave i deoničarskog društva; |
| 1.8. vendosja e kompensimit dhe kushtet tjera të marrëveshjes me auditorin e Shoqërisë Aksionare; | 1.8. determination of the remuneration of and other terms of agreements with the Joint Stock Company's auditor; | 1.8. odluka o nadoknadi i drugim uslovima sporazuma sa revizorom deoničarskog društva; |
| 1.9. përcaktimin e shumave dhe caktimin e datave të pagesës dhe procedurat për pagesën e dividendave; | 1.9. determining the amounts of and the record dates, payment dates and procedures for dividend payments; | 1.9. određivanje iznosa i utvrđivanju datuma isplate i postupka za isplatu dividendi; |
| 1.10. miratimi i raportit vjetor të Shoqërisë Aksionare, raportit të bilancit vjetor dhe vlerësimeve vjetore të fitimeve dhe të humbjeve të cilat pastaj do të dorëzohen tek aksionarët | 1.10. approval of the company's annual report, annual balance sheet and annual profit and loss account which shall then be submitted to the shareholders for approval; | 1.10. usvajanje godišnjeg izveštaja deoničarskog društva, godišnjeg bilansa i godišnjih ocena profita i gubitaka, koji se kasnije podnose deoničarima na usvajanje; |

| | | |
|---|---|---|
| për miratim; dhe<br><br>1.11. Nëse Shoqëria Aksionare ka arritur kufijtëe përcaktuar me ligjin në fuqi për raportimin financiar, Bordi i Drejtorëve angazhon auditor të jashtëm për të kryer auditimin e jashtëm të deklaratës financiare vjetore si dhe të librave e regjistrave të Shoqërisë Aksionare, si dhe raporti i auditimit i bashkëngjitet raportit vjetor të Shoqërisë Aksionare; si dhe<br><br>1.12. vendosja e të gjitha çështjeve tjera të cilat kanë të bëjnë me kompetencën ekskluzive të Bordit të Drejtorëve të përcaktuar në statutin e Shoqërisë Aksionare.<br><br>2. Çështjet që janë në kompetencën ekskluzive të Bordit të drejtorëve të Shoqërisë Aksionare nuk mund të barten ose të vendosen nga personat tjerë ose organet tjera të Shoqërisë Aksionare.<br><br>**Neni 163**<br>**Numri i Drejtorëve**<br><br>Numri i anëtareve në Bordin e Drejtorëve të Shoqërisë Aksionare duhet të përcaktohet në statutin e Shoqërisë Aksionare. Për një Shoqëri Aksionare me më pak se dhjetë (10) aksionarë, Bordi i | 1.11. If the Joint Stock Company reached the thresholds specified in the law in force on financial reporting, the Board of Directors shall engage an external auditor to perform an external audit of the annual financial statement as well as the books and records of the Joint Stock Company, and the audit statement shall be attached to the annual report of the Joint Stock Company; and<br>1.12. deciding any other matters which are referred to the exclusive competence of the board of directors in the Joint Stock Company's charter.<br><br>2. Matters within the exclusive competence of the board of directors may not be transferred to or decided by other persons or other bodies of the Joint Stock Company.<br><br>**Article 163**<br>**Number of Directors**<br><br>The number of members of a joint stock company's board of directors shall be stated in the Joint Stock Company's charter. For a Joint Stock Company with less than ten (10) shareholders, the board | 1.11.Ako je deoničarsko društvo dostiglo prag preciziran u važećem zakonu o finansijskom izveštavanju, Odbor direktora angažuje spoljnog revizora da izvrši spoljnu reviziju godišnjeg finansijskog izveštaja, kao i knjiga i spisa deoničarskog društva, a izjava o reviziji biće priložena uz godišnji izveštaj deoničarskog društva; i<br><br>1.12. odlučivanje u ostalim pitanjima koja se odnose na isključivu nadležnost odbora direktora koja je propisana u statutu deoničarskog društva.<br><br>2.Pitanja koja su u isključivoj nadležnosti odbora direktora deoničarskog društva ne mogu se preneti niti o njima mogu da odlučuju druga lica ili drugi organi deoničarskog društva.<br><br>**Član 163**<br>**Broj direktora**<br><br>Broj članova u odboru direktora deoničarskog društva treba da bude utvrđen u statutu deoničarskog društva. Za deoničarsko društvo sa manje od deset deoničara, odbor direktora treba da ima |

| | | |
|---|---|---|
| Drejtorëve duhet të ketë një (1) ose më shumë anëtarë. Për një Shoqëri Aksionare me dhjetë (10) ose më shumë aksionarë Bordi i Drejtorëve duhet të ketë jo më pak se 3 (tre) anëtarë. | of directors shall have one (1) or more members. For a Joint Stock Company with ten (10) or more shareholders the board of directors shall have not less than three (3) members. | jednog (1) ili više članova.Za deoničarsko društvo sa deset (10) ili više deoničara odbor direktora ne može imati manje od tri (3) člana. |
| **Neni 164**<br>**Zgjedhja dhe Mandati i Drejtorëve** | **Article 164**<br>**Election and Term of Directors** | **Član 164**<br>**Izbor i mandat direktora** |
| 1. Varësisht nga paragrafi 2 i këtij neni të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë Aksionare zgjedhen apo ri-zgjedhen nga aksionarët në kuvendin e tyre vjetor me një mandat tre (3) vjeçar. Cilido ose të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve mund të zgjedhen nga aksionarët në një kuvend të jashtëzakonshëm të caktuar për këtë qëllim. | 1. Subject to paragraph 2 of this Article, all members of a Joint Stock Company's board of directors shall be elected or re-elected by the shareholders at annual shareholder assembly for a term of three (3) years. Any or all members of the board of directors may be elected by the shareholders at any extraordinary shareholder meeting which has been called for that purpose. | 1. U zavisnosti od stava 2 ovog člana, svi članovi odbora direktora deoničarskog društva će biti izabrani ili reizabarani od strane deoničara na godišnjoj skupštini sa mandatom od tri (3) godine. Deoničari mogu izabrati bilo kojeg ili sve članove odbora direktora na vanrednoj sednici deoničara koja je sazvana za tu svrhu. |
| 2. Mandati i drejtorëve të parë të emëruar në statut fillestar skadon në kohën e mbajtjes së kuvendit të parë të aksionarëve në të cilën zgjidhen drejtorët, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me statut ose menjë vendim të miratuar nga aksionarët. | 2. The terms of the initial directors named in the initial charter shall expire at the first shareholder assembly at which directors are elected, unless the charter or a duly approved shareholders' decision provides otherwise. | 2. Mandat prvih direktora imenovanih u početnom statutu ističe u vreme održavanja prve sednice deoničara na kojoj se biraju direktori, izuzev ako je drugačije predviđeno statutom ili odlukom koju su doneli deoničari. |
| 3. Pavarësisht nga skadimi i mandatit të drejtorit, ai vazhdon me ushtrimin e detyrave të tij përderisa të zgjidhet pasardhësi, në mënyrë që veprimtaria e Bordit të Drejtorëve të vazhdojë pa pengesë. | 3. Despite the expiration of a director's term, he shall continue to serve until his successor is elected so that the power of the board of directors shall continue uninterrupted. | 3. Uprkos isteku mandata direktora, on nastavlja sa obavljanjem svoj dužnosti do izbora njegovog naslednika, kako bi se rad odbora direktora nastavio bez prepreka. |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Drejtori mund të ri-zgjidhet për një numër të pa kufizuar mandatesh. | 4. A director may be re-elected an unlimited number of times. | 4. Direktor može biti reizabran na neograničen broj mandata. |
| 5. Asnjë zyrtar, menaxher ose punonjës i Shoqërisë Aksionare nuk mundet njëkohësisht të shërbejë ose të propozohet për drejtor të Shoqërisë Aksionare. | 5. No officer, manager or other employee of a Joint Stock Company shall simultaneously serve or be nominated to serve as a director of a Joint Stock Company. | 5. Nijedan službenik, menadžer ili zaposleni deoničarskog društva ne može istovremeno da služi ili bude predložen za direktora deoničarskog društva. |
| **Neni 165**<br>**Votimi Kumulativ për Drejtorët** | **Article 165**<br>**Cumulative Voting for Directors** | **Član 165**<br>**Kumulativno glasanje za direktore** |
| Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në statutin e Shoqërisë Aksionare, në të gjitha zgjedhjet për drejtorët e Shoqërisë Aksionare, secili aksionar ka të drejtën e votës në bazë të numrit të aksioneve në pronësi të tij për të gjithë personat që janë kandiduar për drejtor, ose t'i mbledhë votat në fjalë dhe t'ia japë një kandidati aq vota sa edhe ka drejtorë që do të zgjidhen, shumëzuar me aksionet në fjalë, ose të shpërndajë votat e tilla të mbledhura kumulative në çfarëdo proporcioni ndërmjet numrit të kandidatëve. | Unless otherwise provided in a Joint Stock Company's charter, in all elections for the directors of a Joint Stock Company, every shareholder shall have the right to vote the number of shares owned by the shareholder for as many persons as there are directors to be elected, or to cumulate such votes and give one candidate as many votes as shall equal the number of directors multiplied by the number of such shares, or to distribute such cumulative votes in any proportion among any number of candidates. | Osim ako je drugačije utvrđeno u statutu deoničarskog društva, na svim izborima za direktore deoničarskog društva, svaki deoničar ima pravo glasa na osnovu broja deonica u vlasništvu deoničara za sva lica koja su se kandidovala za direktora ili da ujedini navedene glasove i da jednom kandidatu koliko i ima direktora koji će biti birani, pomnoženo sa navedenim deonicama, ili raspodeli te kumulativno ujedinjene glasove u kakvoj god srazmeri između broj kandidata. |
| **Neni 166**<br>**Dorëheqja e Drejtorëve** | **Article 166**<br>**Resignation of Directors** | **Član 166**<br>**Ostavka direktora** |
| Drejtori mund të jap dorëheqje në çdo kohë, përmes dërgimit të një njoftimi me shkrim Bordit të Drejtorëve ose kryesuesit | A director may resign at any time by giving written notice to the board of directors or its chairman. The resignation | Direktor može dati ostavku u bilo koje vreme dostavljajući pismeno obaveštenje odboru direktora ili predsedavajućem istog. |

| | | |
|---|---|---|
| të tij. Dorëheqja hyn në fuqi kur dorëzohet njoftimi, përveç nëse njoftimi përcakton ndonjë datë tjetër në të ardhmen. Vendi i zbrazët mund të plotësohet para datës së hyrjes në fuqi të dorëheqjes, por pasardhësi nuk mund të marrë detyrën para datës kur do të hyjë në fuqi dorëheqja. | is effective when the notice is given, unless the notice specifies a future date. The pending vacancy may be filled before the effective date of resignation, but the successor shall not take office until the effective date of resignation. | Ostavka stupa na snagu na dan dostavljanja obaveštenja, izuzev ako je u obaveštenju naveden neki drugi datum u budućnosti. Upražnjeno mesto se može popuniti pre stupanja na snagu ostavke, ali naslednik ne može preuzeti dužnost do stupanja na snagu ostavke. |
| **Neni 167**<br>**Shkarkimi i Drejtorëve** | **Article 167**<br>**Removal of Directors** | **Član 167**<br>**Razrešenje direktora** |
| 1. Një ose më shumë drejtorë të Shoqërisë Aksionare mund të shkarkohen në kuvendin e aksionarëve, me ose pa arsye të theksuar, me shumicë votash të aksioneve të cilat kanë pasur të drejtë të votojnë përzgjedhjen e drejtorëve, përveç se: | 1. One or more directors of a Joint Stock Company may be removed, with or without a stated reason or cause, at a shareholder meeting by a majority of the votes of outstanding shares then entitled to vote at an election of directors, except that: | 1. Jedan ili više direktora deoničarskog društva mogu biti razrešeni, sa ili bez naglašenog razloga, većinom glasova deonica koje su imale pravo glasa tokom izbora direktora, izuzev ako: |
| 1.1. asnjë drejtor nuk mund të shkarkohet në kuvendin e aksionarëve përveç nëse në njoftimin për mbajtjen e kuvendit theksohet se njëri ndër qëllimet e këtij kuvendi është edhe votimi për shkarkimin e këtijdrejtori; dhe | 1.1. no director may be removed at a shareholder meeting unless the notice of the meeting states that a purpose of the meeting was to vote on the removal of such director at the meeting; and | 1.1. nijedan direktor ne može biti razrešen na sednici deoničara osim ako u saopštenju o održavanju sednice nije naglašeno da je jedan od glavnih ciljeva ove sednice glasanje o razrešenju navedenog direktora na sednici, i |
| 1.2. në rast se Shoqëria Aksionare ka votim kumulativ, nëse më pak se i tërë Bordi i Drejtorëve duhet të shkarkohet, asnjë drejtor nuk mund të shkarkohet nëse votat për shkarkimin e tij kanë qenë të mjaftueshme për ta zgjedhur atë në rast të votimit | 1.2. in the case of a Joint Stock Company having cumulative voting, if less than the entire Board of Directors is to be removed, no director may be removed if the votes cast against his removal would be sufficient to elect him if | 1.2. u slučaju da deoničarsko društvo ima kumulativno glasanje, ukoliko treba da bude smenjeno manje od celog odbora direktora, nijedan direktor ne može biti razrešen ako bi glasovi za njegovo razrešenje bili dovoljni za njegov |

| | | |
|---|---|---|
| komulativ për zgjedhjen e të tërë Bordit të Drejtorëve. | then cumulatively voted at an election of the entire board of directors. | izbor u slučaju kumulativnog glasanja za izbor celog odbora direktora. |
| 2. Shkarkimi i një drejtori, vetvetiu nuk e paragjykon ndonjë të drejtë për kompensim apo kompensimin e dëmit pas shkarkimit, të cilën drejtori mund ta ketë në bazë të kontratës së tij me Shoqërinë Aksionare apo sipas ligjin për punën. Sidoqoftë, zgjedhja ose pozita e një personi si drejtor, vetvetiu, nuk krijon të drejta të këtilla. | 2. The removal of a director shall not in itself prejudice any right to compensation or damages upon removal which the director may have under a contract with the Joint Stock Company or under the labor law. However, the election or status of a person as a director shall not, in itself, create any such rights. | 2. Razrešenje direktora samo po sebi ne može prejudicirati neko pravo na obeštećenje ili naknadu štete posle razrešenja, koje direktor može imati na osnovu njegovog ugovora sa deoničarskim društvom ili na osnovu zakona o radu. U svakom slučaju, izbor ili položaj određenog lica kao direktora, po sebi, ne stvara takva prava. |
| **Neni 168**<br>**Pavarësia e Drejtorëve** | **Article 168**<br>**Independence of Directors** | **Član 168**<br>**Samostalnost direktora** |
| 1. Në një Shoqëri Aksionare që ka 100 apo më shumë Aksionarë, anëtarët e familjes të të punësuarve të Shoqërisë Aksionare nuk mund të përbëjnë shumicën në Bordin e Drejtorëve të asaj Shoqërie Aksionare. | 1. In a Joint Stock Company which has 100 or more Shareholders, family members of employees of the Joint Stock Company may not comprise a majority of the board of directors of the Joint Stock Company. | 1. U deoničarskom društvu koje ima 100 ili više deoničara, članovi porodica zaposlenih u deoničarskom društvu ne mogu činiti većinu u odboru direktora deoničarskog društva. |
| 2. Në zgjedhjet e Drejtorëve të Shoqërisë Aksionare me 250 apo më shumë Aksionarë, Bordi i Drejtorëve i Shoqërisë Aksionare dhe çdo organ apo person që i emëron kandidatë për Bordin e Drejtorëve që do të përbëjnë shumicën e anëtarëve të Bordit, duhet t'i propozojë së paku tre (3) kandidatë që do të jenë drejtorë të pavarur. | 2. In elections of directors of a Joint Stock Company having 250 or more Shareholders, the Joint Stock Company's board of directors and any body or person nominating candidates for the board of directors to compose the majority of the board of directors must nominate at least three (3) candidates who would be independent directors. | 2. Prilikom izbora direktora u deoničarskom društvu koje ima 250 ili više deoničara, odbor direktora deoničarskog društva i bilo koji organ ili lice koje predlaže kandidate za odbor koji će činiti većinu članova odbora, je dužan da predloži najmanje tri (3) kandidata koji bi bili nezavisni direktori. |
| 3. Për qëllime të këtij ligji, një person nuk | 3. For purposes of the present law, a | 3. Za ciljeve ovog zakona, određeno lice |

| | | |
|---|---|---|
| konsiderohet si “drejtor i pavarur” nëse, në cilëndo kohë gjatë dy vjetëve para zgjedhjeve përkatëse: | person shall not be considered as an “independent director” if, at any time during the two year period immediately preceding the concerned election: | neće biti smatrano „nezavisnim direktorom“ ukoliko je u bilo koje vreme u toku dve prethodne godine pre pomenutog izbora: |
| 3.1. ka qenë punonjës i Shoqërisë Aksionare; ose | 3.1. such person was an employee of the Joint Stock Company; or | 3.1. bio radnik deoničarskog društva, ili |
| 3.2. ka pasur një anëtar të familjes që ka qenë punonjës i Shoqërisë Aksionare; ose | 3.2. such person had a family member who was an employee of the Joint Stock Company; or | 3.2. ima člana porodice koji je bio zaposlen u deoničarskom društvu, ili |
| 3.3. ky person dhe/ose një anëtar i familjes së personit, individualisht ose bashkërisht: . | 3.3. such person and/or the family members of such person, either individually or collectively: | 3.3. ovo lice i/ili član porodice, zajednički ili pojedinačno: |
| 3.3.1. kanë bërë ose kanë marrë nga Shoqëria Aksionare pagesa me shumë të përgjithshme mbi 20.000 Euro; ose | 3.3.1. provided to or received from the Joint Stock Company payments totalling more than 20,000 Euro, or | 3.3.1. su izvršili ili su primili od deoničarskog društva isplate ukupnog iznosa preko 20.000 evra; ili |
| 3.3.2. kane qenë në pronësi të më shumë se 30% të aksioneve ose interesave të tjera pronësore, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të një Shoqërie Tregtare që ka bërë ose ka marrë nga Shoqëria Aksionare, pagesa në shumë të përgjithshme më të madhe se 20.000 euro; ose | 3.3.2. owned more than a 30% of Shares or other ownership interest, directly or indirectly, in any Business Organization that provided to or received from the Joint Stock Company payments totalling more than 20,000 Euro, or | 3.3.2. raspolagali sa više od 30% deonica ili drugih vlasničkih interesa, direktno ili indirektno, u bilo kojoj organizaciji koja je izvršila ili primila od deoničarskog društva isplate ukupnog iznosa iznad 20.000 evra; ili |
| 3.3.3. ka vepruar si ortak i përgjithshëm, menaxher, drejtor ose zyrtar në një Shoqëri Tregtare që ka bërë ose ka marrë nga Shoqëria | 3.3.3. acted as a general partner, manager, director or officer of a Business Organization that provided to or received from the | 3.3.3. delovali u svojstvu opšteg ortaka, menadžera, direktora ili službenika deoničarskog društva koje je izvršilo ili primilo od |

| | | |
|---|---|---|
| Aksionare pagesa në shumë të përgjithshme më të madhe se 20.000 euro; ose<br><br>3.3.4. ka pasur në pronësi 30% ose më shumë të aksioneve të çdo klase ose lloji të Shoqërisë Aksionare .<br><br>**Neni 169**<br>**Plotësimi i Vendeve të Zbrazëta në Bordin e Drejtorëve**<br><br>Vendet e zbrazëta në Bordin e Drejtorëve duhet të plotësohen me zgjedhjen në kuvendin e ardhshëm të aksionarëve në të cilën duhet të zgjidhen drejtorët. Statuti i ShoqërisëAksionare mund të parasheh që Bordi i Drejtorëve të mund të zgjedhë dikë ta plotësojë këtë vend të zbrazët deri në kuvendin e aksionarëve.<br><br>**Neni 170**<br>**Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve**<br><br>1. Bordi i Drejtorëve mund ta zgjedhë kryesuesin e tij me shumicë votash të të gjithë drejtorëve, dhe Bordi i Drejtorëve mund të shkarkojë dhe zëvendësoje kryesuesin në çdo kohë me shumicë votash.<br><br>2. Kryesuesi kryeson të gjitha mbledhjet e Bordit dhe kuvendet e aksionarëve dhe është përgjegjës përmbajtjen e të gjitha procesverbaleve nga të gjitha mbledhjet e | Joint Stock Company payments totalling more than 20,000 Euros<br><br>3.3.4. owned 30% or more Shares of any class or type in the Joint Stock Company.<br><br>**Article 169**<br>**Filling of Vacancies in the Board of Directors**<br><br>A vacancy in the board of directors shall be filled by election at the next Shareholder Assembly at which directors are to be elected. The Joint Stock Company's charter may provide that the board of directors may elect someone to fill such vacancy until the Shareholder Assembly.<br><br>**Article 170**<br>**Chairman of the Board of Directors**<br><br>1. A board of directors shall elect a chairman by a majority vote of the total number of directors, and the board of directors may remove and replace the chairman at any time by the majority vote.<br><br>2. The chairman shall preside at all meetings of the board and all Shareholder Assemblies and shall be responsible for maintaining the records of all meetings of | deoničarskog društva isplate ukupnog iznosa iznad 20.000 evra; ili<br><br>3.3.4. raspolagao sa 30% ili više svake klase ili vrste deonica deoničarskog društva.<br><br>**Član 169**<br>**Popunjavanje upražnjenih mesta u odboru direktora**<br><br>Upražnjeno mesto u odboru direktora se popunjava izborom na sledećoj sednici deoničara na kojoj treba da se biraju direktori. Statut društva može da propiše da odbor direktora može da izabere jedno lice radi popune takvog praznog mesta do sednice deoničara.<br><br>**Član 170**<br>**Predsedavajući odbora direktora**<br><br>1. Odbor direktora bira predsedavajućeg odbora većinom glasova svih direktora i odbor direktora može većinom glasova razrešiti i zameniti predsedavajućeg u svakom trenutku.<br><br>2. Predsednik predsedava svim sednicama odbora i svim sednicama deoničara i snosi odgovornost za držanje svih zapisnika sa svih sednica odbora. Ako predsedavajući |

| | | |
|---|---|---|
| Bordit. Nëse kryesuesi nuk është zgjedhur ose nuk është i pranishëm në mbledhjen e Bordit ose kuvendet e aksionarëve, atëherë një drejtor i zgjedhur me shumicë votash të drejtorëve të pranishëm shërben si kryesues i mbledhjes ose kuvendit në fjalë.<br><br>3. Në një Shoqëri Aksionare kryesuesi i Bordit të Drejtorëve nuk mund të jetë njëkohësisht edhe Drejtor Menaxhues.<br><br>**Neni 171**<br>**Mbledhjet dhe Njoftimi për Mbledhjet**<br><br>1. Bordi i Drejtorëve:<br><br>1.1. mban një mbledhje të rregullt e cila njihet si mbledhje vjetore, menjëherë pas çdo kuvend vjetore të aksionarëve. Mbledhjet e rregullta mbahen në kohën dhe vendin të cilin e cakton Bordi në mbledhjen vjetore ose në një mbledhje tjetër të Bordit për të cilën janë njoftuar të gjithë drejtorët. Njoftimi mbi mbledhjet e rregullta nuk ka nevojë të dërgohet, përveç nëse këtë e kërkon Bordi i Drejtorëve.<br><br>1.2. mban së paku dy mbledhje të Bordit në vit për Shoqëritë Aksionare.<br><br>2. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Bordit | the board. If a chairman was not elected or is not present at a meeting of the board or at a shareholder assembly, a director chosen by a majority of the directors who are present shall act as chairman.<br><br>3. In a Joint Stock Company, the chairman of the Board of Directors may not be Managing Director at the same time.<br><br>**Article 171**<br>**Meetings and Notice of Meetings**<br><br>1. The board of directors shall:<br><br>1.1. hold a regular meeting, to be known as its annual meeting, immediately following each annual shareholder assembly. Other regular meetings shall be held at such times and places as may be determined by the board at its annual meeting or at another meeting of the board of which all directors shall have been given notice. No notice of regular meetings need be given except as the board may require.<br><br>1.2. hold at least two board meetings annually for Joint Stock Companies.<br><br>2. Extraordinary meetings of the board of | još nije izabran ili nije prisutan na sastanku odbora ili sednici deoničara, onda drugi direktor, izabran većinom glasova prisutnih direktora služi kao predsedavajući navedenog sastanka ili sednice.<br><br>3. U deoničarskom društvu, predsedavajući ne može istovremeno biti i upravni direktor.<br><br>**Član 171**<br>**Sastanci i obaveštenja o sednicama**<br><br>1. Odbor direktora:<br><br>1.1. održava redovne sastanke, koja su poznata kao godišnja sednica, odmah nakon svakog godišnjeg skupa deoničara. Ostale redovne sednice održavaju se u vreme i u mestima koje odredi odbor na godišnjoj sednici ili drugoj sednici odbora o kojoj su svi direktori obavešteni. Nije potrebno davati obaveštenje o redovnim sednicama osim ako to zatraži odbor direktora.<br><br>1.2. održava najmanje dve sednice odbora godišnje u deoničarskom društvu.<br><br>2. Vanredni sastanci odbora direktora mogu |

| | | |
|---|---|---|
| dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë para datës së mbajtjes së kuvendit të jashtëzakonshëm. Njoftimi dërgohet nga ose me udhëzimin e kryesuesit të Bordit ose ndonjë anëtari tjetër të Bordit të Drejtorëve i cili e ka thirrur kuvendin, dhe u dërgohet të gjithë aksionarëve me të drejtë vote në kuvend. | extraordinary assembly. The notice shall be given by or at the direction of the chairman of the board or another member of the board of directors who calls the assembly, and shall be given to each shareholder of record entitled to vote at the assembly. | dana pre datuma održavanja Vanredne skupštine. Obaveštenje se dostavlja od ili na uputstvo predsedavajućeg odbora ili nekog drugog člana Odbora direktora, koji je sazvao Skupštinu i dostavlja se svim deoničarima koji imaju pravo glasa na Skupštini. |
| 2. Njoftimi për mbajtjen e kuvendit vjetor duhet të përmbajë datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së kuvendit, rendin e propozuar të ditës dhe një listë të çështjeve për të cilat duhet votohet në kuvend duke përfshirë informatat e mjaftueshme për listën e kandidatëve të propozuar të Shoqërisë Aksionare për emërim në Bordin e Drejtorëve në kuvend dhe të gjitha çështjet tjera që duhet të përfshihen në njoftim në bazë të statutit të Shoqërisë Aksionare. Njoftimi gjithashtu duhet të përfshijë raportin vjetor të Shoqërisë Aksionare, pasqyrën financiare, deklaratën e fitimeve dhe humbjeve vjetore dhe ndonjë raport të auditorit, ose, nëse këto dokumente nuk janë përfshirë atëherë një deklaratë mbi atë se si dhe kur do t'u dërgohen ose të vihen në dispozicion të aksionarëve para kuvendit vjetor. Bordi i Drejtorëve është i obliguar që të sigurojë që të gjitha këto dokumente ose t'u dërgohen ose të jenë në dispozicion të aksionarëve së paku tridhjetë (30) ditë para kuvendit. | 2. The notice of an annual assembly shall state the date, time and place of the meeting, the Joint Stock Company's proposed agenda and list of issues to be voted on at the assembly, including sufficient information on the Joint Stock Company's proposed candidates for election to the board of directors at the assembly, and any other matters which are required to be included in the notice by the Joint Stock Company's charter. The notice shall also include the Joint Stock Company's annual report, annual balance sheet and annual profit and loss statement and any reports of the auditors or, if not included, a statement of when and how they will be sent to or made available to shareholders prior to the annual assembly. The board of directors shall be obligated to ensure that all such documents are sent to, or easily accessible by, all shareholders at least thirty (30) days prior to the assembly. | 2. Obaveštenje o održavanju Godišnje skupštine mora da sadrži datum, vreme i mesto održavanja skupštine, predloženi dnevni red i spisak pitanja za koja treba da se glasa na skupštini, uključujući i dovoljno informacija o listi kandidata predloženih za imenovanje u odboru direktora u skupštini i sva druga pitanja koja treba da budu uključena u obaveštenju u skladu sa statutom Deoničarskog društva. Obaveštenje takođe treba da sadrži Godišnji izveštaj Deoničarskog društva, finansijski pregled, izjavu godišnjeg dobitka i gubitka i neki izveštaj revizora, ili, ako ti dokumenti nisu uključeni, onda jedna izjava o tome kako i kada će biti poslati ili stavljeni na raspolaganje deoničarima pre Godišnje skupštine. Odbor direktora je dužan da obezbedi da će svi ovi dokumenti ili biti poslati ili dostupni deoničarima najmanje trideset (30) dana pre skupštine. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Njoftimi për mbajtjen e kuvendit të jashtëzakonshëm duhet të përmbajë datën, kohën dhe vendin e kuvendit, një përshkrim të qëllimit të kuvendit, dhe rendin e ditës që është propozuar nga paraqitësi i kërkesës për mbajtjen e kuvendit. | 3. The notice of an extraordinary assembly shall state the date, time and place of the assembly, a description of the purposes of the assembly, and the agenda which was proposed by the person(s) who caused the assembly to be called | 3. Obaveštenje o vanrednoj skupštini navodi datum, vreme i mesto skupštine, opis svrhe skupštine, kao i dnevni red koji predloži lice(a) koje je razlog za sazivanje skupštine. |
| 4. Përveç dërgimit të njoftimit aksionarëve të paraparë më sipër, Shoqëria Aksionare me 100 apo më shumë Aksionarë, po ashtu duhet të publikojë një njoftim të ngjashëm së paku njëzetenjë (21) ditë para datës e cila fillimisht është përcaktuar për mbajtjen e kuvendit, në një gazetë me qarkullim të madh dhe në gjuhët zyrtare të Kosovës. Në këtë njoftim duhet të përcaktohet koha, vendi dhe rendi i ditës së kuvendit. Ky njoftim nuk duhet të jetë më i vogël se një e teta (1/8) e një faqe të shtypur. | 4. In addition to sending such notices to the shareholders as required above, a Joint Stock Company with more than 100 shareholders shall also publish a similar notice at least twenty one (21) days prior to the date originally set for the assembly in a newspaper of general circulation in Kosovo, in the official languages of Kosovo. Such published notice shall specify the time and the place of the assembly and the agenda. This publication shall be no smaller than one eighth (1/8) of a printed page. | 4. Pored slanja gore navedenog obaveštenja deoničarima, Deoničarsko društvo koje ima više od 100 deoničara treba da objavi slično obaveštenje najmanje dvadeset i jedan (21) dana prije datuma koji je prvobitno određen za održavanje skupštine, u novinama sa čitanosti i na službenim jezicima na Kosovu. U tom obaveštenju mora da se utvrđuje vreme, mesto i dnevni red Skupštine. Ovo obaveštenje ne sme biti manje od jedne osmine (1/8) štampane stranice. |
| 5. Nëse kërkesat e ligjit apo Statutit të Shoqërisë Aksionare shkilen materialisht me thirrjen e Kuvendit të Aksionarëve, Kuvendi i Aksionarëve nuk ka të drejtë të miratojë vendime, përveç nëse të gjithë Aksionarët marrin pjesë apo përfaqësohen në mbledhje. Vendimet e marra në mbledhjen e tillë janë nule përveç nëse Aksionarët, në lidhje me të cilët procedura e thirrjes së mbledhjes është shkelur, pajtohen me ato vendime. | 5. If the requirements of law or the Charter of the Joint Stock Company are materially violated in calling a Shareholder Assembly, the Shareholder Assembly shall not have the right to adopt decisions except if all shareholders participate in or are represented at the meeting. Decisions adopted at such meeting are void unless the shareholders with respect to whom the procedure for calling the meeting was violated approve of the decisions. | 5. Ukoliko su kriterijumi zakona ili statuta materijalno povređeni prilikom sazivanja Skupštine deoničara, Skupština deoničara nema pravo da usvaja odluke osim ako svi deoničari učestvuju ili imaju predstavnike na sastanku. Odluke usvojene na ovakvom sastanku su ništavne, osim ako deoničari u odnosu na koje je načinjen prekršaj procedure pri sazivanju sastanka daju odobrenje za odluke. |

| Neni 184<br>Kuvendi ose Pjesëmarrja me Komunikim Elektronik ose Telefonik | Article 184<br>Assembly or Attendance by Electronic or Phone Communication | Član 184<br>Skupština ili učešće putem elektronske komunikacije ili telefona |
|---|---|---|
| 1. Statuti i Shoqërisë Aksionare mund të parashikojnë që aksionarët mund të marrin pjesë në një kuvend të aksionarëve në mënyrë elektronike, telefonike apo mënyra të tjera të komunikimit nga larg, ose që i tërë kuvendi i aksionarëve të zhvillohet me anë të komunikimit nga largësia. | 1. A Joint Stock Company's charter may provide that the shareholders may take part in a shareholder assembly in an electronic or phone communication, or any other remote communication modes, or that the whole shareholder assembly is held in a remote attendance manner. | 1. Statut Deoničarskog društva može predvideti da deoničari mogu učestvovati u skupštini deoničara elektronski, telefonom ili putem drugih oblika komunikacije iz daljine, ili da se cela skupština deoničara odvija putem daljinske komunikacije. |
| 2. Në çdo rast të tillë Shoqëria Aksionare do të sigurojë që: | 2. In any such case, a Joint Stock Company shall ensure: | 2. U svakom takvom slučaju, Deoničarsko društvo će osigurati da: |
| 2.1. Çdo person i cili konsiderohet të jetë i pranishëm në kuvend me komunikim nga largësia të jetë në fakt një aksionar ose pronar i një autorizimi të vlefshëm; | 2.1. Each person who is considered to be present in the meeting via remote communication is actually a shareholder or possesses a valid authorization; | 2.1. Svaka osoba koja se smatra da je prisutna u skupštini sa daljinskom komunikacijom bude u stvari deoničar ili vlasnik važećeg ovlašćenja; |
| 2.2.Çdo person i tillë është në gjendje të marrë pjesë në kuvend dhe të votojë për të gjitha çështjet e paraqitura para aksionarëve, duke përfshirë edhe një mundësi për të lexuar ose të dëgjuar të gjitha punimet e kuvendit njëkohësisht me procedura të tilla; dhe | 2.2. Any such person is able to participate in the meeting and vote on all affairs presented before shareholders, including another opportunity to read or listen simultaneously to all sessions of the meeting with such procedures; and | 2.2. Svaka takva osoba je u stanju da učestvuje u skupštini i glasa o svim pitanjima podnetim pred deoničarima, uključujući i mogućnost da se pročita ili čuje sve o radu Skupštine istovremeno uz takve procedure; |
| 2.3.Çdo deklaratë ose votë e çdo personi të tillë është e regjistruar në procesverbalin e kuvendit. | 2.3. Any statement of vote of any such person is registered in the meeting minutes. | 2.3. Svaka izjava ili glas takve osobe je registrovan u evidenciji skupštine. |

| | | |
|---|---|---|
| 3.Ministria mund të nxjerrë akt nënligjor për rregullimin më të detajuar të kuvendeve të tilla. | 3. The Ministry may issue a sub-legal act to regulate in more detail such assemblies. | 3. Ministarstvo može da donese podzakonski akt za detaljnije regulisanje takvih skupština. |
| **Neni 185**<br>**Heqja dorë nga Njoftimi** | **Article 185**<br>**Waiver of Notice** | **Član 185**<br>**Odricanje od obaveštenja** |
| 1. Kurdo që me këtë ligj ose me statutin e Shoqërisë Aksionare kërkohet dorëzimi i një njoftimi, personi që ka të drejtë të pranojë njoftimin mund të heqë dorë nga e drejta e tij për të pranuar njoftimin me nënshkrimin e një njoftimi për heqjen dorë nga kjo e drejtë. | 1. Whenever any notice is required to be given under the present law or a Joint Stock Company's charter, any person entitled to receive such notice may waive his/her right to such notice by signing a written waiver of notice. | 1. Kad god se ovim zakonom ili statutom Deoničarskog društva zahteva podnošenje obaveštenja, lice koje ima pravo da dobija obaveštenje može da se odrekne svog prava da dobija obaveštenje putem potpisivanja jednog obaveštenja o odricanju od ovog prava. |
| 2. Pjesëmarrja e aksionarit në kuvend përbën heqjen dorë nga të gjitha të drejtat që aksionari mund t'i ketë për të bërë ose dorëzuar ankesë ose për të kundërshtuar në lidhje me mos-dërgimin e njoftimit ose njoftimin e mangët për mbajtjen e kuvendit. Me kusht që e drejta e aksionarit për t'u ankuar të jetë e vlefshme nëse në fillim të kuvendit aksionari e kundërshton mbajtjen e kuvendit për shkak të mos-dërgimit të njoftimit përkatës për mbajtjen e saj. | 2. A shareholder's attendance at an assembly shall constitute a waiver of any right that such shareholder may have to make or file any complaint or raise any objection with respect to a lack of notice or defective notice of the assembly. Provided, however, that the shareholder's right to so complain or object shall not be so waived if, at the beginning of the assembly, the shareholder objects to the assembly because proper notice of the assembly was not given. | 2. Prisustvo deoničara u skupštini predstavlja odricanje od svih prava koja deoničar može imati da ulaže ili podnese žalbu ili da prigovora u vezi sa ne-dostavljanjem obaveštenja ili nepotpunim obaveštenjem o održavanju skupštine. Pod uslovom da je pravo deoničara da se žali važiće ako se na početku skupštine deoničar protivi održavanju skupštine zbog ne dostavljanja relevantnog obaveštenja o njenom održavanju. |
| 3. Pjesëmarrja e aksionarit në kuvend përbën në vete heqjen dorë nga të gjitha të drejtat të cilat aksionari mund t'i ketë për të bërë ose dorëzuar ankesë ose për të kundërshtuar në lidhje me shqyrtimin e një çështjeje të caktuar në kuvend në bazë të | 3. A shareholder's attendance at an assembly shall constitute a waiver of any right that such shareholder may have to make or file any complaint or raise any objection with respect to the consideration of a particular matter at the assembly on | 3. Učešće deoničara u skupštini predstavlja u sebi odricanje od svih prava koja deoničar može imati da ulaže ili podnese žalbu ili da prigovara u vezi sa razmatranjem određenog pitanja u skupštini na osnovu toga da u obaveštenju o održavanju |

| | | |
|---|---|---|
| asaj se në njoftimin për mbajtjen e kuvendit nuk është shënuar që kjo çështje do të diskutohet. Me kusht që e drejta e aksionarit për t'u ankuar ose për të kundërshtuar të jetë e vlefshme nëse gjatë kohës kur çështja fillon të diskutohet në kuvendin e aksionarëve atëherë ai e kundërshton diskutimin e çështjes për shkak të mos njoftimit përkatës në lidhje me këtë çështje. | the basis that the notice of the meeting did not indicate that such matter would be discussed. Provided, however, that the shareholder's right to so complain or object shall not be so waived if - at the time the matter is under discussion at the assembly - the shareholder objects to the discussions about the matter because the matter was not the subject of a proper notice. | skupštine nije naznačeno da će se o tom pitanju diskutovati. Pod uslovom da je pravo deoničara na žalbu ili prigovor važeće ako se u vremenu kada počinje da se raspravlja o pitanju u skupštini deoničara, onda se on protivi razmatranju pitanja zbog neodgovarajućeg obaveštenja po ovom pitanju. |
| **Neni 186**<br>**Rendi i Ditës për Kuvend** | **Article 186**<br>**Agenda for an Assembly** | **Član 186**<br>**Dnevni red Skupštine** |
| 1. Aksionari ose aksionarët të cilët mbajnë së paku 5% të të gjitha aksioneve të Shoqërisë Aksionare në mbledhjen vjetore kanë të drejtë të paraqesin çështje për rendin e ditës për këtë mbledhje dhe gjithashtu kanë të drejtën e propozimit të kandidatëve për zgjedhje në Bordin e Drejtorëve, ashtu që numri i kandidatëve të propozuar nuk mund ta kalojë numrin e përgjithshëm të anëtarëve në Bord. Të gjitha propozimet e tilla duhet të bëhen me shkrim, duhet të përfshijnë emrin dhe numrin e votave të secilit Aksionarë, duhet t'i dërgohen Shoqërisë Aksionare në adresën e Bordit të vet të drejtorëve dhe në adresën e regjistruar të Shoqërisë Aksionare, jo më shumë se katërmbëdhjetë (14) ditë para datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes. Asnjë aksionar nuk mund të numërohet në më shumë se në një grup të | 1. A shareholder or shareholders holding at least 5% of all the votes of a Joint Stock Company at an annual assembly shall have the right to place issues on the agenda of that assembly and also the right to propose candidates for election at that assembly to the Joint Stock Company's board of directors, the number of which may not exceed the total number of members of the board. Any such proposals shall be made in writing, shall include the name(s) and number of votes of each Shareholder, and shall be delivered to the Joint Stock Company, addressed to its board of directors, at the Joint Stock Company's registered address, not later than fourteen (14) days before the date of the assembly. No shareholder may be counted in more than one group of shareholders holding at least 5% per cent of votes for purposes of | 1. Deoničar ili deoničari koji imaju najmanje 5% od ukupnog broja deonica Deoničarskog društva na godišnjem sastanku imaju pravo da podnesu pitanja za dnevni red za ovaj sastanak, a takođe imaju pravo da predlažu kandidate za izbor u Odbor direktora, tako da broj predloženih kandidata ne može da prelazi ukupan broj članova u Odboru. Svi takvi predlozi moraju biti u pismenoj formi, moraju da sadrže ime i broj glasova svakog predlagača, treba da se dostave Deoničarskom društvu na adresi njegovog odbora direktora i registrovanu adresu Deoničarskog društva, ne više od četrnaest (14) dana pre dana određenog za održavanje sastanka. Nijedan deoničar ne može se nabrajati u više od jedne grupe deoničara koji imaju najmanje 5% svih deonica Deoničarskog društva u svrhe ove |

| | | |
|---|---|---|
| aksionarëve që mbajnë së paku 5% të të gjitha aksioneve të Shoqërisë Aksionare për qëllime të kësaj pike. | this item. | tačke. |
| 2. Nëse Bordi i Drejtorëve e pranon një propozim të këtillë më shumë se tri (3) ditë para datës në të cilën do të dërgohet njoftimi për mbajtjen e kuvendit tek aksionarët, Bordi i Drejtorëve duhet ta përfshijë këtë propozim në atë njoftim. Nëse Bordi i Drejtorëve e pranon një propozim pas kësaj kohe, por megjithatë katërmbëdhjetë (14) ose më shumë ditë para mbajtjes se kuvendit, Bordi i Drejtorëve duhet menjëherë t'ua dërgojë propozimin me postë të gjithë aksionarëve të cilëve u është dërguar njoftimi për mbajtjen e kuvendit. | 2. If the board of directors receives such a proposal more than three (3) days before the date that the notice of the assembly is to be sent to the shareholders, the board of directors shall include such a proposal in that notice. If the board of directors receives such a proposal after that time, but still fourteen (14) or more days before the assembly, the board of directors shall promptly mail that proposal to all shareholders to whom the notice of the assembly was sent. | 2. Ako Odbor direktora primi takav predlog više od tri (3) dana pre datuma kada će obaveštenje biti poslato deoničarima o održavanju skupštine, Odbor direktora treba da obuhvata ovaj predlog u tom obaveštenju. Ako Odbor direktora primi predlog nakon ovog vremena, ali ipak četrnaest (14) ili više dana pre održavanja skupštine, odbor direktora mora odmah dostaviti poštom ovaj predlog svim deoničarima kojima je poslato obaveštenje o održavanju skupštine. |
| 3. Një Shoqëri Aksionare mund të emërojë një ose më shumë persona për të numëruar votat në mënyrë të paanshme dhe të bëjë një raport me shkrim për përcaktimet e tyre që do të mbahen në procesverbalin e takimit. Një person i tillë nuk mund të jetë një zyrtar ose punonjës i Shoqërisë Aksionare. Personat e tillë do të: | 3. A Joint Stock Company may appoint one or more persons to count the votes in an impartial manner and deliver a written report on such votes, which shall be kept in the assembly minutes. Such a person may not be an officer or employee of the Joint Stock Company. Such persons shall: | 3. Deoničarsko društvo može imenovati jednog ili više lica za prebrojavanje glasova na nepristrasan način i da sačine pisani izveštaj o njihovim konstatacijama koje će se uneti u zapisniku sastanka. Takva osoba ne može biti zvaničnik ili zaposleni Deoničarskog društva. Takva lica će: |
| 3.1. Përcaktojnë numrin e aksioneve/ aksionarëve të pranishëm, personalisht ose me prokurë dhe që kanë të drejtë vote në kuvend;<br>3.2. përcaktojnë vlefshmërinë e prokurave; | 3.1. Record the number of shares/shareholders present, in person or by proxy, entitled to cast a vote in the assembly;<br><br>3.2. determine the validity of proxy; | 3.1. utvrditi broj deonica / prisutnih deoničara, lično ili preko punomoćnika i koji imaju pravo glasa u Skupštini;<br><br>3.2. utvrditi validnost punomoćnika; |

| | | |
|---|---|---|
| 3.3.numërojnë të gjitha votat; dhe<br><br>3.4. përcaktojnë dhe shpallin rezultatin.<br><br>4. Gjatë kuvendit vjetor, vetëm çështjet që janë në fushëveprimin e njoftimit dhe të rendit të ditës të dërguar paraprakisht, ose që janë në fushëveprimin e një propozimi që është pranuar nga Bordi së paku katërmbëdhjetë (14) ditë para kuvendit, mund të votohen. Megjithatë, ky kufizim nuk e pengon diskutimin e çështjeve të tjera.<br><br>5. Në kuvendin e jashtëzakonshëm, vetëm çështjet e përfshira në njoftimin dhe në rendin e ditës të dërguar paraprakisht mund të votohen. Ky kufizim nuk do ta pengojë diskutimin e çështjeve të tjera.<br><br>**Neni 187**<br>**Caktimi i Datës për Kuvend**<br><br>1. Statuti i Shoqërisë Aksionare mund të vendosë mënyrën për caktimin e datës së mbledhjes lidhur me përcaktimin e listës së aksionarëve që kanë të drejtë në marrjen e njoftimit për mbajtjen e kuvendit, të kërkojnë mbajtjen e një kuvendit të jashtëzakonshëm, të votojnë, ose të ndërmarrin ndonjë veprim tjetër. | 3.3. count all votes cast; and<br><br>3.4. determine and disclose the result.<br><br>4. In an annual assembly, only matters within the scope of the notice and agenda sent prior to the assembly, or within the scope of a proposal accepted by the board fourteen (14) days before the assembly, may be voted. However, such limitation shall not prejudice discussions of other matters.<br><br>5. In an extraordinary assembly, only matters included in the notice and agenda sent prior to the meeting may be voted upon. Such limitation shall not prejudice discussions of other matters.<br><br>**Article 187**<br>**Record Date for an Assembly**<br><br>1. A Joint Stock Company's charter may fix or state the manner for fixing the record date for determining the list of the shareholders who are entitled to receive notice of an assembly, to demand an extraordinary assembly, to vote, or to take any other action. | 3.3. prebrojiti sve glasove; i<br><br>3.4. utvrditi i objaviti rezultat.<br><br>4. Tokom Godišnje skupštine, samo pitanja koja su u okviru obaveštenja i unapred poslatog dnevnog reda, ili su u okviru predloga koji je primljen od strane odbora najmanje četrnaest (14) dana pre skupštine, mogu se glasati. Međutim, ovo ograničenje ne sprečava diskusiju o ostalim pitanjima.<br><br>5. Na vanrednoj skupštini, samo pitanja koja su uključena u obaveštenju i ranije poslatom dnevnom redu mogu se glasati. Ovo ograničenje ne sprečava diskusiju o ostalim pitanjima.<br><br>**Član 187**<br>**Određivanje datuma za Skupštinu**<br><br>1. Statut Deoničarskog društva može da propisuje način za određivanje datuma sastanka u vezi sa određivanjem liste deoničara koji imaju pravo dobiti obaveštenje o održavanju Skupštine, da zahtevaju održavanje vanredne skupštine, da glasaju ili da preduzimaju neku drugu radnju. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Nëse statuti i Shoqërisë Aksionare nuk e cakton ose nuk përcakton mënyrën për vendosjen e caktimit të datës për kuvend, Bordi i Drejtorëve mund ta caktojë një datë të ardhme si datë për mbajtje të kuvendit. Nëse data e kuvendit nuk është vendosur në statut dhe as nga Bordi i Drejtorëve për kuvendin vjetor, data e kuvendit është data në të cilën së pari është dërguar njoftimi për mbajtjen e kuvendit ose që është përcaktuar nga neni 183 i këtij ligji. Nëse data e kuvendit nuk është caktuar në statut ose nga Bordi i Drejtorëve për kuvendin e jashtëzakonshëm, data e kuvendit do të jetë data në të cilën kërkesa e parë përmbajtjen e kuvendit së tillë është nënshkruar nga një aksionar sipas nenit 180 të këtij ligji. | 2. If the Joint Stock Company's charter does not fix or provide for fixing a record date, the board of directors may fix a future date as the record date. If no record date is fixed by the charter or the board of directors for an annual assembly, the record date shall be the date on which notice of the assembly is first mailed or otherwise given under Article 183 of this Law. If no record date is fixed by the charter or the board of directors for an extraordinary assembly, the record date shall be date on which the first demand for the assembly is signed and dated by a shareholder under Article 180 of this Law. | 2. Ako statut Deoničarskog društva ne određuje ili ne utvrđuje način o odlučivanju povodom određivanja datuma za Skupštinu, Odbor direktora može odrediti jedan naredni datum kao datum za održavanje Skupštine. Ukoliko datum Skupština nije određen statutom niti od strane Odbora direktora za godišnju Skupštinu, datum Skupštine je datum kada je prvobitno poslato obaveštenje o održavanju Skupštine ili koji je utvrđen članom 183. ovog zakona. Ako datum Skupštine nije određen u statutu ili od strane Odbora direktora za Vanrednu skupštinu, datum Skupštine će biti datum kada je potpisan prvi zahtev za održavanje takve skupštine od strane jednog deoničara, shodno člana 180. ovog zakona. |
| 3. Data e kuvendit nuk duhet, në çfarëdo rrethanash, të jetë më shumë se tridhjetë (30) ditë ose më pak se tri (3) ditë para mbajtjes së kuvendit ose veprimeve që kërkojnë miratimin e aksionarëve. | 3. A record date may not in any event be more than thirty (30) nor less than three (3) days before the assembly or action requiring a determination of shareholders. | 3. Datum Skupštine ne može, ni pod kakvim okolnostima, biti više od trideset (30) dana ili manje od tri (3) dana pre održavanja skupštine ili aktivnosti koje zahtevaju prihvatanje deoničara. |
| **Neni 188**<br>**Drejtimi i Kuvendit** | **Article 188**<br>**Conduct of an Assembly** | **Član 188**<br>**Upravljanje Skupštinom** |
| 1. Kryesuesi i Kuvendit zgjidhet dhe kryeson secilën kuvend. Kryesuesi emërohet: | 1. A chairman of the assembly shall be elected and preside at each assembly. The chairman shall be appointed: | 1. Predsedavajući Skupštine se bira i predsedava svakom skupštinom. Predsedavajući se imenuje: |
| 1.1. siç është përcaktuar në statutin e Shoqërisë Aksionare; ose | 1.1. as provided in the Joint Stock Company's charter; or | 1.1. kao što je utvrđeno u statutu Deoničarskog društva; ili |

| | | |
|---|---|---|
| 1.2. nëse statuti nuk e parasheh zgjedhjen e kryesuesit, atëherë në bazë të një vendimi të Bordit të Drejtorëve. Kryesuesi vendos lidhur me mënyrën e mbajtjes së kuvendit dhe mund të vendosë rregulla dhe rregulloren e punës për mbajtjen e kuvendit, me kusht që këto rregulla të mos i diskriminojnë ose të pengojnë të drejtën e pjesëmarrjes së cilitdo aksionar. | 1.2. if the charter does not provide for the manner of such appointment, as specified in a decision of the board of directors. The chairman shall determine the order of business and may establish rules and regulations for the conduct of the assembly, provided that such rules shall not unduly discriminate against or impair the participatory rights of any shareholders. | 1.2. ako statut ne predviđa izbor predsedavajućeg, onda na osnovu odluke Odbora direktora. Predsedavajući odlučuje o način održavanja Skupštine i može utvrditi pravila i Poslovnik o radu za održavanje skupštine, pod uslovom da ta pravila ne diskriminišu ili ometaju pravo učešća svakog deoničara. |
| 2. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në statut, votimi do të bëhet me cilëndo metodë të zakonshme dhe të arsyeshme, siç e përcakton kryesuesi. | 2. Unless set out otherwise in the charter, voting shall be by any reasonable, customary and convenient method as the chairman determines. | 2. Osim ako nije drugačije utvrđeno u statutu, glasanje će biti po bilo kom uobičajenim i razumnim metodom, kao što je utvrđeno od strane predsedavajućeg. |
| **Neni 189**<br>**Disponueshmëria e Listës së Aksionarëve për Kuvendin** | **Article 189**<br>**Availability of Shareholder List for an Assembly** | **Član 189**<br>**Dostupnost Spiska deoničara za Skupštinu** |
| Jo më shumë se tri (3) ditë para mbajtjes së kuvendit, Shoqëria Aksionare duhet të vendos në dispozicion për inspektim dhe kopjim nga secili aksionar, me shpenzimet e aksionarit listën e të gjithë aksionarëve që kanë të drejtë vote në kuvend dhe të gjithë aksionarëve të cilëve u është dërguar njoftimi për mbajtjen e kuvendit. Kjo listë duhet të jetë në dispozicion në adresën e regjistruar të Shoqërisë Aksionare dhe duhet të jetë në dispozicion të aksionarëve | Not later than three (3) days before any assembly, a Joint Stock Company shall make available for inspection and copying by any shareholder at the shareholder's expense a list of all shareholders who are entitled to vote at the assembly and all shareholders to whom notice of the assembly was sent. Such list shall be available at the Joint Stock Company's registered address and shall also be kept available for inspection by any shareholder | Ne više od tri (3) dana pre održavanja Skupštine, Deoničarsko društvo mora učiniti dostupnim za inspekciju i kopiranje od svakog deoničara, na troškove deoničara, spisak svih deoničara sa pravom glasa u Skupštini i svim deoničarima kojima je poslato obaveštenje o Skupštini. Ovaj spisak treba biti dostupan na registrovanoj adresi Deoničarskog društva i mora biti dostupan deoničarima tokom Skupštine. |

| | | |
|---|---|---|
| gjatë kuvendit. | at and during the assembly. | |
| **Neni 190**<br>**Votimi Personal ose Përmes Përfaqësuesit** | **Article 190**<br>**Voting in Person or by Proxy** | **Član 190**<br>**Glasanje lično ili preko punomoćnika** |
| 1. Aksionari mund të votojë me aksionet e tij ose personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit, sikurse është përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni. | 1. A shareholder may vote his shares either in person or by proxy as provided for in paragraph 3 of this article. | 1. Deoničar može da glasa sa svojom deonicom ili lično, ili preko punomoćnika, kao što je utvrđeno stavom 3 ovog člana. |
| 2. Përveç kur zbatohet paragrafi 2 i nenit 192 të këtij ligji, aksionet të cilat mbahen nga një Shoqëri Tregtare, apo person juridik, mund te votohen nga një përfaqësues i autorizuar i personit juridik apo Shoqërisë Tregtare, ose përfaqësuesi i përcaktuar në mënyrë të rregullt nga përfaqësuesi i autorizuar i asaj Shoqërie Tregtare, apo i atij personi juridik. | 2. Except where paragraph 2 of Article 192 of this Law applies, shares held by a Business Organization or legal person may be voted by an authorized representative of such Business Organization or legal person or the duly designated proxy of such authorized representative. | 2. Osim kada se primenjuje stav 2 člana 192 ovog zakona, deonicama koje drži Privredno društvo može se glasati od strane ovlašćenog predstavnika tog Privrednog društva ili propisno imenovanog punomoćnika od ovlašćenog zastupnika. |
| 3. Aksionari mund ta emërojë një përfaqësues për të votuar në emër të aksioneve të tij pas dorëzimit të një deklarate për caktimin e përfaqësuesit të nënshkruar nga aksionari, ose nëse aksionari është Shoqëri Tregtare apo person juridik atëherë nga një përfaqësues i autorizuar i asaj Shoqërie Tregtare apo personi juridik. Deklarata për caktimin e përfaqësuesit duhet të përcaktojë shprehimisht se përfaqësuesi e ka te drejtën që të votojë me aksionet e aksionarit. | 3. A shareholder may appoint a proxy to vote his shares by providing such proxy with a written designation of proxy signed by the shareholder or, if the shareholder is a Business Organization or legal person, an authorized representative of such Business Organization or legal person. Such written designation of proxy must clearly state that the proxy shall have the power to vote the shareholder’s shares. | 3. Deoničar može imenovati punomoćnika da glasa u ime njegovih deonica nakon podnošenja izjave o određivanju punomoćnika potpisane od deoničara, ili ako je deoničar Poslovno društvo ili pravno lice, u tom slučaju od strane ovlašćenog punomoćnika tog Poslovno društva. Izjava o određivanju punomoćnika treba da navede izričito da punomoćnik ima pravo da glasa deonicama deoničara. |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Kopja e nënshkruar e deklaratës për caktimin e përfaqësuesit duhet ti dërgohen përfaqësuesit dhe sekretarit të Shoqërisë Aksionare ose zyrtarit tjetër përkatës të Shoqërisë Aksionare para fillimit të kuvendit ose në fillim të kuvendit. Deklarata për caktimin e përfaqësuesit mund të përmbajë kufizime në autorizimet e përfaqësuesit për të votuar në emër të aksionarit, por pa u kufizuar në udhëzimet se si duhet të votohen aksionet në një kuvend të caktuar. Nëse në deklaratën për caktimin e përfaqësuesit nuk janë paraparë këso kufizime ose udhëzime, atëherë përfaqësuesi është i lirë për t'i votuar aksionet sipas vullnetit të tij/saj.<br><br>5. Anëtari i Bordit të Drejtorëve ose një zyrtar apo menaxher i lartë i Shoqërisë Aksionare nuk mund të shërbejnë si përfaqësues i një aksionari i cili njëkohësisht është punonjës i Shoqërisë Aksionare.<br><br>6. Deklarata për caktimin e përfaqësuesit skadon, cilado që është më herët:<br><br>6.1. në datën e skadimit të përcaktuar në deklaratë; ose<br><br>6.2. gjashtë muaj pas datës së nënshkrimit të deklaratës; ose<br><br>6.3. në kohën e revokimit të | 4. Signed copies of the written designation of proxy must be delivered to the proxy and to the Joint Stock Company Secretary or other relevant officer of the Joint Stock Company prior or at the beginning of the assembly. Such a designation of proxy may contain restrictions on the proxy's authority to vote the shares, including but not limited to directions on how the shares must be voted at a particular assembly. If the designation of proxy does not contain such restrictions or directions, the proxy may vote the shares as he wishes.<br><br>5. A member of the Board of Directors, or an officer or senior manager of the concerned Joint Stock Company may not act as a proxy for a shareholder who is simultaneously an employee of that Joint Stock Company.<br><br>6. A designation of proxy shall expire on the earlier of:<br><br>6.1. the expiration date specified therein, if any; or<br><br>6.2. the date that is six months from the date the designation of proxy is issued; or<br><br>6.3. if applicable, the moment the | 4. Kopija potpisane izjave za određivanje punomoćnika mora biti poslata punomoćniku i sekretaru Deoničarskog društva ili drugom nadležnom zvaničniku Deoničarskog društva pre početka Skupštine ili na početku Skupštine. Izjava o određivanju punomoćnika može da sadrži ograničenja u ovlašćenjima punomoćnika da glasa u ime deoničara, ali ne ograničavajući se na uputstva o tome kako se mogu glasati deonice u određenoj skupštini. Ako izjava o određivanju punomoćnika ne sadrži takva ograničenja ili uputstva, punomoćnik može da glasa akcije u skladu sa njegovom / njenom voljom.<br><br>5. Član Odbora direktora ili visoki zvaničnik ili menadžer Deoničarskog društva ne može da služi kao punomoćnik deoničara koji je istovremeno radnik Deoničarskog društva.<br><br>6. Izjava o određivanju punomoćnika ističe, svaka koja je ranije:<br><br>6.1. na dan isteka navedenog u izjavi; ili<br><br>6.2. šest meseci nakon potpisivanja izjave; ili<br><br>6.3. u vreme povlačenja izjave od |

| | | |
|---|---|---|
| deklaratës nga personi i cili e ka nënshkruar deklaratën sipas paragrafin 7 të këtij neni. | person who provided the designation of proxy revokes such designation of proxy in any manner provided for by paragraph 7 of this article. | strane osobe koja je potpisala izjavu iz stava 7. ovog člana. |
| 7. Personi që ka nënshkruar deklaratën për caktimin e përfaqësuesit mund ta revokojë këtë deklaratë në çdo kohë para fillimit të votimit në kuvendin e aksionare në dy mënyra, si vijon: | 7. A person who has provided another person with a designation of proxy may revoke that designation at any time by either by: | 7. Osoba koja je potpisala izjavu o određivanju punomoćnika može povući ovu izjavu u bilo kom trenutku pre početka glasanja u Skupštini deoničara na dva načina, i to: |
| 7.1 përmes dërgimit të një njoftimi me shkrim për revokim në sekretariatin e Shoqërisë Aksionare ose te zyrtari përgjegjës i Shoqërisë Aksionare para fillimit të kuvendit; ose | 7.1 delivering a revocation in writing to the to the Joint Stock Company secretary or other relevant officer of the Joint Stock Company prior to the beginning of the assembly; or | 7.1. slanjem pismenog obaveštenja o opozivu Sekretarijatu Deoničarskog društva ili odgovornom zvaničniku Deoničarskog društva pre početka Skupštine; ili |
| 7.2 përmes pjesëmarrjes në kuvendin përkatës dhe votimit personal. | 7.2 by attending the concerned assembly and voting the concerned shares in person. | 7.2. kroz učešće u dotičnoj Skupštini i ličnim glasanjem. |
| 8. Revokimi i deklaratës për caktimin e përfaqësuesit nuk e zhvleftëson votën e hedhur nga përfaqësuesi para këtij revokimi, nëse kjo votë ka qenë e vlefshme në kohën e hedhjes. | 8. A revocation of a designation of proxy shall not render invalid any vote that was cast by the proxy prior to such revocation, if such vote was valid when cast. | 8. Opoziv izjave o određivanju punomoćnika ne poništava glas preko punomoćnika pre ovog opoziva, ako je to glasanje bilo važila u vreme kada se glasalo. |
| **Neni 191**<br>**Kuorumi dhe Votat e Nevojshme për Marrjen e Vendimeve në Kuvend** | **Article 191**<br>**Quorum and Vote Required for Decision at an Assembly** | **Član 191**<br>**Kvorum i potrebni glasovi za donošenje odluke na Skupštini** |
| 1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në statutin e Shoqërisë Aksionare, shumica e votave të aksioneve që kanë të drejtë vote | 1. Unless otherwise provided in a Joint Stock Company's charter, a majority of votes of the shares entitled to vote on a | 1. Osim ako nije drugačije određeno statutom Deoničarskog društva, većina glasova deonica sa pravom glasa o |

| | | |
|---|---|---|
| në çështjen përkatëse, që përfaqësohen personalisht ose përmes përfaqësuesit, përbëjnë kuorumin në kuvend.<br><br>2. Nëse kuorumi është arritur, votimi i shumicës së aksioneve që kanë të drejtë vote të përfaqësuar në kuvend do të jetë akti dhe vendimi i kuvendit, përveç nëse kërkohet një numër më i madh votash sipas këtij ligji ose statutit të Shoqërisë Aksionare.<br><br>3. Statuti i Shoqërisë Aksionare mund të përcaktojë kuorum më të madh ose kushte të tjera të votimit nga ato të përcaktuara në këtë nen.<br><br>4. Një propozim për ndryshimin dhe plotësimin e statutit që ka për qëllim plotësimin, ndryshimin ose heqjen e një kërkese të votimit duhet të miratohet nga aksionarët në pajtim me, cilëndo që është me e madhe:<br><br>4.1. kuorumin dhe kërkesat e votimit të përcaktuara në statutin ekzistues; ose<br><br>4.2. kuorumin dhe kërkesat e votimit që do të hyjnë në fuqi pas miratimit, regjistrimit dhe publikimit të ndryshimit dhe plotësimit.<br><br>5. Nëse statuti i Shoqërisë Aksionare ose | matter, represented in person or by proxy, shall constitute a quorum for action of the assembly on that matter.<br><br>2. If a quorum is present, the affirmative vote of the majority of the shares represented at the assembly shall be the act and decision of the assembly, unless a greater number of votes are required by the present law or the Joint Stock Company's charter.<br><br>3. A Joint Stock Company's charter may provide for a greater quorum or voting requirement than is provided for in above in this article.<br><br>4. A proposed amendment to the charter that seeks to add, modify or delete a quorum or voting requirement must be adopted by the shareholders in accordance with the greater/more restrictive of the following:<br><br>4.1. the quorum and voting requirements found in the existing charter; or<br><br>4.2. the quorum and voting requirements that will enter into force after the approval, registration and publication of the amendment.<br><br>5. If a Joint Stock Company's charter or | dotičnom pitanju, koji se predstavljaju lično ili preko punomoćnika, čini kvorum u Skupštini.<br><br>2. Ako je kvorum postignut, glasanje većine deonica sa pravom glasa zastupljenih na Skupštini će biti akt i odluka Skupštine, osim ako se traži veći broj glasova u skladu sa ovim zakonom ili statutom Deoničarskog društva.<br><br>3. Statut Deoničarskog društva može utvrditi veći kvorum ili druge uslove glasanja od onih utvrđenih ovim članom.<br><br>4. Predlog izmena i dopuna statuta koji ima za cilj dopunu, izmenu ili uklanjanje zahteva glasanja mora biti usvojen od strane deoničara, u skladu sa, koje god je veće:<br><br>4.1. kvorumom i zahtevima glasanja utvrđenih postojećim statutom; ili<br><br>4.2. kvorumom i zahtevima glasanja koji će stupiti na snagu nakon usvajanja, registracije i objavljivanja izmena i dopuna.<br><br>5. Ako statut Deoničarskog društva ili ovaj |

| | | |
|---|---|---|
| ky ligj kërkojnë votimin e një lloji ose kategorie të caktuar të aksioneve për një çështje të caktuar, vendimi për atë çështje merret kur votohet nga ky grup votues. Rregullat në paragrafët1 dhe 3 të këtij neni, do të aplikohen në relacion me votat nga ai lloj i kategorisë, përveç nëse ajo votë nga kategoria apo lloji do të njihet si mbledhje e veçantë edhe nëse e mbajtur në kuvendin apo forumin e njëjtësi kuvendi i plotë i aksionarëve. | this law provides for voting by a single type or class of stock on a matter, action on that matter shall be taken when voted upon by that voting group. The rules in paragraph 1 and 3 of this Article shall apply in relation to the votes by that class or type, except that the vote by the class or type shall be regarded as a separate assembly even if held in the same assembly or forum as the full shareholders' assembly. | zakon zahtevaju glasanje određene vrste ili kategorije deonica o određenom pitanju, odluka o tom pitanju se donosi kada se izglasa od strane ove grupe glasača.. Pravila iz stava 1 i 3 ovog člana će se primeniti u odnosu na glasove od takve vrste kategorije, osim ako će se takvo glasanje iz kategorije ili vrste smatrati posebnim sastankom i ako je održano na istoj skupštini ili forumu kao celokupna skupština deoničara. |
| 6. Kuvendi i aksionarëve nuk është i vlefshëm nëse kuorumi nuk është arritur, personalisht ose përmes përfaqësuesve. Për tu regjistruar si të pranishëm, secili aksionar ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të dëshmojnë, dhe Shoqëria Aksionare duhet ta verifikojë, se aksionari është regjistruar në mënyrë të rregullt në listën e aksionarëve në datën e mbajtjes së kuvendit. | 6. A shareholder assembly may not undertake business on any item of business unless the required applicable quorum is present in person or by proxy. To be registered as present, each shareholder or his authorized proxy must demonstrate, and the Joint Stock Company must verify, that the shareholder was properly entered in the list of shareholders on the record date. | 6. Skupština deoničara nije važeća ukoliko nije postignut kvorum, lično ili preko punomoćnika. Da bi se registrovali kao prisutni, svaki deoničar ili njegov ovlašćeni predstavnik mora da dokaže, i Deoničarsko društvo treba da potvrdi, da je deoničar uredno registrovana na listi deoničara na dan održavanja sastanka. |
| 7. Kuvendi i aksionarëve shtyhet nëse nuk është arritur kuorumi i kërkuar, brenda një afati të arsyeshëm kohor pas caktimit të mbledhjes. | 7. A shareholder assembly shall be adjourned if the required quorum is not present within a reasonable period after its scheduled time. | 7. Skupština deoničara se odlaže ako nije postignut traženi kvorum, nakon razumnog roka nakon određivanja sastanka. |
| 8. Nëse kuvendi i aksionarëve shtyhet për shkak të mungesës së kuorumit, Shoqëria Aksionare duhet që brenda dy javëve pas datës së shtyrjes së kuvendit, t'i thërrasë dhe t'i njoftojë mbi kuvendin e ri të aksionarëve. Për kuvendin e ri, kuorumi | 8. If a shareholder meeting is adjourned because a quorum was not present, the Joint Stock Company shall, within two weeks after the date of such adjourned assembly, call and give notice of a new assembly of shareholders. For such new | 8. Ako se Skupština deoničara odlaže zbog nedostatka kvoruma, Deoničarsko društvo, u roku od dve nedelje nakon odlaganja skupštine, treba da ih pozove i obavesti o novoj skupštini deoničara. Za novu skupštinu, kvorum je 33% akcija sa pravom |

| | | |
|---|---|---|
| është 33% të aksioneve me të drejtë vote të caktuar dhe vendimi do të jetë thjeshtë shumica përveç nëse është përcaktuar ndryshe sipas këtij ligji ose me statutin e Shoqërisë Aksionare. | assembly, the quorum will be 33% of the votes of shares entitled to be cast and the decision shall be by a simple majority unless the present law or the Joint Stock Company's charter provides otherwise. | glasa i odluka će biti prosta većina, osim ako je drugačije određeno ovim zakonom ili statutom Deoničarskog društva. |
| **Neni 192**<br>**Të Drejtat e Votimit të Aksioneve** | **Article 192**<br>**Voting Rights of a Share** | **Član 192**<br>**Prava glasanja deonica** |
| 1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në statut ose në këtë ligj, çdo aksion i thjeshtë ose aksion i privilegjuar duhet të ketë të drejtën e një vote për çdo çështje që votohet në një kuvend. | 1. Except as provided in the charter or the present law, each outstanding share of common stock or preferred stock of any class shall be entitled to one vote on each matter voted on at an assembly. | 1. Osim ako nije drugačije utvrđeno statutom ili ovim zakonom, svaki jednostavna deonica ili privilegovana deonica mora da ima pravo na jedan glas za svako pitanje koje se glasa na skupštini. |
| 2. Aksionet nuk mund të votohen në një kuvend nëse janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Shoqërisë Aksionare ose të cilitdo person juridik apo Shoqëri Tregtare në të cilën Shoqëria Aksionare ka aksione ose interesa të tjera që i japin të drejtën Shoqërisë Aksionare të kontrollojë votimin nga aksionet e kësaj Shoqërie Tregtare. | 2. Shares may not be voted at an assembly if the shares are owned, directly or indirectly, by the Joint Stock Company or any legal person and/or Business Organization in which the Joint Stock Company has, directly or indirectly, a share or an ownership interest, entitling the Joint Stock Company to control voting from the shares of such Business Organization. | 2. Deonice se ne mogu glasati na skupštini ako su u vlasništvu direktno ili indirektno Deoničarskog društva ili bilo kog pravnog lica i/ili poslovnog društva u kom Deoničarsko društvo ima deonice ili druge interese koji daju pravo Deoničarskom društvu da vrši kontrolu glasanja od deonica ovog poslovnog društva. |
| **Neni 193**<br>**Të Drejtat e Votimit të Aksionarëve të Caktuar** | **Article 193**<br>**Voting Rights of Certain Types of Holders** | **Član 193**<br>**Pravo glasanja određenih vrsta deoničara** |
| 1. Aksionari, aksionet e të cilit janë venë si peng, ka të drejtë vote deri në kohën e bartjes së aksioneve tek pengmarrësi, pas bartjes së aksioneve, pengmarrësi fiton të | 1. A shareholder whose shares are pledged shall be entitled to vote such shares until the shares have been transferred into the name of the pledgee, and thereafter the | 1. Deoničar, čije su akcije stavljene u zalog, ima pravo da glasa do trenutka prenosa deonica na hipotekarnog poverioca, nakon prenosa deonica, hipotekarni poverilac stiče |

| | | |
|---|---|---|
| drejtën e votimit për ato aksione. Megjithatë, nëse marrëveshja e pengut parasheh bartjen e menjëhershme të të drejtës për votimin e aksioneve dhe kjo e drejte evidentohet në kuvendin përkatës të aksionarëve, pengmarrësi do të ketë të drejtë që të votojë aksionet në kuvendin përkatës. | pledgee shall be entitled to vote such shares. If however the pledge agreement grants the voting rights to the pledgee and evidence of this is presented at the concerned shareholders assembly, the pledgee shall be entitled to vote the shares. | pravo glasa o tim deonicama.. Međutim, ako sporazum o zalozi predviđa neposredan prenos prava glasa deonica i ovo pravo se evidentira u odgovarajućoj skupštini deoničara, hipotekarni poverilac će imati pravo da glasa deonice u odgovarajućoj skupštini. |
| 2. Aksionet të cilat mbahen në emër të një personi të vdekur, një personi të mitur ose ndonjë personi tjetër i cili nuk ka aftësi të veprimit, mund të votohen nga përfaqësuesi ligjor i personit në fjalë sipas ligjit, personalisht ose përmes përfaqësuesit të përcaktuar nga përfaqësuesi ligjor, pa bërë bartjen e aksioneve në fjalë në emër të përfaqësuesit të tillë. | 2. Shares held in the name of a deceased person, a minor or another person who is under a legal disability may be voted by such person's legal representative established by law, either in person or by the legal representative's duly designated proxy, without a transfer of such shares into the name of such representative. | 2. Deonice koje se drže u ime pokojnika, maloletnika ili drugog lica koje nije sposobno da deluje, mogu se glasati preko zakonskog zastupnika dotične osobe u skladu sa zakonom, lično ili preko predstavnika određenog od strane pravnog zastupnika, bez prenosa odnosnih deonica na ime tog zastupnika. |
| 3. Aksionet që janë në kontroll të një pranuesi, Përfaqësuesi të Autorizuar në Procedurë të Falimentimit ose personi të ngjashëm, mund të votohen nga personi në fjalë ose përfaqësuesi i tij i autorizuar pa bërë bartjen e aksioneve në emër të personit të tillë, nëse autorizimi për këtë është përcaktuar në vendimin e gjykatës. | 3. Shares held in the name of a receiver, Authorized Representative in a Bankruptcy Procedure or similar person may be voted by such person, or his duly designated proxy, without a transfer of such shares into the name of such person, if the authority to do so is contained in specified in a court order. | 3. Deonice koje su u kontroli primaoca, ovlašćeni zastupnik u stečajnom postupku ili slična soba, mogu se glasati od strane dotičnog lica ili njegovog ovlašćenog zastupnika bez prenosa deonica u ime tog lica, ako je ovlašćenje o tome utvrđeno odlukom suda. |
| **Neni 194**<br>**Procesverbali i Kuvendit** | **Article 194**<br>**Record of an Assembly** | **Član 194**<br>**Zapisnik Skupštine** |
| 1. Procesverbali i secilit kuvend të aksionarëve duhet të përgatitet menjëherë | 1. A record of each shareholders' assembly shall be prepared promptly after | 1. Zapisnik sa svake skupštine deoničara mora biti pripremljeni odmah nakon |

| | | |
|---|---|---|
| 1.Kërkesat e kreditorëve ndaj një Shoqërie Aksionare që i është nënshtruar shpërbërjes vullnetare mund të ekzekutohen:<br><br>1.1. ndaj Shoqërisë Aksionare që i është nënshtruar shpërbërjes vullnetare, deri në atë masë sa asetet e saj nuk i janë shpërndarë aksionarëve; ose<br><br>1.2. nëse të gjitha asetet u janë shpërndarë Aksionarëve gjatë procedurës së shpërbërjes vullnetare, ndaj cilitdo Aksionar, deri në shumën e aksioneve të tij pro-rata ose aseteve që i janë shpërndarë atij gjatë shpërbërjes vullnetare, cilado të jetë më e vogël. Detyrimet e përgjithshme të Aksionarit për të gjitha kërkesat e kreditorëve sipas këtij neni, nuk mund ta tejkalojnë shumën e përgjithshme të aseteve të Shoqërisë Aksionare që i janë shpërndarë atij. | 1. Creditor claims against a Joint Stock Company under voluntary dissolution may be enforced:<br><br>1.1. against the voluntarily dissolved Joint Stock Company, to the extent of its assets which have not been distributed to the shareholders; or<br><br>1.2. if all of the assets have been distributed to the shareholders in voluntary dissolution procedure, against any shareholder to the extent of his pro-rata share of the claim or of the Joint Stock Company’s assets which have been distributed to him in liquidation, whichever is less. A shareholder’s total liability for all claims under this article shall not exceed the total amount of assets of the Joint Stock Company distributed to him. | 1. Potraživanja poverilaca protiv deoničarskog društva u postupku dobrovoljnog raspuštanja mogu da se izvrše:<br>1.1. protiv deoničarskog društva koje je u postupku dobrovoljnog raspuštanja, do mere do koje njena imovine nije raspoređena deoničarima, ili<br><br>1.2. ako je sva imovina raspoređena deoničarima tokom postupka dobrovoljnog raspuštanja, protiv bilo kojeg deoničara do iznosa njegovih deonica *pro rata* ili imovine društva koja je bila raspoređena njemu tokom dobrovoljnog raspuštanja, koje god bilo manje. Opšte obaveze deoničara za sva potraživanja poverilaca prema ovom članu ne mogu da budu veća od ukupnog iznosa imovine deoničarskog društva koja je raspodeljena istom. |

| | | |
|---|---|---|
| **PJESA E TETË**<br>**BASHKIMI DHE NDARJA E KORPORATAVE**<br><br>**KAPITULLI I - BASHKIMI I SHOQËRIVE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**<br><br>**Neni 216**<br>**Bashkimi i Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar**<br><br>1. Një apo më shumë Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar mund të bashkohen në një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të themeluar sipas këtij ligji.<br><br>2. Për këtë qëllim, “bashkimi” do të thotë transaksion në të cilin një apo më shumë Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar:<br><br>2.1. bashkohen dhe bartin të gjitha asetet dhe detyrimet e tyre tek njëra prej tyre; ose<br><br>2.2. bashkohen dhe bartin të gjitha asetet dhe detyrimet e tyre në një Shoqëri të re me Përgjegjësi të Kufizuar të themeluar në pajtim me këtë Ligj, si dhe sipas kushteve të përcaktuara në nenin 220 të këtij ligji.<br><br>3. Për t’u bashkuar, Drejtori(ët) menaxhues | **PART EIGHT**<br>**MERGER AND DEMERGER OF CORPORATIONS**<br><br>**CHAPTER I - MERGER OF LIMITED LIABILITY COMPANIES**<br><br>**Article 216**<br>**Merger of a Limited Liability Company**<br><br>1. One or more Limited Liability Companies may merge into a Limited Liability Company established under the present Law.<br><br>2. For this purpose, a “merger” means a transaction in which one or more Limited Liability Companies:<br><br>2.1. merge and transfer all of their assets and obligations into one of them; or<br><br>2.2. merge and transfer all of their assets and obligations in a new Limited Liability Company established according to the present Law, and according to the conditions specified in Article 220 of this Law.<br><br>3. In order to merge, the Managing | **DEO OSAM**<br>**SPAJANJE I RAZDVAJANJE KORPORACIJA**<br><br>**POGLAVLJE I - SPAJANJE DRUŠTAVA SA OGRANIČENOM ODGOVORNOŠĆU**<br><br>**Član 216**<br>**Spajanje kompanija sa ograničenom odgovornošću**<br><br>1. Jedno ili više društava sa ograničenom odgovornošću može se spojiti u društvo sa ograničenom odgovornošću obrazovanu shodno ovom zakonu.<br><br>2. U ovu svrhu, “spajanje” predstavlja transakciju kojom se jedno ili više društava sa ograničenom odgovornošću:<br><br>2.1. spaja i prenose svoju celokupnu imovinu i obaveze na jednu od njih; ili<br><br>2.2. spaja i prenosi svu svoju imovinu i obaveze na novu društvo sa ograničenom odgovornošću, koje je osnovano u skladu sa postojećim zakonom i u skladu sa uslovima propisanim u članu 220 ovog zakona.<br><br>3. Da bi se izvršilo spajanje, direktor (i) |

| | | |
|---|---|---|
| të cilët kanë të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar lidhin Marrëveshje Bashkimi. Të drejtat dhe detyrimet sipas Marrëveshjes së Bashkimit lindin pas miratimit të marrëveshjes në pajtim me procedurën e përcaktuar me nenin 218 të këtij ligji. | Director(s) entitled to represent the Limited Liability Companies shall enter into a Merger Agreement. Rights and obligations shall arise from the Merger Agreement after approval of the agreement pursuant to the procedure provided for in Article 218 of this Law. | koji ima prava da predstavlja društva sa ograničenom odgovornošću stupa u sporazum o spajanju. Prava i obaveze prostiću iz sporazuma o spajanju nakon usvajanja sporazuma shodno proceduri određenoj u članu 218. ovog zakona. |
| 4. Marrëveshja e bashkimit duhet të përmbajë: | 4. A merger agreement shall set out: | 4. Sporazum o spajanju uspostavlja i utvrđuje; |
| 4.1. Emrin zyrtar, si dhe Emrat Tregtarë, nëse ka, si dhe adresat e regjistruara të Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar; | 4.1. the official name, and trade names if any, and registered addresses of the Limited Liability Companies; | 4.1. zvaničan naziv, i trgovinsko ime ukoliko postoji, i registrovanu adresu društva sa ograničenom odgovornošću; |
| 4.2. marrëveshjen për bartjen e të gjitha aseteve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar që përvetësohet tek Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar përvetësuese në këmbim me bartjen e aksioneve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar përvetësuese; | 4.2. an agreement to transfer all the assets of the Limited Liability Company being acquired to the acquiring Limited Liability Company in exchange for a transfer of shares of the acquiring Limited Liability Company; | 4.2. sporazum o prenosu s imovine društva sa ograničenom odgovornošću koja je stečena u društvu sa ograničenom odgovornošću u razmenu za prenos deonica novog društva sa ograničenom odgovornošću; |
| 4.3. norma e këmbimit të aksioneve për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe shumën e pagesave shtesë nëse bëhen pagesa shtesë; | 4.3. the share exchange ratio for the Limited Liability Companies and the amount of additional payments if additional payments are made; | 4.3. Odnos udela deonica za društva sa ograničenom odgovornošću i iznos dodatnih plaćanja ukoliko su dodatna plaćanja izvršena; |
| 4.4. kushtet dhe afatet e bartjes së aksioneve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar përvetësuese; | 4.4. the terms and conditions of transfer of the shares of the acquiring Limited Liability Company; | 4.4. uslovi prenosa deonica stečenog društva sa ograničenom odgovornošću |

| | | |
|---|---|---|
| 4.5 datën në të cilën aksionet e bartura krijojnë të drejtën në ndarjen e profitit në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar përvetësuese si dhe kushtet e posaçme që ndikojnë në këtë të drejtë; | 4.5. the date as of which the transferred shares shall grant the right to a share of profit of the acquiring Limited Liability Company and the special conditions affecting this right; | 4.5. datum od kada prenete deonice pružaju pravo na udeo u profitu novog društva sa ograničenom odgovornošću i specijalni uslovi koji utiču na ovo pravo; |
| 4.6. të drejtat të cilat Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar përvetësuese do t'i japë Aksionarëve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar që përvetësohet; | 4.6. the rights which the acquiring Limited Liability Company will grant to the shareholders of the Limited Liability Company being acquired; | 4.6. prava po kojima novo društvo sa ograničenom odgovornošću pruža akcionarima novog društva sa ograničenom odgovornošću; |
| 4.7. pasojat e bashkimit për punëtorët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar që përvetësohet; | 4.7. the consequences of merger for the employees of the Limited Liability Company being acquired; | 4.7. posledice spajanja za zaposlene u novom društvu sa ograničenom odgovornošću; |
| 4.8. data në të cilën transaksionet e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar që përvetësohet do të konsiderohet të jetë marrë përsipër nga Shoqëria Përgjegjësi të Kufizuar përvetësuese (data e bilancit të gjendjes së bashkimit); | 4.8. the date as of which the transactions of the Limited Liability Company being acquired shall be deemed to be undertaken by the acquiring Limited Liability Company (merger balance sheet date); | 4.8. datum od kojeg transakcije društva sa ograničenom smatraju da ih je preduzelo novo društvo sa ograničenom odgovornošću (datum spojenog bilansa); |
| 4.9. kompensimi që i paguhet auditorit që auditon marrëveshjen e bashkimit, këshilltarëve të tjerë dhe konsulentëve si dhe përparësitë që fitojnë, në lidhje me bashkimin, Drejtorin(ët) Menaxhues ose Aksionarët me të drejtë përfaqësimi të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. | 4.9. the remuneration paid to the auditor who audits the merger agreement, other advisers and consultants and the advantages granted in connection with the merger to the Managing Director(s) or the Shareholders entitled to represent the Limited Liability Company. | 4.9. nadoknada plaćena revizoru koji vrši reviziju sporazuma o spajanju, drugim savetnicima i konsultantima i povoljnosti koje su pružene u vezi sa spajanjem u vezi sa glavnog direktora ili akcionare koji imaju pravo da predstavljaju društvo sa ograničenom odgovornošću. |

| | | |
|---|---|---|
| 5. Shuma e pagesave shtesë e përcaktuar me marrëveshjen e bashkimit që duhen paguar nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar përvetësuese për Aksionarë te Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar që përvetësohet, të cilat nuk mund të tejkalojë një të dhjetën e shumës së vlerave nominale apo vlerës së përgjithshme të aksioneve të këmbyera. | 5. The sum of additional payments prescribed in the merger agreement which are to be paid by an acquiring Limited Liability Company to the Shareholders of the Limited Liability Company being acquired shall not exceed one-tenth of the sum of the nominal values or book values of their exchanged shares. | 5. Zbir dodatnih plaćanja propisanih u sporazumu o spajanju koja treba da se isplate od strane novog društva sa ograničenom odgovornošću za akcionare novog društva sa ograničenom odgovornošću ne prelaze jednu desetinu iznos nominalne knjigovodstvene vrednosti njihovih deonica. |
| 6. Nëse të gjitha aksionet e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar që përvetësohet mbahen nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar përvetësuese, marrëveshja e bashkimit nuk ka nevojë të japë informatat e përcaktuara me paragrafin 4.2.- 4.4 të këtij neni. | 6. If all shares of a Limited Liability Company being acquired are held by the acquiring Limited Liability Company, the merger agreement need not indicate the information specified in paragraphs 4.2.- 4.4 of this Article. | 6. Ukoliko sve deonice novog društva sa ograničenom odgovornošću budu u rukama starog društva sa ograničenom odgovornošću, sporazum o spajanju ne mora da navodi informacije precizirane u tačkama 4.2.- 4.4 ovog člana. |
| **Neni 217**<br>**Përmbajtja e Planit të Bashkimit** | **Article 217**<br>**Contents of the Merger Plan** | **Član 217**<br>**Sadržaj plana o spajanju** |
| 1. Plani i bashkimit përmban: | 1. A merger plan shall contain: | 1. Plan o spajanju sadrži: |
| 1.1. Emrin zyrtar, si dhe Emrat Tregtarë, nëse ka, si dhe adresat e regjistruara dhe Numrin Unik të Identifikimit të secilës Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar që përfshihet në bashkimin e propozuar; | 1.1. the official name, and trade names if any, and the registered address and Unique Identification Number of each Limited Liability Company involved in the proposed merger; | 1.1. zvanični naziv, i trgovinski naziv ukoliko postoji, i registrovanu adresu i jedinstveni identifikacioni broj svakog društva sa ograničenom odgovornošću uključenog u predloženo spajanje; |
| 1.2. Emrin zyrtar, si dhe Emrin Tregtar, nëse ka, si dhe adresën e regjistruar të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, që propozohet të mbijetojë, brenda të cilës | 1.2. the official name, and trade name if any, and the registered address of the Limited Liability Company, which is proposed to survive, into | 1.2. zvanični naziv i trgovinski naziv ukoliko postoji, i adresu registrovanog društva sa ograničenom odgovornošću predložene da opstane, |

| | | |
|---|---|---|
| Shoqëritë tjera me Përgjegjësi të Kufizuar bashkohen (fuzionohen);<br><br>1.3. kushtet materiale të bashkimit të propozuar,<br><br>1.4. për çdo Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të bashkuar përveç Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar përvetësuese: një përshkrim të hollësishëm të mënyrës dhe bazës që propozohet të përdoret për konvertimin e Aksioneve të kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar në të cilën bashkohen, në:<br><br>1.4.1. para;<br><br>1.4.2. pasuri të tjera, si dhe/ose<br><br>1.4.3. Aksionet dhe/ose letrat me vlerë, borxhet dhe detyrimet tjera të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar që mbijeton ose të ndonjërit Aksionar të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mbijuetuese;<br><br>1.5. i gjithë teksti i Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ose Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar mbijetuese që do të krijohet pas këtij bashkimi.<br><br>2. Nëse Shoqëria Aksionare është palë në bashkim, atëherë duhen plotësuar edhe | which the other Limited Liability Companies merge (fuse);<br><br>1.3. the material conditions of the proposed merger,<br><br>1.4. for each merged Limited Liability Company other than the acquiring Limited Liability Company: a detailed description of the manner and basis that is proposed to be used for converting the Shares of this Limited Liability Company being merged into:<br><br>1.4.1. cash;<br><br>1.4.2. other property, and/or<br><br>1.4.3. Shares and/or other securities, debts or other obligations of the surviving Limited Liability Company or of any Shareholders of the surviving Limited Liability Company;<br><br>1.5. the entire text of the Charter of the Limited Liability Company or Charter of the surviving Limited Liability Company that will be created after this merger.<br><br>2. If a Joint Stock Company is a party to the merger, then the requirements set out | a u koju će se spojiti (stopiti) ostale društva sa ograničenom odgovornošću;<br>1.3. materijalne uslove predloženog spajanja;<br><br>1.4. za svaku spojeno društvo sa ograničenom odgovornošću, sem društva sa ograničenom odgovornošću sticaoca: detaljan opis načina i osnove kako je predloženo za pretvaranje deonica ove društva sa ograničenom odgovornošću u procesu spajanja za:<br><br>1.4.1. gotovinu;<br><br>1.4.2. drugu imovinu; i/ili<br><br>1.4.3. deonice i/ili hartije od vrednosti ili druga dugovanja ili potraživanja opstala društva sa ograničenom odgovornošću ili bilo koga od opstalih deoničara društva sa ograničenom odgovornošću;<br><br>1.5. potpun tekst Statuta i Sporazuma društva sa ograničenom odgovornošću ili Statuta i propisa opstalog društva sa ograničenom odgovornošću, koja će nastati nakon ovog spajanja.<br><br>2. Ukoliko je jedno deoničarsko društvo stranka u spajanju, takođe treba ispuniti |

| | | |
|---|---|---|
| kërkesat e përcaktuara me nenet 222-224 të këtij ligji. | in Articles 222-224 of this Law must also be met. | zahteve propisane članovima 222. do 224. ovog zakona. |
| **Neni 218**<br>**Kushtet për miratimin e Planit të Bashkimit** | **Article 218**<br>**Conditions for Approval of the Merger Plan** | **Član 218**<br>**Uslovi za usvajanje Plana o spajanju** |
| 1. Të drejtat dhe detyrimet krijohen nga marrëveshja e bashkimit nëse marrëveshja e bashkimit miratohet së bashku me Planin e Bashkimit nga të gjitha Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar në bashkim. Miratimi i Marrëveshjes së Bashkimit do të përfshijë aprovimin e draftit të kushteve të bashkimit si dhe çfarëdo ndryshimi në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar përvetësuese që është i nevojshëm për bashkim. | 1. Rights and obligations shall arise from a merger agreement if the merger agreement is approved with the Merger Plan by all merging Limited Liability Companies. The approval of the Merger Agreement shall cover both the approval of the draft terms of merger and any alterations to the Charter of the acquiring Limited Liability Company necessitated by the merger. | 1. Prava i obaveze proističu iz sporazuma o spajanju ukoliko je sporazum o spajanju odobren sa planom spajanja od strane svih društava sa ograničenom odgovornošću koja se spajaju. Odobrenje sporazuma o spajanju pokriva i odobrenje nacrta uslova spajanja i bilo kojih izmena povelje sticajućeg društva sa ograničenom odgovornošću što je neophodno zbog spajanja. |
| 2. Aksionarët duhet t'u jepet mundësia e shqyrtimit të Marrëveshjes së Bashkimit dhe Planit të Bashkimit së paku dy javë para vendosjes për miratimin e Marrëveshjes së Bashkimit përveç nëse parashihet ndryshe me ligj. Aksionari mund të kërkojë kopjen e Marrëveshjes së Bashkimit ose Planit të Bashkimit. | 2. The shareholders shall be provided with the opportunity to examine the Merger Agreement and the Merger Plan at least two weeks before deciding on approval of the Merger Agreement unless otherwise provided by law. A shareholder may demand a copy of the Merger Agreement or Merger Plan. | 2. Akcionarima se pruža mogućnost da preispitaju sporazum o spajanju i plan spajanja najmanje dve nedelje pre odluke o odobrenju sporazuma o spajanju osima ako je drugačije određeno zakonom. Deoničar može zahtevati kopiju sporazuma o spajanju ili plana spajanja. |
| 3. Në rastin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar që është palë e bashkimit, plani i bashkimit duhet miratuar: | 3. In the case of a Limited Liability Company that is a party to the merger, the merger plan must be approved: | 3. U slučaju deoničarskog društva sa ograničenom odgovornošću, plan o spajanju usvajaju: |
| 3.1. nga të gjithë Aksionarët e saj siç kërkohet nga paragrafi 2 i nenit 105 | 3.1. by all of its Shareholders as required by paragraph 2 of Article | 3.1. svi deoničari kako se zahteva shodno stavu 2 člana 105. ovog |

| | | |
|---|---|---|
| të këtij ligji, ose<br><br>3.2. nga çfarëdo numër apo përqindje më e ulët e Aksionarëve të saj që kërkohet me dispozitën e Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, nëse ajo dispozitë është në përputhje me paragrafin 3 të nenit 105 të këtij ligji.<br><br>4. Në rast të një Shoqërie Aksionare, plani i bashkimit duhet të miratohet sipas nenit 222 të këtij ligji.<br><br>**Neni 219**<br>**Regjistrimi dhe Data në të cilën Bashkimi hyn në fuqi**<br><br>1. Pas përfundimit të bashkimit, të gjitha palët në bashkim duhet të dorëzojnë marrëveshjen e bashkimit dhe Planin e Bashkimit në ARBK në pajtim me nenin 44 të këtij ligji. ARBK regjistron marrëveshjen e bashkimit dhe planin e bashkimit, nëse janë në përputhje me kërkesat e neneve 216 - 217 të këtij ligji. Marrëveshja e bashkimit dhe plani i bashkimit duhet të publikohet sipas nenit 22 të këtij ligji.<br><br>2. Bashkimi hyn në fuqi menjëherë pas publikimit nga ARBK-ja në pajtim me paragrafin 2 të nenit 44 dhe nenit 22 të këtij ligji. | 105 of this Law, or<br><br>3.2. by any smaller number or percentage of its Shareholders required by a provision of the Charter of the Limited Liability Company, if that provision is in compliance with paragraph 3 of Article 105 of this Law.<br><br>4. In the case of a Joint Stock Company, the merger plan must be approved according to Article 222 of this Law.<br><br>**Article 219**<br>**Registration and Date the Merger Enters Into Force**<br><br>1. After completion of the merger, all the parties to the merger must submit the merger agreement and the Merger plan to KBRA in accordance with Article 44 of this Law. KBRA registers the merger agreement and merger plan, if they are in compliance with the requirements of Articles 216 - 217 of this Law. The merger agreement and merger plan shall be published according to article 22 of this Law.<br><br>2. The merger shall enter into force immediately after publication by KBRA in accordance with paragraph 2 of Article 44 and Article 22 of this Law. | zakona ili<br><br>3.2.manji broj ili procenat deoničara propisan odredbom sporazuma društva sa ograničenom odgovornošću ukoliko je ta odredba u skladu sa stavom 3 člana 105. ovog zakona.<br><br>4. U slučaju deoničarskog društva plan o spajanju mora da se odobri članom 222. ovog zakona.<br><br>**Član 219**<br>**Upis i datum stupanja spajanja na snagu**<br><br>1. Po završetku spajanja, sve stranke u procesu spajanja dužne su da podnesu sporazum o spajanju i plan spajanja KARP-u, u skladu sa članom 44 ovog zakona. KARP registruje plan o spajanju, ukoliko odgovara uslovima propisanim članovima 216 – 217. ovog zakona. Sporazum o spajanju i plan spajanja se objavljuju u skladu sa članom 22. ovog zakona.<br><br>2. Spajanje stupa na snagu odmah po registraciji u KARP-u, shodno stavu 2 člana 44. i člana 22. ovog zakona. |

| | | |
|---|---|---|
| 3.Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar në bashkim janë rreptësisht të obliguara të sigurojnë, para përfundimit të bashkimit, se të gjitha kushtet e aplikueshme ligjore janë përmbushur dhe të sigurojnë të gjitha miratimet që kërkohen me ligje apo akte nënligjore.<br><br>4. Çdo Aksionar ose kreditor që beson se bashkimi ka shkelur të drejtat e tij/saj mund të kërkojë nga Gjykata kompetente:<br><br>4.1. kompensimin për dëmet dhe/ose<br><br>4.2. nëse veçanërisht kërkohet me ligj, anulimi i bashkimit.<br><br>5. Regjistrimi i marrëveshjes së bashkimit nuk përbën vendim nga ARBK-ja që bashkimi i përmbush çfarëdo kërkese apo dispozite të ligjeve të tjera. Çdo autoritet publik që ka arsye të ligjshme të besojë që bashkimi shkel kërkesat e përcaktuara me ligj për të cilin autoriteti publik është kryesisht përgjegjës për zbatimin e tij, mund të kërkojë në Gjykatën kompetente, në bazë të atij ligji:<br><br>5.1. gjobë për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar në bashkim apo Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar mbijetuese, dhe/ose | 3.The merging Limited Liability Companies are strictly obligated to ensure, prior to the completion of the merger, that all the applicable legal conditions have been fulfilled and to obtain all the approvals required by any Law or sub-legal acts.<br><br>4. Any Shareholder or creditor who believes the merger has violated his rights may claim from the competent Court:<br><br>4.1. compensation for damages and/or<br><br>4.2. if specifically provided for by a law,nullification of the merger.<br><br>5. Registration of the merger agreement shall not constitute a decision by KBRA that the merger complies with any requirements or provisions of other laws. Any Public Authority that has lawful reasons to believe that the merger violates the requirements provided in a law for which the public authority is principally responsible to implement, may seek in a competent Court, pursuant to that law:<br><br>5.1. a fine for the merging Limited Liability Companies or surviving Limited Liability Company, and/or | 3. Društvo sa ograničenom odgovornošću koja se spajaju strogo su obavezna da obezbede, pre završetka spajanja, da svi važeći zakonski uslovi budu ispunjeni i da se pribave sva odobrenja koja se zahtevaju po zakonu ili podzakonskim aktima.<br><br>4. Bilo koji deoničar ili poverenik koji veruje da je spajanje prekršilo njegova prava može od nadležnog suda zahtevati:<br><br>4.1. naknadu štete, i/ili<br><br>4.2. ukoliko je precizno određeno zakonom, poništenje spajanja<br><br>5. Registracija plana o spajanju ne predstavlja odluku KARP-a da je spajanje u skladu sa svim zahtevima odredaba drugi zakona. Bilo koji javni organ koji ima zakonite razloge da veruje da spajanje krši uslove date u zakonu za čije je sprovođenje javni organ prvenstveno odgovoran,, može od nadležnog suda zahtevati shodno tom zakonu:<br><br>5.1. kaznu za društva sa ograničenom odgovornošću koja se spajaju ili za opstalo društvo sa ograničenom odgovornošću, i/ili |

| | | |
|---|---|---|
| 5.2. shpalljen e bashkimit si të pavlefshëm.<br><br>6. Menjëherë pasi të jetë regjistruar bashkimi nga ARBK-ja, Korporata e mbijetuar duhet të publikojë njoftimin e bashkimit për kreditorët e Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar të bashkuara në gazetë ditore kombëtare, duke i informuar ata për mundësinë e dorëzimit, brenda gjashtë muajsh pas publikimit të njoftimit, të kërkesave të tyre në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar mbijetuese në mënyrë që ata të marrin letrën me vlerë.<br><br>7. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar e mbijetuar duhet të sigurojë kërkesat e parashtruara nga kreditorët e Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar të bashkuara brenda gjashtë muajsh pas publikimit të njoftimit të përcaktuar me paragrafin 6 të këtij neni nëse kreditorët nuk kanë mundësi të kërkojnë përmbushjen e kërkesave të tyre dhe vërtetojnë se bashkimi mund të rrezikojë realizimin e kërkesave të tyre.<br><br>**Neni 220**<br>**Pasojat e Bashkimit**<br><br>1. Pas hyrjes së bashkimit në fuqi, sipas paragrafit 2 të nenit 121 të këtij ligji:<br><br>1.1. Shoqëritë me Përgjegjësi të | 5.2. declaring the merger invalid.<br><br>6. Immediately after a merger has been registered by KBRA, the surviving Corporation shall publish a merger notice to the creditors of the merged Limited Liability Companies in national daily newspaper, informing them of the possibility to submit, within six months after the publication of the notice, their claims to the surviving Limited Liability Company in order to receive a security.<br><br>7. The surviving Limited Liability Company shall secure the claims submitted by the creditors of the Limited Liability Companies being merged within six months after the publication of the notice specified in subsection 6 of this article if the creditors have no possibility to demand satisfaction of the claims and they prove that the merger may endanger the fulfilment of the claims.<br><br>**Article 220**<br>**Consequences of a Merger**<br><br>1. After a merger enters into force, according to paragraph 2 of Article 121 of this Law:<br>1.1. the Limited Liability Companies | 5.2. proglašenje spajanja nevažećim<br><br>6. Odmah nakon što se plan spajanja registruje u KARP, opstala društvo sa ograničenom odgovornošću će obaviti obaveštenje o spajanju za poverenike spojenog društva sa ograničenom odgovornošću u nacionalnim dnevnim novinama, informišući ih o mogućnosti da podnesu, u roku od šest meseci nakon objavljivanja obaveštenja njihove zahteve upućene otpalom društvu sa ograničenom odgovornošću kako bi dobili hartije od vrednosti.<br><br>7. Opstalo društvo sa ograničenom odgovornošću obezbeđuje da zahtevi koje su podneli kreditori društvu sa ograničenom odgovornošću koji se spaja u roku od šest meseci nakon objavljivanja obaveštenja navedenog u stavu 6 ovog člana ukoliko poverioci nemaju mogućnosti da zahtevaju zadovoljenje zahteva i dokažu da spajanje može da ugrozi ispunjenje zahteva.<br><br>**Član 220**<br>**Posledice spajanja**<br><br>1. Nakon stupanja na snagu spajanja, shodno stavu 2, član 121. ovog zakona:<br><br>1.1. društvo sa ograničenom |

| | | |
|---|---|---|
| Kufizuar që janë palë në bashkim do të transformohen në një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të vetme që do të emërohet në planin e bashkimit si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e mbijetuar, dhe ekzistenca ligjore e ndarë e të gjitha Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar të tjera – përveç Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar së mbijetuar –do të përfundojë; | which are parties to the merger will transform into a single Limited Liability Company which will be named in merger plan as the surviving Limited Liability Company, and the separate legal existence of all the other Limited Liability Companies - except the surviving Limited Liability Company- shall terminate; | odgovornošću koje su stranke u spajanju, transformišu se u jedno društvo sa ograničenom odgovornošću koja će biti imenovano u planu spajanja kao opstalo društvo sa ograničenom odgovornošću, i posebno zakonsko postojanje svih društava sa ograničenom odgovornošću čime – osim opstalog društva sa ograničenom odgovornošću – se okončava. |
| 1.2. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar e mbijetuar është përgjegjëse për të gjitha detyrimet, të secilit lloj, të secilës Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar në bashkim; | 1.2. the surviving Limited Liability Companyis liable for all the obligations, of any kind, of each Limited Liability Company in the merger; | 1.2. Opstala društva sa ograničenom odgovornošću odgovorno je za sva potraživanja, bilo koje vrste, svake društvo sa ograničenom odgovornošću uključeno je u proces spajanja; |
| 1.3. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar e mbijetuar do të kenë të gjitha të drejtat dhe interesat në të gjitha asetet, të çfarëdo lloji, të secilës Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar në bashkim; | 1.3. the surviving Limited Liability Companyshall have all the rights and interests in all the assets, of any kind, of each Limited Liability Company in the merger | 1.3. Opstalo društvo sa ograničenom odgovornošću stiče sva prava i interese na svu imovinu, svake vrste, svako društvo sa ograničenom odgovornošću uključenog u proces spajanja; |
| 1.4. të gjitha kontestet dhe kërkesat ndaj cilësdo Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar që ka qenë palë në bashkim, ekzistenca e të cilave është ndërprerë pas bashkimit, do të vazhdojnë ndaj Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të mbijetuar; Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar | 1.4. all the disputes and claims against any Limited Liability Company that was a party to the merger and whose existence was terminated after the merger must be continued against the surviving Limited Liability Company; the surviving Limited Liability Companyshall – as a matter of Law - | 1.4. Sve sporove i zahteve iznete protiv društvo sa ograničenom odgovornošću koja je bila uključena u proces spajanja, koje je prestalo da postoji nakon spajanja, mora da se nastaviti protiv opstalog društva sa ograničenom odgovornošću; opstalo društvo sa ograničenom |

| | | |
|---|---|---|
| e mbijetuar – sipas ligjit – i zëvendëson të gjitha Shoqëritë e tjera me Përgjegjësi të Kufizuar të bashkuara, ekzistenca e të cilave është përfunduar nga bashkimi; | substitute all the other merged Limited Liability Companies whose existence was terminated by the merger; | odgovornošću će – kao zakonsko pitanje – zameniti sva ostala spojena društva sa ograničenom odgovornošću, čije je postojanje prestalo spajanjem; |
| 1.5. Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar së mbijetuar do të jetë Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar së mbijetuar që është përcaktuar në planin e bashkimit; | 1.5. The Charter of the surviving Limited Liability Companyshall be the Charter of the surviving Limited Liability Companythat was provided in the merger plan; | 1.5. Statut opstalog društva sa ograničenom odgovornošću zapravo predstavlja Statut opstale društvo sa ograničenom odgovornošću predstavljen u planu o spajanju; |
| 1.6. Aksionet e secilës Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar në bashkim të cilat kërkohen me planin e bashkimit të konvertohen në Aksione dhe/ose letra me vlerë apo borxhe apo detyrime të tjera të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar së mbijetuar duhen konvertuar; | 1.6. the Shares of each merging Limited Liability Companies which were required by the merger plan to be converted into Shares and/or securities or debts or other obligations of the surviving Limited Liability Companymust be converted; | 1.6. deonice svakog društva sa ograničenom odgovornošću uključenog u proces spajanja treba po planu spajanja da se pretvore u deonice i/ili hartije od vrednosti ili dugove i druge obaveze opstalog društva sa ograničenom odgovornošću. |
| 1.7. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar në bashkim konsiderohet të jetë shpërbërë që nga regjistrimi i bashkimit në ARBK. ARBK-ja duhet të shlyejë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar në bashkim nga Regjistri. | 1.7.A merging Limited Liability Company shall be deemed to be dissolved as of entry of the merger in the KBRA. The KBRA shall delete the merging Limited Liability Company from the Registry. | 1.7. društvo sa ograničenom odgovornošću smatra će se rasformiranim od unosa spajanja u KARP. KARP briše spojeno društvo sa ograničenom odgovornošću iz Registra. |

| KAPITULLI II<br>BASHKIMI I SHOQËRIVE AKSIONARE<br><br>Neni 221<br>Përkufizimi i Bashkimit | CHAPTER II<br>MERGER OF JOINT STOCK COMPANIES<br><br>Article 221<br>Definition of Merger | POGLAVLJE II<br>SPAJANJE DEONIČARSKIH DRUŠTAVA<br><br>Član 221<br>Definicija spajanja |
|---|---|---|
| 1. Për qëllime të këtij ligji, "bashkim" do të thotë një transaksion në të cilin një Shoqëri Aksionare në bashkim i transferon të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj një Shoqëri tjetër Aksionare. Shoqëria Aksionare përvetësuese mund të jetë një Shoqëri Aksionare ekzistuese ose një Shoqëri Aksionare e re e cila është themeluar me qëllim të pranimit të këtyre aseteve dhe përgjegjësive. Në transaksione të këtilla:<br><br>1.1. Shoqëria Aksionare në bashkim shpërbëhet;<br><br>1.2. vetëm Shoqëria Aksionare përfituese i mbijeton këtij transaksioni; dhe<br><br>1.3. aksionaret e Shoqërisë Aksionare në bashkim i dorëzojnë aksionet e tyre të Shoqërisë Aksionare në bashkim dhe në këmbim marrin aksione apo interesa të tjera pronësore në Shoqërinë Aksionare përvetësuese dhe/ose pagesa në para të gatshme. | 1. For purposes of the present law, a "merger" means a transaction in which a merging Joint Stock Company transfers all of its assets and liabilities to another Joint Stock Company. The acquiring Joint Stock Company may be an existing Joint Stock Company or a new Joint Stock Company that has been established for the purpose of acquiring such assets and liabilities. In such a transaction:<br><br>1.1.. the merging Joint Stock Company is dissolved;<br><br>1.2. only the acquiring Joint Stock Company survives the transaction; and<br><br>1.3. the shareholders of the merging Joint Stock Company surrender their shares in the merging Joint Stock Company and receive in exchange shares or other ownership interests in the acquiring Joint Stock Company and/or a cash payment. | 1.Za ciljeve ovog zakona „spajanje" znači transakcija u kojoj jedno deoničarsko društvo u spajanju prenosi celokupnu svoju imovinu i obaveze na drugo deoničarsko društvo. Deoničarsko društvo akviziter može biti postojeće deoničarsko društvo ili novo deoničarsko društvo koje je osnovano sa ciljem preuzimanja ove imovine i obaveza. U takvim transakcijama:<br><br>1.1. deoničarsko društvo u spajanju se gasi;<br><br>1.2. samo kompanija akviziter opstaje u ovoj transakciji; i<br><br>1.3. deoničari deoničarskih društava u spajanju predaju svoje deonice i u zamenu dobijaju deonice deoničarskog društva akvizitera i/ili novčane isplate u gotovini. |

| Neni 222<br>Procedurat e Bashkimit | Article 222<br>Procedure for Merger | Član 222<br>Postupak spajanja |
|---|---|---|
| 1. Dy ose me shumë Shoqëri Aksionare mund të ndërmarrin dhe përfundojnë një bashkim si vijon: | 1. Two or more Joint Stock Companies may undertake and complete a merger as follows: | 1. Dva ili više deoničarska društva mogu da pokrenu i zaključe spajanje na sledeći način: |
| 1.1. Drejtorët Menaxhues të Shoqërive Aksionare lidhin Marrëveshjen e Bashkimit e cila hyn në fuqi pas miratimit të marrëveshjes nga Aksionarët e Shoqërive Aksionare, dhe do të përmbajë: | 1.1.the Managing Directors of the Joint Stock Companies shall enter into a Merger Agreement entering into force after approval of the agreement by shareholders of Joint Stock Companies and setting out: | 1.1.Direktori akcionarskih društava stupaju u sporazumu o spajanju koji stupa na snagu nakon odobrenja sporazuma od strane deoničara akcionarskog društva i utvrđivanja sledećeg: |
| 1.1.1. emri zyrtar, si dhe Emrat Tregtar nëse ka, si dhe adresa e regjistruar e Shoqërive Aksionare; | 1.1.1. the official names, and trade names if any, and registered address of the Joint Stock Companies; | 1.1.1.zvanični nazivi i trgovinski naziv ako postoje i registrovane kancelarije deoničarskih društava; |
| 1.1.2. marrëveshjen për bartjen e të gjitha aseteve të Shoqërive Aksionare që përvetësohet te Shoqëria Aksionare përvetësuese në këmbim të bartjes së aksioneve të Shoqërisë Aksionare përvetësuese; | 1.1.2. an agreement to transfer all the assets of the Joint Stock Company being acquired to the acquiring Joint Stock Company in exchange for a transfer of shares of the acquiring Joint Stock Company; | 1.1.2.sporazuma o prenosu sa imovine akcionarskog društva koje je stečeno akviziterskom akcionarskom društvu u razmeni za transfer deonica akviziterskog akcionarskog društva; |
| 1.1.3. norma e këmbimit të Aksioneve për Shoqëritë Aksionare dhe shuma e pagesave shtesë nëse bëhen pagesa shtesë; | 1.1.3. the share exchange ratio for the Joint Stock Companies and the amount of additional payments if additional payments are made; | 1.1.3.odnos razmene deonica za akcionarska društva i iznos dodatnih plaćanja ukoliko se dodatna plaćanja vrše; |
| 1.1.4. kushtet dhe afatet e bartjes së aksioneve të Shoqërisë Aksionare përvetësuese; | 1.1.4. the terms and conditions of transfer of the shares of the acquiring Joint Stock Company; | 1.1.4.uslovi prenosa deonica akviziterskog deoničarskog društva; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1.5. datën në të cilën aksionet e bartura krijojnë të drejtën në ndarjen e profitit në Shoqërinë Aksionare përvetësuese si dhe kushtet e posaçme që ndikojnë në këtë të drejtë; | 1.1.5. the date as of which the transferred shares shall grant the right to a share of profit of the acquiring Joint Stock Company and the special conditions affecting this right; | 1.1.5.datum od kojeg prenete deonice daju pravo na udeo u profitu akviziterskog deoničarskog društva i specijalni uslovi koji utiču na ovo pravo; |
| 1.1.6. të drejtat të cilat Shoqëria Aksionare përvetësuese do t'i japë Aksionarëve të Shoqërisë Aksionare që përvetësohet; | 1.1.6. the rights which the acquiring Joint Stock Company will grant to the shareholders of the Joint Stock being acquired; | 1.1.6.prava koja akvizitersko deoničarsko društvo daje deoničarima akcionarskog društva koje je stečeno; |
| 1.1.7. pasojat e bashkimit për punëtorët e Shoqërisë Aksionare që përvetësohet; | 1.1.7. the consequences of merger for the employees of the Joint Stock Company being acquired; | 1.1.7.posledice spajanja po zaposlene u akcionarskom društvu koje je stečeno; |
| 1.1.8. data në të cilën transaksionet e Shoqërisë Aksionare që përvetësohet konsiderohet të jenë marrë përsipër nga Shoqëria Aksionare përvetësuese (data e bilancit të gjendjes së bashkimit); | 1.1.8. the date as of which the transactions of the Joint Stock Company being acquired shall be deemed to be undertaken by the acquiring Joint Stock Company (merger balance sheet date); | 1.1.8.datum od kojeg se smatra da transakcije kompanije koje je stečena preduzima akvizitersko deoničarsko društvo (datum bilansa spajanja); |
| 1.1.9. kompensimi që i paguhet auditorit që auditon marrëveshjen e bashkimit, këshilltarëve të tjerë dhe konsulentëve si dhe përparësitë të cilat i jepen, në lidhje me bashkimin, Drejtorëve dhe Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë aksionare. | 1.1.9. the remuneration paid to the auditor who audits the merger agreement, other advisers and consultants and the advantages granted in connection with the merger to the Directors and Board of Directors of the Joint Stock Company. | 1.1.9.nadoknada isplaćena revizoru koji vrši reviziju sporazuma o spajanju, drugim savetnicima i konsultantima i povoljnosti dodeljene u vezi sa spajanje za direktore i odbore direktora akcionarskog društva. |
| 1.2. Drejtorët dhe zyrtarët duhet të | 1.2. The directors and officers shall | 1.2. Direktori i službenici pišu, a |

| | | |
|---|---|---|
| hartojnë, ndërsa Bordet e Drejtorëve të secilës Shoqëri Aksionare të miratojnë planin e bashkimit, që përmbush kërkesat e nenit 224 të këtij ligji, si dhe urdhëron që plani t'i dorëzohet Kuvendit të Aksionarëve të secilës Shoqëri Aksionare, që mund të bëhet në kuvendin vjetor ose në atë të jashtëzakonshëm. | draft and the boards of directors of each Joint Stock Company shall adopt a plan of merger which meets the requirements of Article 224 of this Law and directs that the plan be submitted to a shareholder assembly of each Joint Stock Company, which may be either an annual or extraordinary assembly. | odbor direktora svakog deoničarskog društva usvaja plan spajanja koji ispunjava zahteve iz člana 224 ovog zakona i nalaže se da plan bude podnet skupštini deoničara svakog deoničarskog društva, što može biti ili na godišnjoj ili na vanrednoj skupštini. |
| 1.3. secila Shoqëri Aksionare duhet t'i japë një njoftim me shkrim Aksionarëve të cilët kanë të drejtë të votojnë për plan së paku një muaj para mbajtjes së kuvendit të aksionarëve, duke theksuar se qëllimi i kuvendit është shqyrtimi i planit për bashkim. Njoftimi duhet të përfshijë dokumentet në vijim të cilat do të jenë të gatshme për shqyrtim dhe kopjim në adresën e regjistruar të secilës Shoqëri Aksionare: | 1.3. Each Joint Stock Company shall give at least one month's advance written notice of the shareholders assembly to all shareholders entitled to vote on the plan, stating that a purpose of the meeting is to consider the merger plan. The notice shall include the following documents which shall also be available for inspection and copying at the registered address of each Joint Stock Company: | 1.3.Svako deoničarsko društvo priprema pisano obaveštenje najmanje mesec dana pre održavanja skupštine deoničara koji imaju prava glasanja o planu, naglašavajući da je svrha skupštine razmatranje plana o spajanju. Obaveštenje treba da uključuje sledeća dokumenta koja će takođe bita dostupna za pregled i kopiranje u registrovanoj kancelariji svakog deoničarskog društva: |
| 1.3.1. një kopje së bashku me një shpjegim të planit të bashkimit i cili i përcakton bazat juridike dhe ekonomike të bashkimit dhe çfarëdo norme të aplikueshme të këmbimit të aksioneve; | 1.3.1. a copy of the plan together with an explanation of the plan which sets out the legal and economic grounds for the merger and any applicable share exchange ratio; | 1.3.1. kopiju plana sa objašnjenjem plana, koje određuje pravni i ekonomski osnov spajanja i bilo koji primenjivi odnos razmene deonica; |
| 1.3.2. një raport të detajuar me shkrim nga Bordi i Drejtorëve për planin, i cili përcakton bazat juridike dhe ekonomike të planit | 1.3.2. a detailed written report by the board of directors on the plan, setting out the legal and economic grounds for the plan and the | 1.3.2. detaljan pisani izveštaj od odbora direktora o planu, izlažući pravne i ekonomske osnove plana i uslove spajanja, a posebno odnos |

| | | |
|---|---|---|
| dhe afatet e bashkimit dhe në veçanti normën e këmbimit të aksioneve duke përfshirë çfarëdo rekomandimi të bordit të drejtorëve, dhe arsyet për rekomandimin e tillë; | merger terms and in particular the share exchange ratio and containing any directors' recommendations and the reasons for such recommendation; | zamene deonica i uključivanje bilo koje preporuke direktora, kao i razloga za takvu preporuku; |
| 1.3.3. një kopje të një opinioni nga një këshilltar i pavarur financiar për bashkimin sipas nenit 223 të këtij ligji; | 1.3.3. a copy of the opinion of an independent financial adviser on the merger as required by Article 223 of this Law; | 1.3.3. kopiju mišljenja samostalnog finansijskog savetnika o spajanju prema članu 223. ovog zakona; |
| 1.3.4. raportet financiare vjetore të të gjitha Shoqërive Aksionare pjesëmarrëse për tre (3) vitet e kaluara duke përfshirë çfarëdo raporti të auditorit; | 1.3.4. the annual financial statements of all the participating Joint Stock Companies for the previous three (3) years, including any audit reports; | 1.3.4. godišnje finansijske izveštaje svih deoničarskih društava koja učestvuju u spajanju za prethodne tri (3) godine, uključujući i bilo koji izveštaj revizora; |
| 1.3.5. nëse deklarata e fundit financiare përmban informata për një periudhë e cila ka përfunduara më shumë se gjashtë (6) muaj para datës kur plani do t'i dorëzohet kuvendit të aksionarëve, atëherë një marrëveshjeje e veçantë e kontabilitetit e përgatitur nga një kontabilist ose auditor i licencuar në pajtim me standardet e aplikueshme të kontabilitetit do të përgatitet dhe vendoset në dispozicion për shqyrtim dhe kopjim në adresën e regjistruar të secilës Shoqëri Aksionare. Kjo marrëveshjeje e veçantë e | 1.3.5. If the latest financial statement contains information for a period that ended more than six (6) months before the date the plan is to be submitted to the shareholders' assembly, then a special settlement accounting statement prepared by a licensed independent accountant or auditor under applicable accounting standards must be prepared and made available for inspection and copying and inspection at the registered address of each Joint Stock Company. This settlement statement must reflect the financial | 1.3.5. ukoliko je poslednji finansijski izveštaj pripremljen pre više od šest (6) meseci od datuma kada će plan biti dostavljen skupštini deoničara, onda jedan poseban finansijski izveštaj koji će biti izrađen u skladu sa primenjivim standardima računovodstva od strane računovođe ili licenciranog revizora. Ovi specijalni finansijski izveštaji će biti stavljeni na raspolaganje za proveru u registrovanoj kancelariji svakog deoničarskog društva. Ovi specijalni finansijski izveštaji trebaju da odražavaju finansijsko stanje |

| | | |
|---|---|---|
| kontabilitetit duhet të pasqyrojnë gjendjen financiare të secilës Shoqëri Aksionare jo më shumë se tre (3) muaj para datës në të cilën plani i dorëzohet kuvendit të aksionarëve; me kusht që:<br><br>1.3.5.1. kërkesat e këtij nën-paragrafi nuk vlejnë për Shoqërinë Aksionare të re e cila është krijuar si Shoqëri Aksionare mbijetuese në bashkim; dhe<br><br>1.3.5.2. në rast të kësaj marrëveshjeje të veçantë të kontabilitetit, nuk do të kërkohet asnjë inventarizim fizik shtesë i aseteve pasi që pasqyra e fundit vjetore dhe vlerësimi në gjendjen e bilancit duhet vetëm të përshtatet që të reflektojë të hyra në pasqyrën financiare, përveç se zhvlerësimet e brendshme dhe dispozitat e kontabilitetit dhe ndryshimet materiale të vlerës duhet të merren parasysh;<br><br>1.3.6. kopja e statutit të ri të propozuar dhe rregulloreve të Shoqërisë Aksionare përvetësuse; dhe<br><br>1.3.7. një deklaratë mbi të drejtat e | condition of each Joint Stock Company as of a date that is not more than three (3) months before the date the plan is submitted to the shareholders' assembly; provided, however, that:<br><br>1.3.5.1. the requirement of this sub-paragraph shall not apply to any new Joint Stock Company which was created to be the surviving Joint Stock Company in the merger; and<br><br>1.3.5.2. in the case of this special settlement accounting statement no additional physical inventory of the assets shall be required since the last annual accounts and the valuations in the balance sheet need only be adjusted to reflect entries in the accounts, except that interim depreciation and accounting provisions and material changes of value must be taken into account;<br><br>1.3.6. copy of the proposed new charter and bylaws of the acquiring Joint Stock Company; and<br><br>1.3.7. a statement of the | svakog deoničarskog društva ne više od tri (3) meseca pre datuma kada će plan biti podnet skupštini deoničara, uz uslov da:<br><br>1.3.5.1. zahtevi iz ove alineje ne važe za novo deoničarsko društvo koje je osnovano kao nasledno deoničarsko društvo u slučaju spajanja; i<br><br>1.3.5.2. u slučaju posebnog sporazuma o predstavljenom računovodstvu nijedan dodatni fizički inventar imovine neće biti tražen iz poslednjeg godišnjeg izveštaja i ocena bilansa stanja se treba samo uskladiti kako bi odrazila prihode u finansijskom izveštaju, osim što treba uzeti u obzir internu amortizaciju i odredbe računovodstva i materijalne promene vrednosti;<br><br>1.3.6. primerak predloženog novog statuta i pravilnika deoničarskog društva; i<br><br>1.3.7. izjavu o pravima deoničara za |

| | | |
|---|---|---|
| aksionarëve për të kundërshtuar bashkimin si dhe vlerësimin e kërkuar sipas nenit 204 të këtij ligji; | shareholders' right to dissent and appraisal as required by Article 204 of this Law; | osporavanje spajanja kao i ocenu propisanu prema članu 204. ovog zakona. |
| 1.3.8. një kopje e marrëveshjes së bashkimit e lidhur sipas paragrafit 1.1 të këtij neni. | 1.3.8. a copy of the merger agreement entered into according to paragraph 1.1 of this Article. | 1.3.8. primerak sporazuma o spajanju u koji se stupilo stavu 1.1 ovog člana |
| 1. Së paku një muaj para kuvendit të përgjithshëm që vendos për bashkimin, Aksionarëve duhet t'i jepet mundësia për shqyrtimin e marrëveshjes së bashkimit, planin e bashkimit si dhe mendimin e auditorit. Plani i bashkimit duhet të vihet në dispozicion të përfaqësuesit të punëtorëve të Korporatës, ose në mungesë të tij/saj, në dispozicion të punëtorëve të Korporatës, së paku një muaj para mbledhjes apo kuvendit të përgjithshëm që vendos për bashkimin. | 1. At least one month before the general assembly which decides on the merger, the shareholders shall be granted an opportunity to examine the merger agreement, merger plan and auditor's opinion. The merger plan shall be made available to the representative of the employees of the Corporation or, in the absence thereof of representatives, to the employees of the Corporation at least one month prior to the meeting or general meeting which decides on the merger. | 1. Najmanje jedan mesec pre generalne skupštine koja odlučuje o spajanju, deoničarima se pruža prilika da ispitaju sporazum o spajanju, plan spajanja i mišljenje revizora. Plan spajanja se stavlja na raspolaganje predstavniku zaposlenih iz korporacije ili, u odsustvu ovog predstavnika, zaposlenima u korporaciji najmanje mesec dana pre sastanka ili opšteg sastanka koji odlučuje o spajanju. |
| 2. Nëse të gjitha aksionet e Korporatës që përvetësohet që krijojnë të drejtë vote i përkasin Korporatës përvetësuese mbledhja apo kuvendi i Aksionarëve të Korporatës që përvetësohet e që vendos për bashkimin nuk ka nevojë të miratojë marrëveshjen e bashkimit. | 2. If all the shares of the Corporation being acquired granting voting rights belong to the acquiring Corporation, the meeting or shareholders assembly of the Corporation being acquired which decides on the merger need not approve of the merger agreement. | 2. Ukoliko sve deonice korporacije koja se kupuje daju glasačka prava koju pripadaju korporaciji akviziteru, sastanak skupštine deoničara korporacije koja je kupljena gde se odlučuje o spajanju ne mora da usvoji sporazum o spajanju. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Kuvendi i Aksionarëve të Korporatës që përvetësohet mund të caktojë si kusht për miratimin e vendimit të bashkimit, që Korporata përvetësuese të miratojë shprehimisht procedurën e pjesëmarrjes së punëtorëve të Korporatës përvetësuese në menaxhimin e Korporatës. | 3. The shareholders assembly of the Corporation being acquired may set, as a condition for approval of the merger decision, that the acquiring Corporation has expressly approved of the procedure for participation by the employees of the acquiring Corporation in the management of the Corporation. | 3. Skupština deoničara korporacije koja se kupuje može utvrditi, kao uslov za odobrenje odluke o spajanju, da korporacija akviziter izričito odobri postupak za učestvovanje zaposlenih iz kupljene korporacije za rukovođenje korporacijom. |
| **Neni 234**<br>**Norma e këmbimit të aksioneve në rastin e Bashkimit Ndërkufitar** | **Article 234**<br>**Share Exchange Ratio upon Cross-Border Merger** | **Član 234**<br>**Odnos razmene deonica po međunarodnom spajanju** |
| Nëse, në bazë të ligjit të shtetit të huaj në juridiksionin e të cilit vepron Korporata që merr pjesë në bashkim, Aksionarët nuk kanë të drejtë të kërkojnë kompensim, atëherë Aksionari i Korporatës së regjistruar në Kosovë ka të drejtë të kërkojë kompensimin e tillë vetëm nëse Korporata që merr pjesë në bashkim nën juridiksionin e shtetit të juaj njeh, në marrëveshjen e bashkimit të saj, të drejtën e kërkimit të kompensimit të tillë. | If, based on the law of the foreign state under whose jurisdiction a Corporation participating in the merger falls, the shareholders have no right to demand a refund, then a shareholder of a Corporation registered in Kosovo has the right to demand such refund only if a Corporation participating in the merger who falls under the jurisdiction of the foreign state recognises, in its merger agreement, the right to demand such refund. | Ukoliko, na osnovu zakona strane zemlje pod čijom jurisdikcijom je korporacija koja učestvuje u spajanju, deoničari nemaju prava da traže naknadu, onda akcionar korporacije registrovane na Kosovu ima pravo da zahteva ovakvu isplatu samo ako korporacija koja učestvuje u spajanju a potpada pod jurisdikcijom strane zemlje prizna, u svom sporazumu o spajanju, pravo da se traže ovakve isplate. |
| **Neni 235**<br>**Kompensimi në rastin e bashkimit ndërkufitar** | **Article 235**<br>**Compensation upon cross-border merger** | **Član 235**<br>**Nadoknade po međunarodnom spajanju** |
| Nëse Korporata përvetësuese vepron nën juridiksionin e një shteti të huaj, Aksionari i Korporatës që përvetësohet e regjistruar | If the acquiring Corporation falls under the jurisdiction of a foreign state, the shareholder of a Corporation being | Ukoliko korporacija akviziter potpada pod jurisdikciju strane zemlje, akcionar korporacije koja se kupuje a uneta je u |

| | | |
|---|---|---|
| në Regjistrin e Kosovës, i cili nuk pajtohet me vendimin e bashkimit, ka të drejtë, sipas procedurës, që të bartë aksionet e saj ose të kërkojë që Korporata përvetësuese të marrë përsipër aksionin e këmbyer ose aksionet e Aksionarit me kompensim monetar. | acquired entered in the registry of Kosovo who does not agree to the merger resolution has the right, pursuant to the procedure, to transfer the shares thereof or to demand that the acquiring Corporation acquire the exchanged share or shares of the shareholder for monetary compensation. | registar na Kosovu nije saglasan sa rešenjem o spajanu, on ima pravo, shodno postupku, da prenese ove deonice ili da traži da korporacije akviziter otkupi razmenjene deonice deoničara za novčanu nadoknadu. |
| **Neni 236**<br>**Mbrojtja e kreditorëve në rastin e bashkimit ndërkufitar** | **Article 236**<br>**Protection of creditors upon cross-border merger** | **Član 236**<br>**Zaštita poverilaca po međunarodnom spajanju** |
| 1. Në rastin e bashkimit ndërkufitar të Korporatës që regjistrohet në Kosovë, kur Korporata përvetësuese vepron nën juridiksionin e një shteti të huaj, kreditorët e Korporatës kanë të drejtë, brenda dy muajsh prej pranimit të njoftimit, që të parashtrojnë pretendimet e tyre për të marrë sigurimin. | 1. In the case of a cross-border merger of a Corporation registered in Kosovo where the acquiring Corporation falls under the jurisdiction of a foreign state, the creditors of the Corporation have the right, within two months after receiving the notice to submit a claim to receive a security. | 1. U slučaju međunarodnog spajanja korporacije registrovane na Kosovu gde korporacije akviziter potpada pod jurisdikciju strane zemlje, poverioci korporacije imaju pravo, u roku od dva meseca nakon dobijanja obaveštenja, da podnesu zahteva za dobijanje hartija od vrednosti. |
| 2. Vetëm kreditorët që nuk kanë mundësi të kërkojnë realizimin e kërkesave të tyre, dhe të cilët sigurojnë prova që bashkimi ka gjasë të rrezikojë realizimin e kërkesave të tyre kanë të drejtë të marrin sigurimin. | 2. Only a creditor who is not able to demand satisfaction of claims and who provides proof that the merger is likely to endanger the fulfilment of the claims thereof has the right to receive the security. | 2. Samo poverilac koji nije u stanju da zahteva zadovoljenje zahteva i koji pruži dokaz da će spajanje verovatno ugroziti ispunjenje ovih zahteva ima pravo da dobije hartije od vrednosti. |
| **Neni 237**<br>**Regjistrimi i Bashkimit Ndërkufitar** | **Article 237**<br>**Registration of cross-border merger** | **Član 237**<br>**Registracija međunarodnog spajanja** |
| 1. Neni 44 i këtij ligji vlen për aplikimin e dorëzuar në ARBK nga Korporata | 1. Article 44 ofthis Law applies to the application submitted to the KBRA by an | 1. Član 44. važi za prijavu podnetu KARP od strane korporacije akvizitera ili od |

| | | |
|---|---|---|
| përvetësuese apo Korporata që përvetësohet, e regjistruar apo që do të regjistrohet në Regjistrin e Kosovës. Përveç kësaj, Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori(ët) Menaxhues duhet të konfirmojnë që kreditorët e Korporatës të marrin sigurimin në pajtim me nenin 236 të këtij ligji. | acquiring Corporation or Corporation being acquired registered or to be registered in the Registry of Kosovo. In addition to the above, the Board of Directors and Managing Director(s) shall confirm that the creditors of the Corporation have been given a security pursuant to Article 236 ofthis Law. | korporacije koja se kupuje koja je registrovana ili treba da bude registrovana u Registru na Kosovu. Pored gore navedenog, odbor direktora i direktor(i) potvrđuju da su poveriocima korporacije date hartije od vrednosti shodno članu 236 ovog zakona |
| 2. Nëse një Korporatë e regjistruar në Kosovë merr pjesë në bashkim ndërkufitar si Korporata që përvetësohet, ARBK-ja duhet të lëshojë certifikatë për Korporatën që vërteton se Korporata që përvetësohet ka kryer aktet e nevojshme para bashkimit, si dhe që bashkimi është regjistruar në ARBK. Certifikata duhet të përmbajë datën e regjistrimit si dhe gjithashtu ofron një referencë, sipas nevojës, për procedurën gjyqësore të kryer për të kontrolluar normën e këmbimit. | 2. If a Corporation registered in Kosovo participates in a cross-border merger as the Corporation being acquired, the KBRA shall issue a certificate to the Corporation which confirms that the Corporation being acquired has performed the required pre-merger acts and the merger has been entered in the KBRA. The certificate shall set out the date of the entry and also shall make reference, if relevant, to the court proceeding performed to check the exchange ratio. | 2. Ukoliko korporacija koja je registrovana na Kosovu učestvuje u međunarodnom spajanju kao korporacija koja se kupuje, KARP izdaje potvrdu korporaciji kojom se potvrđuje da je korporacija koja se kupuje izvršila zahtevane akte pre spajanja i spajanje je uneto u KARP. Ova potvrda utvrđuje datum unosa i takođe navodi, ako je relevantno, sudski postupak koji je izvršen radi provere odnosa razmene. |
| 3. Ministria, përmes një akti nënligjor të miratuar në pajtim me këtë ligj vendos procedurën për përgatitjen dhe lëshimin e certifikatës për bashkimin ndërkufitar të specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni. | 3. The Ministry, through a sub-legal act adopted in accordance with this law shall establish the procedure for preparing and issuing of the certificate on cross-border merger specified in paragraph 2 of this Article. | 3. Ministarstvo putem podzakonskog akta usvojenog u skladu sa ovim zakonom ustanovljava proceduru za pripremu i izdavanje potvrda o međunarodnom spajanju, što je precizirano u stavu 2 ovog člana. |
| 4. Nëse një Korporatë e regjistruar në Kosovë merr pjesë në bashkimin ndërkufitar si Korporata që përvetësohet, bëhet regjistrimi në Regjistër ku përcaktohet se bashkimi konsiderohet të | 4.If a Corporation registered in Kosovo participates in a cross-border merger as the Corporation being acquired, an entry is made in the Registry stating that the merger is deemed to have taken place | 4. Ukoliko korporacija koja je registrovana na Kosovu učestvuje u međunarodnom spajanju kao korporacija koja se kupuje, vrši se unos u Registar gde se kaže da se smatra da se spajanje odigralo u skladu sa |

| | | |
|---|---|---|
| jetë bërë në pajtim me ligjin e shtetit të huaj nën juridiksionin e të cilit vepron Korporata përvetësuese. Pas pranimit të njoftimit në lidhje me bashkimin që është bërë nga gjykata, noteri apo ndonjë autoritet tjetër kompetent të shtetit të huaj nën juridiksionin e të cilit vepron Korporata përvetësuese, ARBK bën regjistrimin në Regjistër në lidhje me datën në të cilën është bërë bashkimi, në pajtim me njoftimin e marrë. | pursuant to the law of the foreign state under whose jurisdiction the acquiring Corporation falls. After receiving a notice concerning the merger having taken place from a court, notary or other competent authority of the foreign state under whose jurisdiction the acquiring Corporation falls, the KBRA shall make an entry in the Registry concerning the date on which, according to the received notice, the merger took place. | zakonom strane zemlje pod čiju jurisdikciju potpada korporacija akviziter. Nakon prijema obaveštenja od suda o tome da se spajanje odigralo, ili pak od beležnika ili drugog nadležnog autoriteta strane zemlje pod čiju jurisdikciju potpada korporacija akviziter, KARP će izvršiti unos u Registar u vezi sa datuma kada prema dobijen obaveštenju se odigralo spajanje. |
| 5. Pas kryerjes së veprimeve të specifikuara në paragrafin 4 të këtij neni, ARBK i dërgon të gjitha dokumentet që janë dorëzuar asaj në lidhje me Korporatën që përvetësohet, me mjete elektronike, tek gjykata, noteri apo ndonjë autoritet tjetër kompetent të shtetit të huaj nën juridiksionin e të cilit vepron Korporata përvetësuese. | 5. After performing the actions specified in paragraph 4 of this article, KBRA shall forward all the documents which have been submitted to it concerning the Corporation being acquired by electronic means to the court, notary or other competent authority of the foreign state under whose law the acquiring Corporation falls. | 5. Nakon izvršenja akcija preciziranih u stavu 4 ovog člana, KARP prosleđuje sve dokumente koji su bili njemu podneti u vezi sa korporacijom koja se kupuje, elektronskim putem za sud, beležnika ili drugi nadležni autoritet strane zemlje pod čiji zakon potpada korporacija akviziter. |
| 6. Nëse një Korporatë e regjistruar apo që do të regjistrohet në Kosovë merr pjesë në bashkimin ndërkufitar si Korporata përvetësuese, Korporata që përvetësohet e që vepron nën juridiksionin e shtetit të huaj duhet të dorëzojë në ARBK një certifikatë nga gjykata, noteri apo ndonjë autoritet tjetër kompetent të shtetit të huaj përkatës, e cila vërteton që kriteret për bashkim janë plotësuar si dhe që janë përmbyllur veprimet para bashkimit në lidhje me Korporatën që përvetësohet, e që vepron | 6. If a Corporation registered or to be registered in Kosovo participates in a cross-border merger as the acquiring Corporation, the Corporation being acquired which falls under the jurisdiction of a foreign state shall submit the KBRA a certificate by the court, notary or other competent authority of the corresponding foreign state stating that the requirements for merger have been fulfilled and pre-merger actions have been concluded with respect to the Corporation being acquired | 6. Ukoliko korporacija koja je registrovana ili treba da bude registrovana na Kosovu učestvuje u međunarodnom spajanju kao korporacija akviziter, korporacija koja se kupuje a koja potpada pod jurisdikciju strane zemlje podnosi u KARP potvrdu suda, beležnika ili drugog nadležnog autoriteta odgovarajuće strane države, gde se izjavljuje da su uslovi za spajanje ispunjeni i aktivnosti pre spajanja su završene u vezi sa korporacijom koja se kupuje a koja potpada pod jurisdikciju |

| | | |
|---|---|---|
| nën juridiksionin e shtetit të tillë të huaj, si dhe të dorëzojë marrëveshjen e bashkimit. Certifikata duhet të dorëzohet brenda gjashtë (6) muajsh pas lëshimit të saj. Regjistrimi i bashkimit duhet të bëhet edhe nëse është evidente në bazë të certifikatës që procedura gjyqësore për kontrollimin e normës së këmbimit të aksioneve është iniciuar në lidhje me Korporatën që përvetësohet.<br><br>7. Nëse Korporata e regjistruar apo që do të regjistrohet në Kosovë merr pjesë në bashkim ndërkufitar si Korporata përvetësuese, ARBK-ja menjëherë duhet të japë njoftimin për regjistrimin e bashkimit për gjykatën, noterin apo autoritetin tjetër kompetent të shtetit të huaj nën juridiksionin e të cilit vepron Korporata që përvetësohet.<br><br>8. Nëse kapitali i Aksioneve rritet gjatë procesit të bashkimit ndërkufitar, Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori(ët) Menaxhues të Korporatës përvetësuese duhet të dorëzojë kërkesë për regjistrimin e rritjes së kapitalit të Aksioneve brenda një viti pas miratimit të vendimit për rritjen e kapitalit të Aksionit. | which falls under the jurisdiction of such foreign state, and submit the merger agreement. The certificate shall be submitted within six (6) months after its issue. The merger entry shall be made even if it is evident based on the certificate that a court proceeding for checking the share exchange ratio has been initiated with respect to the Corporation being acquired.<br><br>7. If a Corporation registered or to be registered in Kosovo participates in a cross-border merger as the acquiring Corporation, the KBRA shall immediately give notice of the merger entry to a court, notary or other competent authority of the foreign state under whose jurisdiction the Corporation being acquired falls.<br><br>8. If the share capital is increased in the course of cross-border merger, the Board of Directors and Managing Director(s) of the acquiring Corporation shall submit a petition for the entry of the increase of the share capital within one year after the decision to increase the share capital was adopted. | pomenute strane zemlje, i podnet je sporazum o spajanju. Ova potvrda se podnosi u roku od šest (6) meseci nakon njenog izdavanja. Unos spajanja se vrši čak i ako je očigledno na osnovu potvrde da je sudski proces za proveru odnosa razmene deonica pokrenut u odnosu na korporaciju koja se kupuje.<br><br>7. Ako korporacija koja je registrovana ili treba da bude registrovana na Kosovu učestvuje u međunarodnom spajanju kao korporacija akviziter, KARP odmah daje obaveštenje o unosu spajanja sudu, beležniku ili drugom nadležnom autoritetu strane zemlje pod čijom jurisdikcijom je korporacija koja se kupuje.<br><br>8. Ako je deoničarski kapital uvećan tokom međunarodnog spajanja, odbor direktora i direktor(i) korporacije akvizitera podnose zahtev za upis povećanja deoničarskog kapitala u roku od godinu dana nakon usvajanja odluke o povećanju deoničarskog kapitala |

| KAPITULLI IV<br>NDARJA E KORPORATAVE<br><br>Neni 238<br>Metodat e ndarjes | CHAPTER IV<br>DEMERGER OF CORPORATIONS<br><br>Article 238<br>Methods of Demerger | POGLAVLJE IV<br>ODVAJANJE KORPORACIJA<br><br>Član 238<br>Metode odvajanja |
|---|---|---|
| 1. Ndarja hyn në fuqi pa procedurë likuidimi, me anë të shpërndarjes apo pjesëtimit. | 1. Demerger shall be effected without a liquidation proceeding by distribution or separation. | 1. Odvajanje izvršava bez stečajnog postupka raspodelom ili razdvajanjem. |
| 2. Me shpërndarje, Korporata që ndahet duhet të bartë asetet e veta tek Korporatat pranuese. Korporata pranuese mund të jenë Korporatë ekzistuese apo e re. Me shpërndarje, Korporata që ndahet konsiderohet të jetë e shpërbërë. | 2. Upon distribution, the Corporation being divided shall transfer its assets to the recipient Corporations. A recipient Corporation may be an existing or new Corporation. Upon distribution, the Corporation being divided shall be deemed to be dissolved. | 2. Nakon raspodele, korporacija koja se deli prenosi svoju imovinu na korporaciju primaoca. Korporacija primalaca može biti postojeća ili nova korporacija. Nakon raspodele, korporacija koja se deli smatra se ugašenom. |
| 3. Me shpërndarje, Aksionarët e Korporatës që ndahet do të bëhen Aksionarë të Korporatës pranuese. | 3. Upon distribution, the shareholders of the Corporation being divided shall become shareholders of a recipient Corporation. | 3. Nakon raspodele, akcionari korporacije koja se deli postaju akcionari korporacije primaoca. |
| 4. Me pjesëtim, Korporata që ndahet duhet të transferojë një pjesë të aseteve të saj tek njëra apo disa Korporata pranuese. Korporata pranuese mund të jetë Korporatë ekzistuese apo e re. | 4. Upon separation, the Corporation being divided shall transfer part of its assets to one or several recipient Corporations. A recipient Corporation may be an existing or new Corporation. | 4. Nakon razdvajanja, korporacija koja se deli prenosi deo svoje imovine na jednu ili više korporacije primalaca. Korporacija primalac može biti postojeća ili nova korporacija |
| 5. Me pjesëtim, Aksionarët e Korporatës që ndahet do të bëhen Aksionarë të Korporatës pranuese, ose Korporata që ndahet do të bëhet Aksionar i vetëm. | 5. Upon separation, the shareholders of the Corporation being divided shall become shareholders of a recipient Corporation, or the Corporation being divided shall become the sole shareholder. | 5. Nakon razdvajanja, akcionari korporacije koja se deli postaju deoničari korporacije primaoca, ili korporacija koja se deli postaje jedini deoničar. |

| | | |
|---|---|---|
| 6. Korporatat ekzistuese dhe të reja të regjistruara në ARBK mund të jenë njëkohësisht Korporata pranuese. | 6. Existing and new Corporations registered at KBRA may simultaneously be recipient Corporations. | 6. Postojeće i nove korporacije registrovane u KARP mogu istovremeno biti korporacije primaoci. |
| **Neni 239**<br>**Marrëveshja e ndarjes** | **Article 239**<br>**Demerger agreement** | **Član 239**<br>**Sporazum o odvajanju** |
| 1. Për të bërë ndarjen, Drejtorët Menaxhues të Korporatave që marrin pjesë në ndarje lidhin marrëveshjen e ndarjes. Të drejtat dhe detyrimet lindin nga marrëveshje e ndarjes pas miratimit të marrëveshjes me vendim të ndarjes. Marrëveshja e ndarjes duhet të përcaktojë: | 1. In order to demerge, the Managing Directors of Corporations participating in demerger shall enter into a demerger agreement. Rights and obligations shall arise from the demerger agreement after approval of the agreement with demerger decision. A demerger agreement shall set out: | 1. Da bi se odvojili, direktori i korporacija koje učestvuju u odvajanju stupaju u sporazum o odvajanju. Prava i obaveze proističu iz sporazuma o odvajanju nakon usvajanja sporazuma sa odlukom o odvajanju. Sporazum o odvajanju utvrđuje sledeće: |
| 1.1. Emrin zyrtar, si dhe Emrin Tregtar, nëse ka, si dhe adresat e regjistruara të Korporatave që marrin pjesë në ndarje; | 1.1. the official name, and trade name if any, and registered addresses of the Corporations participating in demerger; | 1.1. Zvanični naziv, i trgovinski naziv ako postoji i registrovanu adresu korporacija koje učestvuju u odvajanju; |
| 1.2. me pjesëtim apo shpërndarje, shpërndarja dhe norma e këmbimit të aksioneve të Korporatave që marrin pjesë në ndarje që do të transferohen tek Aksionarët e Korporatës që ndahet, si dhe shumën e pagesave shtesë, nëse ka pagesa shtesë që duhen bërë, për këmbimin e aksioneve për Aksionarët e Korporatës që ndahet; | 1.2. upon distribution or separation, the distribution and exchange ratio of shares in the Corporations participating in the demerger to be transferred to the shareholders of the Corporation being divided, and the amount of additional payments, if additional payments are to be made, for the exchange of shares to the shareholders of the Corporation being divided; | 1.2. Nakon podele ili razdvajanja, raspodela i odnos razmene deonica u korporacija koje učestvuju u odvajanju a koja treba da se prenesu deoničarima korporacije koja se deli, i iznos dodatnih plaćanja, ukoliko dodatna plaćanja treba da se izvršen, za razmenu deoničara korporacije koja se deli. |
| 1.3. me shpërndarje apo pjesëtim, | 1.3. upon distribution or separation, | 1.3. Nakon raspodele ili odvajanja, |

| | | |
|---|---|---|
| kushtet dhe afatet e bartjes së aksioneve të Korporatave pranuese për këmbimin e aksioneve me Aksionarët e Korporatës që ndahet; | the terms and conditions of transfer of the shares of the recipient Corporations for the exchange of shares with shareholders of the Corporation being divided; | uslovi prenosa deonica korporacije primaoca za razmenu deonica sa deoničarima korporacije koja se deli; |
| 1.4. data në të cilën aksionet e bartura krijojnë të drejtën e në ndarjen e fitimit të Korporatave pranuese si dhe kushtet e posaçme që ndikojnë në këtë të drejtë; | 1.4. the date as of which the transferred shares shall grant the right to a share of profit of the recipient Corporations and the special conditions affecting this right; | 1.4. Datum od kada prenete deonice pružaju pravo na udeo u profitu korporacije primaoca i specijalni uslovi koji utiču na ovo pravo; |
| 1.5. të drejtat që Korporatat pranuese do t'i japin Aksionarëve të Korporatës që ndahet, duke përfshirë zotëruesit e aksioneve të preferuara dhe letrave me vlerë të konvertueshme; | 1.5. the rights which the recipient Corporations will grant to the shareholders of the Corporation being divided, including the holders of preferred shares and convertible bonds; | 1.5. Prava koja će korporacije primalac davati deoničarima korporacije koja se deli, uključujući nosioce preferencijalnih deonica i promenjive obveznice; |
| 1.6. lista e aseteve që do të barten tek secila Korporatë pranuese dhe shpërndarja e detyrimeve që i përkasin aseteve tek Korporatat që marrin pjesë në ndarje; | 1.6. a list of assets to be transferred to each recipient Corporation and the distribution of obligations which belong to the assets among the Corporations participating in demerger; | 1.6. Spisak imovine koje je potrebno preneti svakoj korporacije primaocu i raspodela obaveza koje idu uz imovinu između korporacija koje učestvuju u odvajanju; |
| 1.7. pasojat e ndarjes për punëtorët; | 1.7. the consequences of demerger for the employees; | 1.7. Posledice odvajanja za zaposlene; |
| 1.8. në rastin e shpërndarjes, data në të cilën transaksionet e Korporatës që ndahen konsiderohen të jenë marrë përsipër ngas Korporata | 1.8. in the case of distribution, the date as of which the transactions of the Corporation being divided shall be deemed to be undertaken by the | 1.8. U slučaju raspodele, datum od kojeg će se smatrati da transakcije korporacije koja se deli preuzima korporacija primalac (datum bilansa |

| | | |
|---|---|---|
| pranuese (data e bilancit të gjendjes në ndarje);<br><br>1.9. kompensimi që i paguhet auditorit që auditon marrëveshjen e ndarjes si dhe përfitimet që i jepen Drejtorit(ëve) Menaxhues dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Korporatave që marrin pjesë në ndarje.<br><br>2. Shuma e pagesave shtesë e përcaktuar me marrëveshjen e ndarjes që duhen paguar nga korporata pranuese për Aksionarët e Korporatës që ndahet, dhe e cila nuk mund të tejkalojë një të dhjetën e shumës së vlerës nominale apo vlerës së përgjithshme të aksioneve të tyre të këmbyera.<br><br>3. Nëse marrëveshja e miratuar e ndarjes është e kushtëzuar dhe kushti nuk përmbushet brenda pesë (5) vitesh pas lidhjes së marrëveshjes, Korporata mund të shkëpusë marrëveshjen duke bërë njoftimin paraprak së paku gjashtë muaj përpara për atë shkëputje, përveç nëse marrëveshja e ndarjes përcakton afat më të shkurtër për njoftimin paraprak.<br><br>**Neni 240**<br>**Raporti i ndarjes**<br><br>1. Drejtorët Menaxhues të Korporatave që marrin pjesë në ndarje duhet të përgatisin | recipient Corporation (demerger balance sheet date);<br><br>1.9. the remuneration paid to the auditor who audits the demerger agreement and the advantages granted to the Managing Director(s) and members of Board of Directors of the Corporations participating in demerger.<br><br>2. The sum of additional payments prescribed in a demerger agreement which are to be paid by a recipient Corporation to the shareholders of the Corporation being divided shall not exceed one-tenth of the sum of the nominal values or book values of their exchanged shares.<br><br>3. If an approved demerger agreement is conditional and a condition is not met within five (5) years after conclusion of the agreement, a Corporation may terminate the agreement by giving at least six months' advance notice of termination unless the demerger agreement prescribes a shorter term for advance notice.<br><br>**Article 240**<br>**Demerger report**<br><br>1. The Managing Directors of Corporations participating in a demerger | odvajanja);<br><br>1.9. Naknada plaćanja revizoru koji vrši reviziju sporazuma o odvajanju i pogodnosti dodeljene direktoru i članovima odbora direktora korporacija koje učestvuju u odvajanju;<br><br>2. Iznos dodatnih plaćanja propisanih u sporazumu o odvajanju koja treba da isplati korporacija primalaca deoničarima korporacije koja se deli ne prelazi jednu desetinu iznosa nominalne ili knjigovodstvene vrednosti njihovih razmenjenih deonica.<br><br>3. Ako je uslovljen sporazum o odvajanju uslovljen i uslov ne bude ispunjene pet(5) godina, korporacija može raskinuti sporazum dajući najmanje šest meseci unapred obaveštenje o raskidu, osim ako sporazum o odvajanju pripisuje kraći rok za obaveštenje unapred.<br><br>**Član 240**<br>**Izveštaj o odvajanju**<br><br>1. Direktori korporacija koji učestvuju u odvajanju pripremaju pismeni izveštaj u |

| | | |
|---|---|---|
| një raport me shkrim në të cilin shpjegohen dhe arsyetohen ligjërisht dhe ekonomikisht ndarja dhe marrëveshja e ndarjes. Me shpërndarje apo pjesëtim ku aksionet këmbehen me Aksionarë te Korporatës që ndahet, norma e këmbimit të Aksioneve, shpërndarja e Aksioneve të Korporatave që marrin pjesë në ndarje mes Aksionarëve të Korporatës që ndahet, si dhe shumën e pagesave shtesë, nëse ka pagesa shtesë për t'u bërë, duhen arsyetuar në raport. Vështirësitë në lidhje me valorizimin duhen përshkruar ndaras në raport. | shall prepare a written report in which the demerger and demerger agreement shall be explained and justified legally and economically. Upon distribution or separation whereby shares are exchanged with the shareholders of the Corporation being divided, the share exchange ratio, the distribution of shares of the Corporations participating in the demerger among the shareholders of the Corporation being divided, and the amount of additional payments, if additional payments are to be made, shall be justified in the report. Difficulties relating to valuation shall be referred to separately in the report. | kojem se objašnjavaju odvajanje i sporazum o odvajanju i zakonski i ekonomski. Nakon podele ili razdvajanja, gde su deonice razmenjene sa deoničarima korporacije koja se deli, odnos razmene deonica, distribucija deonica korporacije koje učestvuje učestvuju u odvajanju među deoničarima u korporaciji koja se deli, i iznos dodatnih plaćanja ukoliko je potrebno izvršiti ta plaćanja, obrazlažu se u izveštaju. Poteškoće koje se odnose na vrednovanje biti posebno razmatrane u izveštaju. |
| 2. Raporti i ndarjes nuk ka nevojë të përgatitet në rastin e pjesëtimit me anë të këmbimit të aksioneve me Korporatën që ndahet, ose nëse kjo është miratuar nga të gjithë Aksionarët e Korporatave që marrin pjesë në ndarje. | 2. A demerger report need not be prepared upon separation by an exchange of shares with the Corporation being divided, or if this is agreed to by all the shareholders of the Corporations participating in demerger. | 2. Izveštaj o odvajanju ne mora da bude pripremljen nakon razdvajanja po razmeni deonica sa korporacijom koja se deli ili ako jeo vo dogovoreno od strane svih deoničara korporacija koje učestvuju u odvajanju. |
| 3. Korporatat që marrin pjesë në ndarje mund të përgatisin raport të përbashkët të ndarjes. | 3. The Corporations participating in demerger may prepare a joint demerger report. | 3. Korporacije koje učestvuju u odvajanju mogu pripremiti zajednički izveštaj o odvajanju. |
| 4. Raporti i ndarjes nuk ka nevojë të përmbajë informata, publikimi i të cilave mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme ndaj Korporatës që merr pjesë në ndarje apo Korporatës që i përket të njëjtit grup me atë Korporatë. Në rastin e tillë, arsyeja | 4. A demerger report need not set out information, publication of which may result in significant damage to a Corporation participating in demerger or a Corporation belonging to the same group with such Corporation. In such case, the | 4. Izveštaj o odvajanju ne mora da postavlja informacije, čije objavljivanje za rezultat može da ima značajnu štetu za korporaciju koja učestvuje u odvajanju ili za korporaciju koja pripada istoj grupi kao i pomenuta korporacija. U ovakvom slučaju |

| | | |
|---|---|---|
| për mos dorëzim të informatave duhet të përfshihet në raport.<br><br>**Neni 241**<br>**Auditimi**<br><br>1. Auditori duhet të auditojë marrëveshjen e ndarjes.<br><br>2. Auditori nuk ka nevojë të auditojë marrëveshjen e ndarjes në rastin e pjesëtimit me anë të këmbimit të aksioneve me Korporatën që ndahet, ose nëse të gjithë Aksionarët e Korporatave që marrin pjesë në ndarje pajtohen që auditori nuk ka nevojë të auditojë marrëveshjen e ndarjes.<br><br>3. Auditori duhet të emërohet nga Drejtori(ët) Menaxhues të Korporatës që merr pjesë në ndarje. Një auditor mund të emërohet për disa ose për të gjitha Korporatat që marrin pjesë në ndarje.<br><br>4. Auditori duhet të përgatisë raport me shkrim në lidhje me rezultatet e auditimit të marrëveshjes së ndarjes. Auditorët që auditojnë marrëveshjen e ndarjes mund të përgatisin raport të përbashkët për Korporatat.<br><br>5. Raporti duhet të paraqesë nëse norma e këmbimit të Aksioneve dhe pagesat shtesë të përmendura në marrëveshjen e ndarjes përbëjnë shpërblim të përshtatshëm për | reason for failure to submit the information shall be set out in the report.<br><br>**Article 241**<br>**Audit**<br><br>1. An auditor shall audit a demerger agreement.<br><br>2. An auditor need not audit a demerger agreement upon separation by the exchange of shares with the Corporation being divided, or if all the shareholders of the Corporations participating in demerger agree that an auditor need not audit the demerger agreement.<br><br>3. An auditor shall be appointed by the Managing Director(s) of the Corporation participating in a demerger. One auditor may be appointed for some or all of the Corporations participating in demerger.<br><br>4. The auditor shall prepare a written report concerning the results of the audit of a demerger agreement. The auditors who audit a demerger agreement may prepare a joint report for the Corporations.<br><br>5. A report shall indicate whether the share exchange ratio and additional payments indicated in the demerger agreement are appropriate consideration | razlog za propust da se ponese informacija biće naveden u izveštaju.<br><br>**Član 241**<br>**Revizija**<br><br>1. Revizor vrši reviziju sporazuma o odvajanju.<br><br>2. Revizor ne mora da izvrši reviziju sporazuma o odvajanju nakon razdvajanja preko razmene deonica sa korporacijom koja se deli, ili ako se svi deoničari korporacije slože da nije potrebno da revizor vrši reviziju sporazuma o odvajanju.<br><br>3. Revizora imenuje direktor korporacije koja učestvuje u otvaranju. Jedan izvor može da biti imenovan za neke ili sve korporacije koje učestvuju u odvajanju.<br><br>4. Revizor priprema pismeni izveštaj u vezi sa rezultatima revizije sporazuma o odvajanju. Revizori koji vrše reviziju sporazuma o odvajanju mogu pripremiti zajednički izveštaj za korporacije.<br><br>5. Izveštaj navodi da li je odnos razmene deonica i dodatna isplata navedena o sporazumu o odvajanju prikladna za deoničare korporacije koja se deli, kao i |

| | | |
|---|---|---|
| Aksionarët e Korporatës që ndahet, si dhe nëse ndarja mund të shkaktojë dëmtimin e interesave të kreditorëve të Korporatës. | for the shareholders of the Corporation being divided, and whether the demerger may bring about damage to the interests of the creditors of the Corporation. | dali odvajanje može da nanese štetu interesima poverilaca korporacije. |
| 6. Më tutje, raporti i auditorit duhet të përcaktojë metodën që është përdorur në përcaktimin e normës së këmbimit të aksioneve që duhen transferuar tek Aksionarët e Korporatës që ndahet, vështirësitë në lidhje me përcaktimin e normës së këmbimit, nëse metoda e përdorur është e përshtatshme për përcaktimin e normës së këmbimit si dhe metodat tjera të përcaktimit të normës së këmbimit. Nëse përdoren metoda të ndryshme në lidhje me përcaktimin e normës së këmbimit, norma e këmbimit në secilën metodë dhe rëndësia e rezultateve të fituara në bazë të secilës metodë të përcaktimit të normës së këmbimit duhen paraqitur në raport. | 6. Additionally, the auditor's report shall set out the method which was used upon determination of the exchange ratio of shares to be transferred to the shareholders of the Corporation being divided, the difficulties relating to determination of the exchange ratio, whether the used method is appropriate for determination of the exchange ratio and other methods for determination of the exchange ratio. If different methods are used upon determination of the exchange ratio, the exchange ratio in each method and the importance of results obtained on the basis of each method upon determination of the exchange ratio shall be set out. | 6. Pored ovoga, izveštaj revizora utvrđuje metodu koja je korišćena nakon utvrđivanja odnosa razmene deonica koje treba preneti deoničarima korporacije koja se deli, teškoće u vezi sa utvrđivanje odnosa razmene, da li je korišćeni metod prikladan za utvrđivanje odnosa razmena i druge metode utvrđivanja odnosa razmene. Ukoliko su korišćeni različiti metodi pri utvrđivanju odnosa razmene, odnos razmene u svaku metodu i važnost dobijenih rezultata na osnovu svakog metoda nakon utvrđivanja odnosa razmene, takođe se navodi. |
| 7. Auditori mban përgjegjësi, në të njëjtën mënyrë si me auditimin e raporti vjetor, për dëmet që shkaktohen nga auditimi i pasaktë i marrëveshjes së ndarjes ndaj Korporatës, Aksionarëve të saj apo kreditorëve. | 7. An auditor shall be liable, in the same manner as upon auditing an annual report, for the damage caused by inaccurate auditing of the demerger agreement to the Corporation, its shareholders or creditors. | 7. Revizor je odgovoran, na isti način kao i kod revizije godišnjeg izveštaja, za štetu izazvanu nepreciznom revizijom sporazuma o odvajanju pred korporacijom, njenim deoničarima ili poveriocima. |
| 8. Auditori ka të njëjtat të drejta dhe detyrime në auditimin e marrëveshjes së ndarjes me auditimin e një raporti vjetor. Auditori gjithashtu ka të drejtë të marrë informatat e nevojshme për auditim nga | 8. An auditor has the same rights and obligations upon auditing a demerger agreement as upon auditing an annual report. An auditor also has the right to obtain information necessary for auditing | 8. Revizor ima ista prava i obaveze po reviziji sporazuma o odvajanju kao i kod revizije godišnjeg izveštaja. Revizor ima pravo da pribavlja informacije neophodna za reviziju od drugih korporacija koja |

| | | |
|---|---|---|
| Korporatat tjera që i përkasin të njëjtit grup me Korporatat që marrin pjesë në ndarje. | from other Corporations which belong to the same group with the Corporation participating in demerger. | pripadaju istoj grupi kao i korporacija koja učestvuje u odvajanju. |
| 9. Raporti i auditorit nuk ka nevojë të përshkruajë informatat, publikimi i të cilave mund të rezultojë në dëme të konsiderueshme ndaj Korporatës që merr pjesë në ndarje apo Korporatës që i përket të njëjtit grup me atë Korporatë. Në rastin e tillë, arsyeja për dështimin e paraqitjes së informatave duhet përshkruar në raport. | 9. An auditor's report need not set out information, publication of which may result in significant damage to a Corporation participating in demerger or a Corporation belonging to the same group with such Corporation. In such case, the reason for failure to submit the information shall be set out in the report. | 9. Izveštaj revizora ne mora da iznos informacije, čije objavljivanje za rezultat može da ima značajnu štetu za korporaciju koja učestvuj u odvajanju ili korporacije koja pripada istoj grupi sa ovakvom korporacijom koja učestvuje u odvajanju ili korporaciju koja pripada istoj grupi sa ovakvom korporacijom. U ovakvom slučaju, razlog da se ne izvrši objavljivanje informacije biće određen u izveštaju. |
| **Neni 242**<br>**Vendimi për ndarje** | **Article 242**<br>**Demerger Decision** | **Član 242**<br>**Odluka o odvajanju** |
| 1. Të drejtat dhe detyrimet lindin nga marrëveshja e ndarjes nëse marrëveshja e ndarjes miratohet nga Kuvendet e Aksionarëve të të gjitha Korporatave që marrin pjesë në ndarje. | 1. Rights and obligations shall arise from a demerger agreement if the demerger agreement is approved by Shareholders Assemblies of all Corporations participating in the demerger. | 1. Prava i obaveze proističu iz sporazuma o odvajanju ukoliko je sporazum o odvajanju odobren od skupštine deoničara svih korporacija koje učestvuju u odvajanju. |
| 2. Aksionari mund të kërkojë një kopje të marrëveshjes apo vendimit të ndarjes. | 2. A shareholder may demand a copy of the demerger agreement or decision. | 2. Deoničar može zahtevati primerak sporazuma ili odluke o odvajanju. |
| 3. Aksionarët duhet të kenë mundësinë që të shqyrtojnë marrëveshjen e ndarjes, raportin për ndarjen dhe raportin e auditorit së paku dy jave para se të vendosin për miratimin e marrëveshjes së ndarjes përveç nëse parashihet ndryshe me ligj. | 3. The shareholders shall be provided with the opportunity to examine the demerger agreement, demerger report and auditor’s report at least two weeks before deciding on approval of the demerger agreement unless otherwise provided by law. | 3. Deoničari dobijaju prilika da preispitaju sporazum o odvajanju, izveštaj o odvajanju i izveštaj revizora, najmanje dve sedmice pre odluke o odobrenju sporazuma od odvajanju osima ako je drugačije uređeno zakonom. |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Të gjithë Aksionarë te Korporatës që ndahet duhet të jenë në favor të vendimit të ndarjes nëse, në Korporatat që marrin pjesë në ndarje, aksionet duhen përcaktuar ndërmjet Aksionarëve të Korporatës që ndahet në bazë të një raporti që nuk është i njëjtë me atë të Korporatës që ndahet. | 4. All the shareholders of a Corporation being divided must be in favour of the demerger decision if, in the Corporations participating in demerger, shares are to be determined between the shareholders of the Corporation being divided based on a different proportion than in the Corporation being divided. | 4. Svi deoničari korporacije koja se deli moraju biti za odluku o otvaranju, ako su, u korporaciji koja učestvuje u varanju, deonice koje treba da se utvrde između deoničara korporacije podeljene na osnovu drugačije proporcije u odnosu na korporaciju koja se deli. |
| 5. Drejtorët Menaxhues të një Korporate që merr pjesë në ndarje, para se të vendosin për miratimin e marrëveshjes së ndarjes, duhet të njoftojnë Aksionarët për të gjitha ndryshimet materiale në asete të Korporatës të cilat ndodhin gjatë periudhës ndërmjet lidhjes së marrëveshjes së ndarjes si dhe vendimit për miratimin e marrëveshjes së ndarjes. Drejtorët Menaxhues të Korporatës që merr pjesë në ndarje duhet të bëjnë njoftimin për ndryshimet e tilla edhe Drejtorët Menaxhues apo Aksionarëve me të drejtë të përfaqësimit të Korporatave të tjera që marrin pjesë në ndarje, të cilët do të njoftojnë Aksionarët e Korporatave përkatëse të tyre. | 5. The Managing Directors of a Corporation participating in a demerger, prior to deciding on the approval of the demerger agreement, shall notify the Shareholders of all material changes in the assets of the Corporation which occur in the interim between the entry into the demerger agreement and deciding on the approval of the demerger agreement. The Managing Directors of a Corporation participating in demerger shall notify of such changes also the Managing Directors of or the Shareholders entitled to represent the other Corporations participating in demerger, who shall notify of the above changes the Shareholders of their Corporations. | 5. Direktori korporacije koja učestvuje u odvajanju, pre odluke o odobrenju sporazuma o odvajanju, obaveštavaju deoničare o svim materijalnim promenama u imovini korporacije koje su se pojavile u međuvremenu između stupanja u sporazum o odvajanju i odlučivanja o usvajanju sporazuma o odvajanju. Direktori korporacija koji učestvuju u odvajanju obaveštavaju o ovakvim promenama i direktore akcionara koji imaju pravo da zastupaju druge korporacije koje učestvuju u odvajanju, a oni obaveštavaju o ovim promenama deoničare svojih korporacija. |
| 6. Detyrimet e specifikuara tek paragrafi 5 i këtij neni nuk kanë nevojë të përmbushen në rastin e pjesëtimit me anë të këmbimit të aksioneve me Korporatën që ndahet, ose nëse kjo miratohet nga të gjithë Aksionarët e Korporatave që marrin pjesë në ndarje. | 6. The obligations specified in paragraph 5 of this Article need not be performed upon separation by an exchange of shares with the Corporation being divided, or if this is agreed to by all the shareholders of the Corporations participating in demerger. | 6. Obaveze precizirane u stavu 5 ovog člana ne moraju da budu izvršavane nakon razdvajanja putem razmene deonica sa korporacijom koja se deli, ili ako je ovo dogovoreno od strane svih deoničara korporacije koja učestvuje u odvajanju. |

| Neni 243<br>Përgatitja e Kuvendit të Aksionarëve | Article 243<br>Preparation of Shareholders Assembly | Član 243<br>Priprema skupštine deoničara |
|---|---|---|
| 1. Së paku një muaj para se Kuvendi i Aksionarëve të vendosë për ndarjen, Drejtori(ët) Menaxhues do të paraqesin pikat vijuese para Aksionarëve për shqyrtim në adresën e regjistruar të Korporatës: | 1. At least one month before the Shareholders Assembly to decide on a demerger, the Managing Director(s) shall present the following to the shareholders for examination at the registered address of the Corporation: | 1. Najmanje jedan mesec pre skupštine deoničara koja odlučuje o odvajanju, direktor(i) predstavljaju sledeće za razmatranje deoničara u registrovanom sedištu korporacije: |
| 1.1. marrëveshjen e ndarjes; | 1.1. the demerger agreement; | 1.1. Sporazum o odvajanju; |
| 1.2. tre raporte vjetore paraprake të Korporatave që marrin pjesë në ndarje; | 1.2.the three preceding annual reports of the Corporations participating in demerger; | 1.2. Tri prethodna godišnja izveštaja korporacije koja učestvuje u odvajanju; |
| 1.3. raportet e ndarjes të Korporatave që marrin pjesë në ndarje; | 1.3. the demerger reports of the Corporations participating in demerger; | 1.3. Izveštaj u odvajanju korporacija koje učestvuju u odvajanju; |
| 1.4. raportet e auditorëve të Korporatave që marrin pjesë në ndarje. | 1.4. the auditor's reports of the Corporations participating in demerger. | 1.4. Izveštaj revizora o korporacija koje učestvuju u odvajanju. |
| 2. Me kërkesë të një Aksionari, ai apo ajo duhet të marrë menjëherë, pa pagesë, kopjen e plotë ose të pjesshme, në bazë të dëshirës së Aksionarit, të dokumenteve të specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni. Me pëlqimin e Aksionarit, kopja mund t'i dërgohet në adresën elektronike të tij apo saj. | 2. At the request of a shareholder, he or she shall be immediately provided free of charge either complete or partial copy, based on the shareholder's wish, of the documents specified in paragraph 1 of this article. Upon the shareholder's consent, the copy may be sent to his or her e-mail address. | 2. Na zahtev deoničara, on ili ona odmah besplatno dobijaju ili kompletnu ili delimičnu kopiju, zavisno od želje deoničara, dokumenata navedenih u stavu 1 ovog člana. Po priseku deoničara kopija se može poslati na njihovu e-mail adresu, |
| 3. Nëse raporti më i fundit vjetor të Korporatës që merr pjesë në ndarje është | 3. If the latest annual report of a Corporation participating in demerger is | 3. Ukoliko je poslednji godišnji izveštaj korporacije koja učestvuje u odvajanju |

| | | |
|---|---|---|
| 5. Nëse personat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, veprojnë në kundërshtim me detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre sipas këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë Ortakërisë ose Korporatës dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ta kthejnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime. Personat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt dhe sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një person, ata përgjigjen ndaj Ortakërisë ose Korporatës në mënyrë solidare. | 5. If the persons referred to in paragraph 1 of this article, act contrary to the duties and responsibilities according to this article, they shall be liable to compensate the damages to the Partnership or Corporation caused by such infringement, and repay any personal profit that they or any other affiliated persons may have acquired by such action. Persons referred to in the paragraph 1 of this Article shall carry the burden of proof to validate their regular performance of duties and observation of standards. When such infringement is committed by more than one person, they shall be jointly liable to the Partnership or Corporation. | 5. Ako lica određena u stavu 1 ovog člana postupaju u suprotnosti sa svojim obavezama i odgovornostima u ovom članu, dužna su da obeštete štetu partnerstvu ili korporaciji koja je proistekla iz povrede, kao i vrate svaku ličnu korist koju su oni ili njihova povezana lica realizovala iz ovih radnji. Lica navedena u stavu 1 ovog člana snose breme dokazivanja za potvrđivanje svojih radnje na regularan način i prema traženim standardima. Kada je povredu izvršilo više lica, ona na solidaran način odgovaraju partnerstvu ili korporaciji. |
| 6. Personi i cili merr një vendim afarist duke vepruar sipas detyrave të përcaktuara në këtë nen, konsiderohet se i ka përmbushur detyrat sipas këtij neni nëse: | 6. A person taking a commercial decision acting in accordance with their duties as provided by this article, shall be deemed to have performed his/her duties as per this article if: | 6. Lice koje donese poslovnu odluku postupajući prema zadacima utvrđenim u ovom članu, smatra se da je ispunilo obaveze prema ovom članu ako: |
| 6.1. nuk ka një interes personal, financiar ose material siç përcaktohet në nenin 259të këtij ligji me rastin e | 6.1. he/she has no personal, financial or material interest as provided by Article 259 of this Law, in taking | 6.1. nema lični, finansijski ili materijalni interes kao što je propisano u članu 259. prilikom |

| | | |
|---|---|---|
| marrjes së vendimit;<br><br>6.2. është plotësisht i informuar mbi këtë temë në masën e duhur sipas rrethanave dhe nuk ka vepruar në mënyrë neglizhente. | such decision;<br><br>6.2. he/she is fully informed on the issue to the proper extent based on those circumstances and has not acted in a negligent manner. | donošenja odluke;<br><br>6.2. u potpunosti je informisano o ovoj temi do odgovarajuće mere prema okolnostima i nije postupa nemarno. |
| **Neni 259**<br>**Transaksionet që Përfshijnë Konfliktin e Interesit**<br><br>1. Personat e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 258 të këtij ligji konsiderohet se kanë konflikt interesi në një kontratë ose transaksion me Ortakërinë ose Korporatën nëse:<br><br>1.1. Ai/ajo ose ndonjë anëtar i familjes së tij është palë në aktin apo transaksionin ose ka një interes personal, financiar ose material në aktin ose transaksionin; ose<br><br>1.2. Ai/ajo ka një marrëdhënie financiare apo familjare me një palë në aktin ose transaksionin, ose me një person që ka një interes personal, financiar ose material në aktin apo transaksionin, që mund të pritet që të ndikojë negativisht në gjykimin e personit të tillë në Ortakëri apo Korporatë. | **Article 259**<br>**Transactions involving Conflict of Interest**<br><br>1. Persons specified in paragraph 1 of Article 258 of this law are deemed to have a conflict of interests in a contract or transaction with a Partnership or Corporation if:<br><br>1.1. He/she or a family member is party to the act or transaction or has a personal, financial or material interest in the act or transaction; or<br><br>1.2. He/she has a financial or family relationship with a party in the act or transaction, or with a person who holds personal, financial or material interest in such act or transaction, which may be expected to adversely impact the judgment of such person in a Partnership or Corporation. | **Član 259**<br>**Transakcije koje obuhvataju sukob interesa**<br><br>1. Smatra se da lica određena u stavu 1 člana 258 ovog zakon imaju sukob interesa u ugovoru ili transakciji sa partnerstvom ili korporacijom ako:<br><br>1.1. Lice ili određeni član porodice je strana u radnji ili transakciji ili ima lični, finansijski ili materijalni interes u radnji ili transakciji; ili<br><br>1.2. Lice ima finansijske ili porodične odnose sa jednom stranom u radnji ili transakciji ili sa licem koje ima lični, finansijski ili materijalni interes u radnji ili transakciji, za šta se može očekivati da negativno utiče na rasuđivanje tog lica u partnerstvu ili korporaciji. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Për qëllimin e këtij neni, një "marrëdhënie financiare" përfshin të qenit në pozitë të drejtorit, aksionarit kontrollues ose punonjësit të një pale apo personit të tillë, ose të qenit nën ndikimin kontrollues të një pale apo personi. | 2. For the purposes of this Article, a “financial relationship” includes being in a position of a director, controlling shareholder or an employee of such party or person, or being under the controlling influence of a party or person. | 2. Za ciljeve ovog zakona, „finansijski odnos“ uključuje držanje mesta direktora, kontrolnog deoničara ili zaposlenog jedne takve strane ili lica ili biti pod kontrolnim uticajem jedne strane ili lica. |
| 3. Personat e interesuar të cilët zbulojnë një konflikt interesi sipas nenit 261 të këtij ligji të cilët lidhin një kontratë ose transaksion në emër të Ortakërisë ose Korporatës nuk konsiderohet se e kanë shkelur detyrën e besnikërisë nëse kontrata ose transaksioni është miratuar paraprakisht në mirëbesim sipas nenit 260 të këtij ligji pas paraqitjes së faktit dhe me kusht që të gjitha faktet materiale nga personi i interesuar në lidhje me interesat e tij janë lajmëruar apo dihen nga organi që e miraton transaksionin dhe nëse organi miratues e miraton kontratën ose transaksionin me mirëbesim. | 3. The interested persons who disclose a conflict of interest according to Article 261 of this Law and who enter into a contract or transaction on behalf of the Partnership or Corporation shall not be deemed to have violated their duty of loyalty if the contract or transaction was previously approved in good faith according to Article 260 of this Lawafter the appearance of the fact and provided that all material facts from interested person in relation to his interests are disclosed or known to the approving body approving the transaction, and if the approving body approves the contract or transaction in good faith. | 3. Zainteresovana lica koja obelodane sukob interesa prema članu 261 ovog zakon i koje sklope ugovor ili transakciju u ime partnerstva ili korporacije se neće smatrati da su prekršile zadatak lojalnosti ukoliko je ugovor ili transakcija ranije ovlašćena s poverenjem prema članu 260 ovog zakon nakon prijavljivanja činjenice i pod uslovom da su sve materijalne činjenice zainteresovanog lica u vezi njegovog interesa prijavljena ili ih organ koji odobrava transakciju poznaje i ako organ za odobravanje odobri ugovor ili transakciju s poverenjem. |
| 4. Paraqitja dhe miratimi i një kontrate ose transaksioni me konflikt të interesit sipas nenit 260 dhe 261 të këtij ligji nuk e përjashton përgjegjësinë e personit të interesuar dhe mundësinë e ngritjes së padisë pranë gjykatës kompetente sipas nenit 264 dhe 265 të këtij ligji ndaj personit të interesuar nga ana e Ortakëve të një Ortakërie ose Aksionarëve në një Korporatë dhe të kërkojnë kompensim për | 4. Disclosure and approval of a contract or transaction with a conflict of interest according to Article 260 and 261 of this Law shall not exclude the liability of the interested person and the possibility of filing a lawsuit in the competent court, according to Articles 264 and 265 of this Law, against the interested person by the Partners of a Partnership or Shareholders in a Corporation, demanding | 4. Podnošenje i odobrenje ugovora ili transakcije sa sukobom interesa prema članovima 260. i 261 ovog zakona ne isključuje odgovornost zainteresovanog lica i mogućnost pokretanja tužbe u nadležnom sudu, u skladu sa članovima 264. i 265 ovog zakona, protiv zainteresovanog lica od strane ortaka ili partnerstva ili deoničara korporacije i zahtevanje odštete kao i predaju stečene dobiti iz ove transakcije, |

| | | |
|---|---|---|
| dëmet si dhe dorëzimin e fitimit të realizuar nga ky transaksion, nëse transaksioni është miratuar duke u mbështetur në fakte që nuk janë dhënë në mirëbesim ose nëse kontrata ose transaksioni i ka dhënë personit të interesuar një përparësi të padrejtë në dëm të Ortakërisë ose Korporatës ose Ortakëve dhe Aksionarëve të tyre si rrjedhojë e veprimeve neglizhente te tij/saj. | compensation for damages and repayment of profits made from this transaction, if the transaction was approved based on facts not rendered in good faith, or if the contract or transaction conferred upon the interested person an unfair advantage to the detriment of the Partnership or Corporation or Partners and their Shareholders as a result of the negligent actions of the interested person. | ako je transakcija odobrena oslanjajući se na činjenice koji nisu date s poverenjem i sledstveno su zainteresovanom licu dale nepravičnu prednost na štetu partnerstva ili korporacije ili njihovih ortaka ili deoničara kapo posledica njegovog/njenog nemara. |
| 5. Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara ndaj Ortakërisë apo Korporatës shtrihet edhe tek organi miratues sipas nenit 260 të këtij ligji dhe anëtarët e organit miratues, në rastet kur organi miratues ose anëtarët e tij kanë vepruar me keqbesim ose neglizhencë. | 5. The liability for damages caused to the Partnership or Corporation is extended to the approving body specified in Article 260 of this Lawand the members of the approving body, in cases when the approving body or its members acted in bad faith or negligence. | 5. Odgovornost za štetu prouzrokovanu partnerstvu ili korporaciji se prostre i na organ odobrenja prema članu 260 ovog zakon i članovima organa za odobrenje, u slučajevima kada je organ za odobrenje ili članovi istog bez poverenja ili nemarno. |
| 6. Kontrata ose transaksioni me konflikt interesit sipas këtij kapitulli mund të shfuqizohet nga Ortakëria ose Korporata, por çdo shfuqizim i tillë duhet të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave të një pale të tretë, të cilat janë fituar në mirëbesim dhe pa dijeni ose pjesëmarrje në shkelje. | 6. A contract or transaction with a conflict of interest according to this Chapter may be annulled by the Partnership or Corporation, but any such annulment shall be made without prejudice to third party rights acquired in good faith and without knowledge or participation in the infringement. | 6. Ugovor ili transakcija sa sukobom interesa prema ovom poglavlju se može poništiti u partnerstvu ili korporaciji, ali takvo poništenje se mora učiniti bez predrasuda po prava treće strane, koja su stečena s poverenjem i bez znanja ili učešća u kršenju. |
| 7. Pa paragjykuar veprimet tjera të gjykatës kompetente pas pranimit të një padie sipas paragrafit 4të këtij neni, gjykata kompetente mund ta shfuqizojë një kontratë ose transaksion me konflikt interesi sipas këtij kapitulli nëse vërtetohet | 7. Without prejudice to the other actions of the competent Court, upon receiving a lawsuit according to paragraph 4 of this Article, a competent Court may rescind a contract or transaction with a conflict of interest according to this Chapter if it finds | 7. Ne prejudicirajući druge radnje nadležnog suda nakon primanja tužbe prema stavu 4 ovog člana, nadležni sud može da poništi ugovor ili transakciju sa sukobom interesa prema ovom poglavlju ukoliko se utvrdi da je ugovor ili |

| | | |
|---|---|---|
| se kontrata ose transaksioni është paragjykues apo i dyshimtë ndaj Ortakërisë ose Korporatës dhe se transaksioni i ka dhënë të paditurit një përparësi të padrejtë në dëm të Ortakërisë ose Korporatës ose Ortakëve dhe Aksionarëve të tyre sipas paragrafit 4 të këtij neni. Në rast të vërtetimit nga gjykata kompetente të shkeljes sipas këtij paragrafi, pala e interesuar obligohet që ti kthejë Ortakërisë ose Korporatës çfarëdo fitimi të realizuar nga kontrata ose transaksioni dhe ta dëmshpërblejë Ortakërinë ose Korporatën për çfarëdo humbje apo dëmtim të pësuar si rezultat i kontratës ose transaksionit. | that such contract or transaction is unfair or prejudicial to the Partnership or Corporation, and that the transaction conferred upon the respondent an unfair advantage to the detriment of the Partnership or Corporation or their Partners or Shareholders, according to paragraph 4 of this Article. If the competent courts finds a violation according to this paragraph, the interested party shall return to the Partnership or Corporation any profits made out of the contract or transaction, and indemnify the Partnership or Corporation for any losses or damages incurred as a result of the contract or transaction. | transakcija s predrasudama ili sumnjiv prema partnerstvu ili korporaciji i da je transakcija tuženom dala nepravičnu prednost na štetu partnerstva ili korporacije ili njihovih ortaka ili deoničara prema stavu 4 ovog člana. U slučaju potvrđivanja kršenja u nadležnom sudu u skladu sa ovim stavom, zainteresovana strana je primorana da partnerstvu ili korporaciji vrati svaku realizovanu dobit iz ugovora ili transakcije i obešteti partnerstvo ili korporaciju za sve učinjene gubitke ili štetu kao rezultat ugovora ili transakcije. |
| **Neni 260**<br>**Miratimi i Transaksioneve me Konflikt Interesi** | **Article 260**<br>**Approval of Conflict of Interest Transactions** | **Član 260**<br>**Odobrenje transakcija sa sukobom interesa** |
| 1. Transaksionet ose kontratat e përshkruara në paragrafin 1 të nenit 259 të këtij ligji duhet të miratohen me shumicën e votave të Ortakëve të Përgjithshëm të Ortakërisë apo me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Korporatës. | 1. The transactions or contracts described in paragraph 1 of Article 259 of this Law must be approved by a majority of votes of the General Partners of the Partnership or by a majority of votes of the members of the Board of Directors of the Corporation. | 1. Transakcije ili ugovori opisani u stavu 1 člana 259 ovog zakon se moraju odobriti većinom glasova opštih ortaka partnerstva ili većinom glasova odbora direktora korporacije. |
| 2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, një Korporatë me anë të Statutit mund të përcaktojë miratimin e kontratave ose transaksioneve me konflikt interesi me shumicën e votave apo me metodë tjetër të | 2. Notwithstanding paragraph 1 of this Article, a Corporation may establish in its Charter that contracts and transactions with a conflict of interest are approved by a majority vote, or other voting method, of | 2. Nezavisno od stava 1 ovog člana, korporacija statutom može odrediti odobrenje ugovora ili transakcija sa sukobom interesa sa većinom glasova ili drugom metodom glasanja deoničara koji |

| | | |
|---|---|---|
| votimit të Aksionarëve të cilët nuk kanë një interes personal, financiar ose material në kontratën ose transaksionin mbi te cilin votohet, por në asnjë rast Statuti nuk mund të anashkalojë kërkesën e paragrafit 1 të këtij neni, që transaksioni të miratohet së paku nga shumica e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Korporatës.<br><br>3. Personat me konflikt interesi, të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 259 të këtij ligji, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e kontratës apo transaksionit me konflikt interesi sipas këtij neni dhe nuk llogariten në kuorum.<br><br>**Neni 261**<br>**Detyrimi për të Paraqitur Konfliktin e Interesit**<br><br>1.Personate përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 258 të këtij ligji do të njoftojë Ortakërinë ose Korporatën sa herë që kanë një interes personal në një Shoqëri Tregtare që është në konkurrencë me Ortakërinë ose Korporatën, ose në një kontratë ose transaksion ndaj të cilit zbatohen neni 259 ose neni 261të këtij ligji. Ky njoftim duhet të bëhet në kohën kur personi punësohet, zgjidhet ose emërohet në një pozitë sipas paragrafit 3 të nenit 258 të këtij ligji, ose menjëherë në kohën kur ai vjen në dijeni të interesit financiar ose personal në një | the Shareholders who have no personal, financial or material interest in the contract or transaction that is being voted, but in no case may the Charter remove the requirement of paragraph 1 of this Article, for the transaction to be approved by at least the majority of the members of the Board of Directors of the Corporation.<br><br>3. Persons with a conflict of interest, specified in paragraph 1 of Article 259 of this Law, may not participate in voting for the approval of the contract or transaction with a conflict of interest, according to this Article, and shall not be counted in the quorum.<br><br>**Article 261**<br>**Duty to Disclose Conflict of Interest**<br><br>1. Persons referred to in paragraph 1 of Article 258 of this Law shall notify the Partnership or Corporation each time they have a personal interests in a Business Organization which is in competition with the Partnership or Corporation, or in a contract or transaction on which the provisions of Article 259 or Article 261 of this Law apply. This notification must be made at the time the person is employed, elected or appointed in the position according to paragraph 3 of Article 258 of this Law, or immediately at the time when | nemaju lični, finansijski ili materijalni interes u ugovoru ili transakciji o kojoj se glasa, ali ni u kojem slučaju statut ne može prevazići zahtev stava 1 ovog člana, da transakcija bude odobrena od najmanje većine članova odbora direktora korporacije.<br><br>3. Lica sa sukobom interesa, određena u stavu 1 člana 259 ovog zakon, ne mogu da učestvuju na glasanju za odobrenje ugovora ili transakcije sa sukobom interesa prema ovom članu i ne računaju se za kvorum.<br><br>**Član 261**<br>**Obaveza prijavljivanja sukoba interesa**<br><br>1. Lica određena u stavu 1 člana 258 ovog zakon će obavestiti partnerstvo ili korporaciju svaki put kada imaju lični interes u poslovnom društvu koje je konkurentno partnerstvu ili korporaciji ili u ugovoru ili transakciji na koju se primenjuje član 259 ovog zakon ili član 261. Ovo se obaveštenje treba sprovesti u vreme kada se lice zaposli, izabere ili imenuje na položaj prema stavu 3 člana 258 ovog zakon ili odmah kada stekne saznanje o finansijskom ili ličnom interesu u transakciji sa sukobom interesa prema |

| | | |
|---|---|---|
| transaksion me konflikt interesi sipas nenit 259 të këtij ligji. Po ashtu, njoftimi përkatës bëhet në kohën kur një vendim ose transaksion përkatës është në diskutim nga drejtorët, zyrtarët, ortakët ose aksionarët. | he becomes aware of the personal or financial interest in a transaction with a conflict of interest according to Article 259 of this Law. Furthermore, the specific notification is made at the time when a decision or the concerned transaction is being discussed by the directors, officers, partners or shareholders. | članu 259ovog zakon. Takođe, isto obaveštenje se takođe primenjuje u vreme kada o određenoj odluci ili transakciji diskutuju direktori, službenici, partneri ili deoničari. |
| 2. Zbulimi i konfliktit të interesit duhet të përfshijë të gjitha faktet materiale të natyrës së konfliktit të interesit duke përfshirë, pozitën e personit dhe interesin pronësor në Ortakërinë apo Korporatën përkatëse si dhe nëse është e aplikueshme, pozitën e personit dhe interesin pronësor në Shoqërinë tjetër Tregtare të përfshirë dhe detaje rreth shumës së kontratës ose transaksionit dhe detaje të tjera duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, çfarëdo pasurie ose shërbimi që do të blihet, shitet, shkëmbehet apo disponohet në një mënyrë tjetër si dhe përfitimet potenciale nga kontrata ose transaksioni. | 2. Disclosure of conflicts of interest shall include all material facts on the nature of conflict of interest, including, the position of the person and the ownership interest in the concerned Partnership or Corporation including, if applicable, the position of the person and the ownership interest in the other Business Organization involved, and details on the amount of the contract or transaction and other details, including, if applicable, any property or service to be acquired, sold, exchanged or disposed of in any other way, and potential profits from the contract or transaction. | 2. Obelodanjivanje sukoba interesa treba da obuhvati sve materijalne činjenice sukoba interesa uključujući položaj lica i imovinski interes u odnosnom partnerstvu ili korporaciji, i ako je primenjivo, položaj lica i imovinski interes u drugom uključenom poslovnom društvu i, podatke o iznosu ugovora ili transakcije i bilo koje druge detalje, uključujući, ako je primenjivo, bilo koju imovinu ili uslugu koja će biti kupljena, prodata, razmenjena ili biti na raspolaganu na drugi način kao i potencijalnu dobit iz ugovora ili transakcije. |
| 3. Në rastin e një Ortakërie njoftimi duhet të bëhet para Ortakëve të Ortakërisë. | 3. In case of a Partnership, such disclosure shall be made before the Partners of the Partnership. | 3. U slučaju partnerstva obaveštenje treba dati pred ortacima partnerstva. |
| 4. Në rastin e një Korporate, njoftimi i tillë duhet të bëhet para Bordit të Drejtorëve dhe çdo veprim i Bordit të Drejtorëve që miraton ose ratifikon një transaksion të tillë do të raportohet nga kryetari i Bordit të | 4. In case of a Corporation, such notice of disclosure shall be made before the Board of Directors and any action of the Board of Directors approving or ratifying such a transaction shall be reported by the | 4. U slučaju korporacije takvo obaveštenje treba dati pred odborom direktora i svaka radnja odbora direktora kojom se odobrava ili ratifikuje takva transakcija će biti izneta od strane predsednika odbora deoničarima |

| | | |
|---|---|---|
| Drejtorëve para aksionarëve në kuvendin e radhës të aksionarëve, si dhe do të raportohet në pasqyrat vjetore financiare të Korporatës që mbulojnë periudhën në fjalë. | Chairman of the Board of Directors before the shareholders in the next shareholders assembly, and shall be reported in annual financial statements of the Corporation covering such period. | na sledećoj skupštini deoničara, kao i prijaviti u godišnjim finansijskim izveštajima korporacije koji pokrivaju dati period. |
| 5. Zbulimi i kontratës ose transaksionit me konflikt interesi në rastin e Korporatave gjithashtu publikohet si pjese e raportimit vjetor financiar ne pajtim me standardet ndërkombëtare te raportimit financiar (SNRF) sipas legjislacionit në fuqi për raportimin financiar dhe duhet të përfshijë të gjitha faktet materiale të natyrës së konfliktit të interesit duke përfshirë, pozitën e personit dhe interesin pronësor në Ortakërinë apo Korporatën përkatëse si dhe nëse është e aplikueshme, pozitën e personit dhe interesin pronësor në Shoqërinë tjetër Tregtare të përfshirë dhe detaje rreth kontratës ose transaksionit dhe detaje të tjera duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, çfarëdo pasurie ose shërbimi që do të blihet, shitet, shkëmbehet apo disponohet në një mënyrë tjetër si dhe përfitimet potenciale nga kontrata ose transaksioni. | 5. Disclosure of a contract or transaction with conflict of interest in the case of Corporations shall also be published as part of the annual financial reporting, in compliance with international financial reporting standards (SNRF) according to the applicable legislation on financial reporting, and shall include all material facts on the nature of conflict of interest, including, the position of the person and the ownership interest in the concerned Partnership or Corporation as well as, if applicable, the position of the person and the ownership interest in the other Business Organization involved, and details on the amount of the contract or transaction and other details, including, if applicable, any property or service to be acquired, sold, exchanged or disposed of in any other way, and potential profits from the contract or transaction. | 5. Pronalaženje ugovora ili transakcije sa sukobom interesa u slučaju korporacije se takođe objavljuje kao deo finansijskog izveštavanja u skladu sa međunarodnim standardima finansijskog izveštavanja (MSFI) prema zakonodavstvu na snazi o finansijskom izveštavanju i treba da obuhvati sve materijalne činjenice sukoba interesa uključujući položaj lica i imovinski interes u odnosnom partnerstvu ili korporaciji, i ako je primenjivo, položaj lica i imovinski interes u drugom uključenom poslovnom društvu i, podatke o ugovori ili transakciji i bilo koje druge detalje, uključujući, ako je primenjivo, bilo koju imovinu ili uslugu koja će biti kupljena, prodata, razmenjena ili biti na raspolaganu na drugi način kao i potencijalnu dobit iz ugovora ili transakcije. |
| 6. Në rastin e Korporatave, brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga përmbyllja e një transaksioni me konflikt interesi me vlerë prej 10% ose më shumë të të gjitha aseteve të Korporatës, të gjitha faktet materiale lidhur me kontratën ose | 6. In case of a Corporation, within seventy two (72) hours from the completion of a transaction with a conflict of interest at an amount of 10% or more of all assets of the Corporation, all material facts related to the contract or transaction of conflict of | 6. U slučaju korporacija u roku od sedamdeset dva (72) časa od zaključivanja transakcije sa sukobom interesa u vrednosti od 10% ili više ukupne imovine korporacije, sve materijalne činjenice u vezi ugovora ili transakcije sa sukobom interesa |

| | | |
|---|---|---|
| transaksionin me konflikt interesi do të zbulohen plotësisht në uebfaqet e tyre dhe do të vendosen në dispozicion të publikut në adresën e regjistruar. Ky zbulim duhet të përfshijë të gjitha faktet materiale të natyrës së konfliktit të interesit duke përfshirë, pozitën e personit dhe interesin pronësor në Ortakërinë apo Korporatën përkatëse si dhe nëse është e aplikueshme, pozitën e personit dhe interesin pronësor në Shoqërinë tjetër Tregtare të përfshirë dhe detaje rreth kontratës ose transaksionit dhe detaje të tjera duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, çfarëdo pasurie ose shërbimi që do të blihet, shitet, shkëmbehet apo disponohet në një mënyrë tjetër si dhe përfitimet potenciale nga transaksioni.<br><br>**Neni 262**<br>**Vlerësimi i Pavarur i Transaksioneve me Konflikt Interesi**<br><br>Të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë para votimit të një kontrate ose transaksioni me konflikt interesi me vlerë prej dhjetë përqind (10%) ose më shumë të të gjitha aseteve të Korporatës, duhet të merret një vlerësim i shkruar i pavarur mbi kushtet kryesore të kontratës ose transaksionit me konflikt të interesit nga një këshilltar i jashtëm dhe i pavarur financiar që gjithashtu duhet të vlerësojë nëse kontrata ose transaksioni është në përputhje me kushtet e tregut. | interest shall be fully disclosed in its websites, and shall be rendered available to the public in its registered address. Such disclosure shall include all material facts on the nature of conflict of interest, including, the position of the person and the ownership interest in the concerned Partnership or Corporation as well as, if applicable, the position of the person and the ownership interest in the other Business Organization involved, and details on the amount of the contract or transaction and other details, including, if applicable, any property or service to be acquired, sold, exchanged or disposed of in any other way, and potential profits from the contract or transaction.<br><br>**Article 262**<br>**Independent appraisal of transactions of conflict of interest**<br><br>At least fifteen (15) days before voting on a contract or transaction with a conflict of interest at an amount of ten percent (10%) or more of all assets of the Corporation, a written independent appraisal shall be obtained on the main terms of the contract or transaction of conflict of interest from an external and independent financial consultant, who must also appraise whether the contract or transaction was made in compliance with market conditions. | će biti u potpunosti objavljene na svojoj internet stranici i staviti na raspolaganje javnosti u registrovanoj adresi. Ovo objavljivanje treba da obuhvati sve materijalne činjenice prirode sukoba interesa uključujući položaj lica i imovinski interes u drugom uključenom poslovnom društvu i, podatke o ugovoru ili transakciji i bilo koje druge detalje, uključujući, ako je primenjivo, bilo koju imovinu ili uslugu koja će biti kupljena, prodata, razmenjena ili biti na raspolaganu na drugi način kao i potencijalnu dobit iz ugovora ili transakcije.<br><br>**Član 262**<br>**Nezavisna ocena transakcija sa sukobom interesa**<br><br>Najmanje petnaest (15) dana pre glasanja o ugovoru ili transakciji sa sukobom interesa vrednosti od deset procenata (10%) ili više svih sve imovine korporacije, treba dobiti pisani izveštaj o glavnim uslovima ugovora ili transakcije sa sukobom interesa od samostalnog nezavisnog savetnika koji takođe treba da oceni da li je ugovor ili transakcija u skladu sa tržišnim uslovima. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 263**<br>**Qasja ne dokumentacionin qe ndërlidhet me kontratat ose transaksionet me konflikt interesi** | **Article 263**<br>**Access to documentation related to contracts or transactions with conflict of interest** | **Član 263**<br>**Uvid u dokumentaciju koja se odnosi na ugovore ili transakcije sa sukobom interesa** |
| 1. Te gjithë Ortakët apo Aksionarët, pavarësisht numrit të Kuotave apo Aksioneve që i mbajnë në Ortakëri ose Korporatë, të cilët kanë për qëllim të dorëzojnë padi pranë gjykatës kompetente sipas nenit 259 të këtij ligji kanë të drejtë të plotë të qasjes në dokumentacionin në posedim të Ortakërisë ose Korporatës gjatë përgatitjes së padisë së tyre dhe para parashtrimit të padisë në gjykatën kompetente. | 1. All Partners or Shareholders, regardless of the number of Partnership Interests or Shares they own in the Partnership or Corporation, who want to file a lawsuit with the competent court according to Article 259 of this Law shall be fully entitled to access documents in possession of the Partnership or Corporation during preparation of their lawsuit, and before filing the lawsuit with the competent court. | 1. Svi partneri ili deoničari, bez obzira na broj kvota ili deonica koji drže u partnerstvu ili korporaciji, koji imaju za cilj podnošenje tužbe u nadležnom sudu prema članu 259 ovog zakona iznad, imaju pravo punog uvida u dokumentaciju u vlasništvu partnerstva ili korporacije tokom pripreme njihove tužbe i pre podnošenja tužbe u nadležnom sudu. |
| 2. Shpenzimet administrative që ndërlidhen me kopjimin, transportimin ose ruajtjen e këtij dokumentacioni mbulohen nga vetë Ortakët ose Aksionarët që kanë për qëllim dorëzimin e padisë. | 2. Administrative expenses related to copying, transporting or storing such documentation shall be borne by the Partners or Shareholders aiming to file such a lawsuit. | 2. Administrativne troškove koji su povezani sa kopiranjem, prevozom ili čuvanjem ove dokumentacije pokrivaju sami ortaci ili deoničari koji imaju za cilj podnošenje tužbe. |
| **Neni 264**<br>**Paditë e Drejtpërdrejta** | **Article 264**<br>**Direct Lawsuits** | **Član 264**<br>**Direktne tužbe** |
| 1. Një Ortak në një Ortakëri ose Aksionar në një Korporatë ka të drejtë të paraqesë padi në gjykatën kompetente ose në institucionet alternative për zgjidhjen e kontesteve në emrin e tij, kundër cilitdo personi të përcaktuar në nenin 258 të këtij ligji, për të kompensuar dëmet e shkaktuara | 1. A partner in a Partnership or a Shareholder in a Corporation shall be entitled to file a lawsuit with the competent court or any other alternative dispute resolution institutions in his own name, against any person as specified in Article 258 of this Law, for compensating | 1. Jedan ortak u partnerstvu ili deoničar u korporaciji ima pravo podnošenja tužbe u nadležnom sudu ili u alternativnoj ustanovi za rešavanje sporova u svoje ime, protiv bilo kojeg lica određenog u članu 258 ovog zakona za obeštećenje štete koja mu je prouzrokovana usled kršenja obaveza iz |

| | | |
|---|---|---|
| ndaj tij nga shkeljet e detyrave sipas këtij ligji apo ndonjë ligj tjetër në fuqi. | the damages caused to him by the violation of the duties specified in this law or any other law in force. | ovog zakona ili nekog drugog zakona na snazi. |
| 2. Padia mund të parashtrohet nga një person në emër të vet ose nga dy ose më shumë persona, që veprojnë së bashku, në emrat e tyre. | 2. The lawsuit may be filed by a person on his own behalf, or by two or more persons acting together, in their names. | 2. Tužbu može biti podneti jedno lice u svoje ime ili dvoje ili više lica koja zajedno deluju u svoje ime. |
| **Neni 265**<br>**Paditë Derivative** | **Article 265**<br>**Derivative Lawsuits** | **Član 265**<br>**Derivativne tužbe** |
| 1. Aksionari në një Korporatë ka të drejtë të paraqesë padi në gjykatën kompetente ose në institucionet alternative për zgjidhjen e kontesteve në emër të Korporatës kundër çdo personi të përcaktuar në nenin 258 të këtij ligji për të kompensuar dëmet ndaj Korporatës të shkaktuara nga shkelja e detyrimeve ndaj Korporatës sipas këtij ligji ose ndonjë ligj tjetër në fuqi. | 1. A Shareholder in a Corporation shall be entitled to file a lawsuit with the competent court or any other alternative dispute resolution institutions on behalf of the Corporation, against any person specified in Article 258 of this Law for compensation of damages made to the Corporation by a violation of duties towards the Corporation under this law or any other law in force. | 1. Deoničar u korporaciji ima pravo da podnese tužbu u nadležnom sudu ili u alternativnoj ustanovi za rešavanje sporova u ime korporacije, protiv bilo kojeg lica određenog u članu 258 ovog zakona za obeštećenje štete koja je prouzrokovana korporaciji usled kršenja obaveza prema korporaciji iz ovog zakona ili nekog drugog zakona. |
| 2. Padia mund të parashtrohet sipas këtij neni, vetëm në rastet në të cilat:<br>2.1. Pretendohen dëmtime ose shkelje e detyrë ndaj vetë Korporatës; | 2.A lawsuit may be filed according to this Article, only in cases in which:<br>2.1. Damages or infringement of duty is claimed against the Corporation itself; | 2. Tužba može biti podneta prema ovom članu samo u slučajevima kada:<br>2.1.Se pretenduje na štetu i kršenje obaveza prema samoj korporaciji; |
| 2.2. Paditësi ka qenë Aksionar në kohën e veprimeve për të cilat bëhet padia, ose veprimeve që e kanë fituar këtë status për shkak të transferimit të Aksioneve nga një person i cili ka | 2.2. The plaintiff was a Shareholder at the time of action which are the subject of the lawsuit, or actions which have acquired such status due to transfer of shares from a person | 2.2.Tužilac je bio deoničar u vreme radnji za koje se podnosi tužba ili radnji koje su stekle ovaj status zbog prenosa deonica sa jednog lica koje je bilo deoničar u vreme kada su se dogodile |

| | | |
|---|---|---|
| qenë Aksionar në kohën kur kanë ndodhur veprimet për të cilat bëhet padia;<br><br>2.3. Paditësi i ka kërkuar më parë me shkrim Korporatës për të paraqitur padinë dhe kjo kërkesë është refuzuar nga Korporata ose Korporata nuk është përgjigjur brenda tridhjetë (30) ditëve.<br><br>2.4. Në rastin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar kërkesa duhet t'u drejtohet të gjithë drejtorëve ose personave të tjerë të cilët kanë autoritetin për të paraqitur padinë, dhe në një Shoqëri Aksionare kërkesa duhet t'i drejtohet Bordit të drejtorëve. | who was a shareholder at the time of actions which are the subject of the lawsuit;<br><br>2.3. The plaintiff has previously submitted a written request to the Corporation to file the lawsuit, and such request was rejected by the Corporation, or the Corporation failed to respond within thirty (30) days;<br><br>2.4. In the case of a Limited Liability Company, a request shall be addressed to all directors and persons who have the authority to file such a lawsuit, and in a Joint Stock Company, the request shall be addressed to the Board of Directors. | radnje za koje se podnosi tužba;<br><br>2.3.Tužilac je prethodno napismeno tražio od korporacije da podnese tužbu i taj zahtev je korporacija odbila ili korporacija nije odgovorila u roku od trideset (30) dana.<br><br>2.4.U slučaju društva sa ograničenim odgovornostima zahtev treba podneti svim direktorima ili drugim licima koja imaju nadležnost za podnošenje tužbe, a u deoničarskom društvu zahtev treba podneti odboru direktora. |
| 3. Kompensimi i dëmit që mund të rezulton nga një padi derivative është pronë e Korporatës, kurse paditësit i cili ka paraqitur padinë i paguhen shpenzimet e tij të arsyeshme, duke përfshirë tarifat ligjore, nga kompensimi i paguara nga të paditurit. Shuma e shpenzimeve të tilla duhet të miratohet nga gjykata. | 3. The compensation for the damages that may result from a derivative lawsuit shall be the property of the Corporation, while the plaintiff filing the lawsuit shall be paid reasonable expenses, including legal fees, from the compensation paid by the defendants. The amount of such expenses shall be approved by the court. | 3. Obeštećenje štete koje može da proistekne iz derivativne tužbe je vlasništvo korporacije dok se tužiocu koji je podneo tužbu isplaćuju njegovi opravdani troškovi, uključujući zakonske tarife, iz odštete koju je isplatio tuženi. Iznos takvih troškova treba da odobri sud. |

| | | |
|---|---|---|
| **PJESA E NJËMBËDHJETË<br>DISPOZITAT KALIMTARE E PËRFUNDIMTARE** | **PART ELEVEN<br>TRANSITORY AND FINAL PROVISIONS** | **DEO JEDANAEST<br>PRELAZNE I KONAČNE ODREDBE** |
| **Neni 266<br>Dispozitat kalimtare** | **Article 266<br>Transitory Provisions** | **Član 266<br>Prelazne odredbe** |
| 1. Kërkesa për publikimin e Marrëveshjeve të Ortakërisë, Statuteve dhe Memorandumeve të Inkorporimit nga ARBK-ja në pajtim me nenin 22, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11 të këtij ligji hyn në fuqi brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. | 1. The requirement for publication of Partnership Agreements, Charters and Memorandums of Incorporation by the KBRA pursuant to Article 22, paragraph 1, sub-paragraph 1.11 of this Law shall enter into force within one (1) year after the entry into force of this law. | 1. Uslov za objavljivanje sporazuma o partnerstvu, osnivačkih akata i Memoranduma o inkorporaciji od strane KARP-a, u skladu sa članom 22. stav 1 tačka 1.11 ovog Zakona stupa na nagu u roku od jedne (1) godine od stupanja na snagu ovog zakona. |
| 2. Deri në miratimin e aktit nënligjor të përcaktuar në Nenin 17, paragrafi 12 të këtij ligji dhe formularëve të regjistrimit sipas Nenit 9 të këtij ligji, vazhdojnë të aplikohen kërkesat dhe formularët ekzistues sipas Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjit Nr. 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare. | 2. Until adoption of the sub-legal act as provided for by Article 17, paragraph 12 of the present law, and registration forms as per Article 9 of the present Law, existing requirements and forms as per Law no. 02/L-123 on Business Organizations and Law no. 04/L-006 amending the Law no. 02/L-123 on Business Organizations. | 2. Do donošenja podzakonskog akta određenog u članu 17. stav 12 ovog zakona i obrazaca za registraciju iz člana 9. ovog zakona, nastavljaju da se primenjuju postojeći uslovi i obrasci prema Zakonu br. 02/L-123 o poslovnim društvima i Zakonu br. 04/L-006 o izmenama i dopunama Zakona br. 02/L-123 o poslovnim društvima. |
| 3. Të gjitha Shoqëritë Tregtare aktualisht të regjistruara në ARBK si dhe Shoqëritë Tregtare që regjistrohen gjatë periudhës kalimtare të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni obligohen të zbatojnë kërkesat e këtij ligji brenda tre (3) vitesh miratimit të aktit nënligjor për procedurat e regjistrimit sipas Nenit 17, paragrafi 12 të këtij ligji. ARBK-ja, në bashkëpunim me organet | 3. All Business Organizations currently registered with the KBRA and Business Organizations registered in the transitional period as provided by paragraph 2 of the present Article shall be required to conform with the requirements of this law within three (3) years after the entry into force of the sub-legal act on registration procedures as per Article 17, paragraph 12 | 3. Sva poslovna društva koja su trenutno registrovana u KARP-u, kao i poslovna društva koja se registruju tokom prelaznog perioda utvrđenog u stavu 2 ovog članu, obavezuju se da ispune zahteve ovog zakona u roku od tri (3) godine od donošenja podzakonskog akta o postupku registracije prema članu 17. stav 12 ovog Zakona. KARP, u saradnji sa drugim |

| | | |
|---|---|---|
| tjera të administratës shtetërore, duhet të kontaktojnë të gjitha Shoqëritë Tregtare ekzistuese për të siguruar që të dhënat e shënuara në regjistër të jenë të përditësuara. Të gjitha Shoqëritë Tregtare ekzistuese do të jenë të obliguara të zbatojnë këtë kërkesë, ose në të kundërtën do të futen në një listë të Shoqërive Tregtare pasive pas skadimit të periudhës tre (3) vjeçare të përcaktuar në këtë nen. | of this law. KBRA in cooperation with other state administration bodies shall contact all existing Business Organizations to ensure the data included in the registry are updated. All existing Business Organizations shall be required to comply with this requirement or they shall be included in a passive list of Business Organizations after the expiration of the three (3) year period specified in this Article. | organime državne uprave, je dužan da stupi u kontaktsa svim postojećim poslovnim društvima kako bi se osiguralo da su podaci koji su uneti u registar ažurirani. Sva poslovna društva će biti dužna da ispune ovaj zahtev ili će u suprotnom biti uvrštena na listu pasivnih poslovnih društava nakon isteka perioda od tri (3) godine, utvrđenog ovim članom. |
| **Neni 267**<br>**Aktet nënligjore të zbatueshme deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore** | **Article 267**<br>**Sublegal acts applicable until the issuance of new sub-legal acts** | **Ćlan 267**<br>**Primenjivi Podzakonski Akti do izdavanje novih propisa** |
| Me kusht që mos të jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e duhur të këtij ligji, aktet nënligjore të zbatueshme do të vazhdojnë të mbesin në fuqi si në vijim:Udhezimi Administrativ Nr-03/2015 për Përcaktimin e Taksave për Shërbimet e Ofruara nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve. | Provided not to be in violation of this Law and until the issuance of new sub-legal acts for the proper implementation of this law, the following applicable sub-legal acts shall remain in force: Administratve Instruction (mti) no. 03/2015 on determinaton of fees for services provided by the businesss registration agency. | Pod uslovom da nisu u suprotnosti sa ovim Zakonom do donošenja novih podzakonskih akata za pravilno sprovođenje ovog Zakona, primenljivi podzakonski akti ostaju na snazi kao sledeće:Administrativno Uputstvo (mti) br. 03/ 2015 o određivanju taksi za usluge koje pruža agencija za registraciju preduzeća. |
| **Neni 268**<br>**Nxjerrja e akteve nën-ligjore** | **Article 268**<br>**Issuance of sub-law acts** | **Član 268**<br>**Izdavanje novih podzakonskih akata** |
| Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në dispozitën përkatëse më të cilën autorizohet nxjerrja e një akti nënligjor, Qeveria/Ministria do të nxjerrin aktet | Unless otherwise provided in relevant provisions authorizing issuance of secondary legislation, the Government / Ministry shall issue sub-law acts for the | Osim ako je drugačije propisano odgovarajućom odredbom kojom se ovlašćuje donošenje podzakonskog akta, Vlada/Ministarstvo će doneti podzakonske |

| | | |
|---|---|---|
| nënligjore të përcaktuara me këtë Ligj në afat kohor prej një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij Ligji. | implementation of this Law within one (1) year from the day of entry into force of this Law. | akte preopisane u ovom Zakonu u vremenskom roku od jedne (1) godine od dana tupanja na snagu ovog zakona. |
| **Neni 269**<br>**Shfuqizimi i ligjeve të mëhershme** | **Article 269**<br>**Repeal of prior legislation** | **Član 269**<br>**Stavljanje van snage prethodnih zakona** |
| Ky ligj shfuqizon Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin Nr. 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare. | This Law repeals Law no. 02/L-123 on Business Organizations and Law no. 04/L-006 amending the Law no. 02/L-123 on Business Organizations. | Ovim zakonom se stavlja van snage Zakon br. 02/L-123 o poslovnim društvima i Zakon br. 04/L-006 o izmenama i dopunama Zakona br. 02/L-123 o poslovnim društvima. |
| **Neni 270**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 270**<br>**Entry into force** | **Član 270**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky ligj hyn në fuqi ne ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. | This Law shall enter into force on the date of its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo. | Ovaj zakon stupa na snagu na dan objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo. |
| **Kadri VESELI** | **Kadri VESELI** | **Kadri VESELI** |
| Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës | President of the Assembly of the Republic of Kosovo | Predsednik Skupštine Republike Kosova |